

Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike Kushtet e Përgjithshme

PËRMBAJTJA

A. Hyrja dhe Interpretimi	7
A.1 Hyrja dhe objektivat e rregullave	7
A.1.1 Hyrja	7
A.1.2 Objektivi dhe Parimet	8
A.1.3 Efekti i këtij Seksioni	9
A.1.4 Procedurat e ALPEX-it	9
A.2 INTERPRETIMI	9
A.2.1 Interpretimi i përgjithshëm	9
A.2.2 Gjuha zyrtare, njoftimet	10
B. Aspekte Ligjore dhe të Qeverisjes	11
B.1 Qëllimi i këtij Kapitulli	11
B.1.1 Parashikime të përgjithshme	11
B.2 TRUPA ORGANIZATIVE e tregut dhe rolet E TYRE	11
B.2.1 Operimi i ALPEX-it	11
B.2.2 Roli i Komitetit të Bursës	12
B.2.3 Përbërja e Komitetit të Bursës	13
B.2.4 Kryesuesi i Komitetit të Bursës	13
B.2.5 Mbledhjet e Komitetit të Bursës	13
B.2.6 Kostot e Komitetit të Bursës	14
B.2.7 Konfidencialiteti i Komitetit të Bursës	14
B.2.8 Monitorimi i Tregut, Mbikëqyrja dhe Raportimi si qëllim i ALPEX-it	14
B.2.9 Anëtarët e Bursës	15
B.2.10 ALPEX-i në rolin e tij si Kundërpalë Qendrore	15
B.3 Kuadri Ligjor	16
B.3.1 Instrumentet që rregullojnë sjelljen dhe pjesëmarrjen në Bursë	16
B.3.2 Marrëveshja e Anëtarësimit me Bursën	16
B.3.3 Procedurat	16
B.3.4 Publikimi i Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave	17
B.3.5 Ligji dhe juridiksioni qeverisës i ALPEX-it	17
B.3.6 Afati	18
B.3.7 Përparësia	18
B.4 Detyrimet e Palëve	18
B.4.1 Pajtueshmëria me instrumentet	18
B.4.2 Mos diskriminimi	20
B.4.3 Kompetencat dhe detyrimet në rast emergjence	20
B.4.4 Kërkesat rregullative	20
B.4.5 Tarifat e ALPEX-it	21
B.4.6 Detyrimet në lidhje me konfidencialitetin	21
C. Pranimi në Bursë	22
C.1 Kërkesat për anëtarësim	22
C.1.1 Kriteret e pranimit për t'u anëtarësuar në Bursë	22

C.1.2	Informacioni i kërkuar për Pranim	22
C.1.3	Pranimi	24
C.1.4	Tarifa Fikse e Anëtarësimit	25
C.1.5	Të përgjithshme	25
C.2	Mospërmbushja e Detyrimeve, Pezullimi dhe Përfundimi i Anëtarësimit	26
C.2.1	Qëllimi i këtij seksioni	26
C.2.2	Mospërmbushja e Detyrimeve	26
C.2.3	Dorëheqja e Anëtarit të Bursës	26
C.2.4	Ndalimi i Tregtimit	27
C.2.5	Pezullimi i anëtarësimit	28
C.2.6	Pasojat e Ndalimit të Tregtimit dhe Pezullimit	30
C.2.7	Përfundimi i Anëtarësimit	30
C.2.8	Pasojat e Dorëheqjes ose Përfundimi	31
C.2.9	Të përgjithshme	32
C.3	Njoftimet	32
C.3.1	Aplikimi	Error! Bookmark not defined.
C.3.2	Njoftimi i Palëve të tjera	33
D.	Sjellja, Monitorimi dhe Mbikëqyrja e Tregut	33
D.1	Qëllimi i këtij Kapitulli	33
D.1.1	Të përgjithshme	33
D.1.2	Parimet	34
D.1.3	Angazhimi për transparencë	35
D.1.4	Sjellja publike e Anëtarëve të Bursës	36
D.1.5	Raportimi i menjëhershëm shkeljeve të dyshuara	36
D.2	Kërkesat organizative të Anëtarëve të Bursës	36
D.2.1	Aftësitë e Anëtarëve të Bursës	36
D.3	Monitorimi dhe Mbikëqyrja e Tregut	37
D.3.1	Kompetencat për Monitorim dhe Mbikëqyrje	37
D.3.2	Papajtueshmëria	38
D.3.3	Ndarja e Informacionit me Autoritetet Përkatëse	39
D.3.4	Detyrimet e Anëtarëve të Bursës	39
D.4	Pasojat e shkeljes së dispozitave të sjelljes	39
D.4.1	Shkeljet e trajtuara sipas Kapitullit C	39
E.	Kontratat, Produktet dhe Segmentet e Tregut	40
E.1	Qëllimi i këtij Kapitulli	40
E.1.1	Qëllimi	40
E.2	Konceptet	40
E.2.1	Produktet dhe Llojet i Urdhërporosive	40
E.2.2	Shtimi dhe heqja e Produkteve dhe Llojet e Urdhërporosive	40
E.2.3	Urdhërporositë dhe dërgimi i informacionit në Interkonektor	41
E.2.4	Kontratat	42
E.2.5	Zonë Ofertimi	42
E.2.6	Segmentet e Tregut	43
F.	Tregtimi	45
F.1	Qëllimi i këtij Kapitulli	45

F.1.1	Të përgjithshme	45	
F.2	Parimet për tregtim	45	
F.2.1	Sistemi i Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)	45	
F.2.2	Si realizohen Transaksionet dhe Tregtimi	46	
F.2.3	Përdoruesit e autorizuar	46	
F.2.4	Kontrolli i përdoruesit	47	
F.2.5	Libri i Urdhërporosisë	47	
F.2.6	E drejta për të refuzuar Urdhërporositë	47	
F.2.7	Proceset e Përputhjes dhe pas Përputhjes	47	
F.2.8	Publikimi i të dhënave	48	
F.2.9	Njoftimi mbi informacionin e tregtimit tek EMCS-ja	48	
F.2.10	Monedha	49	
F.3	RasTET PërjashtIMORE nga tregtimi i zakonshëm, KLERIMI dhe SHLYERJa	49	
F.3.1	Të përgjithshme	49	
F.3.2	Pezullimi i Tregtimit të një Produkti dhe Urdhërporosie	50	
F.4	Kërkesat NDAJ anëtarëve Të Bursës dhe kushtet për tregtim	51	
F.4.1	Anëtarësimi aktiv	51	
F.4.2	Kërkesat teknike	51	
F.4.3	Agjentet Tregtarë të Certifikuar	52	
F.4.4	Portofolat e Tregtimit	53	
F.4.5	Përfaqësimet nga Anëtari	53	
F.4.6	Përfaqësimet nga ALPEX-i	54	
G.	ÇështjeT kontraktuale	56	
G.1	marrëveshja e anëtarësimiT Në bursë	56	
G.1.1	Rregullat e zbatuara përmes Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë	56	
G.2	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	56	
G.2.1	Llojet e Mosmarrëveshjeve dhe Kalendari i Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes	56	
G.2.2	Njoftim i Mosmarrëveshjeve dhe negociatat në mirëbesim	57	
G.2.3	Objektivat e Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve	57	
G.2.4	Veprimet e Autoritetit Rregullator	58	
G.3	Kufizimi i përgjegjësisë	58	
G.3.1	Kufizimet në përgjegjësi	58	
G.3.2	Dëmshpërblimi nga Anëtari i Bursës	60	
G.3.3	Të drejtat e Pronësisë për Informacionin e Transaksionit	61	
G.3.4	Publikimi	61	
G.4	Forca Madhore	61	
G.4.1	Përkufizimi	61	
G.4.2	Kërkesat dhe Pasojat	61	
G.5	Çështje të Përgjithshme	62	
G.5.1	Heqja Dorë	62	
G.5.2	Pavlefshmëria e Pjesshme (Severance)	63	
G.5.3	Caktimi, transferimi ose rinovimi	63	
H.	Siguria, përdorimi i të dhënave, konfidencialiteti	64	
H.1	Qëllimi i këtij kapitulli	64	
H.1.1	Dispozita të Përgjithshme	64	

H.2	Siguria	64
H.2.1	Konceptet	64
H.2.2	Detyrimet mbi Anëtarët e Bursës	64
H.2.3	Përgjegjësia	65
H.3	Pronësia intelektuale dhe licencat	66
H.3.1	Autorizimet e Anëtarëve të Bursës dhe të drejtat e tjera	66
H.3.2	Kufizimet e të drejtave që u jepen Anëtarëve të Bursës	66
H.3.3	Anëtari i Bursës të respektojë të Drejtat e Pronësisë Intelektuale	66
H.4	Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave	67
H.4.1	Kategoritë e të dhënave	67
H.4.2	Pronësia dhe përdorimi i të dhënave	67
H.4.3	Kërkesat e Raportimit	69
H.4.4	Mbledhja e të dhënave për Rregulloren REMIT	70
H.5	Konfidencialiteti	70
H.5.1	Përkufizimet	70
H.5.2	Mbrojtja e të dhënave	72

I. Çështje teknike 73

I.1	Qëllimi i këtij kapitulli	73
I.1.1	Kërkesa teknike të nivelit të lartë	73
I.1.2	Transmetimi elektronik i Urdhërporosive	73
I.2	Kërkesat për qasje teknike	73
I.2.1	Rregullimet e aksesit siç specifikohet nga ALPEX-i	73
I.2.2	Pajtueshmëria me kërkesat teknike	73
I.2.3	Testim	73
I.2.4	E drejta për inspektim	74
I.2.5	Vendndodhja e sistemeve <i>front-end</i>	74
I.2.6	Sistemet e drejtimit të Urdhërporosive	74
I.2.7	Keqfunksionimet teknike	74
I.2.8	Hapat për të bërë të mundur Tregtimin	74
I.2.9	Pasojat e shkeljeve teknike	75

J. Ndryshimet e Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave 76

J.1	Dispozita të Përgjithshme	76
J.1.1	Kompetenca e ALPEX-it për të ndryshuar Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat	76
J.1.2	Njoftimi, publikimi dhe koha e Ndryshimeve	76
J.1.3	Procedurat e Ndryshimeve	76
J.2	Ndryshimi i Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave	76
J.2.1	Kush mund të propozojë ndryshime	76
J.2.2	ALPEX-i duhet të marrë parasysh Propozimet për Ndryshime	77
J.2.3	Konsultimet me Komitetin e Bursës	77
J.3	Vendimet e ALPEX-it	77
J.3.1	Opsionet e mundshme për ALPEX-in	77
J.3.2	Arsyet e vendimit	77
J.4	Parakushtet për Ndryshimin e Rregullave apo Procedurave	77
J.4.1	Miratimi i Autoritetit Rregullator	77
J.4.2	Parakushte të tjera	78

J.5	NDRYSHIMETE E RREGULLOREVE	78
J.5.1	Të Përgjithshme	78
J.6	ÇËSHTJE TË TJERA	79
J.6.1	Pronësia Intelektuale e lidhur me propozimet për Ndryshim	79
K.	Marrëveshjet e përkohshme	80
K.1	Hyrje	80
K.1.1	Qëllimi	80
K.1.2	Kapitulli K ka Përparësi	80
K.1.3	Fillimi i Tregtimit	80
K.1.4	Kushtet Fillestare të Anëtarëve të Komitetit të Bursës	80
K.2	Ndryshimet në Rregulla dhe Procedura përpara sE të futen në zbatim	80
K.2.1	Rrethanat që mund të kërkojnë ndryshime	80
K.2.2	Ndryshimet mund të bëhen pas konsultimeve	80
K.2.3	Dispozita kalimtare dhe përfundimtare	81

HYRJA DHE INTERPRETIMI

A.1 HYRJA DHE OBJEKTIVAT E RREGULLAVE

A.1.1 Hyrja

A.1.1.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (në vijim referuar si ALPEX) është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e Tregjeve të organizuara të Energjisë Elektrike në Shqipëri, e licencuar nga ERE në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës sh.a (në vijim referuar si KOSTT) ka Licencën përkatëse të Operatorit të Tregut për operimin dhe organizimin e Tregjeve të organizuara të Energjisë Elektrike në Kosovë. KOSTT-i me Licencën e Operatorit të Tregut ka transferuar ALPEX-it (nëpërmjet ALPEX sh.a – Dega në Kosovë) të drejtat dhe detyrimet për operimin dhe organizimin e Tregjeve të organizuara të Energjisë Elektrike në Kosovë sipas vendimit të ZRrE dhe marrëveshjes midis KOSTT-it dhe ALPEX-it e nënshkruar në 16.12.2022. Përcaktimi i ALPEX-it si (NEMO) për operimin e Tregjeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë për Shqipërinë dhe Kosovën është subjekt i aprovimeve prej Autoriteteve Rregullatore përkatëse.

A.1.1.2 Në bazë të dispozitave të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar, ALPEX-i është përgjegjës për:

(a) përgatitjen dhe paraqitjen për miratim tek Autoritetet Rregullatore përkatëse të **Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike**, duke përcaktuar kushtet në të cilat do të kryejë aktivitetet përkatëse të Bursës dhe NEMO-s, në përputhje me kërkesat e:

i. Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar të aprovuara nga Autoritetet Rregullatore përkatëse në lidhje me operimin e Tregjeve Ex-Ante; dhe

ii. Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes (*Clearing and Settlements*); dhe

(b) të sigurojë që ata të cilët marrin ose dëshirojnë të marrin shërbimet në Bursë dhe në NEMO nga ALPEX-i, për aq kohë sa është praktikisht e arsyeshme, si një pikë të vetme kontakti me anë të së cilës ndërveprojnë me ALPEX-in në lidhje me këto shërbime.

(c) Të përgatisë dhe të paraqesë tek Autoritetet Rregullatore përkatëse, për njoftim, Vendimet Teknike përkatëse në lidhje me Rregullat e ALPEX-it.

A.1.1.3 ALPEX i referohet rolit për të ndërmarrë aktivitetet e Bursës së energjisë dhe NEMO-s për tregjet e Shqipërisë dhe Kosovës dhe referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për;

(a) të drejtat dhe detyrimet e tij që rrjedhin nga Licenca përkatëse në veprimtarinë Operimit të Tregut të energjisë elektrike e Shqipërisë, dhe

- (b) të drejtat dhe detyrimet e tij që rrjedhin nga cedimi përkatës prej KOSTT-it për operimin e Tregjeve të organizuara të Energjisë Elektrike të Tregut të Kosovës.
- A.1.1.4 Këto Rregulla të ALPEX-it përcaktojnë detajet specifike në të cilat ALPEX-i, si Operator Tregu, duhet të kryejë detyrat e tij dhe sipas të cilave Anëtarët e Bursës duhet të tregojnë në Bursë.
- A.1.1.5 Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike nuk do të mbulojnë të gjitha detyrat për të cilat ALPEX-i, si NEMO, është përgjegjës sipas Nenit 5 të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.
- A.1.1.6 Tregu i Energjisë Elektrike përfshin aktivitete tregtare të veçanta, por ndërvepruese, të cilat përfshijnë:
- (a) Tregun e Alokimit të Kapaciteteve në përputhje me Procedurën e Alokimit të Kapaciteteve në Zyrën e Koordinuar të Ankandeve të Evropës Juglindore (SEE CAO).
 - (b) Tregjet të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë, të parashikuara në Rregullat e Tregut të energjisë elektrike, Procedurat dhe rregullave të tjera efektive, nëse ka, që operojnë në Tregun e Energjisë Elektrike; dhe
 - (c) Tregun e Balancimit të energjisë elektrike në përputhje me rregullat ose procedurat përkatëse.

A.1.2 **Objektivat e Rregullave**

- A.1.2.1 Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike janë përgatitur për të lehtësuar arritjen e Objektivave të ALPEX-it që mbështeten nga parimet e mëposhtme dhe prej ku ALPEX-i do të duhet:
- (a) të mundësojë përputhshmërinë me kërkesat rregullatore të Shqipërisë dhe Kosovës.
 - (b) të promovojë rezultatet konkurruese nëpërmjet ofrimit të shërbimeve efikase dhe efektive të Bursës.
 - (c) t'iu ofrojë Anëtarëve të Bursës mundësi për t'u konsultuar mbi ndryshimet e Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave.
 - (d) të promovojë sigurinë, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave.
 - (e) të sigurojë të gjitha sistemet dhe ndërveprimet e nevojshme për funksionimin e Tregjeve të ALPEX-it.
 - (f) të realizojë ankandet dhe operacionet e nevojshme tregtare, në përputhje me rregullat e miratuara, duke përdorur për këtë qëllim algoritmet e tregut të bashkuar Evropian.
 - (g) të respektojë kërkesat për transparencë, mosdiskriminim, besueshmëri si dhe të ushtrojë kompetencat për monitorimin e tregut të energjisë elektrike.

A.1.3 **Qëllimi i këtij Seksioni**

A.1.3.1 Seksioni A.1 është vetëm informues dhe pa paragjykuar të drejtat, detyrat dhe detyrimet e përcaktuara në Licencën dhe legjislacionin e referuar në këto Rregulla, nuk ka për qëllim në vetvete të krijojë detyrime ligjore ndërmjet palëve ose të vendosë të drejta dhe detyra për ALPEX-in dhe palët në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë.

A.1.4 **Procedurat e ALPEX-it**

A.1.4.1 Seksioni B.3.3 i Rregullave të ALPEX-it prezanton Procedurat që janë të detyrueshme për ALPEX-in dhe Anëtarët e Bursës.

A.2 INTERPRETIMI

A.2.1 **Interpretimi i përgjithshëm**

A.2.1.1 Në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike, do të zbatohen interpretimet e mëposhtme, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:

- (a) fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas dhe gjinia mashkullore përfshin gjininë femërore dhe asnjënjësore.
- (b) çdo referencë ndaj çdo legjislacioni, primar ose sekondar, në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike përfshin çdo interpretim, ndryshim, modifikim, zëvendësim ose konsolidim ligjor të çdo akti ligjor, nënligjor dhe çfarëdo akti të miratuar në bazë të tyre.
- (c) çdo referencë ndaj pjesëve, kapitujve, seksioneve, paragrafëve, shtojcave janë referenca ndaj pjesëve, kapitujve, seksioneve, paragrafëve, shtojcave të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të ndryshuara ose modifikuara herë pas here në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- (d) Referencat e bëra lidhur me kohën i referohen Kohës Qëndrore Evropiane (CET).
- (e) fjalët , frazat, akronimet dhe shkurtime me shkronjë të madhe kanë kuptimin e dhënë në **Përkufizimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike** ose siç përcaktohet në mënyrë specifike në përmbajtjen e këtyre Rregullave.
- (f) referencat ndaj një Entiteti përfshin gjithashtu edhe palët e treta të lidhura me të, sic janë organet drejtuese të tij, ose çdo subjekt tjetër juridike.
- (g) çdo referencë e një Dite të caktuar duhet të interpretohet si referencë për një ditë kalendarike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.
- (h) termi “përfshijnë” dhe të gjitha variacionet e tij do të thotë “përfshin, por pa u kufizuar në”.
- (i) çdo referencë që i bëhet ALPEX-it për të pasur të drejtën për të marrë një vendim ose për ta përfunduar ose për të formuar një opinion ose gjykim, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, nënkupton që ALPEX-i ka të drejtë të ushtrojë lirinë e tij të plotë dhe të pakufizuar për ta bërë këtë.

- (j) Titujt e kapitujve, seksioneve, paragrafëve, në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrikejanë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e tyre.
- (k) Në rastet kur Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrikedo të kërkojnë që të dhënat të publikohen nga ALPEX-i, ato do të vihen në dispozicion të publikut në një format lehtësisht të përpunueshëm, nëpërmjet një ndërfaqe publike lehtësisht të aksesueshme.
- (l) Në rastet kur në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrikenuk specifikohet një afat kohor për publikimin e informacionit, ALPEX-it i kërkohet të publikojë këtë informacion sa më shpejt që të jetë e mundur.
- (m) Referencat ndaj komunikimeve me shkrim, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, përfshijnë postën elektronike (*e-mail*),komunikimet nëpërmjet Sistemit Elektronik të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) ose nëpërmjet çdo Mjeti tjetër Elektronik të percaktuar nga ALPEX-i.
- (n) çdo referencë e bërë ndaj “**ndryshimit**” duhet të interpretohet se përfshin ndryshimin, korrigjimin, zëvendësimin, plotësimin dhe “**ndryshimet**” do të interpretohet siç duhet.
- (o) për çdo term i cili do të jetë objekt diskutimi midis palëve, për shkak të përshtatjes gjatë shqipërimit të terminologjisë së përdorur, do të merret si referencë kuptimi i tij në gjuhën angleze.

A.2.2 Gjuha zyrtare, njoftimet

- A.2.2.1 Gjuha zyrtare e dokumentacionit dhe komunikimit me shkrim e ALPEX-it është gjuha shqipe. Gjuha angleze mund të përdoret si një përkthim jozyrtar nga gjuha shqipe, por në rast të mospërputhjeve midis versionit të gjuhës shqipe dhe asaj angleze, versioni i gjuhës shqipe do të mbizotërojë.
- A.2.2.2 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, njoftimet nga ALPEX-i do të transmetohen në mënyrë elektronike, nëpërmjet Mjetit Elektronik të percaktuar nga ALPEX.
- A.2.2.3 Sapo informacioni do të bëhet i disponueshëm nga ALPEX-i për Anëtarin e Bursës ose Anëtarin e mundshëm të Bursës, do ta vendosë atë në dispozicion dhe në mënyrë elektronike.

B. . ASPEKTE LIGJORE DHE TË QEVERISJES

B.1 QËLLIMI I KËTIJ KAPITULLI

B.1.1 Parashikime të përgjithshme

B.1.1.1 Ky Kapitull përcakton dispozitat në lidhje me funksionimin dhe administrimin e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike..

B.2 TRUPA ORGANIZATIVE E TREGUT DHE ROLI I SAJ

B.2.1 Operimi i ALPEX-it

B.2.1.1 ALPEX-i ofron platformën për tregtimin e energjisë elektrike në Tregun e Ditës në Avancë dhe në Tregun brenda së Njëjtës Ditë në afatet kohore për livrimin e energjisë elektrike në Zonat e Ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës përmes një platforme elektronike.

B.2.1.2 ALPEX-i është i autorizuar nga të gjitha Palët për të ushtruar dhe kryer të drejtat, detyrimet dhe funksionet që i janë dhënë sipas këtyre Rregullave në masën dhe në përputhje me sa kërkohet nga këto Rregulla.

B.2.1.3 Një referencë për “ALPEX-in” është referencë si për ALPEX sh.a në Shqipëri ashtu edhe për ALPEX sh.a- Dega në Kosovë.

B.2.1.4 ALPEX-i ka funksionet e mëposhtme:

- (a) të kryejë përgjegjësitë e saj lidhur me Operimin e Tregut në Shqipëri dhe Kosovë, siç specifikuar në Rregullat dhe Modelet e Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri dhe Kosovë.
- (b) të kryejë detyrat e NEMO-s në lehtësimin e Tregut të Ditës në Avancë dhe të Tregut brenda së Njëjtës Ditë siç përcaktohet në Rregulloren e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.
- (c) të sigurojë funksionimin dhe operimin e duhur të platformës së tregtimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë; dhe
- (d) të themelojë dhe të sigurohet për funksionimin e trupës organizative të tregut dhe funksioneve të përcaktuara në seksionet B.2.2 dhe B.2.8,

në përputhje me dispozitat e këtyre rregullave, subjekt i të cilave është ALPEX.

B.2.1.5 Për të kryer funksionet e përcaktuara në paragrafin B.2.1.4, ALPEX-i do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- (a) të shqyrtojë aplikimet për anëtarësim në Bursë në përputhje me seksionin C.1:
- (b) të lidhë marrëveshje për pranimin e Anëtarëve të Bursës, siç parashikuar në seksionin C.1;

- (c) të hartojë dhe të paraqesë për miratim pranë Autoriteteve Rregullatore përkatëse, kërkesat dhe procedurat e detajuara të tregtimit dhe Komitetin e Bursës, dhe t'i publikojë ato sipas procedurës të përcaktuar në seksionin B.3.4;
- (d) të kryejë ankandet dhe operacionet e nevojshme tregtare, në përputhje me këto rregulla duke përdorur për këtë qëllim Algoritmin e Bashkimit të Tregut Evropian.
- (e) të ekzekutojë garancitë dhe kryejë pagesat për Anëtarët e Bursës dhe/ose Anëtarët e Klerimit përkatës, në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara në këto rregulla.
- (f) të publikojë volumet e energjisë elektrike të alokuara dhe çmimet përkatëse, sipas afateve të përcaktuara në këto Rregulla.
- (g) të konsultohet me Anëtarët e Bursës mbi propozimet për ndryshimet e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me Kapitullin J.
- (h) të regjistrojë të gjitha Transaksionet në tregjet e ALPEX-it, të cilat do të jenë automatikisht të detyrueshme për t'u shlyer financiarisht.
- (i) të regjistrojë të gjitha Transaksionet në tregjet e ALPEX-it, të cilat do të jenë automatikisht të detyrueshme për t'u kleruar, ku Anëtari i Klerimit do të bëhet Kundërpalë për ALPEX-in që vepron si Kundërpala Qendrore në të gjitha Transaksionet siç përcaktohet në Procedurën e Klerimit dhe të Shlyerjes.
- (j) të lehtësojë Livrimin fizik të tregtimit të kontratave të brendshme afatgjatë dypalëshe (OTC) të cilat mund të bazohen në një kontratë financiare ose fizike, ku energjia elektrike fizike do të tregtohet nëpërmjet Bursës. Për këto tregtime çmimi referencë për kontratën financiare do të jetë Çmimi Klerues (për çdo Njësi Kohore të Tregut në respekt të Ditës së Livrimit) të Tregut të Ditës në Avancë të ALPEX-it. Blerësi do të jetë një Pranues Çmimi ndërsa Shitësi do të ofertojë si një Ndikues në Çmim; dhe
- (k) do të marr vendimet e nevojshme për operimin me integritet dhe të rregullt të Bursës, që përfshin:
 - (i) Monitorimin e përputhshmërisë të Anëtarëve të Bursës me këto Rregullat e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me Kapitullin D.
 - (ii) Monitorimin dhe mbikëqyrjen e sjelljes dhe aktiviteteve të Anëtarëve të Bursës siç përcaktohet në Kapitullin D; dhe
 - (iii) Kryerjen e auditimeve dhe inspektimeve siç përshkruhet/parashikohet në këto rregulla.

B.2.2 Roli i Komitetit të Bursës

B.2.2.1 Komiteti i Bursës është një organ konsultativ i zgjedhur nga Anëtarët e Bursës, në përputhje me Procedurën e Komitetit të Bursës. Roli i tij është promovimi i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, që ato të mbeten aktuale dhe të përditësuara me kalimin e kohës, nëpërmjet konsultimit dhe këshillimit me ALPEX-in për ndryshimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

B.2.2.2 Komiteti i Bursës ka funksionet e mëposhtme:

- (a) të konsultohet nga ALPEX për propozimet për ndryshimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrikesi dhe të shprehë mendimin e tij dhe të sugjerojë modifikime në lidhje me këto propozime brenda afatit të përcaktuar nga ALPEX-i, përpara se ato të pranohen ose refuzohen nga ALPEX-i kur ose t'i dorëzohen Autoriteteve Rregullatore për miratim, kur ajo kërkohet.
- (b) të konsiderojë propozimet për ndryshim të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike nga çdo Anëtar Burse të paraqitura në përputhje me seksionin J.2 dhe aty ku Komiteti i Bursës e konsideron të përshtatshme, të hartojë rekomandime për tu konsideruar nga ALPEX brenda afatit të përcaktuar nga ALPEX-i.
- (c) të shprehë mendime dhe t'i japë rekomandime ALPEX-it në lidhje me prezantimet e reja të ETSS-së ose për ndryshimet në ETSS-në ekzistuese që mund të ndikojnë materialisht në ndërlidhjet me Anëtarët e Bursës.
- (d) të shprehë mendime dhe ti japë rekomandimet ALPEX-it në lidhje me prezantimin e Produkteve të reja ose Segmenteve të rinj të Tregut ose në lidhje me Bashkimin e Tregjeve brenda afatit të përcaktuar nga ALPEX-i.

B.2.2.3 Rekomandimet, propozimet dhe këshillimet e tjera të Komitetit të Bursës nuk janë të detyrueshme për tu pranuar nga ALPEX-i. Nëse ALPEX-i vendos të mos pranojë një rekomandim ose një këshillë të Komitetit të Bursës, ALPEX-i do të jap shpjegim me shkrim Komitetit të Bursës për arsyet e mospranimit të tij.

B.2.3 Përbërja e Komitetit të Bursës

B.2.3.1 Përbërja e Komitetit të Bursës duhet të pasqyrojë llojshmërinë e Anëtarëve të Bursës, sipas tipit të licencave që anëtarë e Bursës zotërojnë.

B.2.3.2 Komiteti i Bursës do të përbëhet nga jo më shumë se 10 (dhjetë) anëtarë, ku 8 (tetë) anëtarë janë të zgjedhur nga Anëtarët e Bursës dhe dy anëtarë janë të emëruar nga ALPEX-i, ku njëri prej të cilëve do të jetë kryetari i Komitetit.

B.2.3.3 Për aq kohë sa Kushtet e Licencimit si NEMO mbeten në fuqi, çdo Autoritet Rregullator mund të emërojë një vëzhgues i cili ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Bursës.

B.2.3.4 Anëtarët e Komitetit të Bursës do të mandatohen për një periudhë dyvjeçare,.

B.2.4 Kryetari i Komitetit të Bursës

B.2.4.1 ALPEX -i emëron kryetarin dhe zëvendës kryetarin e Komitetit të Bursës.

B.2.4.2 Mandati i emërimit për kryetarin dhe zëvendës kryetarin do të jetë dyvjeçar.

B.2.4.3 Kryetari do të drejtojë punimet e Komitetit të Bursës, ose, nëse ai ose ajo nuk është në gjendje ta bëjë këtë, ato do t'i drejtojë zëvendës kryetari.

B.2.5 Mbledhjet e Komitetit të Bursës

B.2.5.1 Komiteti i Bursës do të mbledhet sipas çështjeve konkrete nëse konsiderohet e përshtatshme nga Anëtarët e Komitetit të Bursës ose ALPEX-i.

- B.2.5.2 Komiteti i Bursës ose ALPEX-i do të caktojë datën e çdo mbledhje dhe ALPEX-i do të publikojë paraprakisht datën e çdo mbledhje, të paktën katërbëdhjetë (14) ditë përpara zhvillimit të saj, përveçse kur parashikuar ndryshe në këto rregulla.
- B.2.5.3 ALPEX-i ose një kuorum prej tre (3) anëtarësh të Komitetit të Bursës mund të caktojnë mbledhje shtesë të Komitetit të Bursës duke njoftuar në mënyrë elektronike të gjithë Anëtarët e Komitetit të Bursës, njoftim i cili ju dërgohet në adresat e kontaktit të autorizuara të anëtarëve:
- (a) duke njoftuar të paktën katërbëdhjetë (14) ditë para; ose
 - (b) me një periudhë njoftimi më të shkurtër siç mund të kenë rënë dakord me shkrim nga ALPEX-i dhe të paktën pesë (5) anëtarë të Komitetit të Bursës.
- B.2.5.4 Një person mund të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Bursës si vëzhgues, pasi të ketë informuar paraprakisht kryetarin e komitetit, i cili nga ana e tij duhet të ketë konfirmuar se pjesëmarrja e personit në fjalë është në përputhje me çdo procedurë në fuqi. Aty ku hapësira është e kufizuar dhe me pëlqimin e kryetarit të Komitetit të Bursës, pjesëmarrja e atyre që nuk janë anëtarë mund të kufizohet në bazë të parimit “i pari në kohë, i pari në shërbime” (*first come, first served*).

B.2.6 **Kostot e Komitetit të Bursës**

- B.2.6.1 Anëtarët e Komitetit të Bursës nuk kanë të drejtë shpërblimi ose rimbursimi të shpenzimeve.
- B.2.6.2 ALPEX-i do të ofrojë mbështetje administrative për Komitetin e Bursës.

B.2.7 **Konfidencialiteti i Komitetit të Bursës**

- B.2.7.1 Anëtarët e Komitetit të Bursës duhet të ruajnë rreptësisht konfidencialitetin e të gjithë informacionit konfidencial që marrin gjatë kryerjes së detyrave të tyre si anëtarë të Komitetit të Bursës, përjashtuar rastit kur informacioni të jetë bërë i disponueshëm publikisht ose paraqitja e tij kërkohet me ligj.

B.2.8 **Monitorimi i Tregut, Mbikëqyrja dhe Raportimi si qëllim i ALPEX-it**

- B.2.8.1 ALPEX-i do të kryejë monitorimin e tregut, mbikëqyrjen dhe raportimin në lidhje me Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë:
- (a) sipas kërkesave të Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT) dhe Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar;
 - (b) në përputhje me çdo marrëveshje të rënë dakord ndërmjet ALPEX-it dhe Autoriteteve Rregullatore me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT); dhe
 - (c) siç përcaktohet në Kapitullin D të këtyre Rregullave.

B.2.8.2 Anëtarët e Bursës do të bashkëpunojnë me ALPEX-in në kryerjen e funksioneve të tij sipas këtij seksioni B.2.8 dhe Kapitullit D.

B.2.8.3 ALPEX-i nuk është i autorizuar të vendosë sanksione, të ndërmarrë veprime detyruese ose të pranojë një marrëveshje në vend të vendosjes së një sanksioni ose marrjes së masave detyruese përveç rasteve kur kjo është parashikuar në këto Rregulla.

B.2.9 **Anëtarët e Bursës**

B.2.9.1 Anëtar i Bursës është një person juridik, i cili pranohet nga ALPEX për të qënë i tillë, pasi përmbush kriteret për anëtarësim, në përputhje me Kapitullin C të këtyre rregullave.

B.2.9.2 ALPEX-i nuk mund të refuzojë të nënshkruajë një Marrëveshje Anëtarësimi me Bursën me një Aplikant, i cili plotëson kërkesat e përcaktuara në Kapitullin C dhe kur të gjitha kërkesat e aplikueshme në Procedurat e këtyre rregullave janë përmbushur.

B.2.9.3 Çdo Anëtar i Bursës merr përsipër të veprojë me mirëbesim, ndershmëri, transparencë, në mënyrë profesionale dhe me përgjegjësi, në përputhje me praktikat më të mira të biznesit. Çdo Anëtar i Bursës merr përsipër gjithashtu, që në çdo kohë, të ruajë funksionimin pa probleme dhe integritetin e Tregut të Ditës në Avancë dhe të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë, siç përshkruhet në këto rregulla. Anëtarët e Bursës duhet të zbatojnë rregullat për të mbështetur ALPEX-in në operimin e një tregu të drejtë dhe mirë funksional.

B.2.10 **ALPEX-i në rolin e tij si Kundërpalë Qendrore**

B.2.10.1 ALPEX-i është përgjegjës për Klerimin dhe Shlyerjen e Transaksioneve të kryera në Tregjet e ALPEX-it në rolin e Kundërpalës Qendrore.

B.2.10.2 ALPEX do të kryejë rolin si Kundërpalë Qendrore me Anëtarët e Klerimit që janë përgjegjës për Klerimin e transaksioneve përkatëse të kryera në Tregjet e ALPEX-it përmes një marrëveshje me ALPEX-in dhe në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

B.2.10.3 Në të gjitha Segmentet e Tregjeve të ALPEX-it, ALPEX zbaton Kushtet e Klerimit nëpërmjet një marrëveshjeje të lidhur me:

(a) një Anëtar Burse që zgjedh të jetë Anëtar Personal i Klerimit; ose

(b) një Anëtar i Përgjithshëm Klerimi, i cili ka të drejtë të klerojë Transaksionet e kryera nga Anëtarët e Bursës të kontraktuar prej tij dhe të aprovuara nga ALPEX-i për të marrë pjesë në Klerim.

B.2.10.4 Anëtarët e Klerimit të ALPEX-it, si kusht për anëtarësimin e tij në Bursë dhe gjatë gjithë kohës që është Anëtar i Klerimit, do të zbatojnë të gjitha Kushtet për Klerim, kushte të tilla që do të bëjnë të mundur pjesëmarrjen në shlyerjen e rregullt të Kontratave sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

B.2.10.5 Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes, do të aplikohet për të gjitha Transaksionet dhe Mosmarrëveshjet ndërmjet ALPEX-it, Anëtarëve të Klerimit dhe Anëtarëve të Bursës.

B.3 KUADRI LIGJOR

B.3.1 Instrumentet që rregullojnë sjelljen dhe pjesëmarrjen në Bursë

B.3.1.1 Instrumentet e mëposhtme rregullojnë sjelljen, pjesëmarrjen dhe organizimin e Bursës:

- (a) Marrëveshja e Anëtarësimit me Bursën (përshkruar në seksionin B.3.2).
- (b) Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike .
- (c) Procedurat (të përshkruara në seksionin B.3.3), që përfshijnë:
 - (i) Procedurën e Tregtimit
 - (ii) Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes
 - (iii) Vendimet Teknike të ALPEX-it ; dhe
 - (iv) Procedurën e Komitetit të Bursës

B.3.1.2 Marrëdhënia kontraktuale ndërmjet ALPEX-it dhe Anëtarëve të Bursës dhe/ose Anëtarëve të Klerimit rregullohet nga këto Rregulla, të cilat zbatohen dhe janë të detyrueshme nga ALPEX-i dhe Anëtarët e Bursës nëpërmjet Marrëveshjes së Anëtarësimit me Bursën si dhe nga ALPEX-i dhe Anëtarët e Klerimit nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër për Klerim.

B.3.2 Marrëveshja e Anëtarësimit me Bursën

B.3.2.1 Marrëveshja e Anëtarësimit me Bursën është marrëveshja kuadër e miratuar nga Autoritetet Rregullatore, që ALPEX-i dhe çdo Anëtar Burse duhet të lidhë dhe sipas së cilës Palët janë të detyruar të zbatojnë këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.

B.3.3 Procedurat

B.3.3.1 ALPEX-i është përgjegjës për hartimin, përditësimin, paraqitjen për miratim pranë Autoriteteve Rregullatore si dhe publikimin e Procedurave në përputhje me seksionin B.3.3 dhe Kapitullin J që do të ndiqen nga Palët për kryerjen e detyrimeve dhe funksioneve sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

B.3.3.2 Procedurat mund të përfshijnë detaje mbi:

- (a) Procedurën e Komitetit të Bursës, që përfshijnë:
 - (i) procedurën e zgjedhjes.
 - (ii) përcaktimin për anëtarësim.
 - (iii) largimin dhe dorëheqjen e anëtarëve.
 - (iv) dispozitat mbi kuorumin.
 - (v) vëzhguesit; dhe
 - (vi) proceset për paraqitjen dhe shqyrtimin e Ndryshimit të Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat.
- (b) Procedura e Tregtimit, përfshin:

- (i) Specifikimet e Produkteve dhe llojet e Urdhërporosive për secilin Segment të Tregut.
 - (ii) për çdo Segment Tregu, çështje të detajuara operationale në lidhje me:
 - Përputhjen dhe përpunimin e Urdhërporosive.
 - Kufijtë e tregtimit.
 - Procedurat e Ankandit.
 - Publikimi i të dhënave.
 - (ii) Kërkesat për informacion, inspektim dhe auditim
 - (iii) Aksesit teknik.
 - (iv) Rastet përjashtimore nga tregtimi i zakonshëm.
- (c) Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes përfshin;
- (i) Çështjet e faturimit dhe termat e pagesës
 - (ii) Çështjet e Garancive
 - (iii) Fondi për Mospërbushje të Detyrimeve
 - (iv) Çështjet e llogarive bankare
- B.3.3.3 Procedura e Tregtimit, Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes si dhe Përkufizimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, janë hartuar si dokumente të veçantë, pjesë përbërëse e këtyre rregullave dhe subjekt i miratimit nga Autoritetet Rregullatore. .
- B.3.3.4 Pasi të jetë përgatitur dokumenti i Procedurave, mund të modifikohet vetëm në përputhje me Kapitujt J ose K të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike .
- B.3.4 Publikimi i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Procedurave**
- B.3.4.1 ALPEX-i do të publikojë variantin në fuqi të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike . Ndryshimet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike ose Procedurat do të përfshihen në variantet e publikuara sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 14 ditë kalendarike, pas miratimit të tyre në përputhje me Kapitullin J ose K.
- B.3.4.2 Data e publikimit të variantit të plotë të ndryshuar të këtyre Rregullave nuk do të ndikojë në datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve përkatëse.
- B.3.4.3 ALPEX-i gjithashtu do të publikojë në çdo kohë një listë të Ndryshimeve efektive në fuqi që janë miratuar, por të cilat nuk janë përfshirë ende në variantin aktual të Rregullave të ALPEX-it ose Procedurave.
- B.3.5 Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike**
- B.3.5.1 Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike si dhe çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me to do të interpretohen, kuptohen dhe administrohen në përputhje me ligjet e aplikueshme të Republikave të Shqipërisë dhe Kosovës respektivisht.

B.3.5.2 Sipas seksionit G.2, Palët i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatave të Shqipërisë dhe/ose Gjykatave të Kosovës për të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këto Rregulla, pasi të jetë shteruar çdo dispozitë e përcaktuar nga rregullat respektive.

B.3.6 **Afati**

B.3.6.1 Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike hyjnë në fuqi nga data 27.12.2022.

B.3.7 **Përparësia**

B.3.7.1 Në rast të ndonjë konflikti mes një detyrimi sipas Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë dhe këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, ky konflikt do të zgjidhet sipas përparësisë së renditur më poshtë:

- (a) Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike;
- (b) Marrëveshja për Anëtarësimin në Bursë; dhe
- (c) Marrëveshja Kuadër për Klerim.

B.3.7.2 Në rast të ndonjë mospërputhjeje ose konflikti ndërmjet ndonjë dispozite të ndonjë prej kapitujve, seksioneve ose paragrafëve të këtyre Rregullave, mospërputhja ose konflikti do të zgjidhet me përparësinë e mëposhtme:

- (a) Kapitulli K (Marrëveshjet e Përkohshme);
- (b) Kapitujt e mbetur dhe Përkufizimet e ALPEX-it.

B.3.7.3 Paragrafi B.3.7.2 do të prevalojë ndaj çdo dispozite që shprehet ndryshe nga këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.

B.4 DETYRIMET E PALËVE

B.4.1 **Pajtueshmëria me instrumentet**

B.4.1.1 Çdo Palë duhet t'i respektojë këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike, Procedurat e tyre si dhe Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë.

B.4.1.2 Pa paragjykuar përgjithësimet e paragrafit B.4.1.1, asnjë Palë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, vetë ose në bashkëpunim me ndonjë Palë ose person tjetër, nuk duhet të pengojë funksionimin si duhet të Bursës sipas këtyre Rregullave.

B.4.1.3 Pa paragjykuar ndonjë dispozitë tjetër të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Procedurat ose Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, secila Palë:

- (a) duhet të ushtrojë me kujdes të gjitha të drejtat, funksionet dhe detyrimet e saj sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike;
- (b) duhet të jetë vazhdimisht në pajtueshmëri me lejet dhe Licencat e nevojshme për të qenë anëtar i Bursës dhe për të marrë pjesë në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me këto Rregulla;
- (c) duhet të kryejë të gjitha pagesat që rrjedhin nga këto Rregulla në momentin që ato bëhen detyruese për tu paguar;

- (d) duhet të sigurojë që, me përjashtim të rasteve kur lejohet shprehimisht ndryshe, çdo informacion ose e dhënë që duhet t'i dorëzohet ALPEX-it ose çdo Pale tjetër, ose që duhet ruajtur siç kërkohet, si rrjedhojë e të qenit Anëtar i Bursës (përfshirë ato të seksionit B.4.4), duhet bërë sa më mirë të jetë e mundur në bazë të njohurive dhe besimit që ka. Informacioni duhet të jetë i vërtetë, i vlefshëm, korrekt, i plotë dhe i saktë në momentin që ai jepet dhe, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, edhe gjatë mbajtjes së tij dhe sipas rastiit, do të mbajë të informuar ALPEX-in në kohë për çdo gabim, keqkuptim ose informacion të munguar, si dhe korrigjimin ose përditësimin e çdo informacioni ose të Dhënave që i ka paraqitur tek ALPEX-i ose çdo Palë tjetër sipas këtyre Rregullave;
- (e) duhet të sigurojë që çdo informacion ose e Dhënë që i kërkohet të dorëzohet në ALPEX dhe/ose të çdo personi tjetër, që i kërkohet si rrjedhojë e të qenit Anëtar i Bursës, do të dorëzohet në kohën e duhur për t'i mundësuar ALPEX-it dhe/ose atij personit tjetër, që të kryejë detyrimet dhe funksionet që rrjedhin në përputhje me këto Rregulla ose nga Kërkesat e Rregullatorit për Raportim;
- (f) duhet të bashkëpunojë dhe t'i ofrojë çdo ndihmë të arsyeshme ALPEX-it sipas kërkesës, me qëllim që ALPEX-i të kryejë funksionet dhe detyrimet e tij sipas këtyre Rregullave ose Kërkesave të Rregullatorit për Raportim;
- (g) duhet të mbajë regjistrimin e të dhënave për të gjithë veprimtarinë tregtare në ALPEX, forma dhe përmbajtja e të cilave do të përcaktohet nga ALPEX-i me një Vendim Teknik. Të gjitha këto të dhëna do t'i vihen menjëherë në dispozicion ALPEX-it për qëllime monitorimi, nëse kërkohet,;
- (h) të mbajë regjistrat dhe të lëshojë dokumentet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi;
- (i) nëse vepron si Anëtar Personal i Klerimit, duhet të përmbushë kërkesat e duhura financiare të vendosura nga ALPEX-i dhe të sigurojë marxhinat e kërkuara sipas dispozitave të Rregullave të tregut të energjisë elektrike si dhe Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, si parakusht për t'u pranuar për të tregtuar;
- (j) të ketë sisteme të përshtatshme të auditimit të brendshëm në lidhje me aktivitetin e tij tregtar në ALPEX dhe me qëllim verifikimin e pajtueshmërisë së Anëtarit të Bursës me këto Rregulla të;
- (k) të punësojë një numër të mjaftueshëm punonjësish me njohuritë, përvojën dhe aftësitë e duhura për të garantuar që Anëtari i Bursës është në përputhje me këto Rregulla;
- (l) të sigurojë që punonjësit e tij të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga këto Rregulla;
- (m) ALPEX-i nuk do të jetë përgjegjës kundrejt Anëtarit të Bursës përveç për sjellje të pahijshme me dashje ose neglizhencë të rëndë. ALPEX-i do të marrë masat e duhura për të parandaluar problemet në funksionimin e sistemeve të administruara prej tij dhe të marrë masat për riparimit sa më të shpejtë të defekteve ose keqfunksionimit. ALPEX-i nuk mban përgjegjësi:

- (i) për çdo humbje që mund ti shkaktohet Anëtarit të Bursës ose ndonjë palë e tretë si rezultat i ngjarjeve për shkak të Forcave Madhore, përfshirë, por pa u kufizuar tek, lufta, grevat, trazirat, kryengritjet, trazirat civile, epidemitë, ndërprerjet e përgjithshme të energjisë elektrike, për ta përgjithësuar në termat vendndodhje dhe/ose kohë, mungesa e karburantit ose e lëndëve të para, dështimi, mosfunksionimi ose prishja e sistemeve të komunikimit dhe sistemeve elektronike në përgjithësi, zjarreve, përmytjeve, problemeve të transportit ose shkaqeve të tjera përtej kontrollit të arsyeshëm të ALPEX-it;
- (ii) për kompensimin e çdo humbjeje të shkaktuar nga një Anëtar i Bursës ose ndonjë palë e tretë që është për shkak të mosfunksionimi të ETSS-së, si rezultat i Ngjarjeve për shkak të Forcës Madhore, qoftë edhe përkohësisht, ose për shkak të humbjes së të dhënave të përfshira në ETSS ose të ndonjë përdorimi mashtrues i ETSS ose të dhënave të tij nga palët e treta.

B.4.2 **Mos diskriminimi**

B.4.2.1 ALPEX-i nuk do të bëjë diskriminim midis Anëtarëve të Bursës në ushtrimin e të drejtave dhe kompetencave dhe në kryerjen e funksioneve dhe detyrimeve të tij.

B.4.3 **Kompetencat dhe detyrimet në rast emergjence**

B.4.3.1 Në rast emergjence, përfshirë por pa u kufizuar në rrethanat e përcaktuara në paragrafin F.3.1.1, ALPEX-i mund të lëshojë udhëzime, të marrë vendime ose masa që në mënyrë të arsyeshme i konsideron të përshtatshme për të siguruar sjelljen e duhur të tregtimit në Bursë dhe Shlyerjet të çdo transaksioni tregtar. Këto udhëzime, vendime dhe masa janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët e Bursës dhe/ose Anëtarët e Klerimit, të cilët do t'i respektojnë ato.

B.4.4 **Kërkesat rregullatore**

B.4.4.1 Nëse ALPEX-it i kërkohet të hartojë, mbledhë dhe/ose të dorëzojë ndonjë informacion ose të dhënë, të raportojë ndonjë sjellje ose çështje, në lidhje me Bursën ose operimin e saj, tek Autoritetet Rregullatore ose një Autoritet tjetër Kompetent sipas çdo ligji në fuqi dhe ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar të Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës, (një “**Kërkesë e Rregullatorit për Raportim**”), atëherë çdo Anëtar i Bursës:

- (a) do të sigurojë informacionet, të dhënat dhe raportet, sipas kërkesës së arsyeshme të ALPEX-it ndaj Anëtarit të Bursës, brenda afatit kohor të kërkuar, në mënyrë që ALPEX-i të mund të përmbushë ose plotësojë Kërkesën e Rregullatorit për Raportim (ose të sigurojë që këto informacione, të dhëna dhe raporte të dorëzohen);
- (b) do të bashkëpunojë me ALPEX-in dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat sipas kërkesës së arsyeshme të ALPEX-it, të cilat janë të nevojshme ose duhen për t'i mundësuar ALPEX-it të jetë në përputhje ose të përmbushë Kërkesën e Rregullatorit për Raportim; dhe

- (c) jep pëlqimin që ALPEX-i t'i japë informacion, të dhëna ose raporte Autoritetit Rregullator ose një Autoriteti tjetër Kompetent në përputhje me Kërkesën e Rregullatorit për Raportimit (ose të sigurojë që të jepet çdo pëlqim i nevojshëm).

B.4.5 Tarifat e ALPEX-it

- B.4.5.1 Kostot e operacionale të Tregjeve të Ditës në Avancë dhe atyre Brenda së Njëjtës Ditë mbulohen nëpërmjet pagesave të Tarifave Fikse dhe Variabël nga Anëtarët e Bursës në ALPEX.
- B.4.5.2 ALPEX-i mund të ngarkojë Anëtarët e Bursës dhe aplikantët për të qënë Anëtar Burse, që t'i paguajnë ALPEX-it Tarifat e përcaktuara në përputhje me Listën e Tarifave të ALPEX-it në mënyrën dhe në kohën e përcaktuar në këtë dokument dhe në përputhje me Procedurat.
- B.4.5.3 ALPEX-i do të specifikojë llogarinë ku duhet të bëhet pagesa e Tarifave Fikse dhe Variabël.
- B.4.5.4 Çdo Anëtar i Bursës do t'i paguajë ALPEX-it të gjitha Tarifat Fikse dhe Variabël sipas paragrafit B.4.5.1, ku do të përfshihet TVSH-ja përkatëse apo ndonjë taksë tjetër e detyrueshme nga legjislacioni në fuqi, sipas një faturë të lëshuar nga ALPEX-i.
- B.4.5.5 Kur ndonjë nga pagesat sipas këtyre Rregullave të ALPEX-it është me vonesë, Kamatë Vonesat do të llogariten sipas legjislacionit në fuqi dhe do të akumulohen nga data e lindjes së detyrimit deri në datën e pagesës së plotë mbi shumën në vonesë.
- B.4.5.6 Tarifat Fikse dhe Variabël propozohen nga ALPEX dhe miratohen me Vendim të Autoritetit Rregullator. Tarifat Fikse dhe Variabël aplikohen pas kalimit të një periudhe kohore të përcaktuar në Vendimin e Autoritetit Rregullator të përmendur më lart.
- B.4.5.7 Tarifat Fikse dhe Variabël në fuqi, publikohen në faqen zyrtare të internetit të ALPEX: www.alpex.al.

B.4.6 Detyrimet në lidhje me konfidencialitetin

- B.4.6.1 ALPEX-i dhe çdo Anëtar i Bursës do të respektojnë detyrimet e konfidencialitetit të përcaktuara në seksionin H.5 të këtij dokumenti.

C. PRANIMI NË BURSË

C.1 KËRKESAT PËR ANËTARËSIM

C.1.1 Kriteret e pranimit për t'u anëtarësuar në Bursë

C.1.1.1 Mund të aplikojë për t'u anëtarësuar në Bursë, çdo subjekt juridike që disponon të gjitha autorizimet dhe licencat përkatëse (ose janë përjashtuar nga detyrimi për të pasur një licencë të tillë) për tregtimin e energjisë elektrike (ku është e aplikueshme) të kërkuara sipas Legjislacionit në fuqi, si;

- (a) Të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike ose ata prodhues të energjisë elektrike, të cilët janë të përjashtuar nga detyrimi për marrjen e një licence prodhimi të energjisë elektrike.
- (b) Të licencuarit në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
- (c) Të licencuarit në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- (d) Klientët e energjisë elektrike, mbajtës të një Licence për Konsum vetjak (nëse do të jetë rasti)
- (e) Operatorët e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike.
- (f) Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike.
- (g) Furnizuesi i Shërbimit Universal.
- (h) Operatori i Energjisë së Rinovueshme.

C.1.1.2 Për t'u anëtarësuar në Bursë, subjekti duhet të jetë Palë Përgjegjëse për Balancim ose të jenë pjesë e Grupit të Palës Përgjegjëse për Balancim të konfirmuar zyrtarisht nga OST/KOSTT.

C.1.1.3 Për tu anëtarësuar në Bursë, subjekti duhet të ketë, ose të provojë që do të përmbushë kërkesat e ALPEX-it në lidhje me aftësinë teknike për të tregtuar në platformën e Bursës, sipas procedurës së publikuar në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it.

C.1.1.4 Për tu anëtarësuar në Bursë, subjekti duhet të jetë i regjistruar në Autoritetin Rregullator përkatës sipas Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT); dhe

C.1.1.5 Për tu anëtarësuar në Bursë, subjekti duhet të veprojë si Anëtar Personal i Klerimit ose duke paraqitur një deklaratë bashkëpunimi me një Anëtar të Përgjithshëm Klerimi të ALPEX-it në lidhje me Klerimin e tregtimeve të tij.

C.1.2 Informacioni i kërkuar për Pranim

C.1.2.1 Një subjekt që kërkon të pranohet si Anëtar i Bursës ("**Aplikanti**") duhet:

- (a) t'i paguajë ALPEX-it Tarifën Fikse Administrative në fuqi;
- (b) të paraqesë në ALPEX aplikimin për anëtarësime ("**Aplikim për Anëtarësime**") që përmban të gjithë informacionin përkatës të renditur në formë të tillë që ALPEX-i ta përshkruajë dhe ta publikojë në faqen e tij zyrtare të ueb-it.

- (c) të sigurojë se i përmbush kriteret për t'u pranuar si Anëtar i Bursës ,të përcaktuara nga paragrafi C.1.1.1 deri në paragrafin C.1.1.4.
- C.1.2.2 Tarifa Fikse Administrative do të jetë e pakthyeshme, pavarësisht pranimit ose jo për të qënë Anëtar i Bursës.
- C.1.2.3 të konfirmojë vlefshmërinë e çdo informacioni të dhënë sipas seksionit C.1.2 dhe ta provojë atë duke dorëzuar dokumentacionin origjinale ose kopje të noterizuara të këtyre dokumenteve në përputhje me Vendimin Teknik përkatës të ALPEX-it.
- C.1.2.4 Me paraqitjen e “Aplikimit për Anëtarësim”, konsiderohet se Aplikanti pranon të gjitha dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe merr përsipër të gjitha detyrimet në seksionin C.1.1.
- C.1.2.5 Në momentin e paraqitjes së “Aplikimit për Anëtarësim”, Aplikanti duhet të zbulojë çdo lloj kapaciteti tjetër që mund të ketë, si p.sh. kandidat për Anëtar Burse apo operator i tregut të rregulluar dhe t'i japë ALPEX-it të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me këto kapacitete. ALPEX-i mund t'u kërkojë të dhëna dhe informacione, këtyre subjekteve dhe autoriteteve kompetente mbi Aplikantin, si pjesë e mbledhjes dhe verifikimit të informacionit të rëndësishëm për shqyrtimin e aplikimit.
- C.1.2.6 Kapaciteti i Anëtarit të Bursës nuk i transferohet apo jepet një pale të tretë. Procedura specifike si dhe çdo kusht teknik dhe detaj i nevojshëm që Anëtari i Bursës duhet të përmbushë në rast të transformimeve të shoqërisë tregtare përcaktohet me Vendimin Teknik të ALPEX-it.
- C.1.2.7 Për të marrë pjesë në tregjet e ALPEX-it, Aplikanti është i detyruar të caktojë të paktën një (1) Agjent Tregtar të Certifikuar. Gjithashtu, duhet të ketë një numër të mjaftueshëm Agjentësh Tregtarë të Certifikuar, duke marrë parasysh vëllimin e tregtimeve që do të kryejë dhe detyrimet e tij për të përmbushur rregullat e sjelljes profesionale në përputhje me dispozitat në fuqi.
- C.1.2.8 Aplikimi për Anëtarësim do të shoqërohet me një formular standard "si të njohësh klientin tënd", në të cilin përcaktohen qartë procedurat organizative sipas të cilave ai synon të operojë si Anëtar i Bursës. ALPEX-i mund t'u sigurojë Aplikantëve një model që do të shërbejë si udhëzues mbi përmbajtjen e formularit standart "si të njohësh klientin tënd", sipas procedurës së publikuar në faqen zyrtare të ueb-it të ALPEX-it.
- C.1.2.9 Kur ALPEX-i merr një “Aplikim për Anëtarësim”, duhet që brenda 20 Ditëve nga marrja e aplikimit:
- (a) të refuzojë “Aplikimin për Anëtarësim”, nëse Aplikanti nuk i përmbush kërkesat në fuqi, të përcaktuara në paragrafin C.1.1.1, mund, duke e njoftuar me shkrim Aplikantin mbi refuzimin; ose
 - (b) nëse e gjykon se nevojiten informacione ose sqarime të mëtejshme, të njoftojë Aplikantin duke identifikuar informacionin ose sqarimin e mëtejshëm që nevojitet.
- C.1.2.10 Njoftimi në paragrafin C.1.2.9(b), është i justifikuar nga ALPEX-i, dhe lidhet me rastet e mëposhtme:

- (a) kur Aplikanti nuk ka paraqitur një "Aplikim për Anëtarësim" të plotësuar dhe të nënshkruar siç duhet, dhe dokumentet përkatëse bashkëlidhur , në dosjen e Aplikimit.
- (b) kur ALPEX-i në të kaluarën e ka përjashtuar kandidatin si Anëtar të Bursës si rezultat i shkeljes së rregullave dhe marrëveshjeve me të, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Procedurat, përveç rasteve kur rrethanat që çuan në përjashtimin e tij, nuk ekzistojnë më ose ALPEX-i është bindur, në mënyrë të arsyeshme, se shkelja nuk do të përsëritet.
- (c) nëse pranimi i "Aplikimit për Anëtarësim" do të bënte që ALPEX-i të shkelte ndonjë dispozitë të një detyrimi ligjor ose rregullator.
- (d) kur ndonjë nga deklaratimet e kandidatit është i pasaktë ose i rreme; ose
- (e) kur nuk ka paguar tarifën e parashikuar në C.1.2.1(a) dhe/ose nëse në të shkuarën ka patur detyrime të prapambetura ndaj ALPEX-it.

C.1.2.11 Pavarësisht përmbajtjes së paragrafi C.1.2.10(a), në rastet kur ALPEX-i e konsideron se informacioni që do ti jepte të drejtën e një aplikanti për t'u anëtarësuar është hequr nga aplikimi për anëtarësim, ALPEX-i do t'i dërgojë njoftim Aplikantit duke identifikuar informacionin e nevojshëm.

C.1.2.12 Nëse ALPEX-i nuk e merr informacionin e kërkuar ose sqarimet e mëtejshme brenda 10 Ditëve nga data që është bërë kërkesa sipas paragrafit C.1.2.9(b) ose paragrafin C.1.2.8, atëherë do të konsiderohet se Aplikanti e ka tërhequr Aplikimin për Anëtarësim. Aplikanti mund të kërkojë me tepër kohë për të dhënë informacione ose sqarime të mëtejshme dhe ALPEX-i nuk duhet ta refuzojë në mënyrë të paarsyeshme pranimin e një kërkesë të tillë.

C.1.3 Pranimi

C.1.3.1 ALPEX-i do t'i pranojë dhe trajtojë aplikimet nga Anëtarët e Bursës në mënyrë të drejtë dhe jo diskriminuese. Megjithatë, në varësi të parimit të lartpërmendur, ALPEX-i mund të vendosë terma dhe kushte të veçanta për entitete të caktuara, nëse kjo gjë, sipas mendimit të arsyeshëm të ALPEX-it, është e nevojshme për të pasqyruar rrethanat e veçanta të atij subjekti, ose për të pranuar një entitet që në të kundërt do të përjashtohet nga Anëtarësimi, përfshirë termat dhe kushtet e kërkuara nga Ligji në fuqi në juridiksionin ku është i vendosur subjekti.

C.1.3.2 Nëse ALPEX-i mendon që një Aplikant përmbush kërkesat në fuqi të përcaktuara në seksionin C.1.1, dhe se ka paraqitur të gjithë informacionin dhe sqarimet e kërkuara sipas seksionit C.1.2, ALPEX-i brenda njëzet (20) Ditëve nga marrja përfundimtare e të gjithë informacionit të kërkuar do t'i japë Aplikantit një Njoftim për Pranim, sipas të cilit Aplikanti fiton të drejtën për të vazhduar procedurat për Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë. ALPEX-i mund të specifikojë çdo lloj kushti që duhet të plotësohet përpara se Marrëveshja për Anëtarësim në Bursë të hyjë në fuqi.

C.1.3.3 Aplikanti do t'ia kthejë ALPEX-it Marrëveshjen për Anëtarësim në Bursë të plotësuar dhe nënshkruar menjëherë pasi ta ketë marrë. Nëse ALPEX-i është i sigurt që Marrëveshja për Anëtarësimi në Bursë është plotësuar dhe nënshkruar siç duhet nga Aplikanti dhe janë përmbushur të gjitha kushtet e specifikuar, atëherë ALPEX-

i do ta njoftojë me shkrim Anëtarin e ri të Bursës për Datën e Hyrjes në Fuqi të anëtarësimit të tij.

- C.1.3.4 Anëtari i ri i Bursës ka të drejtë të tregtojë në Bursë nga Data e Hyrjes në Fuqi e specifikuar në Njoftimin për Tregun sipas paragrafit C.1.3.3 dhe pas plotësimit të kushtit të parashikuar në seksionin F.4.
- C.1.3.5 ALPEX-i duhet t'i informojë Anëtarët e Bursës për emrin e Anëtarit të ri të Bursës me një Njoftim për Tregun dhe duhet të publikojë detajet mbi pranimin e Anëtarit të ri në faqen e internetit të ALPEX-it.
- C.1.3.6 Nëse ALPEX-i vendos të mos e pranojë një Aplikant, atëherë duhet t'i japë Aplikantit arsyet e vendimit të tij. ALPEX-i do të pranojë vetëm Aplikantët të cilët plotësojnë kriteret për tu bërë Anëtar. Aplikantët nuk do të refuzohen pa ndonjë arsye të justifikuar.
- C.1.3.7 ALPEX-i duhet të informojë menjëherë Aplikantin me shkrim për rezultatin e procesit të aplikimit. Nëse aplikimi miratohet, palëve do t'u vihet në dispozicion një kopje origjinale e Marrëveshjes për Anëtarësim në Bursë e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i nënshkruarve dhe ALPEX-it. Marrëveshja për Anëtarësim në Bursë lidhet në gjuhën shqipe ose angleze, ndërsa të drejtën e zgjedhjes së gjuhës e ka Aplikanti. Fuqia juridike dhe marrëdhëniet ndërmjet versionit anglisht dhe shqip të Rregullave në fuqi të ALPEX-it rregullohen sipas kushteve tek Marrëveshja për Anëtarësim në Bursë.
- C.1.3.8 Çdo Anëtar i Bursës ka të drejtë të kërkojë nga ALPEX-i formimin e Portofoleve për Tregtim, lidhur me Tregun e Ditës në Avancë të ALPEX-it.
- C.1.3.9 Çdo Anëtar i Bursës ka të drejtë të kërkojë nga ALPEX-i formimin e Portofolit të Tregtimit, lidhur me Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë të ALPEX-it dhe formimin e Portofoleve të Tregtimit, për Tregun e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë të ALPEX-it.
- C.1.3.10 Një Anëtar i Bursës mundet që me paraqitjen e një kërkesë, e cila është subjekt i miratimit të ALPEX-it , t'i jepet një numër shtesë Portofolash Tregtimi për një ose secilin prej Tregjeve të ALPEX-it në të cilat merr pjesë.

C.1.4 **Tarifa Fikse e Anëtarësimit**

- C.1.4.1 ALPEX-i do të publikojë detajet e Tarifës Fikse për Anëtarësimin, të shprehura në monedhën Euro.
- C.1.4.2 ALPEX-i do të specifikojë llogarinë bankare ku duhet të bëhet pagesa e Tarifës Fikse për Anëtarësim.

C.1.5 **Të përgjithshme**

- C.1.5.1 Kur të plotësojë Aplikimin për Anëtarësim, Aplikanti duhet të japë informacionin e kërkuar dhe, kur është e aplikueshme në formatin e specifikuar, në standardin e publikuar në faqen e internetit të ALPEX-it.
- C.1.5.2 Aplikanti e autorizon ALPEX-in të bëjë kërkime që i konsideron të përshtatshme dhe të ndajë çdo informacion të dhënë nga Aplikanti me Anëtarin e Klerimit të Përgjithshëm në lidhje me përpunimin e një Aplikimi për Anëtarësim.

C.2 MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI I ANËTARËSIMIT

C.2.1 Qëllimi i këtij seksioni

C.2.1.1 Ky seksion përcakton të drejtat, detyrimet dhe proceset në lidhje me Mospërbushjen e Detyrimeve, Dorëheqjen, Ndalimin e Tregtimit, Pezullimin dhe Përfundimin.

C.2.2 Mospërbushja e Detyrimeve

C.2.2.1 Anëtar i Bursës do të jetë në kushtet e Mospërbushjes së Detyrimeve kur është në shkelje të ndonjërës nga dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Procedurave ose Marrëveshjes për Anëtarësim në Bursë dhe përfshin pa kufizim dështimin për të paguar ose shkakun e mospagimit të një shume parash ose shkeljen e një ose më shumë dispozitave të Sjelljes në Kapitullin D.

C.2.2.2 Anëtar i Bursës do të njoftojë ALPEX-in, sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, sapo të jetë në dijeni për të gjitha rrethanat që kanë shkaktuar ose do të shkaktonin Mospërbushjen e Detyrimeve, ose ndodhjen e një ngjarje të përshkruar në ndonjë nga paragrafët C.2.5.1(a) deri tek C.2.5.1(c) dhe C.2.5.2(a) deri tek C.2.5.2(d) në lidhje me Anëtarin e Bursës.

C.2.2.3 Sapo ALPEX-i të konstatojë për Mospërbushjen e Detyrimeve në lidhje me një Anëtar të Bursës, ku nëpërmjet një njoftimi sipas paragrafit C.2.2.2 ose në ndonjë rrugë tjetër, ALPEX-i do t'i lëshojë një Njoftim për Mospërbushje Detyrimesh Anëtarit të Bursës që është në këto kushte, duke specifikuar Mospërbushjen e Detyrimeve.

C.2.2.4 ALPEX-i do të specifikojë në një Njoftimin për Mospërbushje Detyrimesh:

- (a) Natyrën e Mospërbushjes së Detyrimeve;
- (b) Nëse Mospërbushja e Detyrimeve mund të korrigjohet, kohën nga data e Njoftimit të Mospërbushjes brenda së cilës i kërkohet Anëtarit të Bursës që është në këto kushte, për ta korrigjuar atë; dhe
- (c) Çdo veprim tjetër që ALPEX-i në mënyrë të arsyeshme mundet t'i kërkojë Anëtarit të Bursës, që është në Mospërbushje të Detyrimeve në lidhje me këtë Mospërbushje Detyrimesh.

C.2.2.5 Anëtar i Bursës që është në Mospërbushje të detyrimeve duhet të veprojë sipas Njoftimit për Mospërbushjen e Detyrimeve.

C.2.3 Dorëheqja e Anëtarit të Bursës

C.2.3.1 Një Anëtar i Bursës mund të aplikojë pranë ALPEX-it për të hequr dorë nga anëtarësia e tij në Bursë në përputhje me këtë seksion.

C.2.3.2 Kërkesa për dorëheqje duhet të jetë me shkrim dhe duhet të specifikojë kohën dhe datën në të cilën Anëtar i Bursës dëshiron që dorëheqja të hyjë në fuqi, e cila duhet të jetë jo më pak se gjashtëdhjetë (60) Ditë nga paraqitja e kërkesës.

- C.2.3.3 ALPEX-i do të pranojë dorëheqjen e Anëtarit të Bursës nëse është i bindur që Anëtari përkatës i Bursës i ka përmbushur (ose do ti përmbushë deri në momentin kur dorëheqja të hyjë në fuqi) të gjitha kushtet e mëposhtme:
- (a) Anëtari i Bursës nuk ka detyrime ose borxhe të mbetura ndaj ALPEX-it sipas këtyre Rregullave; dhe
 - (b) çdo Mospërmbushje e pazgjdhur nga Anëtari i Bursës në momentin e paraqitjes së kërkesës së dorëheqjes mund të rikuperohet, ose është rikuperuar;
- C.2.3.4 ALPEX-i mund të zgjasë afatin e referuar në paragrafin C.2.3.2, në varësi të detyrimeve të pa përmbushura të Anëtarit të Bursës dhe/ose nevojës për të mbrojtur ETSS-në nga rreziqet e shfaqura ose që mund të shfaqen. Kur ndryshohet afati kohor, efektet e dorëheqjes dhe përfundimit të marrëveshjeve përkatëse të referuara në paragrafin C.2.3.3, do të hyjnë në fuqi në datën e ndryshuar që ALPEX-i pranon dorëheqjen, e cila do të hyjë në fuqi jo më vonë se, data e përfundimit të afatit të ri kohor.
- C.2.3.5 Nëse ALPEX pranon dorëheqjen e një Anëtari të Bursës, atëherë duhet të njoftojë me shkrim Anëtarin e Bursës duke specifikuar kohën kur dorëheqja do të hyjë në fuqi.
- C.2.3.6 Me plotësimin e kushteve të paragrafëve të mësipërme, ALPEX-i do ta pranojë dorëheqjen, dhe nëpërmjet një Njoftimi për Tregun, do të informojë në lidhje me këtë, Anëtarët e tjerë të Bursës, Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit dhe Autoritetin Rregullator sipas rastit. Kur dorëheqja nuk pranohet, ALPEX-i do të jap një përgjigje të arsyetuar.
- C.2.3.7 Dorëheqja e Anëtarit të Bursës nuk pengon ri-anëtarësimin e tij, me kusht që në momentin e pranimit të plotësohen të gjitha kushtet e pranimit në Bursë.
- C.2.3.8 Procedura e dorëheqjes mund të përcaktohet me Vendim Teknik të ALPEX-it.
- C.2.3.9 Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Operatori i Energjisë së Rinovueshme, Furnizuesi i Shërbimit Universal dhe Prodhuesi Publik nuk do lejohen të përfundojnë pjesëmarrjen në Bursë, përveçse kur kjo kërkohet nga Autoritetet Kompetente.

C.2.4 **Ndalimi i Tregtimit**

- C.2.4.1 ALPEX-i mund të deklarojë se një Anëtar i Bursës është subjekt i Ndalimit të Tregtimit nëse:
- (a) Anëtari i Bursës shkel Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, Procedurat ose Marrëveshjen e Anëtarësimin në Bursë dhe ALPEX-i konsideron se shkelja ndikon negativisht në operimin e ETSS-së ose aftësinë e një Anëtari tjetër të Bursës për t'u ndërlidhur me këto sisteme;
 - (b) Mungesa e një marrëveshje të vlefshme si Palë Përgjegjëse për Balancim, në përputhje me dispozitat e paragrafit C.1.1.2.
 - (c) ALPEX-i vlerëson se Anëtari i Bursës mund të ketë shkelur një ose më shumë nga dispozitat e sjelljes të përcaktuara në Kapitullin D; ose

- (d) ALPEX-it i kërkohet të përjashtojë një Anëtar Burse nga Tregtimi nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit në përputhje me Kushtet e Klerimit.
- C.2.4.2 Nëse një Anëtar i Bursës është subjekt i Ndalimit të Tregtimit, ALPEX-i do të njoftojë me shkrim Anëtarin e Bursës duke specifikuar kohën kur Ndalimi i Tregtimit hyn në fuqi dhe arsyen ose arsyet që shkaktuan ndalimin e tregtimit.
- C.2.4.3 Kur Ndalimi i Tregtimit vjen si pasojë e një Mospërmbushje Detyrimesh dhe nëse një Njoftim për Mospërmbushjen e Detyrimeve nuk është lëshuar akoma nga ALPEX-i në lidhje me këtë Mospërmbushjeje, atëherë ALPEX-i do të lëshojë Njoftimin për Mospërmbushje Detyrimesh në përputhje me paragrafin C.2.2.3.
- C.2.4.4 Kur ALPEX-i konstaton se:
- (a) një Anëtar i Bursës e ka korrigjuar arsyen ose arsyet që shkaktajnë Ndalimin e Tregtimit të identifikuar në një njoftim sipas paragrafit C.2.4.2; dhe
 - (b) nuk ekzistojnë rrethana të tjera të qenësishme që do t'i jepnin të drejtë ALPEX-it që ta deklarojnë Anëtarin e Bursës si subjekt të Ndalimit të Tregtimit,
- ALPEX-i do ta heqë Ndalimin e Tregtimit duke njoftuar që Anëtari i Bursës nuk është më subjekt i Ndalimit të Tregtimit.
- C.2.4.5 Kur ALPEX-i heq një Ndalim të Tregtimit që ka prekur një Anëtar të Bursës, ai do të:
- (a) riaktivizojë ndërlidhjen e Anëtarit të Bursës në ETSS; dhe
 - (b) njoftojë me shkrim Anëtarin e Bursës.
- C.2.4.6 ALPEX-i do të bëjë përpjekje të riaktivizojë ndërlidhjen sipas paragrafit C.2.4.5(a), përpara ose në të njëjtën kohë me njoftimin sipas paragrafit C.2.4.5(b)
- C.2.5 **Pezullimi i anëtarësimit**
- C.2.5.1 ALPEX-i do të lëshojë një Urdhër për Pezullim për një Anëtar të Bursës kur:
- (a) ALPEX ka ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me Anëtarin e Bursës i cili është njëkohësisht Anëtar Personal i Klerimit, që ALPEX-i konsideron se do të ose mund (me përfundimin e kohës) të pengojë Anëtarin e Bursës të likuidojë Kontratat e krijuara sipas këtyre Rregullave të ALPEX-it për një periudhë kohe;
 - (b) ALPEX bëhet i vetëdijshëm se Anëtari i Bursës nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në seksionin C.1.1.1; ose
 - (c) Anëtari i Bursës ka dështuar të paguajë ndonjë detyrim financiar të prapambetur sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë elektrike.
 - (d) Anëtari i Bursës i cili është Anëtar Personal i Klerimit ka dështuar të paguajë Pagesat e Tregtimit sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë elektrike.
 - (e) ka shkelur parashikimet e përcaktuara në paragrafin D.3.2.2
- C.2.5.2 ALPEX-i mund të lëshojë një Urdhër për Pezullim për një Anëtar të Bursës kur:
- (a) për një Anëtar në Bursë bëhet ligjërisht e pamundur të përmbushë detyrimet e tij sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë elektrike;

- (b) një Kërkesë Ligjore e nevojshme për t'i mundësuar Anëtarit në Bursë të përmbushë detyrimet dhe funksionet e tij sipas këtyre Rregullave, ndryshohet ose revokohet tërësisht ose pjesërisht në mënyrë të tillë që e pengon Anëtarin e Bursës që të përmbushë detyrimet dhe funksionet e tij sipas këtyre Rregullave;
- (c) Anëtari në Bursës pezullon ose mbyll aktivitetin e biznesit, ose një pjesë e biznesit të tij, aktivitetet e të cilëve ndërlidhen me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë elektrike;
- (d) Anëtari i Bursës bëhet i paaftë financiarisht;
- (e) kur një Urdhërporosi shkel Ligjin në fuqi, Rregullat e Tregut të Energjisë elektrike, ose angazhimet kontraktuale të ndërmarra nga ALPEX-it si pjesë e rolit të tij si NEMO;
- (f) Anëtari i Bursës mund të ketë shkelur një ose më shumë nga dispozitat e sjelljes në Kapitullin D; ose
- (g) ALPEX-i ka nxjerrë një Njoftim për Mospërmbushje Detyrimesh për Anëtarin e Bursës sipas paragrafit C.2.2.3 ose paragrafit C.2.4.3 dhe Anëtari i Bursës ka dështuar të korrigjojë Mospërmbushjen e Detyrimeve sipas kushteve të Njoftimit për Mospërmbushje Detyrimesh.

C.2.5.3 Kur Pezullimi vjen si rrjedhojë e një Mospërmbushje Detyrimesh dhe Njoftimi i Mospërmbushjes së Detyrimeve nuk është lëshuar akoma nga ALPEX-i në lidhje me këtë Mospërmbushje Detyrimesh, atëherë ALPEX-i duhet të lëshojë Njoftimin për Mospërmbushje Detyrimesh në përputhje me paragrafit C.2.2.4.

C.2.5.4 Urdhri për Pezullim:

- (a) duhet të specifikojë datën dhe kohën kur Pezullimi hyn në fuqi;
- (b) mund të specifikojë periudhën e Pezullimit ose një ngjarje, e cila nëse ndodh, Pezullimi merr fund; dhe
- (c) mund të specifikojë kushtet e Pezullimit.

C.2.5.5 Nëse ALPEX-i lëshon një Urdhër për Pezullim për një Anëtar të Bursës, atëherë ky urdhër do:

- (a) të njoftojë me shkrim Anëtarin e Bursës që preket prej këtij urdhri;
- (b) t'i dërgojë një kopje të urdhrin Autoriteteve Rregullatorë dhe Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit; dhe
- (c) të informojë Anëtarët e tjerë të Bursës nëpërmjet një Njoftimi për Tregun.

C.2.5.6 Pezullimi sipas Urdhrit për Pezullim ka efekt të menjëhershëm nga data dhe ora e specifikuar në Urdhrin për Pezullim.

C.2.5.7 ALPEX-i e anulon Urdhrin për Pezullim, nëse Anëtari përkatës i Bursës e korrigjon çështjen ose çështjet që kanë shkaktuar Urdhrin për Pezullim ose nëse rrethanat që kanë shkaktuar Urdhrin për Pezullim nuk janë më të aplikueshme dhe asnjë Urdhër tjetër Pezullimi nuk është lëshuar ndaj Anëtarit të Bursës.

C.2.5.8 Kur një Urdhër për Pezullim ndryshohet ose anulohet nga ALPEX-i, atëherë ALPEX-i do:

- (a) të njoftojë me shkrim Anëtarin e Bursës që preket prej këtij urdhri;
- (b) të informojë Anëtarët e tjerë të Bursës për ndryshimin ose anulimin me një Njoftim për Tregun; dhe
- (c) t'i dërgojë një kopje të njoftimit përkatës Autoriteteve Rregullatorë dhe Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit.

C.2.6 **Pasojat e Ndalimit të Tregtimit dhe Pezullimit**

C.2.6.1 Nëse një Anëtar i Bursës i nënshtrohet Ndalimit të Tregtimit ose është pezulluar sipas një Urdhri për Pezullim:

- (a) ALPEX-i duhet të çaktivizojë ndërlidhjen e Anëtarit të Bursës në ETSS dhe të marrë masa për të bërë të mundur Ndalimin e Tregtimit ose Pezullimin;
- (b) Anëtari i Bursës duhet të anulojë të gjitha Urdhërporositë në emër të tij në ETSS dhe, në ato raste kur ai nuk arrin ta bëjë këtë anulim, atëherë ALPEX-i do t'i anulojë këto Urdhërporosi;
- (c) Anëtari i Bursës do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të korigjuar dhe për të eliminuar pasojat e shkakut ose shkaqeve që sollën Ndalimin e Tregtimit ose Pezullimin; dhe
- (d) Anëtari i Bursës do të mbyllë tregtimin dhe do të sigurojë që Agjentët e tij Tregtar të ndërpresin tregtimin në Bursë derisa ALPEX-i të njoftojë Anëtarin e Bursës se Ndalimi i Tregtimit ose Pezullimi është anuluar ose ka përfunduar.

C.2.7 **Përfundimi i Anëtarësimit**

C.2.7.1 ALPEX-i do të lëshojë një Urdhër Përfundimi për një Anëtar të Bursës i cili:

- (a) ka shkelur një ose më shumë nga dispozitat e Sjelljes të përcaktuara në Kapitullin D dhe Autoritetet Rregullatore i kërkojnë ALPEX-it përfundimin e anëtarësimit të Anëtarit në Bursë;
- (b) nuk është më në gjendje të shlyejë Kontrata sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, si Anëtar Personal i Klerimit;

C.2.7.2 ALPEX-i, sipas paragrafit C.2.7.3, mund të lëshojë Urdhër Përfundimi për një Anëtar të Bursës i cili:

- (a) Ka qenë subjekt i Ndalimit të Tregtimit për më shumë se njëzet (20) Ditë;
- (b) Ka qenë i pezulluar për më shumë se njëzet (20) Ditë;
- (c) nuk e ka korigjuar Mospërmbushjen ose Mospërmbushjet e Detyrimeve që kanë shkaktuar një Njoftim për Mospërmbushje Detyrimesh brenda njëzet (20) Ditësh;
- (d) nuk i plotëson më kërkesat e përcaktuara në seksionin C.1.1;

- (e) është në shkelje të një Urdhri për Pezullim ose nuk ka ndërmarrë veprime që i janë kërkuar nga ALPEX-i brenda afatit kohor të përcaktuar në Urdhrin për Pezullim.

C.2.7.3 Përpara lëshimit të Urdhër Përfundimi sipas paragrafit C.2.7.2, ALPEX-i do të njoftojë Autoritetin Rregullator. Është në vendimmarrjen e Autoriteti Rregullatorë për të dhënë vendimin përfundimtar.

C.2.7.4 Kur ALPEX-i lëshon një Urdhër Përfundimi, ky urdhër do të specifikojë kohën dhe datën nga e cila urdhri do të hyjë në fuqi dhe kushtet për Përfundim.

C.2.7.5 Nëse ALPEX-i lëshon një Urdhër Përfundimi për një Anëtar të Bursës, atëherë ai duhet të:

- (a) dërgojë një kopje të urdhrin tek Autoriteti Rregullatorë; dhe
- (b) informojë Anëtarët e tjerë të Bursës nëpërmjet një Njoftimi për Tregun.

C.2.8 Pasojat e Dorëheqjes ose Përfundimi

C.2.8.1 Kur një Anëtar i Bursës jep dorëheqjen ose anëtarësimi i tij përfundon sipas seksionit C.2.7, atëherë Anëtari i Bursës:

- (a) Do të pushoj së ekzistuari si Anëtar i Bursës dhe si palë në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë;
- (b) Për më tepër:
 - (i) do të sigurohet që Agjentët e tij Tregtarë të ndërpresin tregtimin në Bursë; dhe
 - (ii) duhet të anulojë të gjitha Urdhërporositë në emër të tij në ETSS, dhe, për ato që nuk arrin ta bëjë, atëherë ALPEX-i do t'i anulojë ato,

nga koha e përcaktuar në njoftim, sipas paragrafit C.2.3.5 ose në Urdhër Përfundimi (siç aplikohet).

C.2.8.2 Dorëheqja ose Përfundimi i një Anëtari të Bursës nuk ndikon:

- (a) në të drejtat ose detyrimet e akumuluar të Anëtarit të Bursës sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë, nga të cilat kanë lindur ose që lidhen me çdo veprim ose mosveprim përpara datës së dorëheqjes ose përfundimit të saj;
- (b) në pagimin e çdo shume që ishte ose bëhet e pagueshme sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Procedurave të Klerimit dhe Shlyerjes, në lidhje me çfarëdo periudhe përpara dorëheqjes ose përfundimit të marrëveshjes (përfshirë dhe çdo Mosmarrëveshje në lidhje me diçka që ka ndodhur përpara dorëheqjes ose përfundimit të anëtarësimit të Anëtarit të Bursës, edhe nëse Njoftimi i Mosmarrëveshjes është dhënë pas datës së dorëheqjes ose përfundimit të saj); dhe
- (c) në detyrimet e vazhdueshme të Anëtarit të Bursës sipas ose në lidhje me çdo kontratë të krijuar përpara dorëheqjes ose përfundimit të saj;

- C.2.8.3 Çdo dispozitë e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, e cila shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar ka si qëllim të hyjë në fuqi ose të vazhdojë të jetë në fuqi, pas dorëheqjes ose përfundimit së marrëveshjes së një Anëtari të Bursës, do të vazhdojë të jetë e detyrueshme për Anëtarin e Bursës.
- C.2.8.4 Për të shmangur çdo dyshim, Anëtari i Bursës do të vazhdojë të jetë i detyruar të respektojë Procesin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve në lidhje me çdo Mosmarrëveshje që lind pas dorëheqjes ose përfundimit të tij, por që i referohet periudhës përpara dorëheqjes ose përfundimit të marrëveshjes.
- C.2.8.5 ALPEX-it nuk ka detyrimin të rikthejë ndonjë Tarifë Fikse të paguar nga një Anëtar i Bursës pas dorëheqjes ose ndërprerjes/përfundimit të marrëveshjes.

C.2.9 Të përgjithshme

- C.2.9.1 , ndërkohë që një Anëtar i Bursës është subjekt i Ndalimit të Tregtimit ose është i Pezulluar:
- (a) Anëtari i Bursës do të vazhdojë të përmbushë dhe do të mbetet përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet e akumuluar sipas këtyre Rregullave të ALPEX-it, Procedurat ose Kushteve të Klerimit gjatë Ndalimit të Tregtimit ose Pezullimit; dhe
 - (b) Ndalimi i Tregtimit ose Pezullimi nuk ndikon në detyrimet e vazhdueshme të Anëtarit përkatës të Bursës sipas ose në lidhje me ndonjë Kontratë të krijuar përpara hyrjes në fuqi të Ndalimit të Tregtimit ose Urdhrit për Pezullim.
- C.2.9.2 ALPEX-i mund ta ndryshojë Njoftimin për Mospërmbushje Detyrimesh dhe Urdhrin e Pezullimit sipas paragrafit C.2.5.4, ose një Urdhër Përfundimi me miratimin me shkrim të Autoritetit Rregullatorë, duke e njoftuar me shkrim Anëtarin përkatës të Bursës.
- C.2.9.3 ALPEX-i mund të deklarojë një Anëtar Burse si subjekt të Ndalimit të Tregtimit në rrethanat e parashikuara në seksionin C.2.4, ose të lëshojë një Urdhër Pezullimi pas ndodhjes së një ngjarjeje të përshkruar në ndonjë nga paragrafët C.2.5.1(a) deri në C.2.5.1(c) dhe paragrafëve C.2.5.2(a) deri në C.2.5.2(e), që gjithashtu formojnë një Mospërmbushje Detyrimesh, pa lëshuar një Njoftim për Mospërmbushje Detyrimesh ose duke pritur që të përfundojë periudha e korrigjimit sipas Njoftimit të Mospërmbushjes së Detyrimeve.

C.3 NJOFTIMET

C.3.1 Fusha e zbatimit

- C.3.1.1 Ky seksion zbatohet për komunikimet që duhet të bëjë ALPEX-i ose një Anëtar i Bursës, përfshirë lajmërimet, njoftimet, deklaratat dhe urdhrat e bëra, lëshuara, ndryshuara ose të anuluar sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, ku përfshihen komunikimet në lidhje me:
- (a) Njoftimet për Mospërmbushje Detyrimesh;
 - (b) Ndalimin e Tregtimit;
 - (c) Urdhrat për Pezullim;

- (d) Urdhrat e Përfundimit;
- (e) Njoftimet mbi Mosmarrëveshjet dhe gjendjen aktuale të gjithsecilit;
- (f) Njoftimet mbi Ngjarjet e Forcës Madhore; dhe
- (g) Njoftimet për Tregun.

C.3.2 Njoftimi i Palëve të tjera

- C.3.2.1 Çdo njoftim që kërkohet të jepet në lidhje me qëllimet e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike do të jepet me shkrim, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këto Rregulla.
- C.3.2.2 Çdo njoftim që duhet të jepet me shkrim, ose një komunikim për të cilin kërkohet një mënyrë tjetër i përshkruar në këto Rregulla, mund të jepet gjithashtu me postë elektronike (e-mail) ose me anë të një njoftimi për një Anëtar të Bursës nga ETSS-ja, ose nga Mjeti Elektronik i Përcaktuar.
- C.3.2.3 Të dhënat e ALPEX-it mbi kontaktet e tij do të gjenden të specifikuara në faqen e tij të internetit, në çdo kohë.
- C.3.2.4 Adresa e Anëtarit të Bursës për komunikimin me ALPEX-in është ajo që Anëtari i Bursës ka specifikuar në “Aplikimin për Anëtarësim”. Për çdo ndryshim të adresës së Anëtarit të Bursës do të njoftojë me shkrim ALPEX-in.
- C.3.2.5 Çdo njoftim me shkrim do të konsiderohet se është marrë:
 - (a) në rastet kur dërgohet dorazi, dhe merret në dorëzim;
 - (b) në rastin kur dërgohet nëpërmjet një shërbimi postar të regjistruar, kur pranohet; ose
 - (c) në rastin e postës elektronike, kur posta elektronike (e-mail) hyn në sistemin e IT-së së Palës marrëse.
- C.3.2.6 Secila Palë do të specifikojë një adresë postare, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe një përfaqësues për dërgimin e njoftimeve me shkrim dhe mund t'i ndryshojë këto detaje duke njoftuar me shkrim ALPEX-in.
- C.3.2.7 Komunikimet me shkrim ndërmjet Anëtarëve dhe ALPEX-it do të jenë në gjuhën shqipe ose angleze siç përcaktohet në Marrëveshjen e Anëtarësimin në Bursë.

D. SJELLJA, MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E TREGUT

D.1 QËLLIMI I KËTIJ KAPITULLI

D.1.1 Të përgjithshme

- D.1.1.1 Qëllimi i këtij kapitulli është zbatimi i praktikave më të mira të Rregulloreve të BE-së për Sjelljen dhe Mbikëqyrjen e Tregut
- D.1.1.2 Në përputhje me Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT), ky Kapitull përcakton rregullat në lidhje me Sjelljen në Treg dhe sjelljet të cilat duhet të ndiqen dhe respektohen në çdo kohë nga Anëtarët e Bursës.

D.1.1.3 Ky Kapitull përcakton gjithashtu funksionin e mbikëqyrjes së tregut të ALPEX-it, që synon parandalimin, zbulimin dhe raportimin tek Autoriteti Rregullatorë për çdo shkelje të rregullave të këtij Kapitulli nga Anëtarët e Bursës, si dhe detyrimin e Anëtarëve të Bursës për ta mbështetur këtë funksion.

D.1.2 **Parimet**

D.1.2.1 Është përgjegjësi e çdo Anëtari të Bursës të sigurojë se është në përputhje me kërkesat e Sjelljes në Treg sipas Kapitullit D, të të gjitha palëve përkatëse të organizatës së tij. Çdo Anëtar i Bursës do të sigurojë që çdo person i përfshirë në Tregtim dhe/ose në Klerim në emër të tij, përfshirë menaxherët dhe personat e tjerë që marrin vendime në lidhje me Llojin e një Urdhërporosie, i nënshtrohen kufizimeve dhe detyrimeve që bëjnë të mundur që Anëtarët e Bursës të respektojnë plotësisht dhe në mënyrë efikase Sjelljen në Treg.

D.1.2.2 Është përgjegjësi e përbashkët e ALPEX-it dhe Anëtarëve të Bursës të sigurojnë një treg të drejtë dhe transparent të energjisë elektrike, me qëllim nxitjen e besimit të publikut në Bursë, mekanizmat e formimit të çmimeve dhe çmimet referencë në dobi të konsumatorëve fundorë. Si i tillë:

- (a) ALPEX-i dhe çdo Anëtar i Bursës do të veprojnë në përputhje me Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT) dhe me këtë Kapitull D; dhe
- (b) Anëtarët e Bursës do të respektojnë të gjitha detyrimet e vendosura ndaj tyre në lidhje me Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT) nga Autoriteti Rregullator do të sigurojnë që stafi i tyre të përmbushë të gjitha këto detyrime dhe do të njoftojnë stafin që informacioni i tyre mund të ndahet me ALPEX-in dhe Autoritetin Rregullator.

D.1.2.3 Pa kufizuar përgjithësinë e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin D.1.2.2(b) dhe B.2.9.3, asnjë Anëtar i Bursës nuk do të:

- (a) përfshihet ose përpiqet të përfshihet në Manipulimin e Tregut në një treg me shumicë të energjisë; ose
- (b) përfshihet në ndonjë nga aktivitetet e ndaluara nga Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT) në lidhje me një produkt energjie me shumicë.

D.1.2.4 Anëtarët e Bursës duhet në çdo kohë:

- (a) të veprojnë me drejtësi kundrejt ALPEX-it dhe Anëtarëve të tjerë të Bursës; dhe
- (b) tregtojnë në Bursë në përputhje me parimet e tregtarëve profesionistë të tregut.

D.1.2.5 Çdo Anëtar i Bursës do të sigurojë që çdo Urdhërporosi e bërë prej tij të pasqyrojë një interes të vërtetë blerjeje ose shitjeje dhe që të gjitha Transaksionet në të cilat ai është palë janë të vërteta.

D.1.2.6 Një Anëtar i Bursës nuk mund të ndikojë në asnjë mënyrë të pahijshme në çmimin ose strukturën e çmimeve në tregjet e ALPEX-it, ose të pengojë në ndonjë mënyrë tjetër ndërlidhjen e anëtarëve të tjerë në treg.

- D.1.2.7 Anëtarët e Bursës nuk duhet të aplikojnë metoda të paarsyeshme biznesi kur kryejnë Tregti dhe duhet të përpiqen gjithmonë të veprojnë në përputhje me praktikat e mira të biznesit.
- D.1.2.8 Anëtarët e Bursës duhet të respektojnë në çdo kohë dispozitat e Seksionit D.1 kur Tregtojnë. Papajtueshmëria me dispozitat e këtij Kapitulli mund të sanksionohet nga ALPEX-i në përputhje me dispozitat e Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat.
- D.1.2.9 ALPEX-i do të monitorojë tregjet e tij me qëllim që të garantojë që të gjitha Tregtimet dhe aktivitetet e tjera në Tregjet e ALPEX-it të jenë në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Ligjin në Fuqi. ALPEX-i mund të kryejë monitorime dhe kërkojë shpjegimet mbi aktivitetet e tregtimit të Anëtarëve të Bursës siç përcaktohet në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat.
- D.1.2.10 ALPEX-i mund të kërkojë dhe të mbledhë informacion nga Anëtarët e Bursës në lidhje me biznesin e tyre, dhe Anëtarët e Bursës bien dakord të japin çdo informacion të tillë të kërkuar pa vonesë.
- D.1.2.11 Çdo shkelje e këtij seksioni D.1 nëse nuk mund të rregullohet sipas këtyre Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat, do të konsiderohet si Mospërmbushje Detyrimesh.
- D.1.3 Angazhimi për transparencë**
- D.1.3.1 Anëtarët e Bursës do të mbështesin dhe bashkëpunojnë plotësisht me ALPEX-in në zhvillimin dhe zbatimin e masave për të rritur transparencën në Bursë në përputhje me Legjislacionin në Fuqi.
- D.1.3.2 Çdo Anëtar i Bursës do të bëjë publik çdo Informacion të Brendshëm siç përcaktohet në këto rregulla për Sjelljen në Treg në lidhje me Tregun e Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës për sa i përket biznesit ose objekteve që zotëron ose kontrollon Anëtari i Bursës në fjalë ose për çështjet operative për të cilat është përgjegjës ai Anëtar i Bursës, qoftë tërësisht ose pjesërisht.
- D.1.3.3 ALPEX-i i jep informacion publikut dhe në veçanti Anëtarëve të Bursës, sipas kërkesës, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. ALPEX-i do të sigurojë që zbulimi i detajeve dhe informacionit që zotëron të mos u japë avantazh tregtar ose konkurrencë në mënyrë të padrejtë palëve të treta dhe në veçanti Anëtarëve të Bursës.
- D.1.3.4 Detyrimi për të dhënë informacion është subjekt i respektimit të parimit të sekretit tregtar. Stafi i ALPEX-it ka gjithashtu detyrimin të respektojë parimin e konfidencialitetit.
- D.1.3.5 Është përgjegjësi e ALPEX-it që ta mbajë në mënyrë sa më transparente informacionin e përditësuar të tregut.
- D.1.3.6 Burimi kryesor i informacionit të tregut të publikuar do të jetë faqja zyrtare e internetit të ALPEX-it.
- D.1.3.7 I gjithë informacioni i tregut në faqen e internetit të ALPEX-it është publik në një format lehtësisht të aksesueshëm dhe që mund të përpunohet.

D.1.3.8 Informacionet shtesë dhe detajet teknike në lidhje me të dhënat e ofruara nga ALPEX-i mund të specifikohen me një Vendim Teknik të ALPEX-it, të publikuara në faqen e tij të internetit.

D.1.4 **Sjellja publike e Anëtarëve të Bursës**

D.1.4.1 Një Anëtar i Bursës duhet të sigurohet që çdo deklaratë publike që bën në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Bursë është e vërtetë dhe e saktë.

D.1.4.2 Anëtarët e Bursës nuk duhet të njollosin emrin e ALPEX-it duke bërë deklarata të rreme.

D.1.5 **Raportimi i menjëhershëm shkeljeve të dyshuara**

D.1.5.1 Nëse një Anëtar i Bursës zbulon ndonjë veprim që dyshohet si shkelje e Kapitullit D të këtyre Rregullave, mund të informojë menjëherë ALPEX-in.

D.1.5.2 Nëse ALPEX-i zbulon ose informohet për ndonjë veprim që dyshohet si shkelje e Kapitullit D të këtyre Rregullave të ALPEX-it, do të informojë Autoritetin Rregullator pa vonesë.

D.2 **KËRKESAT ORGANIZATIVE TË ANËTARËVE TË BURSËS**

D.2.1 **Aftësitë e Anëtarëve të Bursës**

D.2.1.1 Çdo Anëtar i Bursës do t'i organizojë aktivitetet e biznesit të tij në mënyrë të tillë që të përmbushë detyrimet e tij sipas Legjislacionit primar dhe sekondar në Fuqi në lidhje me Tregtimin në Bursë dhe Shlyerjen e Transaksioneve të tregut.

D.2.1.2 Anëtari i Bursës duhet të ketë dhe të mbajë infrastrukturën e përshtatshme organizative, operacionale dhe tekniko-ekonomike, si dhe mekanizmat e duhura dhe të përshtatshëm të kontrollit dhe sigurisë për përpunimin elektronik të të dhënave dhe procedurat e kontrollit të brendshëm në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Tregjet e ALPEX-it, dhe në veçanti për:

- (a) administrimin efektiv të rreziqeve si pasojë e pjesëmarrjes së tij në Tregjet e ALPEX-it dhe përmbushjen e detyrimeve përkatëse;
- (b) monitorimin e Klerimit pa probleme të tregtimeve të tij dhe përmbushjen e detyrimeve që ndërmerr, në lidhje me Klerimin e tregtimeve të tij, sipas rastit;
- (c) uljen e rrezikut për t'u përfshirë në ndonjë sjellje abuzive dhe në dëm të tregut;
- (d) monitorimin, menaxhimin dhe përmbushjen me efektivitet, sipas rastit, të detyrimeve të tij ndaj Autoritetit Kompetent, ALPEX-it, në lidhje me tregjet e ALPEX-it.

D.2.1.3 Anëtarët e Bursës duhet të kenë plane organizative që përfshijnë:

- (a) kontrollimin e aktiviteteve të tyre të Tregtimit;
- (b) Masat e duhura për menaxhimin e riskut;
- (c) Pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e përcaktuara në paragrafin C.1.1.

- D.2.1.4 Anëtarët e Bursës do të informojnë menjëherë ALPEX-in për çdo ndryshim në organizimin e tyre që mund të ndikojë në Tregtimin e rregullt ose në ekzekutimin si duhet të Transaksioneve.
- D.2.1.5 Anëtarët e Bursës duhet t'u përgjigjen kërkesave të ALPEX-it në lidhje me vlerësimin në detaje të aktivitetit të tyre nga ALPEX-i, gjatë shqyrtimit të aplikimit për tu bërë Anëtar i Bursës.

D.3 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E TREGUT

D.3.1 Kompetencat për Monitorim dhe Mbikëqyrje

- D.3.1.1 Anëtarët e Bursës janë të detyruar të japin çdo informacion që ALPEX-i e konsideron të rëndësishëm, në kontekstin e kryerjes së rolit të tij si monitorues ose në kontekstin e çdo hetimi të ndonjë shkeljeje të dyshuar në këtë Kapitull ose të përmbushin kërkesat ligjore në fuqi sa më shpejt të jetë e mundur pas një kërkesë me shkrim nga ALPEX-i.
- D.3.1.2 Çdo Anëtarë i Bursës pranon që ALPEX-i herë pas here, pavarësisht nëse një informacion i tillë është marrë në kontekstin e një hetimi ose jo, mund t'i japë Autoritetit Rregullator përkatës informacion mbi aktivitetin Tregtar dhe informacione të tjera shtesë. Një informacion i tillë mund t'u jepet gjithashtu grupeve të mbikëqyrjes së tregjeve të tjera përkatëse ose OST-ve, gjithmonë me kusht që të ketë një marrëveshje me shkrim ndërmjet ALPEX-it dhe këtij tregu ose OST-së që kufizon përdorimin e informacionit të përbashkët për qëllime të mbikëqyrjes së tregut dhe garanton trajtimin konfidencial të një informacioni të tillë.
- D.3.1.3 Komunikimi ndërmjet Anëtarëve të Bursës dhe ALPEX-it mund të përfshijë të dhëna personale të individëve deri në atë masë sa ky informacion të përfshihet në çdo komunikim përkatës ose në çdo komunikim të nevojshëm.
- D.3.1.4 Çdo informacion i marrë në përputhje me këtë Kapitull do të përdoret vetëm për qëllime të mbikëqyrjes të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Legjislacionit në Fuqi, përfshirë hetimin e veprimeve që dyshohen si shkelje.
- D.3.1.5 ALPEX-i do të ketë të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer detyrat e tij, përfshirë të drejtat:
- (a) të kryejë hetime në rastet kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka pasur shkelje të seksionit D.1.2;
 - (b) nëpërmjet njoftimit me shkrim, t'i kërkojë çdo Anëtar i Bursës (pavarësisht nëse Anëtar i Bursës është apo jo i dyshuar për një shkelje), që të japë informacion ose informacion specifik për një gjë të caktuar, ose të krijojë dokumente ose materiale specifike (në çfarëdo formati) sipas një përshkrimi specifik, i cili në vlerësimin e ALPEX-it ka të bëjë me ndonjë çështje që lidhet me hetimin, përfshirë dhënien e detajeve të përfituesit ekonomik të çdo Urdhërporosie, Transaksioni ose Kontrate.
- D.3.1.6 Nëse ALPEX-i njofton një Anëtar të Bursës sipas paragrafit D.3.1.5(b), atëherë Anëtar i Bursës duhet të veprojë në përputhje me njoftimin.

D.3.1.7 Pavarësisht nëse i ka ushtruar apo jo kompetencat e veta të hetimit në përputhje me paragrafin D.3.1.5., nëse ALPEX dyshon se një Anëtar i Bursës ka shkelur një dispozitë të sjelljes të përcaktuar në këtë Kapitull D, ALPEX-i do të njoftojë Autoritetin Rregullator përkatës për dyshimet e tij dhe mund t'i bëjë rekomandime Autoritetit Rregullator në mënyrë që të mbrojë interesat e Bursës dhe Anëtarëve të tij.

D.3.2 Papajtueshmëria

D.3.2.1 Një Ngjarje Papajtueshmërie ndodh në rastet kur nëse një Anëtar i Bursës:

- (a) nuk përmbush detyrimin e tij sipas dokumenteve dhe/ose marrëveshjeve që kanë lidhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrikeose përndryshe është në shkelje të këtyre Rregullave dhe dokumentacionit të lidhur me të; ose
- (b) është në shkelje të Legjislacionit në Fuqi dhe një shkelje e tillë ndikon ose do të ndikojë në aftësinë e Anëtarit të Bursës për të qenë në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike dhe dokumentacionit të lidhur me të.

D.3.2.2 Një Ngjarje Papajtueshmërie Materiale ndodh kur:

- (a) Anëtari i Bursës nuk është në përputhje me kërkesat sipas seksionit F.4.; ose
- (b) Anëtari i Bursës është në shkelje të Përfaqësimit sipas paragrafëve nga F.4.5.1(a) deri tek F.4.5.1(g) (përfshirë këtë të fundit) të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, me kusht që Përfaqësimi i shprehur sipas mendimit të ALPEX-it është i pasaktë ose të çon në drejtim të gabuar në aspektin material dhe nuk është korrigjuar brenda kohës së procesit të mosmarrëveshjeve pasi ALPEX-i i ka dërguar njoftim me shkrim Anëtarit të Bursës për një ngjarje të tillë Papajtueshmërie; ose
- (c) përfaqësimi i rremë tregon qartë se Anëtari i Bursës është i papërshtatshëm për Tregtim të mëtejshëm; ose
- (d) ndodh një Ngjarje Papajtueshmërie e cila mund të ndikojë negativisht tek Tregtimi sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Legjislacionit në Fuqi dhe Marrëveshjes së Anëtarësimit dhe kjo ngjarje Papajtueshmërie nuk korrigjohet brenda Kalendarit të Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, pasi ALPEX-i i ka dërguar njoftim me shkrim Anëtarit të Bursës për këtë Ngjarje Papajtueshmërie; ose
- (e) ngjarja e Papajtueshmërisë është shkaktuar nga neglizhenca, me dashje ose me anë të mashtrimit nga Anëtari i Bursës dhe një Ngjarje e tillë e Papajtueshmërie nuk korrigjohet brenda Kalendarit të Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, pasi ALPEX-i e ka njoftuar me shkrim Anëtarin e Bursës për një Ngjarje të tillë Papajtueshmërie; ose
- (f) Anëtari i Bursës nuk i paguan ALPEX-it ndonjë nga detyrimet e tij që lindin sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrikemenjëherë sapo ose përpara se këto detyrime të bëhen të detyrueshëm për tu paguar; ose
- (g) Një Ngjarje e Papajtueshmërisë (përveç siç përcaktohet në pikat a. deri e. të këtij paragrafi D.3.3.2.) nuk korrigjohet brenda Kalendarit me anë të Procesit

të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, pasi ALPEX-i e ka njoftuar me shkrim Anëtarin e Bursës për një Ngjarje të tillë Papajtueshmërie.

D.3.3 Ndarja e Informacionit me Autoritetet Përkatëse

D.3.3.1 Anëtarët e Bursës pranojnë se në kryerjen e funksioneve të tyre sipas Kapitullit D, ALPEX-i do të bashkëpunojë me entitetet e mëposhtme ("**Autoritetet Përkatëse**"):

- (a) Autoritetet Rregullatore;
- (b) Gjykatat e vendit; dhe
- (c) Çdo organ relevant që kryen mbikëqyrjen e tregut në përputhje me rregullat dhe rregulloret në fuqi.

D.3.4 Detyrimet e Anëtarëve të Bursës

D.3.4.1 Anëtarët e Bursës duhet të veprojnë menjëherë dhe në përputhje me të gjitha udhëzimet e një Autoriteti Përkatës ose të ALPEX-it në lidhje me Sjelljen e Tregut, monitorimin dhe mbikëqyrjen sipas këtij Kapitulli D.

D.3.4.2 Anëtarët e Bursës japin aprovimin e tyre të përvokueshëm që ALPEX-i të njoftojë Autoritetet Rregullatorë kur dyshon se një Urdhërporosi, Transaksion ose Kontratë mund të jetë në shkelje të Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT).

D.4 PASOJAT E SHKELJES SË DISPOZITAVE TË SJELLJES

D.4.1 Shkeljet e trajtuara sipas Kapitullit C

D.4.1.1 Nëse një Anëtar i Bursës shkel këtë Kapitull D, përfshirë dhe mospërbushjen e udhëzimeve sipas paragrafit D.3.4.1, atëherë aplikohen dispozitat e seksionit C.2.

E. KONTRATAT, PRODUKTET DHE SEGMENTET E TREGUT

E.1 QËLLIMI I KËTIJ KAPITULLI

E.1.1 Qëllimi

- E.1.1.1 Ky kapitull përshkruan konceptet e përdorura në Bursë.
- E.1.1.2 Konceptet dhe përshkrimet e bëra në këtë Kapitull i nënshtrohen përjashtimeve të përcaktuara në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.
- E.1.1.3 Dispozitat e detajuara përcaktohen në Procedurën e Tregtimit, e cila është pjesë përbërëse e këtyre rregullave.

E.2 KONCEPTET

E.2.1 Produktet dhe Llojet i Urdhërporosive

- E.2.1.1 Produktet mund të jenë, produkte orare, 30 minuta, 15 minuta dhe në bllok, sipas rastit kur janë të aplikueshme. Blloqet krijohen nga lidhja e më shumë se një produkti për të njëjtën Njësi Kohore Tregu.
- E.2.1.2 Një Lloji Urdhërporosie është një format i caktuar, sipas të cilit një Anëtar i Bursës duhet të dorëzojë një Urdhërporosi Shitjeje dhe/ose Blerjeje të energjisë elektrike në Bursë.
- E.2.1.3 Specifikimet e Llojeve të Urdhërporosive për Segmentet e Tregjeve të Ankandit të Ditës në Avancë, Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë dhe Segmentin e Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë të Bursës janë renditur në Shtojcën A të Procedurës së Tregtimit.
- E.2.1.4 ALPEX-i nuk është përgjegjës për asnjë kosto ose shpenzim të shkaktuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi kundrejt Anëtarëve të Bursës për shkak të ndryshimit të Llojeve të Urdhërporosive të ofruara.

E.2.2 Shtimi dhe heqja e Produkteve dhe Llojet e Urdhërporosive

- E.2.2.1 ALPEX-i mund të shtojë, modifikojë ose heqë Produktet dhe/ose Llojet e Urdhërporosive të disponueshme në Bursë duke modifikuar Procedurat në përputhje me Procesin për Ndryshim në Kapitullin J, ose në përputhje me procesin kalimtar në Kapitullin K, me kusht që:
 - (a) një vendim për të shtuar një Produkt dhe/ose një Lloj Urdhërporosi për Segmentet e Tregjeve të Ankandin e Ditës në Avancë, Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë dhe Segmentin e Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë duhet të marrë parasysh faktorët e:
 - (i) integritet rajonal i Tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës; dhe
 - (ii) ofruesit dhe operatorëve të sistemeve dhe shërbimeve të nevojshme për funksionimin e Bursës;

E.2.2.2 Anëtarët e Bursës mund të propozojnë modifikime për Produktet dhe/ose Llojet e Urdhërporosive ekzistuese ose pranimin e Produkteve dhe/ose Llojeve të Urdhërporosive të reja, në përputhje me Procesi për Ndryshim në Kapitullin J.

E.2.3 Urdhërporositë dhe dërgimi i informacionit në Interkonektor

E.2.3.1 Një Urdhërporosi përfaqëson ofertën e një Anëtari të Bursës për të shitur ose për të blerë energji elektrike brenda Zonave të Ofertimit të Shqipërisë dhe/ose Kosovës, në lidhje me një Portofol specifik, Njësi Kohore Tregu, vëllim të caktuar dhe çmimin në përputhje me specifikimet për Produktin në fjalë.

E.2.3.2 Urdhërporositë e dërguara në ALPEX nga Anëtarët e Bursës duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat në fuqi të përcaktuara në Procedurat dhe të përfshijnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- (a) Identifikimin e Anëtarit të Bursës;
- (b) Segmentin e Tregut të cilit i referohet Urdhërporosia;
- (c) Portofoli me të cilën lidhet Urdhërporosia;
- (d) Njësia Kohore e Tregut për të cilën aplikohet Urdhërporosia;
- (e) Sasia ose sasi të Urdhërporosisë;
- (f) Kufizimet e ekzekutimit nëse ka; dhe
- (g) nëse Urdhërporosia është një Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje.

E.2.3.3 ETSS mbledh Urdhërporositë në Librin e Urdhërporosive për çdo Segment të Tregut.

E.2.3.4 Në lidhje me Ankandet nga Koha e Mbylljes së Portës, të gjitha Urdhërporositë në Librin e Urdhërporosive do të konsiderohen se janë në proces Përputhje për këtë Libër Urdhërporosi.

E.2.3.5 Urdhërporositë e dorëzuara nga Anëtarët e Bursës qëndrojnë në Librin e Urdhërporosive deri kur:

- (a) Urdhërporosia është anuluar nga ose në emër të Anëtarit të Bursës që e ka vendosur atë;
- (b) ALPEX-i e anulon atë sipas këtyre Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike;
- (c) Anëtari i Bursës modifikon Urdhërporosinë; ose
- (d) Urdhërporosia është pranuar, refuzuar ose i ka mbaruar afati.

E.2.3.6 Anëtarët e Bursës janë përgjegjës për të garantuar që Urdhërporositë që ata dorëzojnë janë të sakta dhe pasqyrojnë qëllimet e tyre tregtare, ndërsa ALPEX-i:

- (a) nuk ka përgjegjësi për të ndjekur zbatimin e paraqitjes së një Urdhërporosie nga një Anëtar i Bursës apo çështje të tjera të informacionit që lidhen me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike;
- (b) nuk ka asnjë detyrim në lidhje me:
 - (i) në dështimin për të dorëzuar një Urdhërporosi; ose

- (ii) Urdhërporositë ose informacione të tjera të paraqitura sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të cilat përmbajnë të dhëna me gabime ose nuk janë të plota ose nuk janë të sakta, ose që nuk pasqyrojnë qëllimet e Anëtarit të Bursës që e dorëzon atë.

E.2.3.7 OST-të do të paraqesin informacionin e mëposhtëm tek ALPEX-i në lidhje me Interkonektorët përkatës:

- (a) Kapacitetin e disponueshëm Ndërkufitarë; dhe
- (b) të tjera informacione siç kërkohen nga Procedurat e këtyre rregullave.

E.2.4 Kontratat

E.2.4.1 Ekzistojnë dy lloje Kontratash:

- (a) Kontratat për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike brenda Zonave të Ofertimit; dhe
- (b) Kontratat e Bashkimit të Tregut lidhur me shitjen ose blerjen e energjisë elektrike midis dy Zonave të Ofertimit.

E.2.4.2 Njoftimi i një Transaksioni nga ETSS në EMCS në përputhje me paragrafin F.2.9.1 krijon një Kontratë për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Anëtarit të Bursës që ka dorëzuar Urdhërporosinë përkatëse dhe ALPEX-it.

E.2.4.3 Një Kontratë e krijuar në referim të paragrafit E.2.4.2. për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike është një angazhim i qëndrueshëm dhe i përvokueshëm në lidhje me Njësinë Kohore të Tregut përkatës:

- (a) Në rastin e një Kontrate për blerjen e energjisë elektrike, blerësi do të marrë sasinë e energjinë elektrike të kontraktuar dhe do të shlyejë financiarisht kontratën me çmimin e specifikuar; dhe
- (b) Në rastin e një Kontrate për shitjen e energjisë elektrike, shitësi do të livrojë sasinë e energjinë elektrike dhe do të shlyhet financiarisht për kontratën me çmimin e specifikuar;

Me përmbushjen e detyrimeve të Livrimit nëpërmjet transferimit të pozicionit të blerjes dhe të shitjes nga ALPEX-i tek OST-ët për qëllim të Tregut të Balancimit në përputhje me Procedurat e Tregut dhe Procedurat e Klerimit dhe Shlyerjes.

E.2.4.4 Njoftimi nga ETSS në EMCS, në përputhje me paragrafin F.2.9.2 krijon një Kontratë të Bashkimit të Tregjeve, me sasi të dhe çmimet e përcaktuar nga zgjidhja e bashkimit të çmimeve.

E.2.4.5 Shlyerja e pagesave për OST-n dhe KOSTT-in për të Ardhurat nga Kongjestionimi, nën të cilën OST-ja dhe KOSTT-i kanë transferuar të Drejtat e Transmetimit Fizik për Interkoneksionet përkatëse tek ALPEX-i.

E.2.5 Zonë Ofertimi

E.2.5.1 Zonë Ofertimi është një zonë tregtare brenda së cilës Anëtarët e Bursës marrin pjesë në Bursë dhe e kanë të mundur të shkëmbejnë energjinë pa alokim të kapaciteteve.

E.2.6 Segmentet e Tregut

E.2.6.1 Në Bursë ekzistojnë Segmentet e mëposhtme të Tregut:

- (a) Ankandi i Ditës në Avancë;
- (b) Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë; dhe
- (c) Tregtimi i Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë.

E.2.6.2 Ankandi

- (a) Gjatë Ankandit, të gjitha Urdhërporositë e dorëzuara nga Koha e Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës pranohen për ekzekutim nga ETSS-ja. Të gjitha Urdhërporositë e pranuar sipas rregullave të aplikueshme të vlefshmërisë, sipas rastit, futen në Librin e Urdhërporosive pasi marrin gjurmën e kohës përkatëse;
- (b) me përfundimin e Kohës së Mbylljes së Portës së Ankandit, të gjitha Urdhërporositë e pranuar të blerjes dhe shitjes mbledhen nga Libri i Urdhërporosive dhe më pas algoritmi llogarit balancimin e energjise elektrike të tregtuar, sasisë e pranuar të Urdhërporosive të Blerjes dhe Shitjes dhe çmimin e balancuar në çdo Ankand.

E.2.6.3 Tregtimi i Vazhdueshëm

- (a) Gjatë Tregtimit të Vazhdueshëm, të gjitha Urdhërporositë që janë dorëzuar nga Koha e Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës pranohen për ekzekutim nga ETSS-ja. Me dorëzimin e tyre në ETSS, Urdhërporositë e pranuar sipas metodës së Tregtimit të Vazhdueshëm, regjistrohen në Librin e Urdhërporosive pasi marrin gjurmën e kohës përkatëse.
- (b) Libri i Urdhërporosive Lokale përfshin Urdhërporositë e Blerjes dhe Shitjes të cilat regjistrohen sipas kriterëve të renditjes së tyre.
- (c) Urdhërporositë të cilat, në kohën e hyrjes së tyre në ETSS, nuk plotësojnë kriteret e përputhshmërisë për tregtimet e ekzekutuara automatikisht, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe sipas llojit të Urdhërporosisë, regjistrohen në Librin e Urdhërporosive. Urdhërporositë renditen sipas llojit të Urdhërporosisë për Blerje ose Shitje.
- (d) Çdo Urdhërporosi renditet, sipas llojit, në bazë të kriterëve të mëposhtme:
 - (i) Çmimit më të mirë: Urdhërporosi Blerjeje renditen sipas përparësisë në bazë të çmimit më të lartë, ndërsa Urdhërporosi Shitjeje renditen në bazë të çmimit më të ulët.
 - (ii) Koha: Urdhërporosi me të njëjtin çmim renditen sipas përparësisë në bazë të kohës së hyrjes në ETSS.
- (e) Në bazë të kriterëve të renditjes, Urdhërporositë kryhen si më poshtë: Në kohën e hyrjes në ETSS, kufiri i çmimit të një Urdhërporosi Blerjeje duhet të jetë i barabartë ose më i lartë se çmimi më i mirë i një Urdhërporosi të Shitjes të regjistruar dhe, në rastin e një Urdhërporosi Shitjeje, kufiri i çmimit duhet të jetë i barabartë ose nën çmimin më të mirë të Urdhërporosive të regjistruar për Blerje.

E.2.6.4 Detajet e tregtimit për çdo Segment Tregu përshkruhen në Procedurën e Tregtimit, e cila është pjesë përbërëse e këtyre Rregullave.

F. TREGTIMI

F.1 QËLLIMI I KËTIJ KAPITULLI

F.1.1 Të përgjithshme

F.1.1.1 Ky Kapitull përcakton:

- (a) Parimet e tregtimit që zbatohen në të gjitha Segmentet e Tregut në Bursë;
- (b) Rastet e përjashtuara nga tregtimi i zakonshëm; dhe
- (c) Kërkesat e përgjithshme të Anëtarëve të Bursës për Tregtim.

F.1.1.2 Dispozitat e detajuara të tregtimit përcaktohen në Procedurat dhe në dokumentacionin teknik të specifikuar në Procedura.

F.2 PARIMET PËR TREGTIM

F.2.1 Sistemi i Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)

F.2.1.1 ALPEX-i ka mekanizmat dhe procedurat për garantimin e operimit pa probleme, normal dhe të sigurt të ETSS-së në përputhje me specifikimet e përcaktuara në dispozitat e aplikueshme dhe praktikat më të mira të tregut.

F.2.1.2 ETSS-ja ka një tjetër sistem në gatishmëri, i cili në vetvete është sistem i pavarur elektronik dhe që do të aktivizohet në rast të mosfunksionimit të sistemit kryesor.

F.2.1.3 Anëtarët e Bursës kanë të drejtën e hyrjes së drejtpërdrejtë në informacionin e bazës së të dhënave të ETSS-së që ka të bëjë me ta.

F.2.1.4 ETSS mbështet në veçanti operacionet e mëposhtme:

- (a) regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të Anëtarëve të Bursës;
- (b) regjistrimin e Produkteve dhe Llojeve të pranuar të Urdhërporosive;
- (c) përpunimin dhe regjistrimin e Urdhërporosive;
- (d) përpunimin dhe regjistrimin e Kufirit të Kreditit në përputhje me dispozitat të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes;
- (e) ndërfaqen e tij me sistemin e menaxhuar nga ALPEX-i në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes;
- (f) ndërfaqen me sistemin e menaxhimit të tregut të OST-ve;
- (g) ndërfaqen me platformën e përdorur nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve për Ankandet e Ditës në Avancë dhe Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë;
- (h) ndërfaqen me platformën elektronike e përdorur si pjesë e operimit të Tregtimit të Vazhdueshëm Pan-Evropian Brenda së Njëjtës Ditë (p.sh XBID);
- (i) krijimin e Kurbës së Grupuar anonime të Urdhërporosive dhe dërgimin tek Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve;

- (j) pranimi i rezultatit në mënyrë anonime i bashkimit të tregjeve, dekriptimi i rezultateve në lidhje me Anëtarin e Bursës dhe Aseteve që kanë të bëjnë me ta;
 - (k) njoftimi i rezultateve të tregut tek Anëtarët e Bursës.
- F.2.1.5 Për qëllim të kryerjes së tregtimeve nëpërmjet ETSS, Anëtarët e Bursës transmetojnë në formë elektronike nga pajisjet e tyre të punës Urdhërporositë përkatëse.
- F.2.1.6 ETSS-ja përdoret gjithashtu në rastin e zbatimit të Procedurave Alternative në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- F.2.1.7 Hyrja në ETSS mundësohet nga ALPEX-i për përdoruesit e autorizuar të Anëtarëve të Bursës në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- F.2.1.8 ALPEX-i ka autoritetin të shkëpusë lidhjen e një Anëtari Burse në rast të rrethanave të jashtëzakonshme të mosfunksionimit teknik të ETSS-së ose kur Anëtari i Bursës nuk vepron në përputhje me specifikimet dhe udhëzimet teknike të ALPEX-it ose kur ALPEX-i zbulon përdorimin e paautorizuar të lidhjes së Anëtarit të Bursës në ETSS ose kur ekziston një arsye tjetër për marrjen e masave.
- F.2.1.9 ALPEX-i mban të dhënat e hyrjeve të Anëtarëve të Bursës në ETSS.
- F.2.2 Realizimi i Transaksioneve dhe Tregtimi**
- F.2.2.1 Tregtimi në Bursë përfshin Përputhjen e Urdhërporosive të blerjes dhe shitjes të paraqitura nga Anëtarët e Bursës.
- F.2.2.2 Alokimi i Portofolit (p.sh Rregulli i Pranimit të Urdhërporosive) duhet të përfshihet në Procedurën e Tregtimit.
- F.2.2.3 Një Transaksion në Segmentet e Tregjeve të Ankandeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë ndodh në Bursë kur një Urdhërporosi në një Libër të Urdhërporosive është Përputhur sipas algoritmit evropian (p.sh algoritmi EUPHEMIA).
- F.2.2.4 Tregtimet në Tregjet e Energjisë Elektrike kryhen në mënyrë elektronike dhe anonime.
- F.2.2.5 Tregtimi kryhet nëpërmjet Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) në përputhje me dispozitat Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat.
- F.2.2.6 Orët e tregtimit në Tregjet e ALPEX-it shpallen në Kalendarin e Tregtimit nga ALPEX-i në faqen e tij zyrtare të internetit. Kalendari i Tregtimit shpallet dy (2) muaj para përfundimit të çdo viti për vitin pasardhës dhe përditësohet, nëse kërkohet, me Vendim Teknik të ALPEX-it të lëshuar në të njëjtën Ditë kur ALPEX-i vihet në dijeni të arsyes për përditësimin e Kalendarit të Tregtimit.
- F.2.3 Përdoruesit e autorizuar**
- F.2.3.1 Përdorimi i ETSS-së për të dorëzuar Urdhërporosi në Tregjet e ALPEX-it për ti ekzekutuar tregtimet u lejohet vetëm Agjenteve Tregtarë të Certifikuar e të autorizuar nga Anëtarët e Bursës.

F.2.3.2 Anëtarët e Bursës duhet t'i japin ALPEX-it informacionin mbi përdoruesit e tyre dhe çdo informacion tjetër përkatës që ka të bëjë me ndërlidhjen në ETSS, si dhe çdo ndryshim të këtij informacioni.

F.2.4 **Kontrolli i përdoruesit**

F.2.4.1 Anëtarët e Bursës janë të detyruar të krijojnë procedura të veçanta të auditimit të brendshëm për monitorimin e detyrave të kryera nga përdoruesit e ETSS-së.

F.2.4.2 ALPEX-i, mund të ndalojë ndërlidhjen e përdoruesit në ETSS, nëse ka raste të vendosjes së masave sipas dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

F.2.5 **Libri i Urdhërporosisë**

F.2.5.1 Libri i Urdhërporosisë është një listë elektronike e Urdhërporosive të blerjeve dhe shitjeve. Librat e Urdhërporosive mbahen nga ALPEX-i për çdo Segment Tregu, Njësi Kohore Tregu dhe Ditë Livrimi.

F.2.5.2 Librat e Urdhërporosive hapen dhe mbyllen në datën dhe orën e përcaktuar në përputhje me Procedurën e Tregtimit, sipas Segmentit të Tregut me të cilin lidhen. Në momentin që Libri i Urdhërporosive është i hapur, Anëtarët e Bursës mund të dërgojnë Urdhërporosi për një Segment Tregu të specifikuar, në përputhje me Procedurën e Tregtimit.

F.2.5.3 Libri i Urdhërporosisë dhe Transaksionet do të jenë anonime.

F.2.6 **E drejta për të refuzuar Urdhërporositë**

F.2.6.1 Pavarësisht çdo dispozite tjetër të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, sipas përcaktimit të tij ALPEX-i rezervon të drejtën, në liri të plotë veprimi dhe pa njoftim paraprak për Anëtarin e Bursës, që të mos pranojë, të anulojë ose refuzojë të shfaqë ose të përputhë çdo Urdhërporosi, që do të binte ndesh me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike ose Legjislacionin në Fuqi. Çdo vendim i tillë duhet të jetë i bazuar në mënyrë të arsyeshme dhe ALPEX-i duhet të njoftojë menjëherë Anëtarin e Bursës për këtë vendim.

F.2.7 **Proceset e Përputhjes dhe pas Përputhjes**

F.2.7.1 Kur ndërmerren proceset sipas seksionit F.2.7, ALPEX-i duhet:

- (a) Të zbatojë rregullat që përshkruhen në Procedurat, pjesë përbërëse e këtyre Rregullave;
- (b) T'u siguroj trajtim të drejtë dhe jodiskriminues Anëtarëve të Bursës;
- (c) Të sigurojë që çmimet e Transaksioneve të jenë të dukshme në ETSS vetëm pasi të kenë dalë Rezultatet Paraprake të Tregut të Bashkuar.

F.2.7.2 Për Segmentet e Tregut të Ankandit të Ditës në Avancë dhe Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë:

- (a) ALPEX-i do të anonimizojë dhe do të dërgojë Urdhërporositë duke i bashkuar në një Libër të mbyllur Urdhërporosish së bashku me Kapacitetet e

disponueshme Ndërkufitare dhe kufizimet e alokimit tek, Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve;

- (b) Urdhërporositë dhe informacionet e dërguara nga ALPEX-i do të futen në procesin e Bashkimit të Tregut së bashku me Urdhërporositë dhe informacionin në lidhje me të njëjtin Segment të Tregut të dërguara nga NEMO-t e tjera, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi në Bashkimin e Tregjeve;
- (c) Anëtarët e Bursës pranojnë se, në rastin e Segmenteve të Tregjeve të bashkuara, përpara se ALPEX-i të publikojë rezultatet e Ankandit, Operatori i Sistemit të Transmetimit të Zonës së bashkuar të Ofertimit mund:
 - (i) Të verifikojë elementet e rezultateve;
 - (ii) Të mos pranojë elemente që janë të papajtueshme me Kapacitetin Ndërkufitar dhe kufizimet e alokimeve të ofruara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit; dhe
- (d) Duke zbatuar rezultatet e ofruara nga Operatori i Ofruesit të Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve përkatëse, ALPEX-i duhet të përcaktojë statusin e ekzekutimit të çdo Urdhërporosie dhe Informacionin e Transaksioneve në Interkonektorë.

F.2.7.3 Për Segmentin e Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë:

- (a) Anëtarët e Bursës mund të dorëzojnë Urdhërporositë të cilat do të jenë anonime dhe të shfaqura në ETSS; dhe
- (b) Në mënyrë që të Përputhen Urdhërporositë, volumi, çmimi dhe çdo kufizim i specifikuar i një Urdhërporosie Shitjeje është Përputhur me volumin, çmimin dhe kufizimin përkatës të një Urdhërporosie Blerjeje për të njëjtën Njësi Kohore Tregu.

F.2.7.4 Kur është e nevojshme, ALPEX-i mund të zbatojë rregullat e trajtimit të barabartë në lidhje me rezultatet e Segmenteve të Tregut të Ankandit të Ditës në Avancë dhe Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë, në përputhje me Procedurat.

F.2.7.5 ALPEX-i duhet të publikojë rezultatet e Ankandit dhe të dhëna të tjera përkatëse për secilin Segment Tregu në përputhje me Procedurat.

F.2.8 **Publikimi i të dhënave**

F.2.8.1 ALPEX-i duhet ti publikojë të Dhënat e tregut në përputhje me Procedurat për publikimin e tyre.

F.2.9 **Njoftimi mbi informacionin e tregtimit tek EMCS-ja**

F.2.9.1 ETSS-ja do të njoftoj EMCS-në për të tilla informacione në çdo Transaksion siç kërkohet nga EMCS-ja, duke përfshirë:

- (a) Segmentin e Tregut të ALPEX-it;
- (b) Kodin EIC të Anëtarit të Bursës;
- (c) Kodin EIC të Aseteve për të cilat Transaksionet janë përfunduar, nëse është rasti;

- (d) Llojin e Urdhërporosisë;
- (e) Transaksionin e Blerjes ose Shitjes;
- (f) Sasinë dhe Çmimin e Klerues të energjisë elektrike;
- (g) Vlerën e Transaksionit;
- (h) Ditën e Livrimit të Tregtimeve;
- (i) Njësinë Kohore të Tregut të cilës Transaksionet i përkasin;
- (j) Monedhën e Tregtimit në EUR; dhe
- (k) Kodin e Llogarisë së Klerimit.

F.2.9.2 ETSS-ja do të njoftojë gjithashtu EMCS-në për informacionin e mëposhtëm (**Informacioni i Transaksionit në Interkonektor**) që vjen si rezultat i një Ankandi në lidhje me çdo Interkonektor:

- (a) Segmentin e Tregut të ALPEX-it;
- (b) Interkonektorin përkatës dhe Agjentin e Transaksioneve;
- (c) Sasinë e përcaktuar dhe drejtimin e energjisë elektrike të transferuar;
- (d) Njësinë Kohore të Tregut përkatës; dhe
- (e) Informacione të tjera siç kërkohen nga Procedurat.

F.2.10 **Monedha**

F.2.10.1 Tregtimi në Segmentet e Tregut të Ankandeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë do të jetë në Euro për Urdhërporositë e dorëzuara nga Zonat e Ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës.

F.2.10.2 Tregtimi në Segmentet e Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë do të bëhet në Euro për Urdhërporositë e dorëzuara nga Zonat e Ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës.

F.3 **RASTET PËRJASHTIMORE NGA TREGTIMI I ZAKONSHËM, KLERIMI DHE SHLYERJA**

F.3.1 **Të përgjithshme**

F.3.1.1 Pavarësisht nga dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, nëse linden rrethana, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- (a) mos funksionimin ose mosdisponueshmërinë e sistemeve, proceseve, të dhënave ose informacionit;
- (b) Urdhërporosi Blerjeje dhe Shitjeje të pa Përputhura;
- (c) Ndarjen e Tregjeve (decoupling);
- (d) mos funksionimin e EMCS (për çfarë do lloj arsyes) për të kleruar dhe të shlyer financiarisht Kontratat: ose
- (e) shfaqjen me gabime e të dhënave të dorëzuara,

dhe këto rrethana mund të:

- (f) ndikojnë thelbësisht në aftësinë e Anëtarëve të Bursës për të dërguar Urdhërporosi ose për të transmetuar ose për të marrë të dhëna tek ose nga ETSS;
- (g) mos lejojnë mbylljen e Librit të Urdhërporosive;
- (h) pengojnë zhvillimin e një ankandi në rrethana normale dhe dërgimin e rezultateve të Ankandit brenda Kufijve Minimal ose Maksimal të Lejuar të Çmimit të Ankandit;
- (i) mos lejojnë Klerimin dhe Shlyerjen e një Kontrate;
- (j) rezultojnë të pasakta në rezultatet e Ankandit ose transaksionit; ose
- (k) parandalojnë, kufizojnë ose prishin funksionimin normal të një Ankandi ose të Segmentit të Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë, ose kërcënojnë integritetin ose funksionimin e rregullt dhe të drejtë të Bursës,

Atëherë ALPEX-i mund të marrë ndonjë nga masat e përcaktuara në paragrafin F.3.1.2.

F.3.1.2 Në rrethanat e përcaktuara në paragrafin F.3.1.1, ALPEX-i mund të marrë masat e mëposhtme, që i konsideron të përshtatshme, për rregullimin e situatës:

- (a) të zhvillojë një Ankand Lokal për Zonën e Ofertimit, pa Bashkimin e Tregjeve;
- (b) të shtyjë ose të ndryshojë kohën në të cilën Libri i Urdhërporosisë mbyllet ose kohën kur publikohet rezultati;
- (c) të autorizojë Anëtarët e Bursës për të vendosur Urdhërporosi të reja ose për të ndryshuar Urdhërporositë ekzistuese dhe nëse e bën këtë, ALPEX-i do t'u mundësojë Anëtarëve të Bursës një afat të ri për mbylljen e Librit të Urdhërporosive;
- (d) të zhvillojë një Ankand të dytë në përputhje me Procedurat;
- (e) të zbatojë Procedurën Alternative në përputhje me Procedurat;
- (f) të anulojë një ose më shumë Urdhërporosi ose një Ankand; ose
- (g) të marrë ndonjë masë tjetër që konsideron, se do të zbusë në mënyrë efektive rrethanat që dalin sipas paragrafit F.3.1.1.

F.3.1.3 Nëse koha e Mbylljes së Librit të Urdhërporosive vonohet ndjeshëm, atëherë ALPEX-i do të njoftojë Anëtarët e Bursës sa më shpejt të jetë e mundur.

F.3.2 **Pezullimi i Tregimit të një Produkti dhe Urdhërporosie**

F.3.2.1 ALPEX-i mund të pezullojë tregtimin e një Produkti/Urdhërporosi ose Produkteve/Urdhërporosive të caktuara nëse gjykon se rrezikohet tregtimi i rregullt në Bursë për arsye teknike (përfshirë rastet kur konsiderohet e nevojshme kryerja e testeve të mëtejshme) ose nëse e konsideron të nevojshme në këndvështrimin e Objektivave ose Parimeve të ALPEX-it.

F.3.2.2 Nëse ALPEX-i pezullon tregtimin e një Produkti/Urdhërporosi:

- (a) Me anë të një Njoftimi për Tregun, ALPEX-i do të njoftojë pa vonesë Anëtarët e Bursës për pezullimin;
 - (b) Asnjë Urdhërporosi e re nuk do të futet në Librin e Urdhërporosive duke përdorur Produktin/Llojin e Urdhërporosisë së pezulluar; dhe
 - (c) ALPEX-i do të anulojë të gjitha Urdhërporositë ekzistuese që përfshijnë Produktin/Llojin e Urdhërporosisë së pezulluar.
- F.3.2.3 Në rast të likuiditetit të kufizuar ose funksionimit të parregullt të një Produkti/Lloji Urdhërporosie e caktuar, që mund të dëmtojë funksionimin e atij Tregu ose ta bëjë funksionimin e tij joefikas, ALPEX-i pas marrjes së opinionit të Komitetit të Bursës, do të njoftojë Autoritetin Rregullator për pezullimin e funksionimit të tij për një periudhë të caktuar kohore. Në këtë rast Komiteti i Bursës duhet të mbledhet brenda dy Ditëve nga kërkesa e ALPEX-it, në të kundërt ALPEX-i ka të drejtë të njoftojë Autoritetin Rregullator pa pritur opinionin e Komitetit të Bursës.
- F.3.2.4 Autoriteti Rregullator, me vendim të tij, mund të pezullojë funksionimin e Produktit ose Llojin e Urdhërporosisë dhe të përcaktojë periudhën e pezullimit.
- F.3.2.5 Një procedurë e caktuar do të ndiqet për të anuluar pezullimin e funksionimit të Produkteve / Llojeve të Urdhërporosive.
- F.3.2.6 ALPEX-i mund ta riaktivizojë një Produkt/Lloj të Urdhërporosisë të pezulluar më parë duke e bërë atë të disponueshëm për tregtim, me arsyetimin që:
- (a) ALPEX-i konsideron që riaktivizim i Produktit/Llojit të Urdhërporosisë nuk do të rrezikojë tregtimin e rregullt në Bursë; dhe
 - (b) ALPEX-i ka nxjerrë një Njoftim për Tregun tek Anëtarët e Bursës që përmban Datën Efektive për riaktivizim e Produktit/Llojit të Urdhërporosisë që do të paraqitet për Ditën e Livrimit dhe Njësinë Kohore të Tregut përkatës duke marrë në konsideratë karakteristikat e Produktit dhe rrethanat që çuan në këtë pezullim.

F.4 KËRKESAT NDAJ ANËTARËVE TË BURSËS DHE KUSHTET PËR TREGTIM

F.4.1 Anëtarësimi aktiv

F.4.1.1 Tregtimi në Bursë do të kryhet vetëm nga një Anëtar i Bursës që nuk është subjekt i Ndalimit të Tregtimit sipas seksionit C.2.4 ose një Urdhër për Pezullim sipas seksionit C.2.

F.4.2 Kërkesat teknike

F.4.2.1 Në mënyrë që të sigurohet funksionimi i rregullt i Bursës, çdo Anëtar i Bursës duhet:

- (a) të jetë në përputhje me rregullat që kanë të bëjnë me kërkesat teknike, infrastrukturën dhe aksesin e përcaktuar në Kapitullin I, në Procedurat, ose në dokumentacionin teknik të përcaktuar në Procedurat;
- (b) të ketë në dispozicion infrastrukturën e duhur teknike për të garantuar tregtimin korrekt nëpërmjet ETSS dhe Klerimin korrekt nëpërmjet EMCS për rastin e një Anëtari Personal të Klerimit.

- (c) të mbajë në gjendje të mirë infrastrukturën teknike dhe të garantojë gatishmërinë për operim të vazhdueshëm; dhe
 - (d) të sigurojë që disponon personelin e mjaftueshëm dhe të kualifikuar për Tregtim dhe Klerim në rastin e një Anëtari Personal të Klerimit.
- F.4.2.2 Për të zbatuar në mënyrë efektive dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, ALPEX-i mund të nxjerrë Vendime Teknike që rregullojnë vetëm çështjet teknike të natyrës jo-rregullative për Anëtarët e Bursës.
- F.4.2.3 Vendimet Teknike bëhen publike në faqen e internetit të ALPEX-it dhe hyjnë në fuqi nga data e publikimit. Nëse konsiderohet i përshtatshëm për zbatimin pa probleme të marrëveshjes, mund të shtyhet hyrja në fuqi ose mund të aplikohen kushte shtesë kalimtare të cilat ndikojnë në vlefshmërinë e këtij Vendimi Teknik. Në këtë rast, në këtë Vendim Teknik bëhet një referim i veçantë.
- F.4.2.4 Në rast konflikti ndërmjet Vendimeve Teknike të ALPEX-it dhe dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, do të mbizotërojnë dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- F.4.3 Agjentet Tregtarë të Certifikuar**
- F.4.3.1 Çdo Anëtar i Bursës duhet që të caktojë një (1) Agjent Tregtar të Certifikuar për Tregtim në emër të Anëtarit të Bursës në secilin prej Tregjeve të ALPEX-it ku Anëtari merr pjesë, miratimi i të cilit nuk do të ndalohej pa arsye nga ALPEX-i. Anëtari i Bursës mund të caktojë të njëjtin person si Agjent Tregtar të Certifikuar në disa Tregje të ALPEX-it.
- F.4.3.2 Përveçse kur është rënë dakord ndryshe me ALPEX-in, Agjenti Tregtar i Certifikuar do të ketë qasje të plotë në ETSS në lidhje me të gjitha Portofolat e Tregtimit të Anëtarit respektive të Bursës për secilin nga Tregjet e ALPEX-it për të cilët ai është caktuar. Çdo Anëtar i Bursës duhet të sigurojë që Agjenti i tij Tregtar i Certifikuar të jetë plotësisht i autorizuar të përfaqësojë Anëtarin e Bursës në ALPEX në të gjitha çështjet që lidhen me Tregtimin e Anëtarit të Bursës në secilin Treg të ALPEX-it për të cilën ai është emëruar. Agjenti Tregtar i Certifikuar do të jetë në gjendje të ndërmarrë një veprim në mënyrën e duhur në lidhje me afatet kohore ditore dhe kërkesat e tjera në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrikenë tërësinë e tyre.
- F.4.3.3 Mbas marrjes të një njoftimi me shkrim nga Anëtari i Bursës për tërheqjen e emërimit të një Agjenti Tregtar të Certifikuar, ALPEX-i do t'i dërgojë një konfirmim me shkrim për marrjen e këtij njoftimi dhe do të ndalojë hyrjen e Agjentit Tregtar të Certifikuar në ETSS sa më shpejt që të jetë e mundur. Pavarësisht marrjes së konfirmimit me shkrim nga ALPEX-i lidhur me marrjen e njoftimit nga Anëtari i Bursës, ky i fundit do të mbetet i lidhur dhe përgjegjës për të gjitha veprimet ose mosveprimet e Agjentit Tregtar të Certifikuar lidhur me Tregtimin gjatë periudhës që ky Agjent ka të drejtën e hyrjes në ETSS, derisa ALPEX-i të ketë konfirmuar me shkrim se hyrja e Agjentit Tregtar të Certifikuar në ETSS ka përfunduar.
- F.4.3.4 Në rast se Agjenti Tregtar i Certifikuar është revokuar, ALPEX-i do të dorëzojë Anëtarit të Bursës një Llogari Përdoruesi të re për hyrjen në ETSS për një Treg të

caktuar të ALPEX-it, vetëm pasi Anëtari i Bursës të ketë emëruar një Agjent të ri Tregtar që duhet Certifikuar nga ALPEX-i.

F.4.3.5 Anëtari i Bursës është përgjegjës për Llogarinë e Përdoruesit për hyrjen në ETSS për Tregjet e ALPEX-it, dhe për të gjitha veprimet dhe aktivitetet që kryhen lidhur me Llogarinë e Përdoruesit nga momenti që Anëtari i Bursës merr detajet e Llogarisë së Përdoruesit deri në momentin që ALPEX-i pezullon Llogarinë e Përdoruesit sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë. Përgjegjësia për Llogarinë e Përdoruesit përfshin detyrimin për dëmet (për ALPEX-in ose Anëtarin) nga përdorimi i paautorizuar i Llogarisë së Përdoruesit.

F.4.3.6 Për më tepër, Anëtari i Bursës mund të kërkojë hapjen e një Llogarie Përdoruesi për shërbimin API për hyrjen në ETSS. Në mënyrë që ALPEX-i të hapë një Llogari Përdoruesi për një Anëtar për shërbimin API për hyrje në ETSS, Anëtari i Bursës është i detyruar t'i dërgojë ALPEX-it një kërkesë të plotësuar për shërbimin API.

F.4.4 **Portofolet e Tregtimit**

F.4.4.1 Anëtarëve të Bursës do t'u jepen Portofole për Tregtim, subjekt i miratimit paraprak nga ALPEX-i (cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme) në bazë të kërkesës se tyre për të marr pjesë në Tregjet e ALPEX-it.

F.4.5 **Përfaqësimet nga Anëtari**

F.4.5.1 Çdo Anëtar përfaqëson dhe garanton ALPEX-in në çdo datë në të cilën është paraqitur një Urdhërporosi ose është lidhur një Transaksion që:

- (a) **Autoriteti:** Ka autoritetin të kryejë detyrimet e tij sipas këtyre Rregullave të ALPEX-it ose Procedurat ose Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë dhe çdo Transaksion;
- (b) **Statusi:** Është i organizuar siç duhet dhe ekziston në mënyrë të vlefshme në bazë të ligjeve dhe juridiksionit për sipërmarrjen;
- (c) **Organizata:** Ka personel të përshtatshëm dhe të organizuar për të kryer veprimtarinë, dhe personeli i saj ka kompetencat dhe njohuritë e nevojshme për Tregtim;
- (d) **Vlerësimi i rrezikut:** Është i vetëdijshëm dhe i kupton karakteristikat e secilit prej Produkteve dhe rreziqet që lidhen me të, dhe ka paraqitur Urdhërporosi pasi ka patur mundësi të plotë për të shqyrtuar termat dhe kushtet e tyre dhe ka një kuptueshmëri të përshtatshme të këtyre termave dhe kushteve dhe të rreziqeve të tyre, dhe është i aftë të marrë përsipër këto rreziqe;
- (e) **Nuk ka shkelje ose konflikt:** Ekzekutimi, dorëzimi dhe zbatimi i Marrëveshjes përkatëse për Anëtarësimin në Bursë ose Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat nuk shkelin ose bien në kundërshtim me ndonjë Ligj të Zbatueshëm ose ndonjë dispozitë të dokumenteve të tij kushtetuese të zbatueshme për Anëtarin ose ndonjë nga asetet e tij, ose çdo kufizim kontraktual ose që prek atë ose ndonjë nga asetet e tij;
- (f) **Autorizimet e kërkuara:** Të gjitha Autorizimet e Kërkuara sipas Legjislacionit në Fuqi janë marrë dhe janë plotësisht të vlefshme, kanë përmbushur të gjitha

kushtet e autoriteteve dhe nuk ka licenca ose dosje të mëtejshme ose akte të tjera për t'u marrë nga Anëtari i Bursës në përputhje me ndonjë Autoritet Rregullator ose Gjykatë në lidhje me Tregtimin ose Klerimin;

- (g) **Informacion i Saktë:** Të gjitha informacionet e zbatueshme që dërgohen me shkrim nga ose në emër të Anëtarit të Bursës i cili është i lidhur ose identifikohet si subjekt ose i lidhur me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, është i vërtetë, i saktë dhe i plotë në çdo aspekt material dhe që nga data kur i dërgohet ALPEX-it;
- (h) **Pajtueshmëria:** Asnjë Ngjarje e Papajtueshmërisë ose Ngjarje e Papajtueshmërisë Materiale ose ngjarje që me njoftim ose me mungesë kohe ose të dyja do të përbënin një Ngjarje e Papajtueshmërisë ose Ngjarje të Papajtueshmërisë Materiale që ka ndodhur në lidhje me të dhe asnjë ngjarje e tillë nuk do të ndodhte si rezultat i hyrjes ose kryerjes së detyrimeve të saj sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë.

F.4.5.2 Anëtari, kur kryen Tregtimin, konsiderohen të zbatueshme Përfaqësimet e specifikuar më sipër si dhe çdo përfaqësim të mëtejshëm të specifikuar si të tillë në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë.

F.4.5.3 Anëtari pranon së është i detyruar të njoftojë ALPEX-in me shkrim në rast të ndonjë shkeljeje apo shkeljeje të dyshuar të Përfaqësimeve të tij menjëherë pasi Anëtari të vihet në dijeni.

F.4.6 **Përfaqësimet nga ALPEX-i**

F.4.6.1 ALPEX-i përfaqëson dhe garanton të gjithë Anëtarët në lidhje me çdo Transaksion i cili është futur në ETSS-ën e tij:

- (a) **Autoriteti:** Ka autoritetin për të kryer detyrimet e tij sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe çdo Transaksion;
- (b) **Statusi:** Është i organizuar siç duhet dhe ekziston në mënyrë të vlefshme sipas ligjeve dhe juridiksionit mbi sipërmarrjen;
- (c) **Organizata:** Ka personel dhe organizimin e duhur për t'i mundësuar kryerjen e veprimtarisë të saj dhe personeli i saj ka kompetencat dhe njohuritë e nevojshme për t'i mundësuar të kryejë detyrimet e veta sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike;
- (d) **Asnjë Shkelje ose Konflikt:** Ekzekutimi, dorëzimi dhe zbatimi i Marrëveshjeve të Anëtarësisë në Bursë ose Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike nuk shkelin ose bien në kundërshtim me ndonjë Ligj të Zbatueshëm ose ndonjë dispozitë të dokumenteve të tij kushtetuese të zbatueshme për ALPEX-in ose ndonjë nga asetet e tij, ose çdo kufizim kontraktual të detyrueshëm ose që prek atë ose ndonjë nga asetet e tij;
- (e) **Autorizimet e Nevojshme:** Të gjitha Autorizimet e Nevojshme sipas Ligjit të Zbatueshëm janë marrë dhe janë në fuqi dhe të vlefshëm, dhe të gjitha kushtet e çdo Autorizimi të Nevojshëm janë përmbushur, dhe nuk ka licenca ose dosje të tjera me apo akte të tjera nga ose në lidhje me ndonjë Autoritet Rregullator

apo Gjykatë që kërkohet të merret, ose të kryhet nga ALPEX-i në lidhje me performancën e tij sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike;

- (f) **Informacion i saktë:** I gjithë informacioni i zbatueshëm, i dërguar me shkrim nga ose në emër të ALPEX-it, i cili identifikohet si subjekt ose i lidhur me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike janë si në ditën e dorëzimit të tij të parë tek Anëtarët dhe përveç kur është i përcaktuar ndryshe në informacionin efektiv, i besueshëm se është i vërtetë dhe i saktë në çdo aspekt material; dhe
- (g) **Pajtueshmëria:** Në lidhje me ALPEX-in, asnjë mos përmbushje detyrimesh, ose ngjarje që me njoftim ose kalim kohor ose të dyja do të përbënte një mos përmbushje detyrimesh do të ndodhte si rezultat i hyrjes ose kryerjes së detyrimeve të tij sipas Marrëveshjeve të Anëtarësimit ose Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

G. ÇËSHJET KONTRAKTUALE

G.1 MARRËVESHJA E ANËTARËSIMIT NË BURSË

G.1.1 Rregullat e zbatuara përmes Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë

- G.1.1.1 Siç përcaktohet në seksionet B.3.1 dhe B.3.2, çdo entitet juridik do të bëhet palë në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, sipas së cilës ai bëhet i detyruar për ti zbatuar këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.
- G.1.1.2 ALPEX-i ose një Anëtar i Bursës duhet ti zbatojë këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike në përputhje me kushtet e Marrëveshjes të Anëtarësimit në Bursë.

G.2 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

G.2.1 Llojet e Mosmarrëveshjeve dhe Kalendarin e Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes

G.2.1.1 Një "**Mosmarrëveshje**" nënkupton çdo pretendim, mosmarrëveshje ose dallim të çfarëdolloj natyre pavarësisht që lind sipas, nga ose në lidhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë (duke përfshirë ekzistencën ose vlefshmërinë e së njëjtës).

G.2.1.2 Kategoritë e Mosmarrëveshjes sipas këtyre Rregullave të ALPEX-it janë si mëposhtë vijon:

- (a) një **Mosmarrëveshje për Pranimin**: është një Mosmarrëveshje në lidhje me Procesin e Pranimit;
- (b) një mosmarrëveshje **që ka të bëjë me një Ndalim Tregtimi ose Pezullim ose Përfundim** të anëtarësimit;
- (c) një **Mosmarrëveshje Konflikti**: është një Mosmarrëveshje në lidhje me një konflikt të pretenduar midis këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrikedhe Kërkesave të tjera Ligjore përkatëse; dhe
- (d) një **Mosmarrëveshje e Përgjithshme**: është një Mosmarrëveshje e cila nuk bën pjesë në asnjë prej kategorive pararendëse në këtë paragraf G.2.1.2, duke përfshirë një Mosmarrëveshje në lidhje me pagesat sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

G.2.1.3 Mosmarrëveshjet në lidhje me Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit dhe çështjet e lidhura me to do të trajtohen në përputhje me kontratat midis Anëtarit të Bursës dhe Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit dhe jo në përputhje me dispozitat e këtij seksioni G.2.

G.2.1.4 "**Kalendarin e Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes**" në lidhje me secilën kategori Mosmarrëveshjes do të jetë procesi dhe orari i përcaktuar nga ALPEX i cili do të specifikojë afatet dhe programin kohor për marrjen e veprimeve sipas këtij seksioni G.2 në lidhje me një Mosmarrëveshje në secilën kategori. ALPEX-i do të hartojë Kalendarin e Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes, duke u bazuar në parimin "I pari në rradhë, i pari në shërbime" dhe do të publikojë kalendarin në faqen e tij të internetit.

G.2.1.5 ALPEX-i, për shkaqe objektive mund të marrë vendim për të ndryshuar Kalendarin e Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes, me kusht që vendimi i marrë nga ALPEX për ndryshimin e kalendarit të Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes nuk do të:

- (a) hyjë në fuqi deri në mbarimin e një periudhe prej pesëmbëdhjetë (15) Ditësh pas vendimit, ose një periudhe me të gjatë siç mund të specifikohet nga ALPEX-i; dhe
- (b) ndikojë në Mosmarrëveshjet që janë subjekt i një Njoftimi për Mosmarrëveshje cili është dërguar.

G.2.1.6 Ky seksion nuk ka për qëllim të përjashtojë takimin e Palëve në Mosmarrëveshje për të kërkuar zgjidhjen e një Mosmarrëveshjeje në çdo kohë.

G.2.2 Njoftim i Mosmarrëveshjeve dhe negociatat në mirëbesim

G.2.2.1 Një Mosmarrëveshje ekziston kur njëra Palë njofton me shkrim një Palë ose Palët e tjera për Mosmarrëveshjen përmes një Njoftimi të Mosmarrëveshjes në përputhje me këto Rregulla.

G.2.2.2 Një Njoftim Mosmarrëveshjeje mund t'i vihet në dispozicion një numri të caktuar Palësh. Kur ALPEX-i konstaton se zgjidhja e një Mosmarrëveshjeje do të ndikojë mbi një Palë të tretë që nuk i është dërguar Njoftimi i Mosmarrëveshjes, ALPEX-i do të informojë Palën e tretë për ekzistencën, natyrën dhe evolucionin e Mosmarrëveshjes, duke ruajtur konfidencialitetin e Palëve në Mosmarrëveshje.

G.2.2.3 Njoftimi i Mosmarrëveshjes do të përcaktojë natyrën e Mosmarrëveshjes (duke përfshirë ngjarjen ose ngjarjet që janë objekt i Mosmarrëveshjes dhe kategorinë e Mosmarrëveshjes) dhe çështjet e përfshira dhe do të publikohen herë pas here nga ALPEX-i.

G.2.2.4 Një kopje e Njoftimit për Mosmarrëveshje do të dërgohet ALPEX-it;

- (a) kur ALPEX-i është palë në Mosmarrëveshje, dhe
- (b) Autoriteteve Rregullatorë.

G.2.2.5 Parashikimet e përcaktuara në Procesin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes nuk do të paragjykojnë ose pengojnë të drejtën e një Palë që të kërkojë ndërmjetësim pa shkuar në Gjykatën që ka juridiksionin kompetent.

G.2.2.6 Detyrimet e Palëve në kuadrin e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike nuk do të preken për shkak të ekzistencës së një Mosmarrëveshjeje, përveçse kur parashikohet nga një vendim i ALPEX-it ose një Gjykatë që ka juridiksionin kompetent. Për të shmangur çdo dyshim në përmbushjen e detyrimeve të pagesave sipas afateve, Palët në Mosmarrëveshje do të vijojnë të kryejnë të gjitha detyrimet dhe funksionet e tyre siç kërkohen nga Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

G.2.3 Objektivat e Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve

G.2.3.1 ALPEX-i dhe Anëtarët e Bursës pranojnë synimin që Procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve i përcaktuar në përputhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë

Elektrike dhe i përshkruar në detaje në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni G.2 , duhet, për aq sa është e mundur:

- (a) të jetë i thjeshtë, i shpejtë dhe pa kosto;
- (b) të ruajë marrëdhënien midis Palëve në Mosmarrëveshjeje;
- (c) të zgjidhë dhe të lejojë vazhdimin dhe funksionimin e duhur të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike duke pasur parasysh Objektivin e ALPEX-it;
- (d) të zgjidhë Mosmarrëveshjet mbi baza të barabarta në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike duke pasur parasysh Objektivin e ALPEX-it;
- (e) të marrë parasysh aftësitë dhe njohuritë që kërkohen për Mosmarrëveshjen përkatëse; dhe
- (f) të inkurajojë zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve pa përfaqësim formal ligjor ose mbështetje në procedurat ligjore (përveç sa është përcaktuar në këtë seksion G.2).

G.2.3.2 Kur një Njoftim për Mosmarrëveshje është dërguar, një përfaqësues i secilës nga Palët në Mosmarrëveshje, i ngarkuar me autoritetin për të zgjidhur Mosmarrëveshjen, do të takohet në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në Kalendarin e Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes për të kërkuar një zgjidhje në mirëbesim të Mosmarrëveshjes.

G.2.3.3 Nëse palët nuk arrijnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas paragrafit G.2.3.1, ajo do të shqyrtohet nga Autoriteti Rregullator respektiv, sipas ligjit të zbatueshëm dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

G.2.4 Veprimet e Autoritetit Rregullator

G.2.4.1 Autoriteti Rregullator do të shqyrtojë çështjet e ngritura të kërkesës ose ankesës sipas rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të autoritetit rregullator.

G.2.4.2 Nëse palët nuk arrijnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas paragrafit G.2.4.1, ato do t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhje të mosmarrëveshjes. .

G.3 KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

G.3.1 Kufizimet në përgjegjësi

G.3.1.1 Asgjë prej Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike nuk e përjashton ose kufizon përgjegjësinë e çdo Pale në rastet e:

- (a) mashtrimit ose keqinterpretim mashtrues;
- (b) vdekjes ose dëmtimit personal të shkaktuar nga neglizhenca e tij;
- (c) çdo përgjegjësi tjetër që nuk mund të përjashtohet ose të kufizohet nga ligji në fuqi; ose
- (d) dëmshpërblimit në paragrafin G.3.2.

G.3.1.2 ALPEX nuk do të jetë përgjegjës për asnjë humbje ose dëmtim të shkaktuar direkt ose indirekt nga:

- (a) keqfunksionimet e një shërbimi kur ky keqfunksionim i atribuohet rrethanave përtej kontrollit të tij, që janë, ndër të tjera, mos disponueshmëria, dështimi ose ndërprerja e rrjeteve të telekomunikacionit ose nga kufizimet apo limitet e imponuara nga operatorët e telekomunikacionit ose nga ofruesit e tjerë të shërbimeve;
- (b) pasaktësia, mos disponueshmëria e pjesshme ose totale ose informacioni teknik i pa plotë ose të dhëna që vijnë nga palë të treta; ose
- (c) deformimi i të dhënave të kompjuterizuara gjatë transferimit nëpërmjet Internetit, nga defekte të harduerit kompjuterik që përdoret për të komunikuar midis Anëtarit të Bursës dhe ALPEX-it.

G.3.1.3 Për më tepër, ALPEX-i nuk do të jetë përgjegjës për asnjë humbje ose dëmtim të shkaktuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga:

- (a) pamundësia ose vështirësia e Anëtarit të Bursës për të hyrë në ETSS për shkak të aksesit në harduer ose pajisjeve për të cilat është përgjegjës Anëtari i Bursës ose një palë e tretë;
- (b) kundërshtimin e një tregtimi të ekzekutuar nga Anëtari i Bursës, ku një kundërshtim i tillë ngrihet pas çdo periudhe anulimi të parashikuar në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike; ose
- (c) papajtueshmëria nga Anëtari i Bursës me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.

G.3.1.4 ALPEX-i nuk do të ketë asnjë përgjegjësi (qoftë nga kontrata, neglizhenca, keqinterpretimi, dëmtim, zhdëmtimi ose diçka tjetër) sipas ose në lidhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjet e Anëtarësimit në Bursë në lidhje me:

- (a) humbjet, dëmet, kostot ose shpenzimet indirekte, me pasoja, të rastësishme ose të veçanta;
- (b) humbje të fitimeve aktuale ose të parashikuara;
- (c) humbjen e kontratave, humbjen e biznesit ose humbjen e mundësive;
- (d) humbjen e përdorimit të parave;
- (e) humbjen e kursimeve të parashikuara;
- (f) humbje të të ardhurave, fitimeve ose pagesave *ex-gratia* (që vijnë nga një detyrim moral dhe jo ligjor);
- (g) humbjen e emrit të mirë ose reputacionit;
- (h) humbjen e kohës së funksionimit; ose
- (i) humbje që rezulton nga përgjegjësia e Anëtarit të Bursës ndaj çdo personi tjetër kurdo që lind përveç siç parashikohet në seksionin G.3.2.

- G.3.1.5 ALPEX-i në asnjë rrethanë nuk do të jetë përgjegjës për çdo humbje ose dëmtim të një Anëtari të Bursës të shkaktuar nga ndonjë veprim ose mosveprim i një Anëtar tjetër të Bursës, duke përfshirë humbjet ose dëmet e shkaktuara ndaj tij.
- G.3.1.6 ALPEX-i nuk do të jetë përgjegjës për asnjë humbje ose dëmtim të një Anëtari të Bursës që vjen nga Tregtimi ose Procedurës së Tregtimit si rezultat i çdo veprimi ose mosveprimi nga ALPEX-i, me kusht që ALPEX-i të mos ketë vepruar në mënyrë neglizhence, të pandershme ose nuk ka përmbushur detyrimet në mënyrë të qëllimshme.
- G.3.1.7 Përveçse rasteve kur ALPEX-i ka vepruar në mënyrë të pandershme ose është në mos përmbushje të qëllimshme të detyrimeve, ALPEX-i në asnjë rrethanë tjetër nuk do të jetë përgjegjës ndaj Anëtarit të Bursës për humbje indirekte dhe dëme pasuese duke përfshirë humbjen e fitimeve ose kontratave.
- G.3.1.8 Mos përmbushja e detyrimeve të Anëtarit të Bursës në lidhje me tregtimet e tij në ALPEX, si rezultat i zbatimit të masave nga autoritetet gjyqësore ose administrative ndaj Anëtarit të Bursës ose kryerja e parregullt të operacioneve në Tregjet e ALPEX-it për shkak të zbatimit të këtyre masave, do të përbëjnë përgjegjësi të rreptë mbi baza objektive për një Anëtar Burse. Në mënyrë që të trajtohen kushtet e mësipërme, masat përkatëse merren ndaj Anëtarit, në zbatim të dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- G.3.1.9 ALPEX-i nuk duhet të jetë përgjegjës për ndonjë humbje ose dëmtim të një Anëtari, që mund të vijë nga një ngjarje e Ndarjes së Tregut në Tregjet e Ditës në Avancë dhe/ose Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë, në përputhje me procedurat e zbatueshme.
- G.3.1.10 Anëtari i Bursës është përgjegjës ndaj ALPEX-it për përmbushjen e çdo detyrimi që rrjedh nga këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike. Kjo përgjegjësi përfshin çdo veprim ose mosveprim të organeve që i përfaqësojnë ato, agjentët të tyre zëvendësues, punonjësve të tyre, në veçanti personat e autorizuar, ose të cilëve ata lejojnë aksesin në sistemet e Tregut të ALPEX-it në mënyrë që të tregtojnë.

G.3.2 **Dëmshpërblimi nga Anëtari i Bursës**

- G.3.2.1 Çdo Anëtar i Bursës pranon të dëmshpërblejë dhe të mbajë të padëmtuar ALPEX-in nga ndonjë humbje, pretendim, kërkesë, dëm apo detyrim të ndonjë lloji, duke përfshirë shpenzimet e shkaktuara në mënyrë të arsyeshme për ALPEX-in në lidhje me hetimin, përgatitjen ose mbrojtjen e ndonjë veprimi hetimor, administrativ, gjyqësor ose rregullator ose procedimi në ndonjë juridiksion (të përmbledhura, "**Detyrimet**"), që kanë të bëjnë me ose lindin nga ndonjë shkelje nga Anëtari i Bursës për detyrimet e tij nën këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike dhe çdo Kontratë në të cilën ai është palë. Një Anëtar i Bursës nuk do të jetë përgjegjës për zhdëmtimin në këtë paragraf G.3.2.1 përveç rasteve kur ndonjë detyrim vjen si pasojë e ndonjë neglizhence ose ndonjë shkelje nga ALPEX-i për detyrimet e tij sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- G.3.2.2 Çdo Anëtar i Bursës është i detyruar të dëmshpërblejë plotësisht të gjitha kostot që mund të lindin për ALPEX-in lidhur me TVSH-në, detyrimet doganore, kapacitetet ndërkufitare apo detyrime të tjera të ngjashme lidhur me energjinë elektrike, e cila

tregtohej në Tregjet e ALPEX-it, pasi këto kosto janë përgjegjësi e vetme e Anëtarit në fjalë.

G.3.3 Të drejtat e Pronësisë për Informacionin e Transaksionit

G.3.3.1 Sa herë që një Anëtar Burse dorëzon të dhëna në formën e Urdhërporosive ose mënyrë tjetër tek ALPEX-i nëpërmjet ETSS ose nëpërmjet komunikimeve të tjera të mundësuar nga rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, këto të dhëna do t'i përkasin ALPEX-it. Të Drejtat e Autorit dhe të gjitha të Drejtat e tjera të Pronësisë Intelktuale ose të drejtat e pronësisë të çfarëdolloj natyre që përmban Informacioni i Transaksionit (duke përfshirë, për shmangien të dyshimeve, të gjitha të drejtat e bazës së të dhënave dhe të drejtat e ngjashme pavarësisht nëse mbrohen ose jo me ligj) që rrjedhin nga Tregtimi janë dhe do të mbeten në çdo kohë pronë e ALPEX-it. Asgjë në këtë paragraf nuk e kufizon ALPEX-in për të disponuar dhe përdorur lirisht, ekonomikisht ose mënyrë tjetër, të dhëna të tilla dhe pronësi intelektuale ose pronësie të tjera, subjekt i kërkesave të zbatueshme të konfidencialitetit.

G.3.4 Publikimi

G.3.4.1 ALPEX-i ka të drejtë të përdorë, kopjojë, përshtasë, ofrojë, shpërndajë, publikojë, shesë, caktojë, transferojë, të japë me qira, me kontratë, të ngarkojë ose të trajtojë ndryshe me Informacionin e Transaksionit dhe informacione të tjera në lidhje me çështjet teknike dhe financiare, pa asnjë detyrim konfidencialiteti ndaj ndonjë Anëtarit të Bursës, për sa kohë që një informacion i tillë nuk identifikon ndonjë Anëtar të Bursës individualisht. Anëtarët e Bursës nuk kanë të drejtë për shpërblim në lidhje me veprimtari të tilla.

G.3.4.2 ALPEX-i mund t'ua transmetojë informacionin autoriteteve publike dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit nëse kjo kërkohet nga Legjislacioni në Fuqi. ALPEX-i do ta informojë Anëtarin e Bursës për një dhënie informacioni të tillë, në masën që është e lejuar ta bëjë këtë sipas Legjislacionit në Fuqi. Një sjellje e tillë nga ALPEX-i nuk do të konsiderohet në asnjë rast shkelje e konfidencialitetit ose shkelje e të Drejtave të Pronësisë Intelktuale të Anëtarit të Bursës.

G.3.4.3 Me qëllim të Bashkimit të Tregjeve përkatëse, ALPEX-i do t'u përcjellë NEMO-ve bashkëpunuese informacionin e përmbledhur dhe anonim për Urdhërporositë për Zonën e Ofertimit.

G.3.4.4 Përveç dispozitave të këtij paragrafi, ALPEX-i ka të drejtë të zbulojë dhe të publikojë informacionin siç është përcaktuar në Sjelljen e Tregut.

G.4 FORCA MADHORE

G.4.1 Përkufizimi

G.4.1.1 Me Forcë Madhore nënkuptojmë çdo ngjarje të parashikuar si e tillë nga legjislacioni në fuqi në Shqipëri dhe Kosovë.

G.4.2 Kërkesat dhe Pasojat

G.4.2.1 Kur një Palë bëhet plotësisht ose pjesërisht e paaftë për të përmbushur të gjitha ose ndonjë nga detyrimet e saj sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike

ose Marrëveshjes së Anëtarësimit të Bursës për shkak të një Ngjarjeje e Forcës Madhore, detyrimet përkatëse të Palës pezullohen dhe Pala lirohet nga përgjegjësia, subjekt i paragrafit G.4.2.2, në lidhje me detyrimet e tilla me kusht që një përgjegjësi dhe pezullim i tillë të mos jetë me shtrirje më të madhe dhe me kohëzgjatje jo më të gjatë se sa kërkohet nga Ngjarja e Forcës Madhore.

G.4.2.2 Pala do të lirohet nga përgjegjësia vetëm për atë kohë sa dhe në masën që ndodh Ngjarja e Forcës Madhore.

G.4.2.3 Një Anëtar i Bursës i prekur nga një Ngjarje e Forcës Madhore duhet t'i japë ALPEX-it një njoftim me shkrim që përmban detajet e përcaktuara më poshtë. Nëse ALPEX-i është prekur nga një Ngjarje e Forcës Madhore, ai duhet të publikojë një Njoftim Tregu që përmban detajet e përcaktuara më poshtë. Detajet që do të përfshihen në një njoftim sipas këtij paragrafi janë:

- (a) detajet e Ngjarjes së Forcës Madhore;
- (b) natyra dhe shtrirja e detyrimeve të prekura nga Ngjarja e Forcës Madhore ;
- (c) periudha kohore gjatë së cilës pala e prekur vlerëson se nuk do të jetë në gjendje të përmbushë ose do të vonohet në përmbushjen e detyrimeve të saj; dhe
- (d) detajet e veprimit që ka ndërmarrë ose propozon të ndërmarrë për të korrigjuar situatën.

G.4.2.4 Një Palë e prekur nga një Ngjarje e Forcës Madhore duhet:

- (a) të përdorë të gjithë kujdesin e mundshëm për të shmangur, hequr ose kufizuar efektet e Ngjarjes së Forcës Madhore në përmbushjen e detyrimeve të pezulluara sa më shpejt që të jetë e mundur;
- (b) të rifillojnë menjëherë kryerjen e detyrimeve të pezulluara sa më shpejt që të jetë e mundur;
- (c) nëse Pala e prekur është Anëtare e Bursës, e mban ALPEX-in të informuar për statusin e Ngjarjes së Forcës Madhore dhe njofton menjëherë ALPEX-in pas rifillimit të përmbushjes së detyrimeve të pezulluara; dhe
- (d) nëse Pala e prekur është ALPEX-i, ai menjëherë do të publikojë një Njoftim për Tregun pas rifillimit të përmbushjes së detyrimeve të pezulluara.

G.5 ÇËSHTJE TË PËRGJTHSHME

G.5.1 Heqja Dorë

G.5.1.1 Asnjë dështim për ta ushtruar një të drejtë, as ndonjë vonesë në ushtrimin e ndonjë të drejte nga ana e ndonjë Pale apo korrigjuar sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjes së Anëtarësimit të Bursës do konsiderohet si një heqje dorë prej saj , as ushtrimi i vetëm ose pjesor i ndonjë të drejte apo pengimin për ta korrigjuar më tej ose ushtrimin tjetër të saj apo ushtrimin e ndonjë të drejte tjetër ose rikuperimin sipas këtyre Rregullave dhe Procedurave të ALPEX-it ose Marrëveshjes së Anëtarësimit të Bursës.

G.5.2 Pavlefshmëria e Pjesshme

G.5.2.1 Secila nga dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursës është e ndashme. Në qoftë se në çdo kohë ndonjë dispozitë ose pjesë e një dispozite të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në çdo aspekt për qëllimet e çdo Ligji në Fuqi ose me vendim të ndonjë Autoriteti Kompetent, ajo do të konsiderohet e ndarë dhe ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë nuk do të ndikohen ose dëmtohen në asnjë mënyrë prej tyre.

G.5.3 Caktimi, transferimi ose rinovimi

G.5.3.1 Një Anëtar i Bursës nuk duhet të transferojë, lëshojë, rinovojë, ngarkojë ose ndërmarrë ndonjë formë tjetër të marrëveshjes, ose të pretendojë të transferojë, lëshojë, rinovojë, ngarkojë ose ndërmarrë ndonjë formë tjetër të marrëveshjes në lidhje me:

- (a) të gjitha ose ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e tij sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjes së Anëtarësimit të Bursës; ose
- (b) të gjitha ose ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e tij sipas çdo Kontrate që ka të bëjë me përmbushjen e detyrimeve kundrejt ALPEX-it,

pa pëlqimin paraprak me shkrim të ALPEX-it, i cili nuk do të ndalohet ose refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, ose siç parashikohet ndryshe në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.

G.5.3.2 këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike nuk lejojnë tregtimin sekondar.

G.5.3.3 Çdo kërkesë për të transferuar të gjitha ose ndonjë nga të drejtat e anëtarit të Bursës sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë do të jetë subjekt i pëlqimit paraprak të ALPEX-it por jo të ndonjë Pale tjetër. Në dhënien e pëlqimit sipas këtij paragrafi, ALPEX-i mund të vendosë kushte të cilat i vlerëson se janë të nevojshme për qëllime të funksionimit të duhur të Bursës.

H. SIGURIA, PËRDORIMI I TË DHËNAVE, KONFIDENCIALITETI

H.1 QËLLIMI I KËTIJ KAPITULLI

H.1.1 Dispozita të Përgjithshme

H.1.1.1 Ky Kapitull përshkruan detyrimet kryesore të ALPEX-it dhe Anëtarëve të Bursës në lidhje me sigurinë e sistemit dhe përdorimin e internetit, kategoritë e të dhënave të kërkuara për Bursën, të drejtat për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave dhe konfidencialitetin.

H.1.1.2 Kërkesat e detajuara mund të jenë të përcaktuara në Procedurën e Tregtimit, e cila është pjesë përbërëse e këtyre Rregullave.

H.2 SIGURIA

H.2.1 Konceptet

H.2.1.1 Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Procedurat e Tregtimit përcaktojnë masat e sigurisë fizike dhe logjike që synojnë të mbrojnë integritetin e sistemeve të secilës Palë.

H.2.1.2 ALPEX-i ka ETSS e tij dhe çdo Anëtar i Bursës ka Sistemet e veta për të cilat është përgjegjës. Megjithatë, të gjitha informacionet e transmetuara midis këtyre dy sistemeve kryhen nëpërmjet Internetit.

H.2.1.3 Çdo Anëtar i Bursës është përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e politikave dhe praktikave efektive që mbështesin sigurinë dhe integritetin e sistemit të sistemeve të anëtarëve dhe të ETSS.

H.2.2 Detyrimet mbi Anëtarët e Bursës

H.2.2.1 Anëtarët e Bursës duhet:

- (a) të respektojnë masat e sigurisë kibernetike, të cilat synojnë të mbrojnë integritetin e Sistemeve të çdo Anëtari dhe të Sistemeve të Anëtareve të tjerë dhe ETSS-n duke përfshirë:
 - (i) mbrojtjen e faqes dhe të kodit të aksesit; dhe
 - (ii) në rastin e Sistemeve të tyre të Anëtarëve, mbajtjen e përditësuar të programeve kompjuterike (*softwares*), duke shkarkuar kodet (*patches*) dhe përditësimet e aplikueshme menjëherë si dhe duke zbatuar procedurat e back-up për udhëzimet, të dhënat dhe dosjet.
- (b) të marrë masa për të shmangur sulmet e viruseve (*malware*) kompjuterike mbi Sistemet e tyre ose të tjera të Anëtarëve ose mbi ETSS-në në përputhje me praktikën më të mirë të industrisë duke përfshirë:
 - (i) përdorimin e kontrolleve antiviruse për të gjitha komunikimet me ETSS;
 - (ii) lajmërimin e menjëhershëm të ALPEX, kur evidentohet se kontrollet e sigurisë të operuara nga Sistemet e Anëtarëve janë kompromentuar;

(iii) ofrimin e ndihmës për të kërkuar shkakun e çdo kompromisi të kontrolleve të sigurisë të Sistemeve të Anëtarëve ose sistemet e ALPEX-it;

(iv) marrjen e veprimeve të duhura për ndreqjen ose mitigimin në trajtimin e cënimit të të dhënave;

(c) të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave,

në përputhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike dhe çdo dokumentacion teknik të përcaktuar në to.

H.2.2.2 Çdo Anëtar i Bursës duhet:

(a) të jetë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës dhe procedurave të tij të administrimit të autorizimeve për qasje logjike në ETSS;

(b) të veprojë në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës mbi sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit;

(c) të zbatojë politikën, rregullat, metodat dhe procedurat për të mbajtur dhe përmirësuar mbrojtjen e Sistemeve të tij në përputhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike dhe çdo dokumentacion teknik të përcaktuar në to;

(d) të organizojë masa të brendshme të sigurisë kibernetike, duke përfshirë kufizimin e aksesit në vendin në të cilin ndodhen pajisjet e tij, në mënyrë që të mbrojtë kodet e tij të aksesit nga palët e treta të paautorizuara;

(e) të përditësojë Sistemet e tij sipas nevojës, për të vazhduar përmbushjen e kërkesave teknike të përcaktuara në Kapitullin I, Procedurat dhe çdo dokumentacion teknik të përcaktuar në Procedura.

H.2.3 Përgjegjësia

H.2.3.1 ALPEX-i dhe çdo Anëtar i Bursës:

(a) dëshmon aftësinë e tij për navigimin në internet dhe kupton kufizimet e performancës dhe karakteristikat e lidhura me aksesin në sistemet ose aplikacionet e bazuara në internet.

(b) do të jetë përgjegjës për zgjedhjen e vet të ofruesve të shërbimeve të IT duke përfshirë, ofruesit e saj të aksesit në Internet.

(c) pranon se besueshmëria teknike e transmetimit të të dhënave të bazuara në Internet është relative, pasi këto të dhëna barten mbi rrjete heterogjene me karakteristika teknike të ndryshme; dhe

(d) pranon se është përgjegjës për marrjen e masave të duhura për të mbrojtur të dhënat e veta, softuerin dhe harduerin nga aksesit nga palët e treta të paautorizuara dhe kontaminimin me anë të malware-ve, me anë të masave logjike dhe fizike të sigurisë, duke përfshirë firewall-et, të zbatuara sipas praktikës së pranuar.

H.3 PRONËSIA INTELEKTUALE DHE LICENCAT

H.3.1 Autorizimet e Anëtarëve të Bursës dhe të drejtat e tjera

H.3.1.1 Çdo Anëtar i Bursës duhet të jetë përgjegjës për lidhjen me ETSS-në dhe do të sigurojë të gjitha autorizimet, të drejtat e pronësisë, licencat dhe kontratat për të gjitha konfigurimet, firmware dhe softuerët e nevojshëm për tregtim.

H.3.1.2 Kur një aplikim softuerik që është i nevojshëm për një Anëtar Burse për të hyrë në ETSS kërkon një licence ose të drejtë tjetër, ALPEX-i jep detaje të dispozitave përkatëse për Anëtarin e Bursës dhe ky Anëtar duhet të respektojë këto dispozita.

H.3.2 Kufizimet e të drejtave që u jepen Anëtarëve të Bursës

H.3.2.1 Kur ALPEX-i i jep një Anëtarin të Bursës të drejta për të përdorur ETSS-në, të drejta të tilla duhet:

- (a) të jetë një licencë jo-ekskluzive, e patransferueshme për të përdorur ETSS-në në masën e nevojshme për tregtimin në Bursë;
- (b) të jenë të kufizuara për t'u përdorur për Zonat e përcaktuara të Ofertimit dhe në masën e nevojshme;
- (c) të jenë të vlefshme vetëm përsa kohë Anëtarin i Bursës mbetet Palë në Marrëveshjen e Anëtarësimin në Bursë;
- (d) të kufizohet për të lejuar hyrjen në ETSS vetëm me qëllim të transmetimit dhe marrjes së të dhënave të lejuara sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike; dhe
- (e) të përjashtojë përdorimin për çdo qëllim tjetër, përveçse në përputhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.

H.3.2.2 Anëtarin i Bursës është i ndaluar nga:

- (a) aksesin, replikimin, ose modifikimin, çmontimin, dekompilimin ose bashkimin e kodeve burimore ose kodeve të objektit të ETSS;
- (b) përdorimin me vetëdije i ETSS-së për qëllime të vetë veprimtarisë së testimit të Anëtarit të Bursës, pa miratimin me shkrim të ALPEX-it; ose
- (c) autorizimin e çdo personi tjetër për të përdorur ETSS-në, (duke përfshirë me anë të nënlicensës, caktimit, ose transferimit), përveç Agjentit të tij Tregtar.

H.3.2.3 Të drejtat e një Anëtarin të Bursës për të përdorur ETSS-në mund të revokohen nëse Anëtarin i Bursës nuk përputhet me termat dhe kushtet e përcaktuara në paragrafin H.3.3.1.

H.3.3 Anëtarin i Bursës të respektojë të Drejtat e Pronësisë Intellectuale

H.3.3.1 Çdo Anëtar i Bursës duhet të respektojë të Drejtat e Pronësisë Intellectuale të ALPEX-it dhe të të gjitha palëve të treta që ofrojnë një sistem ose aplikim softuerik të nevojshëm për të hyrë në ETSS, duke përfshirë:

- (a) marrjen e të gjitha masave të arsyeshme në lidhje me stafin e tij, ofruesit e shërbimeve, nënkontraktuesit dhe palët e treta për të mbrojtur të Drejtat e Pronësisë Intelektuale;
- (b) duke u përmbajtur nga ndryshimi i referencave për të drejtat e pronësisë dhe të drejtat e autorit të specifikuar mbi materialet e furnizuara nga ALPEX-i;
- (c) duke mos hequr apo modifikuar referencat për të drejtat e autorit, markat tregtare, emrat e tregtisë apo ndonjë shenjë tjetër të pronësisë intelektuale.

H.4 MBLEDHJA DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE

H.4.1 Kategoritë e të dhënave

H.4.1.1 Si pjesë e funksionimit në Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda së Njëjtës Ditë, ALPEX-i përpunon kategoritë e mëposhtme të të dhënave (këtej e tutje "të dhënat")

- (a) Të Dhënat e Pjesëmarrjes, të cilat lidhen me kategoritë e mëposhtme të të dhënave:
 - (i) informacion të kërkuar për të fituar dhe mbajtur kapacitetin e Anëtarëve të Bursës;
 - (ii) fjalëkalimet e përdoruesve të autorizuar për akses në ETSS;
 - (iii) Listën e Agjentëve Tregtar të Certifikuar.
- (b) Të dhënat e Tregtimit, të cilat lidhen me kategoritë e mëposhtme të të dhënave:
 - (i) Urdhërporositë e paraqitura në ETSS;
 - (ii) Librat e Urdhërporosive / Kurbat e Grupuar të Blerjes dhe Shitjes;
 - (iii) Çmimet Klerues të Tregut për Njësinë e Kohore të Tregut të Ditës së Livrimit dhe për Zonën e Ofertimit, sasi të pranuar të energjisë të Urdhërporosive të Grupuar Orare, listën e pranimit të Urdhërporosive në Bllok dhe Pozicionin Neto për secilën Zonë Ofertimi dhe Njësi Kohore Tregu;
 - (iv) Informacion rreth Urdhërporosive të Përputhura, në lidhje me sasinë e përputhur dhe çmimin e tregtimit;
 - (v) çdo të dhënë tjetër të publikuar në faqen e internetit të ALPEX-it dhe të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, dhe
 - (vi) të dhënat e Klerimit dhe Shlyerjes të Tregtimeve të ekzekutuara në ALPEX.

H.4.2 Pronësia dhe përdorimi i të dhënave

H.4.2.1 ALPEX dhe Anëtarët e Bursës do të mbajnë pronësinë e dokumenteve, të dhënave dhe informacionit të çdo lloji që ata i japin një Pale tjetër sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe në të cilat secila palë mund të ketë akses.

H.4.2.2 Pavarësisht paragrafit H.4.2.1:

- (a) ALPEX ka të drejta ekskluzive dhe kontroll mbi të gjitha të Dhënat e listuara nën seksionin H.4.1.
- (b) Çdo Anëtar i Bursës i jep ALPEX-it të drejtën për të përdorur, komunikuar, kopjuar dhe përpunuar të dhënat e tij të Urdhërporosive dhe anëtarësimit, siç përshkruhen në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.

H.4.2.3 Kur ALPEX publikon të dhënat tregtare, ALPEX-i do të mbajë pronësinë e këtyre të dhënave. Megjithatë, një Anëtar i Bursës mund t' i përdorë këto të dhëna brenda organizatës së tij rreptësisht për qëllime të lidhura me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.

H.4.2.4 Të drejtat e ALPEX-it në lidhje me të dhënat:

- (a) ALPEX-i zotëron të dhënat e paragrafit H.4.2.1, me përjashtim të të Dhënave të Pjesëmarrjes (paragrafi H.4.2.1 (a)) dhe të Urdhërporosive të dërguara në ETSS (paragrafi H.4.2.1 (b),i)), pronësia e të cilëve i përket Anëtarëve të Bursës.
- (b) ALPEX-i rezervon të drejtën për të përdorur a) të dhënat e pjesëmarrjes dhe b) Urdhërporositë e dërguara në ETSS, në mënyrë anonime, për qëllime të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. ALPEX-i duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme organizative dhe procedurale dhe të zhvillojë mekanizmat e duhur të kontrollit për të siguruar përdorimin e saktë të të dhënave të mësipërme.
- (c) Ofruesit e shërbimit të ALPEX-it rezervojnë të drejtën për të përdorur të Dhënat e Tregtimit për çdo qëllim që lidhet direkt ose indirekt me funksionimin e Tregjeve të menaxhuara nga ALPEX-i sipas Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat.
- (d) Përdorimi i të dhënave të mësipërme nga ALPEX-i dhe ofruesit e tij të shërbimeve sipas rastit është subjekt i konfidencialitetit të biznesit.

H.4.2.5 Kushtet e Përdorimit të të Dhënave të Tregtimit nga Anëtarët e Bursës

- (a) Anëtarët e Bursës nuk mund të nxjerrin dhe të përdorin asnjë të Dhënë Tregtare pa pëlqimin paraprak të ALPEX-it. Anëtarët e Bursës nuk lejohen të komercializojnë, rishesin ose t'u japin akses të Dhënave Tregtare palëve të treta pa përfunduar një marrëveshje me ALPEX-in.
- (b) Anëtarët e Bursës mund të nxjerrin dhe të përdorin të dhëna të kufizuara jo-kritike me kusht që një përdorim i tillë të mbetet i saktë, jo-përsëritës dhe jo-sistematik dhe është paraprirë nga njoftimi përkatës në ALPEX.

H.4.2.6 Paraqitja e të dhënave tek autoritetet kompetente

- (a) ALPEX-i duhet të raportojë të dhënat e paragrafit H.4.2.1 autoriteteve kompetente, siç specifikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, ose:
 - (i) në përputhje me ligjet ose rregulloret kombëtare në fuqi, dhe/ose
 - (ii) me kërkesë të autoriteteve kompetente mbikëqyrëse.

H.4.3 **Kërkesat e Raportimit**

- H.4.3.1 Kërkesat e raportimit të referuara në këtë seksion janë plotësuese për kërkesat e tjera të raportimit të përcaktuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike dhe në kuadrin rregullator dhe në veçanti në detyrimin e ALPEX-it për të vënë informacionin në dispozicion në faqen e tij të internetit.
- H.4.3.2 ALPEX-i do të publikojë të paktën informacionin e mëposhtëm të tregut për Njësinë Kohore të Tregut për çdo Ditë Livrimi përpara Kohës së Hapjes së Portës të Tregut të Ditës në Avancë, duke qenë subjekt i ruajtjes së konfidencialitetit, dhe do të mbajë një arkiv të këtij informacioni për pesë (5) vjet, të arritshëm për të gjithë Anëtarët e Bursës dhe palët e tjera të interesuara.
- (a) lista e Anëtarëve të pezulluar të Bursës, dhe
 - (b) çdo informacion tjetër që mund të caktohet me një Vendim Rregullator mbi rekomandimin e ALPEX-it.
- H.4.3.3 ALPEX-i do të publikojë të paktën informacionin e mëposhtëm të tregut për Njësinë Kohore të Tregut për çdo Ditë Livrimi gjashtëdhjetë (60) minuta pas publikimit të Rezultateve të Tregut të Ditës në Avancë, duke ruajtur konfidencialitetin, dhe do të mbajë një arkiv të këtij informacioni për pesë (5) vjet, të arritshëm për të gjithë Anëtarët e Bursës dhe palët e tjera të interesuara.
- (a) kurbat e grupuara dhe anonime të shitjes dhe blerjes të përfshira në Librin e Urdhërporosive Lokale;
 - (b) statistikat mbi numrin e përgjithshëm të Urdhërporosive Bllok të paraqitura dhe të pranuar, së bashku me shumën e sasive të ofruara dhe të pranuar të energjisë në Urdhërporosi në Bllok;
 - (c) Çmimet e Klerues të Tregut për Zonë Ofertimit, dhe
 - (d) Skedulimi i Grupuar i Tregut për cdo energji të injektuar dhe të tërhequr për Zonë Ofertimi për çdo Njësi Kohore Tregu, dhe
 - (e) çdo informacion tjetër që mund të përcaktohet si një Vendim i Autoriteti Rregullator mbi rekomandimin e ALPEX-it.
- H.4.3.4 ALPEX-i do të përgatisë dhe botojë në faqen e tij të internetit raporte mujore me të paktën shifrat e mësipërme të grupuara në bazë mujore.
- H.4.3.5 Publikimi i informacionit
- (a) ALPEX-i ofron informacion në kohë mbi Tregjet e Ditës në Avancë dhe atë Brenda së Njëjtës Ditë si për seksionet H.5.3 dhe sipas Vendimeve Teknike përkatëse në një mënyrë transparente, duke pranuar se Anëtarët e Bursës mund ta përdorin këtë informacion për të marrë pjesë në Tregje.
 - (b) Megjithatë, kur informacioni i kërkuar është i papërfunduar ose i pasaktë nuk lind asnjë përgjegjësi, me kusht që ALPEX-i të ketë bërë përpjekje të arsyeshme për të siguruar informacion të saktë në kohë dhe jo diskriminues.
 - (c) Burimi kryesor i informacionit të publikuar në treg është faqja e internetit të ALPEX-it. Të gjitha informacionet e tregut në faqen e ueb-internetit të ALPEX-

it janë të disponueshme publikisht në një format lehtësisht të arritshëm dhe të editueshëm.

- (d) Informacioni shtesë dhe detajet teknike në lidhje me të dhënat e ofruara nga ALPEX-i mund të specifikohen me një Vendim të ALPEX-it i cili do të publikohet në faqen e tij të internetit.

H.4.3.6 Transparenca

- (a) ALPEX-i respekton parimin e transparencës dhe publikon statistikën që grumbullon mbi tregtimin në kuadrin e ETSS-së.
- (b) ALPEX-i ofron informacion për publikun, dhe në veçanti për Anëtarët e Bursës, kur i kërkohet, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. ALPEX-i siguron që zbulimi i hollësive dhe informacionit që mban nuk u jep avantazhe të padrejta tregtare ose konkurruese palëve të treta, dhe në veçanti Anëtarëve të Bursës.
- (c) Detyrimi për të dhënë informacion duhet të përmbushë respektimin e parimit të sekretit tregtar. Stafi i ALPEX-it gjithashtu ka detyrimin për të respektuar parimin e konfidencialitetit.
- (d) Është përgjegjësi e ALPEX-it të mbajë informacionin e përditësuar të tregut sa më transparent që të jetë e mundur.

H.4.4 **Mbledhja e të dhënave për Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT)**

- H.4.4.1 Kur informacioni ose të dhënat kërkohen nga një Autoritet Përkatës në përputhje me kapitullin D, Anëtarët e Bursës duhet të japin informacione ose të dhëna të tilla në kohë, në mënyrë të saktë.

H.5 **KONFIDENCIALITETI**

H.5.1 **Përkufizimet**

- H.5.1.1 **Informacion Konfidencial** do të thotë, në lidhje me çdo Palë, informacion i cili është përcaktuar me shkrim nga ajo Palë si "Informacion Konfidencial", ose që do të konsiderohej si konfidencial nga natyra e tij dhe që zbulohet në lidhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike, Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë ose veprimtarinë e Palës që zbulon informacionin, në lidhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike. Informacioni konfidencial nuk duhet të përfshijë:

- (a) ekzistencën dhe kushtet e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike ose Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë; dhe
- (b) Regjistrimet e të dhënave ose informacioni i cili është në kohën përkatëse që kërkohet të publikohet në përputhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike.

- H.5.1.2 "Aplikimi për Anëtarësim" dhe çdo informacion tjetër i shkëmbyer si pjesë e marrjes së statusit të Anëtarit të Bursës, si dhe informacioni i Anëtarit të Bursës të përfshirë në regjistrat e mbajtur nga ALPEX-i konsiderohen konfidencialë sipas parashikimeve të dispozitave më specifike të seksionit H.5.

- H.5.1.3 ALPEX-i dhe çdo Anëtar i Bursës që merr informacion konfidencial në lidhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike duhet të ruajë konfidencialitetin e këtyre informacioneve dhe nuk do të zbulojë, raportojë, botojë, komunikojë, transferojnë ose përdorë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo pjesë të informacionit konfidencial për qëllime të tjera përveç qëllimeve për të cilat këto informacione u janë bërë të ditura atyre.
- H.5.1.4 Subjekt i paragrafit H.5.1.3, ALPEX-i ose një Anëtar i Bursës mund të zbulojë informacionin konfidencial të një pale që i bën zbulimin një pale të tretë pa pëlqimin paraprak dhe të shprehur të palës tjetër dhe me kusht që pala marrëse të ketë siguruar se Pala e tretë është e lidhur me detyrime konfidenciale ekuivalente siç përcaktohen në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.
- H.5.1.5 Subjekt i paragrafit H.5.1.3, ALPEX-i ose një Anëtar i Bursës mund të zbulojë informacion konfidencial të një pale që zbulon:
- (a) në masën e lejuar apo parashikuar shprehimisht nga Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike dhe ligji në fuqi;
 - (b) në masën e nevojshme për t'u përputhur me legjislacionin dhe rregulloren kombëtare të zbatueshme;
 - (c) në masën e kërkuar nga gjykata në procedimet përpara saj në të cilat marrësi është palë;
 - (d) nëse kërkohet nga Operatorët e tyre përkatës të Sistemit të Transmetimit për kryerjen e duhur të misionit të tyre dhe detyrimet e tyre sipas ligjit të zbatueshëm dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, qoftë nga vetë ata ose nëpërmjet agjentëve ose këshilltarëve, ose
 - (e) kur është e nevojshme për të marrë autorizime ose miratime nga autoritetet kompetente.
- H.5.1.6 Përveç kësaj, detyrimet që dalin sipas këtij nën seksioni nuk zbatohen:
- (a) nëse pala që merr informacionin mund të demonstrojë se në kohën e shpërndarjes së informacionit ky informacion ishte tashmë në dispozicion të publikut;
 - (b) nëse pala marrëse jep prova se, që nga koha e informimit, ky informacion është marrë ligjërisht nga një palë e tretë ose është vënë në dispozicion të publikut;
 - (c) në informacionin konfidencial të zbuluar në përputhje me rregullimet ligjore dhe rregullatore, në një formë të fiksuar, nga e cila nuk mund të nxirret asnjë informacion lidhur me një Anëtar të veçantë të Bursës;
 - (d) për informacionin publikimin e të cilit parashikohet në mënyrë të shprehur nga Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike dhe ligji në fuqi.
- H.5.1.7 Fitimi i statusit të Anëtarit të Bursës dhe shkëmbimi i informacionit konfidencial nuk do të krijojë asnjë të drejtë për patenta, *know-how*, njohuri ose ndonjë formë tjetër të pronësisë intelektuale në lidhje me informacionin ose mjetet e vënë në dispozicion ose të dërguara nga një palë kontraktuese tek një tjetër sipas Rregullave Tregut të Energjisë Elektrike.

H.5.2 **Mbrojtja e të dhënave**

- H.5.2.1 Pa paragjykim për përgjithësinë e çdo dispozite tjetër të këtyre Rregullave Tregut të Energjisë Elektrike, çdo Palë duhet:
- (a) të përputhet me kërkesat e zbatueshme të Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me çdo të Dhënë Personale të cilën e përpunon në rrjedhën e veprimtarisë së tij në lidhje me këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike;
 - (b) të sigurojë që masat e tij të zbatueshmërisë janë të përditësuara; dhe
 - (c) të përdorin përpjekjet e tyre të arsyeshme për të lidhur çdo kontratë të nevojshme për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale sipas Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- H.5.2.2 Çdo person që dorëzon të Dhëna Personale në ALPEX sipas këtyre Rregullave ose Procedurave (qoftë të dërguar vetë apo si pjesë e një dokumenti tjetër apo si grup informacioni apo të dhënash) duhet, para se ta bëjë këtë, të sigurojë pëlqime të tilla siç mund të kërkohej sipas Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ose çdo Ligj tjetër në Fuqi për të mundësuar që të Dhënat Personale të përdoren nga ALPEX në përputhje me, ose siç është menduar nga, këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike. Pa paragjykim për përgjithësinë e kësaj kërkesë, çdo Anëtar i Bursës duhet të prokurojë që çdo anëtar i stafit të tij të dhënat personale të të cilit ka ndërmend t'i transmetojë ALPEX-it do të japë së pari pëlqimin për një transferim të tillë dhe për përpunimin e këtyre të Dhënave Personale nga ALPEX-i për qëllime të kryerjes së funksioneve të tij sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- H.5.2.3 Një Anëtar i Bursës njofton ALPEX-in menjëherë për çdo shkelje të dispozitave në këtë seksion H.5.2.

I. ÇËSHTJE TEKNIKE

I.1 QËLLIMI I KËTIJ KAPITULLI

I.1.1 Kërkesa teknike të nivelit të lartë

I.1.1.1 Ky Kapitull i përshkruan kërkesat teknike të nivelit të lartë që Anëtarët e Bursës duhet të përmbushin në mënyrë që të marrin pjesë në Bursë. Anëtarët e Bursës duhet të përmbushin gjithashtu kërkesat e detajuara teknike të përcaktuara në Procedurat, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre Rregullave.

I.1.2 Transmetimi elektronik i Urdhërporosive

I.1.2.1 Anëtarët e Bursës që dërgojnë Urdhërporosi në ETSS do ta bëjnë këtë në përputhje me Procedurat e Tregimit, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre Rregullave.

I.2 KËRKESAT PËR QASJE TEKNIKE

I.2.1 Rregullimet e aksesit siç specifikohet nga ALPEX-i

I.2.1.1 Anëtarët e Bursës duhet të hyjnë në ETSS vetëm duke plotësuar në detaje rendin elektronik dhe sistemin e pritjes të specifikuar nga ALPEX-i dhe të përshkruara në Procedurat, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre Rregullave.

I.2.2 Pajtueshmëria me kërkesat teknike

I.2.2.1 Për lidhjen me ETSS dhe aksesin në shërbimet e ALPEX-it, Sistemet e Anëtarit të Bursës duhet të përputhen me kërkesat teknike të përcaktuara në:

- (a) këto rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike;
- (b) Procedurat, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre Rregullave; dhe
- (c) dokumentet teknike dhe operacionale të detajuara të ofruara Anëtarëve të Bursës nga ALPEX-i, në zbatim të Procedurave.

I.2.2.2 Anëtarët e Bursës duhet të zotërojnë pajisje hardware dhe software që sigurojnë sisteme të afta t'i përgjigjen situatave të paparashikuara dhe lidhje me mungesën e internetit, dhe të veprojnë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në këto Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

I.2.3 Testim

I.2.3.1 Nëse kërkohet nga ALPEX-i, Anëtarët e Bursës duhet të mbështesin dhe marrin pjesë në çdo sesion testimi dhe prove (Mock sessions) me qëllim që të konfirmojnë përputhjen operacionale me ETSS-në.

I.2.3.2 Të gjithë Anëtarët e Bursës duhet të kalojnë testimin e përputhshmërisë për t'u lejuar të kenë akses në ETSS, dhe në përputhje me Procedurat, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre Rregullave.

I.2.4 E drejta për inspektim

I.2.4.1 Çdo Anëtar i Bursës pranon se ALPEX-i (ose ofruesit ose nënkontraktuesit e tij të autorizuar të shërbimit) do të lejohet të auditojë përputhshmërinë e Anëtarit të Bursës me të gjitha parashikimet e Ligjeve në Fuqi, Rregullat e të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre Rregullave dhe në përgjithësi parashikimet e operimit të Tregjeve të ALPEX-it.

I.2.5 Vendndodhja e sistemeve *front-end*

I.2.5.1 Një Anëtar Burse ose një Aplikant për pranim mund të kërkojë dhe ALPEX-i mund të lejojë instalimin e sistemeve *front-end* në zyrat e Anëtarit të Bursës me kusht që aplikimi dhe pajtueshmëria e dispozitave teknike të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të sigurohen gjithashtu në vendin në të cilin ndodhet zyra shtesë.

I.2.6 Sistemet e drejtimit të Urdhërporosive

I.2.6.1 Nëse ALPEX-i i lejon një Anëtarit të Bursës të përdorë sistemet e drejtimit të Urdhërporosive në përputhje me Procedurat, ky Anëtar i Bursës duhet të jetë përgjegjës për të siguruar që:

- (a) objekti i sistemeve të drejtimit të Urdhërporosive përdoret siç duhet, për qëllimin e caktuar dhe në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike; dhe
- (b) çdo Urdhërporosi që hyn në ETSS nëpërmjet sistemit të drejtimit të urdhërporosive nga palët e treta të cilët nuk janë pranuar në Bursë gjithashtu duhet të respektojë dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

I.2.6.2 Nëse një Anëtar i Bursës nuk është në përputhje me kërkesat në paragrafin I.2.6.1, ALPEX-i mund të kufizojë ose revokojë lejen e tij për të përdorur një sistem të drejtimit të Urdhërporosive.

I.2.7 Keqfunksionimet teknike

I.2.7.1 Një Anëtar i Bursës duhet të informojë ALPEX-in menjëherë për çdo keqfunksionim që prek pajisjet e tij teknike ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas këtij seksioni I.2.

I.2.7.2 Anëtarit i Bursës autorizon ALPEX-in të marrë masat e duhura për të mbrojtur ose rinisur tregtimin dhe zgjidhjen e duhur pas një keqfunksionimi.

I.2.8 Hapat për të bërë të mundur Tregtimin

I.2.8.1 ALPEX-i do t'u sigurojë Anëtarëve të Bursës të dhënat e emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit që kërkohen për të hyrë në ETSS.

I.2.8.2 ETSS lejon hyrjen vetëm tek përdoruesit e autorizuar të Anëtarëve të Bursës.

I.2.8.3 Për të pasur akses, çdo përdorues duhet të marrë nga ALPEX-i një fjalëkalim të veçantë që është unik për përdoruesin.

I.2.8.4 Të gjitha Urdhërporositë e dërguara në ALPEX nga Anëtarët e Bursës dhe të transmetuara në ETSS me qëllim ekzekutimin e tregtisë, janë detyruese për Anëtarët

e Bursës. Në çdo rast, Anëtari i Bursës do të jetë përgjegjës për përdorimin e një fjalëkalimi nga persona të paautorizuar.

I.2.8.5 Anëtarët e Bursës kanë detyrimin për të informuar menjëherë ALPEX-i për çdo ndryshim që përfshin përdoruesit ose ndonjë revokim të autoritetit të përdoruesit për çfarëdo arsye, në mënyrë që ALPEX-i të mund të çaktivizojë në mënyrë të përhershme ose të përkohshme fjalëkalimin e atij përdoruesi.

I.2.9 **Pasoja e shkeljeve teknike**

I.2.9.1 Në rast të shkeljes materiale të kërkesave teknike në seksionin I.2 nga një Anëtar Bursës, ALPEX-i mund të pezullojë përkohësisht Anëtarin e Bursës në përputhje me seksionin C.2.

J. NDRYSHIMET E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

J.1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

J.1.1 Ndryshuar Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike

J.1.1.1 Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrikemund të jenë objekt ndryshimi, në përputhje me Kapitullin J dhe pasi të jenë plotësuar kërkesat për miratim të Autoriteteve Rregullatore dhe parakushtet e tjera të përcaktuara në seksionin J.4.

J.1.2 Njoftimi, publikimi dhe koha e Ndryshimeve

J.1.2.1 ALPEX-i duhet të njoftojë Anëtarët e Bursës dhe të publikojë Ndryshimet e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 14 ditë kalendarike pas marrjes së vendimit për t'i ndryshuar ato.

J.1.2.2 Ndryshimi hyn në fuqi në datën e specifikuar në njoftim, me kusht që të mos ketë efekt prapa veprues.

J.1.2.3 Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të ndryshuara janë të detyrueshme për ALPEX-in dhe Anëtarët e Bursës siç specifikohet në seksionin B.4 të këtyre Rregullave të ALPEX-it.

J.1.2.4 Nëse Anëtarët e Bursës nuk janë dakord me ndryshimet, ata kanë të drejtë të heqin dorë nga anëtarësia sipas seksionit C.2.3.

J.1.3 Procedurat e Ndryshimeve

J.1.3.1 ALPEX-i mund ti zhvillojë Procedurat sipas seksionit B.3.3 për të përcaktuar procese të mëtejshme të detajuara dhe afate kohore për dorëzimin dhe shqyrtimin e Propozimeve për Ndryshim, të cilat nuk janë objekt miratimi nga Autoritetet Rregullatore.

J.2 NDRYSHIMI I RREGULLAVE TË ALPEX-IT DHE PROCEDURAVE

J.2.1 Kush mund të propozojë ndryshime

J.2.1.1 Propozimin për Ndryshime mund ta paraqesë çdo Palë, Komiteti i Bursës, ALPEX-i ose, kur kërkohet miratimi sipas seksionit J.4.1.1, propozimin mund ta bëjnë Autoritetet Rregullatore.

J.2.1.2 Përveç se kur kërkohet miratimi nga Autoritetet Rregullatore, propozimi i Ndryshimeve do t'i jepet ALPEX-it dhe duhet të:

- (a) të jetë në formën e publikuar nga ALPEX-i, nëse ka të tillë; dhe
- (b) të jetë i qartë dhe i argumentuar me detaje të mjaftueshme për të bërë të mundur shqyrtimin e tij;

J.2.2 ALPEX-i duhet të marrë parasysh Propozimet për Ndryshime

J.2.2.1 ALPEX-i mund të vendosë të ndryshojë ose ti kombinojë Propozimet për Ndryshime dhe, nëse e bën këtë, do të informojë Komitetin e Bursës për ndryshimet e bëra dhe arsyetimin përkatës.

J.2.2.2 ALPEX-i mund të kërkojë informacion shtesë nga Propozuesi përpara se të konsultohet me Komitetin e Bursës.

J.2.3 Konsultimet me Komitetin e Bursës

J.2.3.1 ALPEX do të konsultohet me Komitetin e Bursës për të gjitha Propozimet për Ndryshime dhe duhet të marrë parasysh pikëpamjet e shprehura nga Komiteti i Bursës, nëse ka, për të vendosur nëse do të ndryshojë ose jo Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

J.2.3.2 ALPEX-i do t'i lërë një kohë të arsyeshme Komitetit të Bursës për të shqyrtuar Propozimin për Ndryshime, përveç rasteve kur ALPEX-i vëren se Propozimi për Ndryshim është urgjent ose kërkohet në përputhje me paragrafin J.5, rast në të cilin ALPEX-i mund të kërkojë shqyrtim të përshpejtuar nga Komiteti i Bursës.

J.2.3.3 ALPEX-i dhe Komiteti i Bursës do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të respektuar çdo afat kohor në lidhje me konsultimin, siç përcaktohet në Procedura.

J.3 VENDIMET E ALPEX-IT

J.3.1 Opsionet e mundshme për ALPEX-in

J.3.1.1 Sipas pikave J.2 dhe J.4, në lidhje me një Propozim për Ndryshime, i cili nuk është objekt miratimi nga Autoritetet Rregullatore, ALPEX-i do të vendosë nëse:

- (a) do të ndryshojë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike;
- (b) nuk do të ndryshojë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike;
- (c) do të kërkojë që Komiteti i Bursës të marrë përsipër shqyrtimin e mëtejshëm të çështjeve të ngritura në Propozimin për Ndryshim.

J.3.1.2 Përpara së të marrë vendimin sipas paragrafit J.3.1.1, ALPEX-i mund të ndërmarrë një konsultim shtesë sipas nevojës.

J.3.2 Arsyet e vendimit

J.3.2.1 Nëse ALPEX-i vendos të mos i pranojë opinionet ose këshillat e Komitetit të Bursës, ALPEX-i do t'ja shpjegojë me shkrim Komitetit të Bursës arsyet e mospranimit të tij.

J.4 PARAKUSHTET PËR NDRYSHIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

J.4.1 Miratimi i Autoritetit Rregullator

J.4.1.1 Krahas parakushteve të përcaktuara në paragrafin J.4.2, në rastet kur është kusht, Ndryshimi i propozuar i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrikeduhet të miratohet nga Autoritetet Rregullatore.

J.4.2 Parakushte të tjera

- J.4.2.1 ALPEX-i mund të ndryshojë këto Rregulla të Tregut të Energjisë në çdo kohë, me kusht që:
- (a) Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike që dalin nga këto ndryshime duhet të jenë në përputhje me Objektivat dhe Parimet e ALPEX-it;
 - (b) Ndryshimet i janë dorëzuar Komitetit të Bursës në lidhje me pikëpamjet e tij në përputhje me seksionin J.2.3 dhe seksionin B.2.2;
 - (c) në rastin e Ndryshimit të Procedurave, pjesë ndryshimi përputhet me çdo proces të përcaktuar në vetë Procedurat; dhe
 - (d) Data e Hyrjes në Fuqi e ndryshimit merr parasysh çdo ndryshim të nevojshëm në lidhje me sistemet dhe proceset për zbatimin e Ndryshimit.
- J.4.2.2 Pavarësisht nga paragrafi J.1.2, ndryshimi i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike mund të hyjë në fuqi me efekt të menjëhershëm pas njoftimit të Anëtarëve të prekur të Bursës dhe Autoritetit Rregullator:
- (a) Nëse kërkohet kështu nga legjislacioni në fuqi;
 - (b) Nëse ndryshime të tilla janë të nevojshme për vazhdimin e operacioneve Tregtare ose për integritetin e tregjeve përkatëse;
 - (c) Nëse këto ndryshime janë të nevojshme për të korrigjuar gabimet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike; ose
 - (d) Nëse ndryshime të tilla janë vetëm për të korrigjuar drejtshkrimin dhe nuk sjellin ndonjë ndryshim thelbësor në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, përfshirë sqarime dhe ndryshime në paraqitje, etj.
- J.4.2.3 Nëse këto ndryshime të parashikuara në paragrafin J.4.2.2 nuk miratohen nga Autoritetet Rregullatorë brenda 45 ditëve kalendarike , këto ndryshime nuk do të kenë me efekte pas këtij afati.

J.5 PROCESI KONSULTATIV I PËRSHPEJTUAR PËR NDRYSHIMET E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERJISË ELEKTRIKE

J.5.1 Të Përgjithshme

- J.5.1.1 Kur ALPEX konsideron që Ndryshimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike kërkohen për ti dhënë efekt ndryshimeve të bëra për transpozimet e Rregulloreve të EU, ose të tjera transpozime të rregulloreve Evropiane nga vendimet e Autoritetit Rregullator që në mënyrë direkte ndikojnë në operimin e Bursës, në këto kushte ALPEX-i mund të adoptojë një proces konsultativ të përshpejtuar, me kusht që ky proces do të përfshijë:
- (a) Njoftimin e arsyeshëm të Anëtarëve të Bursës për Ndryshimeve e kërkuara;
 - (b) Konsultimin me Komitetin e Bursës në lidhje me implementimin e Ndryshimet e kërkuara.
- J.5.1.2 Kur ky Ndryshim i kërkuar sipas paragrafin J.5.1.1 ka ndikim në këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike dhe kërkohet aprovim sipas paragrafit J.4.1.1, ALPEX-i do të njoftojë Autoritetet Rregullatore brenda afatit të përcaktuar për Ndryshimin e

kërkuar, arsyet pse duhet bërë ndryshimi, dhe kohën e propozuar për zbatimin e tij, dhe do të kërkojë aprovimin brenda afateve kohore nga Autoriteti Rregullator për të parandaluar ndonjë përplasje me rregulloret që do zbatohen në tregjet Evropiane të energjisë elektrike.

J.6 ÇËSHTJE TË TJERA

J.6.1 Pronësia Intelektuale e lidhur me propozimet për Ndryshim

- J.6.1.1 Çdo Palë e cila paraqet Propozimin për Ndryshim do të konsiderohet sikur e ka dhënë në mënyrë të pakthyeshme dhe pa pagesë licencën botërore të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale ose të drejtave të tjera dhe ka hequr dorë nga ndonjë e drejtë morale, në përmbajtje, formë ose të tjera aspekte të Propozimit për Ndryshim dhe kjo licencë dhe heqje dorë do të jenë një parakusht për paraqitjen e vlefshme të një Propozimi për Ndryshim.
- J.6.1.2 Secili Propozues, i cili nuk është Palë, do ti kërkohet të jap në mënyrë të pakthyeshme dhe pa pagesë licencën botërore të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale ose të drejta të tjera dhe ka hequr dorë nga ndonjë e drejtë morale, në përmbajtje, formë ose të tjera aspekte të Propozimit për Ndryshim dhe kjo licencë dhe heqje dorë do të jetë një parakusht për paraqitjen e vlefshme të një Propozimi për Ndryshim.
- J.6.1.3 ALPEX bën të disponueshme në faqen e internetit të tij një formë të Propozimit për Ndryshim ku përfshihet në mënyrë të pakthyeshme dhe pa pagesë licenca botërore të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale ose të drejta të tjera dhe ka hequr dorë nga ndonjë e drejtë morale, në përmbajtje, formë ose të tjera aspekte të propozimeve.

K. MARRËVESHJET E PËRKOHSHME

K.1 HYRJE

K.1.1 Qëllimi

K.1.1.1 Ky kapitull saktëson disa marrëveshje të përkohshme që do të zbatohen në lidhje me Bursën pas datës së hyrjes në fuqi për një periudhë tranzitore, e cila specifikohet në secilin rast.

K.1.2 Përparësia e këtij Kapitulli

K.1.2.1 Ky Kapitull ka përparësi ndaj Kapitujve të tjerë të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe në rast të ndonjë mospërputhjeje ose konflikti midis një dispozite të këtij Kapitulli K dhe çdo dispozite tjetër të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, dispozita e Kapitullit K mbizotëron në lidhje me mospërputhjen ose konfliktin për periudhën tranzitore të specifikuar.

K.1.3 Fillimi i Tregtimit

K.1.3.1 E para Njësi Kohore e Tregut për qëllim të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike do të fillojë në Kohën e Përcaktuar.

K.1.4 Kushtet Fillestare të Anëtarëve të Komitetit të Bursës

K.1.4.1 Pavarësisht nga paragrafi B.2.3.4, emërimi fillestar i anëtarëve të Komitetit të Bursës do të bëhet sipas kushteve që përfshijnë disa emërime për një mandat njëvjeçar dhe disa për një mandat dyvjeçar. Vendosja e datave të ndryshme të përfundimit të afatit ka për qëllim promovimin e vazhdimësisë së Komitetit të Bursës.

K.2 NDRYSHIMET NË RREGULLA DHE PROCEDURA PËRPARA SE TË FUTEN NË ZBATIM

K.2.1 Rrethanat që mund të kërkojnë ndryshime

K.2.1.1 Rezultatet e testimit të produktit dhe provave të tregut, ose miratimet e jashtme të kërkuara në lidhje me fillimin e tregtimit, mund të kërkojnë një ose më shumë ndryshime në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, gjatë periudhës ndërmjet miratimit të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike nga Autoritetet Rregullatore dhe Kohës së Përcaktuar, për fillimin e tregtimit.

K.2.2 Ndryshimet mund të bëhen pas konsultimeve

K.2.2.1 Nëse jemi në rrethanat e paragrafit K.2.1.1, atëherë ALPEX-i mund ti ndryshojë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike siç duhet, pa përfunduar hapat proceduralë të përcaktuar në Kapitullin J të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, ose Procedurat e Komitetit të Bursës, me kusht që ALPEX-i të:

- (a) jetë konsultuar me grupet e interesit për të shpjeguar arsyet e ndryshimeve dhe efektin e ndryshimeve, dhe ka marrë parasysh të gjitha komentet e marra në ato konsultime;

- (b) jetë këshilluar me Autoritetet Rregullatore në lidhje me ndryshimet, rezultatin e konsultimit të përmendur në paragrafin (a) më sipër, dhe tu ketë dhënë një mundësi Autoriteteve Rregullatore për të sugjeruar çdo Ndryshim që:
 - (i) lidhet drejtpërdrejtë me çështjet që janë objekt i ndryshimeve të marra në konsideratë; dhe
 - (ii) është nën kompetencën e ALPEX-it për tu bërë.
- (c) ketë njoftuar Komitetin e Bursës për të paraqitur mendimin e tij me shkrim për ndryshime që afektojnë palët e treta, në përputhje me afatet e përcaktuara nga ALPEX.

K.2.2.2 ALPEX-i duhet të njoftojë Anëtarët e Bursës dhe Autoritetet Rregullatore për çdo Ndryshim të bërë në përputhje me seksionin K.2, dhe do t'i publikojë këto Ndryshime në përputhje me seksionin J.1.2.

K.2.3 **Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

- K.2.3.1 Këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike hyjnë në fuqi me miratimin e tyre nga Autoritetet Rregullator përkatës, më datë 27.12.2022. Me hyrjen në fuqi të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, , “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjes së pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë” dhe shtojcat përkatëse të miratuara me vendimin e Bordi të ERE-s Nr. 214, datë 28.12.2017 shfuqizohen.
- K.2.3.2 Për një periudhë 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave, asnje prej anëtarëve të Bursës nuk do të pranohen të regjistrohen si Anëtar Personal Klerimi.

PËRKUFIZIMET E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

PËRKUFIZIMET DHE AKRONIMET TË PERDORUARA NË RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE PROCEDURAT

Vetëm nëse nuk është parashikuar ndryshe, referencat në këtë dokument të Kapitujve, seksioneve dhe paragrafëve janë referencat të dispozitave të Rregullave të tregut të energjisë elektrike dhe Procedurave.

A - J

Agjent i Transaksioneve	nënkupton entitetin ose entitetet me detyrën e transferimit të Pozicioneve Neto ndërmjet Kundërpalëve Qendrore
Agjent Klerues i Certifikuar	Nënkupton një person i cili është certifikuar nga ALPEX për të kryer operacionet e Klerimit dhe Shlyerjes në emër një Anëtari Klerimi lidhur me Transaksionet e Energjisë Elektrike në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat
Agjent Tregtar i Certifikuar	Nënkupton një person i cili është certifikuar nga ALPEX dhe është përgjegjës dhe i autorizuar për të kryer tregtimin në emër të një Anëtari të Bursës në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat
Algoritmi për Bashkimin i Çmimit	Algoritmi i përdorur në Bashkimin e vetëm të Ditës në Avancë për qëllim të përputhjes të njëkohshme të urdhërporosive dhe kapaciteteve ndërkufitare të alokuara. Algoritmi për Bashkimin e Çmimit përdoret në situatën e bashkimit ose jo të Ankandëve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë
Anëtar i Bursës	Nënkupton një entitet të pranuar si një anëtar në Bursë në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike
Anëtar i Klerimit	Nënkupton një entitet që ndërmerr veprimtari nëpërmjet EMCS-së për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve në Tregjet e ALPEX-it dhe është përgjegjës përpara ALPEX-it për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo pjesëmarrje në përputhje me kushtet dhe dispozitat e Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat
Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit	Nënkupton një Anëtar Klerimi i cili ka të drejtë të kleroj Transaksionet e kryera nga Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it
Anëtar Personal i Klerimit	Nënkupton një Anëtar Klerimi që ka të drejtë të kleroj Transaksionet të kryera prej tij si një Anëtar i Bursës në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes
Ankand	Nënkupton një ankand i kryer në Segmentin e Tregut të Ditës në Avancë ose Segmentin e Tregut Brenda së Njëjtës Ditë
Ankand Lokal	Një Ankand i zhvilluar vetëm brenda një Zone Ofertimi

Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë	Nënkupton një Ankand në Segmentin e Tregut Brenda së Njëjtës Ditë
Ankandet Plotësuese Rajonale Brenda së Njëjtës Ditë (CRIDA)	Nënkupton Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë që zhvillohen në një zonë e cila përbëhet nga disa Zona Ofertimi , plotësuese të Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës së Ditë
Ankandet Lokale Brenda të Njëjtës Ditë (LIDA)	Nënkupton një Ankand Brenda së Njëjtës Ditë që përfshin Zonat të ndara Ofertimi në Shqipëri ose Kosovë
Ankandi i Ditës në Avancë	Nënkupton Ankandin në Segmentin e Tregut të Ditës në Avancë
Aplikanti	Nënkupton një entitet ligjor që kërkon të pranohet si Anëtar i Bursës në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme në seksioni C.1. ose të pranohet si Anëtar i Klerimit në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes në seksionin C.2
Aplikimi për Anëtarësim	Nënkupton një formë aplikimi standard i cili duhet të plotësohet nga çdo Aplikant që ka si qëllim të pranohet si Anëtar i Bursës
Asetet Funktionale të Bashkimit të Tregjeve	Asetet Funktionale të Bashkimit të Tregjeve janë: Price Matcher Broker (PMB) dhe EUPHEMIA
Autoriteti Kompetent	Nënkupton qeverinë e Shqipërisë apo Kosovës, Autoritetin Rregullator të Energjisë të Shqipërisë, Zyrën e Rregullatorit për Energji të Kosovës, Autoritetin e Konkurrencës së Shqipërisë, Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës, Gjykatat Kompetente të Shqipërisë ose Kosovës, Ministrin, Departamentin, Komisionin, Entitetin dhe çdo trupë ndërkombëtare me fuqi dhe kompetence për ti bërë të detyrueshme vendimet, shpërblimin, rregullin ose gjykimet
Autoriteti Përkatës	Nënkupton Autoritetin Rregullator ose Autoritet tjetër Kompetent sipas Ligjit në Fuqi
Autoriteti Rregullator	Nënkupton ose ERE-n dhe/ose ZRrE-n
Autorizimet e Kërkuara	Nënkupton të gjitha licencat, autorizimet, lejet, marrëveshjet, kontratat dhe të tjera aprovime (nëse ka) të cilat mundësohen nga Autoriteti Përkatës dhe që kërkohen për ti mundësuar një Pale të përmbush detyrimet e saj sipas Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat , në përputhje me ligjin në fuqi
Banka	Nënkupton një entitet që mban një Licencë Bankare përkatëse
Banka për Shlyerje	nënkupton një Bankë Tregtare, nëpërmjet së cilës kryhet shlyerja në para e transaksioneve për tu kleruar nga ALPEX në përputhje me kushtet e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes

Banka Qendrore	Nënkupton Bankën e Shqipërisë në referim të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Qendrore të Kosovës kur i referohet Republikës së Kosovës
Bashkimi Çmimit i Rajoneve (PCR)	Nënkupton një iniciative të nëntë bursave të energjisë evropiane për të zhvilluar një zgjidhje të vetme të bashkimit të çmimit e cila do përdoret për të llogaritur çmimet e energjisë elektrike në Evropës dhe alokimin e Kapacitetit Ndërkufitar
Bashkimi i Tregjeve	Nënkupton një mekanizëm për integrimin e tregjeve të energjisë elektrike të zonave të ndryshme me metodat jodiskriminuese, në implicit dhe bazë tregu, për formimin e çmimit dhe alokimin e Kapaciteteve Ndërkufitare të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë
Blllok Vartës	Nënkupton bllokun e varur në pranimin e tij nga pranimi i një tjetër blloku
Blloku i Izoluar	Nënkupton Urdhërporositë në Bllok pa Bllloqet e Varura
Blloku Udhëheqës	Nënkupton bllokun i cili kushtëzon pranimin e bllloqeve të tjera
Borxh i Keq i Pasiguruar	Për të shmangur çdo keqkuptim, ky përkufizim aplikohet vetëm për qëllim të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe nuk ka për qëllim për të nënkuptuar se çdo shumë e caktuar është një “borxh i keq” brenda kuptimit të kësaj shprehje në përkufizimet standarde ose praktike fiskale, financiare ose kontabilitetit
Burimet Personale të Dedikuara	Nënkupton burime financiare të paravendosura në dispozicion të ALPEX si një Palë Qendrore për të mbuluar humbjet e mundshme në rast të një Mospërbushje të Detyrimeve nga një Anëtar Klerimi, të cilat tejkalojnë humbjet që janë mbuluara prej Margjinës të mundësuar nga ky Anëtar dhe as nga Fondi i Mospërbushjes së Detyrimeve në përputhje me dispozitat e specifikuar në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes
Bursa	Nënkupton tregun e organizuar që operohet nga ALPEX duke ofruar tregtimin e energjisë elektrike, klerimin dhe shlyerjen në afatet kohore për tregjet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë për livrimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë siç është vendosur në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat.
Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX)	Nënkupton entitetin përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike me shumicë në Shqipëri në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe në fuqi, dhe në Kosovë bazuar në vendimin e ZRrE-së nr. V_1332_2020 dhe Marrëveshjes ndërmjet KOSTT dhe ALPEX firmosur më 16.12.2022

Çifti Çmim-Sasi	Nënkupton një çift çmim-sasi i përfshirë në një Urdhërporosi dhe: (a) në lidhje me Ankandin e Ditës në Avancë, përshkruhet në paragrafin B.1.5.5. të Procedurës së Tregtimit (b) në lidhje me Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë, përshkruhet në paragrafin C.1.5.5 të Procedurës së Tregtimit; dhe (c) në lidhje me Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë, përshkruhet në paragrafin D.1.2.4 të Procedurës së Tregtimit.
Çmimi i Ankandit	Nënkupton Çmimin Klerues për një Njësi Kohore Tregu të caktuar i dalë prej Ankandit nga ku të gjitha Kontratat që rrjedhin prej Ankandit dhe që i përkasin kësaj Njësi Kohore Tregu do të shlyen
Çmimi i Maksimal i Tregut të Ditës në Avancë	Nënkupton nivelin maksimal i çmimit të lejuar për Urdhërporositë të futura në Ankandin e Ditës në Avancë
Çmimi i Minimal i Tregut të Ditës në Avancë	Nënkupton nivelin minimal i çmimit të lejuar për Urdhërporositë të futura në Ankandin e Ditës në Avancë
Çmimi Klerues	Nënkupton çmimin e vendosur nga përputhja e Urdhërporosive me çmim të pranuar me vlerën më të lartë për shitje me Urdhërporositë me çmim të pranuar me vlerën më të ulët për blerje në tregun e energjisë elektrike
Çmimi Klerues i Tregut	Nënkupton çmimin e vendosur nga përputhja e Urdhërporosisë Shitjeje të pranuar me çmimin më të lartë me Urdhërporosinë Blerjeje të pranuar me çmimin më të ulët në tregun e energjisë elektrike
Çmimi Maksimal i Ankandit të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë	Çmimi Klerues Maksimal në lidhje me një Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë
Çmimi Maksimal i Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	Niveli maksimal i çmimit të lejuar për Urdhërporositë e dorëzuara në Tregun e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë
Çmimi Minimal i Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	Niveli minimal i çmimit të lejuar për Urdhërporositë e futura në Tregun e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë
Çmimi Minimal i Ankandit të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë	Çmimi Minimal i Klerimit në respekt të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë
CET	Zona Kohore e Evropës Qendrore

CRIDA-1	Nënkupton Ankandin e parë të Bashkimit të Tregjeve Brenda së Njëjtës Ditë duke përfshirë Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të realizuar për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit
CRIDA-2	Nënkupton Ankandin e dytë të Bashkimit të Tregjeve në Brenda së Njëjtës Ditë duke përfshirë Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të realizuar për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit
CRIDA-3	Nënkupton Ankandin e tretë të Bashkimit të Tregjeve në Brenda së Njëjtës Ditë duke përfshirë Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të realizuar për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit
DAM	Nënkupton Tregun e Ditës në Avancë
Data e Hyrjes në Fuqi	Nënkupton datën e së cilës një dokument ose marrëveshje hyn në fuqi
Data e Pagesës	Nënkupton datën dhe kohën përpara së cilës çdo shumë për tu paguar nën Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes në vijim të termave të tyre duhet të paguhet
Debitori i ALPEX	Nënkupton Anëtarin e Klerimit i cili paguan ALPEX-in sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes
Dita e Fillimit	Nënkupton datën e hyrjes në fuqi të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes siç vendoset nga Autoriteti Rregullator
Dita e Klerimit	Nënkupton një Ditë kalendarike në të cilën procedurat e Klerimit kryhen dhe detyrimet dhe të drejtat e Anëtarëve të Klerimit janë llogaritur në bazë të transaksioneve që kanë qenë përmbyllur në Tregjet e Energjisë Elektrike dhe regjistruar në Sistemin e Klerimit. Ditët e Klerimit janë Ditë Pune në përputhje me kalendarin e ditës së klerimit të përcaktuar dhe shpallur nga ALPEX-i
Dita e Livrimit	Nënkupton një seri të vazhdueshme të Periudhave të Livrimit e cila fillon në orën 00:00 CET në një Ditë kalendarike dhe mbaron në orën 24:00 CET e së njëjtës Ditë kalendarike
Dita e Shlyerjes	Nënkupton Ditën Bankare kur do të bëhet shlyerja përkatëse
Dita e Tregtimit	Nënkupton një Ditë kalendarike kur Tregjet e ALPEX-it hapen për Tregtim
Ditë	Nënkupton një Ditë kalendarike

Ditë pune	<p>Nënkupton një Ditë jave në të cilën nuk është:</p> <p>(a) një Ditë pushim publik ose Ditë pushim bankar në Shqipëri ose Kosovë;</p> <p>(b) një Ditë jo-pune sipas udhëzimit të Bankës Qendrore të Shqipërisë ose Kosovës , sipas rastit.</p> <p>Termi “Jo-Ditë Pune” do të interpretohet në përputhje me rrethanat</p>
Dorëheqje	<p>Nënkupton një aplikim me shkrim për dorëheqje nga Anëtari i Bursës nëse ALPEX është i bindur se ky Anëtar ka përmbushur (ose do të përmbushë deri në kohën kur dorëheqja hyn në fuqi)</p>
Ekzekutimi i Garancisë	<p>Nënkupton ekzekutimin nga ALPEX të Letër Garancisë të lëshuar nga banka dhe tërheqjen e një pjese ose të gjithë Kufirit të Kreditit të Anëtarit të Klerimit</p>
EMCS - Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë	<p>Nënkupton Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë Elektrike siç përshkruhet në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes</p>
Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE)	<p>Nënkupton institucionin rregullatorë në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror i cili operon sipas ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe në fuqi</p>
Entitet	<p>Nënkupton çdo formë organizimi i shoqërive tregtare siç parashikohet në ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar dhe ligji nr.06/L-016 “Për Shoqëritë Tregtare” për Republikën e Kosovës</p>
ETSS - Sistemi Elektronik i Tregtimit në Çast	<p>Nënkupton Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast. Sistem tregtimi i cili menaxhon të gjithë proceset e Tregjeve Elektrike, kryen të gjitha llogaritjet, mban të dhënat dhe rezultatet në Tregjet e ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë dhe menaxhon ndërfaqen midis tregjeve të sipërpërmendur me Tregun e Balancimit të operuar nga Operatori përkatës i Sistemit të Transmetimit</p>
Euro	<p>Nënkupton njësinë monetare dhe monedhën e Bashkimit Evropian e përfaqësuar me simbolin €</p>
Faturë	<p>Ka kuptimin e dhënë në seksionin G.4.2</p>
Fondi i Mospërmbushjes së Detyrimeve	<p>Nënkupton Fondin e krijuar nga ALPEX-i për të mbuluar riskun nga aktiviteti i Klerimit që ai kryen si Kundërpalë Qendrore në përputhje me dispozitat e veçanta të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, duke përfshirë Kapitullin E të saj</p>
Furnizues	<p>Nënkupton një mbajtës të licencës për furnizim të energjisë elektrike dhe kryen veprimtaritë e furnizimit</p>
Furnizuesi i Shërbimit Universal	<p>nënkupton një shoqëri sipas përcaktimit në ligjin përkatës për energjinë elektrike të Shqipërisë ose Kosovës</p>

Garancia	Nënkupton procesin e vendosur në seksionin G.3. të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes
Garancia e Vlefshme	Nënkupton Garancinë e mundësuar nga një Anëtar i Klerimit në përputhje me termat e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe e cila nuk është vendosur nga ALPEX-i si Margjinë
Gjenerues	Nënkupton një entitet ligjor cili prodhon energji elektrike dhe mban një licencë për prodhimin e energjisë elektrike
Gjeneruesi Publik	Nënkupton një Gjenerues i energjisë elektrike në pronësi të shtetit të Shqipërisë dhe/ose Kosovës
Gjithçka-ose- Asgjë - Kushti (AON)	Ka kuptimin e dhënë në paragrafin D.1.6.4 të Procedurës së Tregtimit
Gjykata	Nënkupton një gjykatë brenda sistemit ligjor të Shqipërisë ose Kosovës sipas rastit
Grupi Ekskluziv i Urdhërporosive në Bllok	Nënkupton një Urdhërporosi në Bllok që paraqet kushtet dhe vetitë specifike siç mundësohen në paragrafin B.1.9 të Procedurës së Tregtimit
IDM	Nënkupton Tregun Brenda së Njëjtës Ditë
Informacion Konfidencial	<p>Nënkupton informacionin (në lidhje me një Palë) i cili është përcaktuar me shkrim nga një Palë si konfidencial ose i cili do të mund të konsiderohet të jetë konfidencial prej natyrës së tij dhe i cili është zbuluar në lidhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat, Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, Marrëveshjen Kuadër për Klerim. Informacioni Konfidencial nuk do të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ekzistencën e termave të Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave, Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë dhe Marrëveshjen Kuadër për Klerim; dhe 2. Regjistrimin e të Dhënave ose informacionin i cili është kërkuar në kohën e përcaktuar për tu publikuar në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat dhe Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, Marrëveshjen Kuadër për Klerim
Informacion mbi Transaksionet në Interkonektor	<p>Nënkupton informacionin e mëposhtëm që vjen nga një Ankand në lidhje me çdo Interkonektor:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tregjet e ALPEX-it (i Ditës në Avancë ose Brenda së Njëjtës Ditë); 2. Interkonektori përkatës ose Agjenti i Transaksioneve 3. Sasi e planifikuar dhe drejtimi i energjisë elektrike të transferuar 4. Njësinë Kohore të Tregut përkatëse; dhe 5. Të tjera informacione sipas Procedurës dhe Kushteve të kërkuara të Klerimit

Informacioni i Brendshëm	Nënkupton një informacion të një natyre të përpiktë i cili nuk ka qenë publikuar, i cili lidhet direkt ose indirekt me një ose disa produkte të energjisë elektrike me shumicë dhe të cilat nëse këto do të ishin publikuar me shumë gjasa do të ndikonin çmimet e këtyre produkteve
Interkonektor	Nënkupton një linjë transmetimi e cila lidh kufirin midis dy vendeve të cilat lidhin sistemin kombëtar të transmetimit të këtyre vendeve
Jo-Anëtar Klerimi	Një Anëtarë i Bursës në Tregjet e ALPEX-it i cili nuk ka kapacitetin e Anëtarit të Klerimit dhe bashkëpunon me të paktën një Anëtar të Përgjithshëm Klerimi për Klerimin e Transaksioneve që ky Anëtarë kryen në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me kushtet e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
Juridiksioni	Nënkupton juridiksionin në Shqipëri ose Kosovë ose të dyja sipas rastit

K - M

Kalendari i Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes	Nënkupton afatet të vendosura nga ALPEX-i gjatë kohës të cilat midis të tjerash specifikojnë afatet kohore dhe periudhën kohore për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve
Kalendari i Shlyerjes	Nënkupton një kalendar për Shlyerjen e Transaksioneve e publikuar nga ALPEX
Kamatëvonesa	Nënkupton interesin që një Anëtar Klerimi duhet të paguaj nëse dështon të përmbushë detyrimet financiare në kohë dhe vlera e interesit parashikohet nga dispozitat për dështimin e përmbushjes në kohë të detyrimeve monetare
Kapaciteti Ndërkufitar	Nënkupton Kapacitetin i sistemit ndërkufitar që vendoset për transmetimin e energjisë midis Zonave të Ofertimit
Kërkesat Ligjore	Nënkupton çdo kërkesë nga legjislacioni primar dhe sekondar, statuti, urdhri, rregulli, rregullorja dhe termat e ndonjë licencë, leje të nxjerra nga ndonjë autoritet përkatës qeveritar
Kërkesë e Rregullatorit për Raportim	Nënkupton raportimin e kërkuar nga Autoriteti Rregullator ose Autoritet tjetër Kompetent sipas çdo Ligji në Fuqi për të përpiluar, mbledhur, dhe/ose dorëzuar ndonjë informacion ose të dhënë ose ndonjë sjelljeje ose çështje të lidhura me Bursën ose operimin e saj

Klerimi	Nënkupton procesin e zbatuar nga ALPEX-i për të krijuar Pozicionet, duke përfshirë llogaritjen e Kredive ose Debive të Anëtarit të Klerimit kundrejt ALPEX-it, për Llogari Klerimi lidhur me Pozicionin e sipërpërmendur si dhe për të siguruar disponueshmërinë e parasë për të garantuar ekspozimin e ALPEX-it, i cili ngrihet nga këto Pozicione në përputhje me dispozitat e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes
Kodi EIC (Kodet e Identifikimit të Energjisë)	Nënkupton një kod unik identifikimi për Anëtarin e Bursës në të gjitha tregtimet në Tregun e Energjisë Elektrike
Koha e Hapjes së Portës	Nënkupton kohën nga e cila Anëtari i Bursës mund të dorëzoj Urdhërporosi në ETSS
Koha e Mbylljes së Portës	<ul style="list-style-type: none"> - Në Tregjet e Ditës në Avancë dhe Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë ka kuptimin e Kohës së Mbylljes së Portës së Ankandit - Në Tregtimin e Vazhdueshme Brenda së Njëjtës Ditë nënkupton kohën përfundimtare të Tregtimin për Njësi Kohore Tregu siç specifikohet në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat
Koha e Mbylljes së Portës për Ankandin	Nënkupton kohën pas të cilës ETSS nuk pranon Urdhërporosi për Segmentin e Tregut dhe Ditës së Livrimit të caktuar
Koha e Përcaktuar	Nënkupton kohën specifike të përcaktuar nga një vendim përkatës i lëshuar nga Autoriteti Rregullator prej së cilit aktiviteti i Bursës në tregjet e ALPEX-it do të fillojë
Komiteti i Bursës	Nënkupton një komitet konsultativ të zgjedhur nga Anëtarët e Bursës. Roli i tij është të mundësojë këshillim për ALPEX-in përmes konsultimeve dhe të promovoj që Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të mbeten të përditësuar me kalimin e kohës
Konsumator	Nënkupton një entitet i cili merr energji elektrike për përdorim vetjak
Kontrata	Nënkupton që Palët bien dakord të përmbushin detyrimet për shitje ose blerje të energjisë elektrike në Tregjet e ALPEX-it
Kontrata e Bashkimit të Tregjeve	Nënkupton Palët të rëna dakord për të përmbushur detyrimet për shitjen dhe blerjen e energjisë në Bashkimin e Tregjeve të ALPEX-it
Kontratat OTC	Nënkupton tregtimin e brendshëm afatgjatë i cili do të bazohet në një kontratë financiare dypalëshe ku energjia elektrike do të tregtohet përmes Bursës
Kontributi Fillestar	Nënkupton një kontribut përkatës në para të dhënë nga Anëtari Klerimit për Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve në mënyrë që të fitojë kapacitetin përkatës

Kontributi Minimal	Nënkupton një kontribut minimal në para të dhënë nga Anëtari i Klerimit për Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve
Kreditori i ALPEX	Nënkupton Anëtarin e Klerimit i cili paguhet sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes
Kufiri i Kreditit	Nënkupton kufirin financiar të kërkuar dhe mundësuar nga Anëtari i Klerimit sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, procedurë e cila është e zbatueshme për Anëtarin e Bursës për të vendosur Urdhërporosi dhe të kryej Transaksion në Tregjet ALPEX-it
Kufiri i Tregtimi	Nënkupton vlerën monetare deri në të cilën një Anëtar i Bursës mund të tregtoj për një periudhë të caktuar
Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë	Nënkupton Çmimi Klerues Maksimal i pranuar në lidhje me një Ankand Brenda së Njëjtës Ditë
Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë	Nënkupton Çmimi Klerues Maksimal i pranuar në një Ankand të Ditës në Avancë
Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit të Ankandit të Dytë	Nënkupton Çmimi Klerues Maksimal i pranuar në lidhje me një Ankand të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë
Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit të Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	Nënkupton Çmimi maksimal i përputhur i pranuar për Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë
Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë	Nënkupton Çmimi Klerues Minimal i pranuar në një Ankand të Ditës në Avancë
Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit të Ankandit të Dytë	Nënkupton Çmimi Klerues Minimal i pranuar në lidhje me një Ankand të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë
Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit të Tregut Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë	Nënkupton Çmimi Klerues Minimal të pranuar në lidhje me Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë.
Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	Nënkupton Çmimi i përputhur minimal i pranuar për Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë
Kufizimet në Alokim	Nënkupton kufizimet që duhen respektuar gjatë alokimit të kapacitetit për të mbajtur sistemin e transmetimit brenda kufijve të sigurisë operationale dhe që nuk ka qenë përfshirë si Kapacitet Ndërkufitar

Kufizimi i Ankandit	Për ankandet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë, nënkupton një situatë ku Kurba e Grupuar e Urdhërporosi Blerjeje dhe Kurba e Grupuar e Urdhërporosi Shitjeje në Ankand nuk do të priten brenda Kufirit të Lejuar të Çmimit Maksimal dhe Minimal
Kundërpalë	Nënkupton çdo Palë kundrejt ALPEX-it
Kundërpalë Qendrore	Nënkupton ALPEX-in që vendoset në mes të Palëve për Kontratat e dala nga Tregjet e ALPEX-it
Kursi i Këmbimit	Nënkupton kursin zyrtar të këmbimit midis monedhës Lekë dhe Euro të publikuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë të Ditës përpara Ditës së Livrimit
Kushtet e Licencës për NEMO	Nënkupton Kushtet e NEMO të përcaktuar në Licencën e ALPEX-it
Kushtet e Përgjithshme	Nënkupton dokumentin e hartuar nga ALPEX dhe aprovuar nga Autoriteti Rregullatorë i quajtur si Rregullat e ALPEX-it
Kushtet për Klerim	Nënkupton rregullat, procedurat termat dhe kushtet e ALPEX-it në rolin e tij si Kundërpalë Qendrore
Kushti	Nënkupton një kusht nga i cili një Urdhërporosi është subjekt i saj, siç përshkruhet në Procedurën e Tregtimit
Kushti i Vlefshëm Deri në Datën- (GTD)	Nënkupton kushtin e vlerësimit të një Urdhërporosie të futur në Zgjidhjen e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë siç parashikohet në paragrafin D.1.6.5(a) të Procedurës së Tregtimit
Kushti i Vlefshëm për Sesionin- (GFS)	Nënkupton kushtin e vlerësimit të një Urdhërporosi të futur në Zgjidhjen e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë siç parashikohet në paragrafin D.1.6.5(b) të Procedurës së Tregtimit
Kushti Kushti Prano ose Largo - Fill-Or-Kill	Nënkupton kushte ekzekutimi në Urdhërporositë të vendosura në Zgjidhjen e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë siç përcaktohet në paragrafin D.1.6.2 të Procedurës së Tregtimit
Kushti Pa Kushte (None-NON)	Kusht Ekzekutimi mbi një Urdhërporosi të vendosur në Zgjidhjen e Tregtimit Brenda së Njëjtës Ditë siç parashikohet në paragrafin D.1.6.1 të Procedurës së Tregtimit
Kushti, Ekzekutoje Menjëherë ose Fshije - (Immediate-or-Cancel)	Kushti mbi një Urdhërporosi të vendosur në Zgjidhjen e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë të mundësuar në paragrafin D.1.6 të Procedurës së Tregtimit

Legjislacioni i Mbrojtjes së të Dhënave	Nënkupton Rregullat dhe në çdo rast të gjitha rregullat , statutet dhe instrumentet të krijuara dhe të ndryshuara rregullisht dhe ndonjë legjislacion tjetër i aplikueshëm i cili zbatohet duke përfshirë ndonjë ndryshim ose zëvendësim të tij
Lekë	Nënkupton njësinë monetare dhe monedhën e Shqipërisë e përfaqësuar me simbolin ALL
Letër Garanci Bankare	Nënkupton një dokument të lëshuar nga Banka që garanton ALPEX-in që do të paguhet për detyrimet që rrjedhin nga Transaksioni në Tregjet e ALPEX-it në rast se Anëtarit Klerimit përkatës do të jetë në kushtet e Mospërbushjes së Detyrimeve. Forma e saj vendoset nga Vendimi Teknik
Lëshuesi i Letër Garancisë (LoG)	Nënkupton një entitet që mban një licencë përkatëse bankare dhe në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes
Libri e Urdhërporosive	Nënkupton përmbledhjen ku Urdhërporositë futen në ETSS nga Anëtarët e Bursës për tregtimin në Tregun me Shumicë të Energjisë Elektrike ku Produktet janë renditur
Libri i Urdhërporosisë Lokale	Nënkupton një libër të Urdhërporosive të operuar nga NEMO të veçanta
Libri i Urdhërporosive te Grupuar	Nënkupton një modul në Sistemin Bashkimit të Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë që mbledh të gjitha Urdhërporositë e përputhura nga NEMO-t që marrin pjesë në Bashkimin e Vetëm Brenda së Njëjtës Ditë dhe kryerjen e përputhjes së vazhdueshme të këtyre Urdhërporosive
Licenca e Operatorit të Tregut	Nënkupton licencën për të veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike nën ligjin e energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës sipas rastit
Licencë	Nënkupton një të drejtë të dhënë tek një entitet ligjor për ushtrimin e një aktiviteti në sektorin energjisë elektrike, duke përfshirë por pa u kufizuar , licencën e gjeneruesit të energjisë elektrike , licencën e furnizuesit të energjisë elektrike, licencën e tregtarit të energjisë elektrike, licencën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, licencën e Operatorit të Tregut ose ndonjë licencë siç kushtet mund ta kërkojnë të lëshuar nga Autoriteti Rregullator
Licencë Bankare	Nënkupton një licence lëshuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë ose e Kosovës sipas rastit
LIDA-1	Nënkupton Ankandin e parë Lokal të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë duke i konsideruar Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të ndara, e kryer për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit

LIDA-2	Nënkupton Ankandin e dytë Lokal të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë duke i konsideruar Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të ndara, e kryer për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit
LIDA-3	Nënkupton Ankandin e tretë Lokal të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë duke i konsideruar Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të ndara, e kryer për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit
Ligji/Legjislacioni në Fuqi	Nënkupton çdo instrument statusor, legjislativ ose rregullatorë siç aplikohet tek Palët
Lista e Tarifave të ALPEX	Nënkupton deklaratën e tarifave të publikuar në çdo kohë nga ALPEX për qëllim të Aktiviteti të tij të aprovuar nga Autoriteti Rregullator përkatës sipas rastit
Llogari e Klerimit	Nënkupton llogarinë e Personale të Klerimit ose Llogarinë e Klerimit të Anëtarit të Bursës sipas rastit
Llogari Përdoruesi	Nënkupton një identitet individual hyrës (log-in), që përfshin emër përdorimi, çelës sigurie, karte sigurie personale, kodin PIN, fjalëkalimin ose kredenciale të tjera për të aksesuar ose pajisje që i përkasin një identiteti të tillë të hyrjes (log-in) të ofruara për të hyrë në ETSS
Llogari Personale Klerimi	Llogari e mbajtur në EMCS nga Anëtari Personal i Klerimit nën emrin e tij për Klerimin e Transaksioneve të kryera nga ai në rolin e Anëtarit të Bursës në Tregjet e ALPEX-it
Llogaria Bankare e ALPEX	Nënkupton llogarinë bankare në emër të ALPEX-it të mbajtur në Bankën për Shlyerje, në dhe nga kryhen Pagesat dhe Tarifa e Tregtimit sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes
Llogaria bankare e Garancisë në Para	Nënkupton llogari e përbashkët bankare e krijuar nga Anëtari i Klerimit dhe ALPEX-i, në emër të ALPEX-it sipas seksionit G.2.2 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për qëllim të formimit të një pjese ose të gjithë Kufirit të Kreditit për Anëtarin të Klerimit
Llogaria bankare për Shlyerje	Nënkupton një llogari të përbashkët bankare e ALPEX-it dhe Anëtarit të Klerimit dhe ndonjë nën llogari të saj, e mbajtur në Bankën për Shlyerjen, me qëllim kryerjen e shlyerjeve në para të Transaksioneve të Energjisë Elektrike në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes
Llogaria e Klerimit të Anëtarit të Bursës	Nënkupton një llogari në Sistem e mbajtur nga një Anëtar i Përgjithshëm Klerimi në emër të një Anëtarit të Bursës në Tregjet e ALPEX-it për Klerimin e Transaksioneve në këto Tregje për këtë Anëtar

Llojet e Urdhërporosive	Kuptimi i dhënë ne seksionin B.1.3 të Procedurës së Tregtimit
Manipulimi i Tregut	Ka kuptimin e dhënë në Artikullin (1.3) të Rregullit REMIT
Margjinë	Nënkupton margjinën e kërkuar që është llogaritur nga ALPEX-i në respekt të Anëtarit të Klerimit në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes me qëllim të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të Anëtarit të Klerimit në lidhje me Transaksionet në Tregun e energjisë Elektrike të kleruar prej tij
Marrëveshje Anëtarësimi në Bursë	Nënkupton një dokument të nënshkruar nga ALPEX dhe Aplikanti për hyrje në Tregjet e ALPEX në mënyrë që të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat
Marrëveshje Kuadër për Klerim	Nënkupton marrëveshjen sipas së cilës një entitet obligohet të zbatoj Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes
Mjeti Elektronik i Emëruar	Nënkupton një mjet elektronik të përzgjedhur nga ALPEX-i me qëllim që të krijojë komunikime me Anëtarët e Bursës dhe/ose me Anëtarët e Klerimit
Modeli Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri	Nënkupton Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.519, Datë 13.07.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”
Moduli i Menaxhimit të Kapaciteteve	Nënkupton sistemin që përmban informacionin e përditësuar lidhur me Kapacitetet e vlefshme Ndërkufitare me qëllim shpërndarjen e Kapaciteteve Ndërkufitare për Tregtimin e Vazhdueshëm
Monedha	Nënkupton Euro në Shqipëri dhe Kosovë dhe Lekë në Shqipëri dhe “ Monedhat ” do të interpretohen në përputhje me rrethanat
Mosmarrëveshje	Nënkupton ndonjë pretendim, mosmarrëveshje, ose diferenca të çfarëdo lloji natyre kurdoherë që lindin prej ose në lidhje me Rregullat e ALPEX-it, ose Procedurat ose Marrëveshja a Anëtarësimin në Bursë ose Marrëveshja Kuadër për Klerimi
Mosmarrëveshje Konflikti	Nënkupton një Mosmarrëveshje në lidhje me një konflikt të pretenduar midis Rregullave të ALPEX-it apo Procedurave dhe Kërkesave Ligjore të tjera përkatëse
Mosmarrëveshje e Përgjithshme	Nënkupton një Mosmarrëveshje e cila nuk përfshihet në ndonjërin prej kategorive të Mosmarrëveshjes së Aderimit dhe Konfliktit duke përfshirë një Mosmarrëveshje në lidhje me pagesat sipas Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat
Mosmarrëveshje për Pranimin	Nënkupton një Mosmarrëveshje që vjen si pasojë e Procesit të Pranimit

Mospërbushja e Detyrimeve	Nënkupton kur Anëtari i Bursës dhe/ose Anëtari i Klerimit është në thyerje të ndonjë dispozite të Rregullave të ALPEX-it, ose Procedurave ose Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë ose Marrëveshjes Kuadër për Klerim dhe që përfshin pa limituar një dështim në pagimin e një shume parash ose një thyerje të një ose me shumë dispozitave të sjelljes të dokumenteve të sipërpërmendur
Muaj	Nënkupton një muaj kalendarik
Mungesë	Nënkupton, kur ndonjë nga Anëtarët e Klerimit dështon të kryejë ndonjë pagesë të parashikuar në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes deri në Datën për tu Paguar, shumën e papaguar së bashku me ndonjë interes të aplikuar

N - S

Ndalimi i Tregtimit	Nënkupton një pezullim të përkohshëm për tregtim në Bursë
Ndarja ose Ndarja e Tregut	Nënkupton situatën në të cilën Procesi i Bashkimit të Çmimit është ndërprerë dh/ose anuluar
Ndërfaqja e Programimit të Aplikacionit (API)	Nënkupton Ndërfaqen e programuar të aplikacioneve
Ndikues në Çmim	është një Anëtar i Bursës i cili është i aftë të influencojë në Çmimin e Klerues të Tregut dhe ta pranojë atë për shlyerjen e Transaksioneve të tij
Ndryshim	Nënkupton një ndryshim të dispozitave të Rregullave të ALPEX-it ose Procedurave
NEMO	Nënkupton Operatorin e Tregut të Emëruar të Energjisë Elektrike i përcaktuar sipas Rregullit të NEMO të Shqipërisë dhe/ose Kosovës sipas rastit
Ngjarje Papajtueshmërie	Nënkupton një ngjarje që ekziston nëse një Anëtar i Bursës në opinionin e arsyeshëm të ALPEX-it: <ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk përmbush detyrimet e tij nën një rënë prej dokumenteve dhe/ose marrëveshjeve ku janë palë të Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave; ose 2. Është në shkelje të Ligjit në Fuqi dhe kjo shkelje ndikon ose do të ndikojë në aftësinë e Anëtarit të Bursës të veprojë në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat dhe dokumentacionin që lidhet me të
Ngjarje Papajtueshmërie Materiale	Ka kuptimin në paragrafin D.3.2.2 të Rregullave të ALPEX-it

Ngjarje për shkak të Forcës Madhore	Nënkupton çdo ngjarje e cila parashikohet si ngjarje e Forcës Madhore të përcaktuar nga ligji në fuqi në Shqipëri dhe Kosovë.
Njësia Kohore Tregu	Nënkupton periudhën për të cilën çmimi i tregut krijohet ose periudhën me të shkurtër të mundshme për dy Zona Ofertimi , nëse Njësitë Kohore të Tregut janë të ndryshme
Njoftim për Mosmarrëveshje	Nënkupton një njoftim me anë të një dokumenti të dërguar nga ALPEX-i tek një Palë kur ka një Mosmarrëveshje
Njoftim për Pranimin	Nënkupton një dokumenti i cili specifikon kur një Palë do të pranohet si Anëtar Klerimi
Njoftim për Tregun	Nënkupton çdo deklaratë të nxjerrë në mënyrë elektronike nga ALPEX për të komunikuar me të gjitha Palët
Njoftimi për Mospërbushje Detyrimesh	Nënkupton një njoftim që ALPEX-i do të lëshojë për Anëtarin e Bursës dhe/ose Anëtarin e Klerimit i cili është në Mospërbushje të Detyrimeve duke specifikuar natyrën e kësaj Mospërbushjeje
Norma e Kontributit	Nënkupton normën e kontributit të vendosur prej Vendimeve të ALPEX-it
Norma e Pranimit	Nënkupton sasinë e pranuar të energjisë elektrike nga një Urdhërporosi në Bllok, e cila është pjesë e energjisë elektrike së ofertuar. Norma e Pranimit mund të jetë zero ose ndërmjet Normës Minimale të Pranimit (e specifikuar për një Urdhërporosi në Bllok) dhe njësisë (1). Norma e Pranimit mund të lidhet edhe me Urdhërporosi të Lidhura në Bllok dhe Grupit Ekskluziv të Urdhërporosisë në Bllok
Norma Minimale e Pranimit	Norma Minimale e Pranimit në çdo Urdhërporosi në Bllok, në të cilin Blloku që mund të përputhet dhe vlera e secilës është më pak se ose i barabartë me 100%
Numri Regjistrimit Tatimor	Ka kuptimin e dhënë në Ligjin në Fuqi
Objektivi i ALPEX-it	Ka kuptimin e dhënë në Termat e Përgjithshme në paragrafin A.1.2
Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve	Nënkupton entitetin i cili kryen detyrat për përputhjen e Urdhërporosive për Tregjet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë për Zona të ndryshme Ofertimi dhe alokimin e njëkohshëm të Kapaciteteve Ndërkufitare
Operator Sistemi, Transmisionit dhe Tregut sh.a (KOSTT)	Ka kuptimin e dhënë në Ligjin në Fuqi nr.05/L-085 “Për energjinë elektrike”

Operatori e Bashkimit të Tregjeve (MCO)	Nënkupton detyrat për përputhjen e Urdhërporosive nga Tregjet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë për Zona të ndryshme Ofertimi dhe alokimin e njëkohshëm të Kapaciteteve Ndërkufitar
Operatori i Energjisë së Rinovueshme	Nënkupton operatorin që kryen funksionet e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme siç parashikohet në Ligjin përkatës për Burimet e Rinovueshme
Operatori i Sistemit të Transmetimit	Nënkupton një entitet përgjegjës për operimin, garantimin e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe që përfshin mbajtjen e një licencë për operimin e sistemit të transmetimit të dhënë nga Autoriteti Rregullator
Operatori i Tregut	Nënkupton ALPEX sh.a dhe KOSTT sh.a të ndara në rolet e tyre përkatëse të vendosura nga autorizimet e Autoriteteve Rregullatore sipas Licencës së tyre si Operator Tregu dhe çdo përjashtimi tjetër për administrimin e Procedurës së Tregtimit dhe zbatimin e funksioneve të "Operatorit të Tregut" nën këtë Procedurë
OST	Nënkupton një entitet i cili është i licencuar nga ERE për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit të Shqipërisë
Pagesat e Tregtimit	Nënkupton pagesat e Kontratës që rezultojnë nga tregtimi në Tregun e Ditës së Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë
Pala	Nënkupton ALPEX-in, Anëtarin e Bursës, Anëtarin e Klerimit ose çdo person ose entitet i prekur direkt ose indirekt nga Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat
Pala e Prekur	Nënkupton një Palë të përfshirë dhe ALPEX-in që preket nga Forca Madhore
Pala në Mosmarrëveshje	Nënkupton një Palë në Mosmarrëveshje
Pala në Mospërmbushje Detyrimesh	Nënkupton një Palë që është në Mospërmbushje të Detyrimeve
Pala Përgjegjëse për Balancim	Ka kuptimin siç përcaktohet në Rregullat e Tregut të Balancimit
Pala Zbuluese e Informacionit	Nënkupton një Palë që zbulon Informacion Konfidencial
Parimi e ALPEX-it	Ka kuptimin e dhënë në Termat e Përgjithshme në paragrafin A.1.2
Përfundim Vullnetar	Nënkupton Përfundimin vullnetar me vullnetin e tij si Anëtar Klerimi në përputhje me seksionin F.3. të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes
Përfundimi	Nënkupton Përfundimin statusit të Anëtarit të Bursës

Përkufizime	Nënkupton dokumentin Përkufizimet e ALPEX-it përdorur në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat
Përputhja	Nënkupton mënyrën e tregtimit përmes të cilat Urdhërporositë Shitjeje u caktohen Urdhërporosive përkatëse Blerjeje për të siguruar maksimizimin e tepricës ekonomike për Bashkimet e Tregjeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë
Përputhja në Grup	Nënkupton përputhjen e Urdhërporosive në Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë që do të ndodhë në rast të rritjes së Kapacitetit Ndërkufitar
Pezullim	Nënkupton procesin prej ku ALPEX-i pezullon anëtarësimin e një Anëtari të Bursës në përputhje me Urdhër-Pezullimin
Pjesa Proporcionale	Në referencë të Anëtarit të Klerimit nënkupton shumën përkatëse të depozituar në para nga ky Anëtar në llogarinë bankare të Fondit për Mospërbushje të Detyrimeve
Portofoli	Nënkupton një llogari elektronike e mbajtur nga ALPEX për çdo Anëtar të Bursës ku Urdhërporositë për Shitje/Blerje mund të vendosen
Pozicione	Detyrimet dhe të drejtat korresponduese në para që vijnë nga Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX-it dhe që nuk janë shlyer akoma
Pozicioni Neto	Nënkupton shumën të neto të importit ose eksportit të energjisë elektrike për çdo Njësi Kohore Tregu për një Zone Ofertimi
Pranimi	Nënkupton procesin iniciues sipas të cilit një Aplikant bëhet i pranueshëm për të vazhduar procedurën për përmbushjen e kërkesave teknike, ligjore, dhe ekonomike të përcaktuara nga ALPEX deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së Anëtarësimin në Bursë
Pranues i Çmimit	Është një Anëtar i Bursës i cili dorëzon Urdhërporosi pa çmim Blerje ose Shitje dhe i cili duhet të pranojë Çmimin Klerues të Tregut përkatës për shlyerjen e Transaksioneve të tij
Procedura Alternative	Nënkupton një proces alternativ i përdorur për llogaritjen e Çmimit Klerues të Tregut në rast të dështimit të Aseteve Funktionale të Bashkimit të Tregjeve
Procedura e Alokimit të Kapaciteteve	Nënkupton Rregullat për Harmonizimin e Alokimit të Kapaciteteve Ndërkufitare e kryer nga SEE CAO dhe aprovuar nga bordi i ERE-s me vendim nr. 124 datë 21.07.2016 dhe bordi i ZRrE-së me vendim nr. V_1317_2020 të datës 12.11.2020

Procedurat	Nënkupton procedurën e detajuar që duhet të ndiqet nga Palët në kryerjen e detyrimeve dhe funksioneve të tyre nën Rregullat e ALPEX-it
Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes	Nënkupton dokumentin e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes aprovuar nga Autoriteti Rregullator i cili përcakton termat e aktivitetit të klerimit dhe shlyerjes për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike me shumicë në tregjet e ALPEX-it
Procedurat e Komitetit të Bursës	Nënkupton një dokument të zhvilluar prej ALPEX-it që vendos role, mbledhje, konfidencialitete dhe përbërje të Komitetit të Bursës
Procedura e Tregtimit	Nënkupton një dokument i përgatitur nga ALPEX-it dhe aprovuar nga Autoriteti Rregullator përkatës
Procesi i Aderimit	Nënkupton procesin që ndiqet nga një Aplikant për të fituar kapacitetin e Anëtarit të Klerimit
Procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes	Nënkupton procesin e zgjidhjes së Mosmarrëveshjes midis Anëtarit të Bursës/Anëtarit të Klerimit dhe ALPEX në lidhje me Rregullat e ALPEX-it, ose Procedurave ose Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë ose Marrëveshjen Kuadër për Klerim
Procesi për Ndryshim	Nënkupton procesin e paraqitjes, vlerësimit dhe pranimit ose refuzimit të Propozimeve për Ndryshim dhe bërjes së këtyre Ndryshimeve
Produkt	Produktet e energjisë elektrike me shumicë të cilat tregtohen në Tregjet e energjisë Elektrike në përputhje me përkufizimet e tyre dhe dispozitat specifike
Propozim për Ndryshim	Nënkupton çdo propozim i cili është paraqitur tek ALPEX-i për të ndryshuar, korrigjuar ose përshtatur Rregullat e ALPEX-it ose Procedurat
Propozues	Në lidhje të një Propozimi për Ndryshim, nënkupton një Palë që ka të drejtën për të paraqitur Propozimet për Ndryshim për këto rregulla të ALPEX-it dhe Procedurat
REMIT	Nënkupton rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të energjisë elektrike me shumicë të publikuar nga Autoriteti Rregullatorë i Shqipërisë ose i Kosovës sipas rastit
Rezultatet Paraprake të Tregut të Bashkuar	Rezultatet e Bashkimit të Tregjeve të cilat dërgohen nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve tek NEMO-t me qëllim të vlerësimit
Risku Brenda së Njëjtës Ditë	Ka kuptimin e dhënë në seksionin G.5.2
SDAC	Bashkimi i Ditës në Avancë në një të Vetëm

SEE CAO	Nënkupton Zyrën e Koordinuar për Ankandet në Evropën Jug-Lindore
Segmenti i Tregut	Ka kuptimin e dhënë në Ankandin e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë dhe Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë. Një Segment Tregu përbëhet nga një Zone Ofertimi e lidhur me një Procedurë Tregtimi dhe Njësi Kohore e Tregut siç përcaktohet në Procedurën e Tregimit
Shlyerja	Nënkupton procesin që kryhet ndërmjet ALPEX-it dhe Anëtarëve të Klerimit ku nëpërmjet të cilit ALPEX-i menaxhon shlyerjet në para për Transaksionet e përfunduara në tregjet e ALPEX-it
Shlyerja e Transaksioneve	Nënkupton procesin e lëvizjes së mjeteve monetare ndërmjet llogarive bankare të palëve që marrin pjesë në shlyerjen e transaksioneve, ka kuptimin e dhënë në seksionin G.3.4
Shlyerja në Para	Nënkupton procesin e zbatuar nga ALPEX-i me Anëtarët e Klerimit për pagesën e detyrimeve dhe arkëtimin e të drejtave të cilat rrjedhin nga klerimi i Transaksioneve të Energjisë Elektrike në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes
Shtojcë	Nënkupton një shtojcë të Proceduarve dhe termi “Shtojcë” do të interpretohet në përputhje me rrethanat
Sistemet e Anëtarit	Nënkupton sistemet e Anëtarit të Bursës të përdoruar për transmetimin dhe marrjen e të dhënave në Bursë
Sjellja në Treg	Nënkupton përgjegjësi për çdo Anëtar të Bursës për të garantuar përputhshmërinë me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat e cila duhet të respektohet dhe të veprohet sipas saj gjatë gjithë kohës
Skedulimi i Tregut	Skedulimi i energjisë neto (Pozicioni Neto) që rezulton nga tregtimi në të gjitha Tregjet e ALPEX-it, i cili transferohet nga ALPEX-i tek sistemi i menaxhimit të tregut të OST-së dhe KOSTT-it për qëllimin e balancimit të sistemit të transmetimit ose përdoret për proceset e tjera siç janë Klerimi dhe Shlyerja, etj
Specifikimi i Produktit	Nënkupton specifikimet për Segmentet e tregut në Ankandin Ditës në Avancë, Brenda së Njëjtës Ditë dhe Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë të Bursës të listuar në Shtojcën A të Procedurës së Tregimit

T - Z

Tarifa Fikse Administrative	Nënkupton një Tarifë fikse të përshtirë në Listën e Tarifave të ALPEX-it që një Aplikant do të paguaj me qëllim që aplikimi i tij të shqyrtohet
------------------------------------	---

Tarifa Fikse e Aderimit	Nënkupton një Tarifë fikse për tu paguar tek ALPEX-si nga një Aplikant për të fituar kapacitetin e Anëtarit të Klerimit
Tarifa Fikse e Anëtarësimit	Nënkupton një Tarifë Fikse për tu paguar tek ALPEX-i nga një Aplikant për pranimin si Anëtar i Bursës
Tarifa Fikse Vjetore	Nënkupton një Tarifë Fikse për tu paguar tek ALPEX nga një Entitet për vazhdimin e marrëdhënieve si Anëtar i Bursës dhe/ose Anëtar i Klerimit siç parashikohet në Lista e Tarifave të ALPEX
Tarifë Fikse	Nënkupton një vlerë monetare fikse e paguar tek ALPEX-i nga Anëtari i Bursës ose Anëtari i Klerimit siç parashikohet në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat dhe Listën e Tarifave
Tarifë Variabël	Nënkupton një vlerë monetare variabël e paguar nga Anëtari i Bursës për tregtim dhe Klerim në Tregjet të ALPEX-it
Tatimi i Vlerës së Shtuar	(a) nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar të ngarkuar sipas dispozitave të Ligjit në fuqi në lidhje me Shqipërinë, Ligjit Shqiptar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, (i ndryshuar) ; ose (b) në respekt të Kosovës, Ligjin përkatës të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, (i ndryshuar) dhe përfshin çdo taksë zëvendësuese ose të ngjashme që vendoset për furnizimin e mallrave ose shërbimeve
Të Dhënat	Nënkupton çdo informacion lidhur me tregun e energjisë elektrike
Të Dhënat për Pjesëmarrje	Nënkupton kategoritë e të dhënave të mëposhtme: 1. Informacionin e kërkuar për të fituar dhe mbajtur kapacitetin e Anëtarit të Bursës; Fjalëkalimin e përdoruesit të autorizuar për të pasur mundësi qasje në ETSS;
Të dhënat për Tregtimin	Nënkupton një listë me informacione të tilla si çmimi, kuotat e kërkesës/ofertës dhe volumi i tregut
Të Dhënat Personale	Ka kuptimin e vendosur në Ligjin Shqiptar Nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar, prej ligjit Nr. 48/2012, datë 26.04.2012 i ndryshuar dhe për Kosovën Ligji Nr. 06/L-082 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale	Nënkupton të drejtat (të tanishme dhe të ardhshme) patentat, shpikjet, të drejtat për projektet, të drejta për bazën e të dhënave, sekretet tregtare, njohuritë, çdo aplikacion për regjistrimin e ndonjëres të sipërpërmendura dhe ndonjë të drejte pronësie industriale ose intelektuale të çfarë do lloj natyre, e regjistruar apo jo, që ekziston tani ose në të ardhmen kudo në botë

Të Drejtat për Transmetim Fizik apo PTR	Nënkupton një e drejtë kombëtare të dhënë nga OST-të tek ALPEX-si për të sistemuar transferimin e energjisë nëpër Interkoneksion për një Njësi Kohore të Tregut me drejtim, sasi dhe çmim të përcaktuar nga zgjidhja e Bashkimit të Çmimit
Transaksioni ose Transaksioni i Energjisë Elektrike	Nënkupton Transaksionet në Produktet të cilat janë realizuar në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me kushtet e Rregullave së ALPEX-it dhe Procedurat
Tregjet e ALPEX-it	Përfshin Tregjet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë duke përfshirë Ankandet dhe Tregtimin e Vazhdueshëm i cili operon si një treg i energjisë elektrike me shumicë i organizuar në të cilin Transaksionet klerohen nga ALPEX-i
Tregtar	Nënkupton një entitet ligjor mbajtës i një licence tregtimi të energjisë elektrike të lëshuar nga Autoriteti përkatës rregullator
Tregtimi i Vazhdueshëm	Nënkupton një Tregti të kryer në Segmentin e Tregut Brenda së Njëjtës Ditë
Tregtimi i Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	Nënkupton procesin e tregimit në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë për përputhjen e Urdhërporosive dhe alokimin e Kapaciteteve Ndërkufitare në mënyrë të vazhdueshëm
Tregtimi i Vazhdueshëm Pan-Evropian Brenda së Njëjtës Ditë (XBID)	Nënkupton një platformë elektronike e përdorur si pjesë e operimit të Tregimit të Vazhdueshëm Pan-Evropian Brenda së Njëjtës Ditë
Tregtimi/ Tregtia	Nënkupton një kontratë që rezulton nga tregtimi në Tregjet e Ditës në Avancë ose Brenda së Njëjtës Ditë
Tregu Balancues	Përkufizimi sipas ligjit përkatës
Tregu Brenda së Njëjtës Ditë	Nënkupton tregun e ALPEX ku transaksionet kryhen për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike me detyrimin e livrimit fizik, pas skadimit të kufirit të kohës për dorëzimin e Urdhërporosive për transaksionet në tregun e Ditës në Avancë dhe të lidhura me Ditën e Livrimit në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi si dhe Procedurën Klerimit dhe Shlyerjes
Tregu i Alokimit të Kapaciteteve	Nënkupton tregun për alokim të Kapaciteteve Ndërkufitare të kryer nga SEE CAO
Tregu i Ditës në Avancë	Nënkupton tregun e energjisë elektrike ku dorëzimi i Urdhërporosi Blerjeje dhe Shitjeje të vendosura në ditën para livrimit në intervalin prej Kohës së Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës
Tregu i Energjisë Elektrike	Përfshin tre tregje si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Tregu i Alokimit të Kapaciteteve 2. Tregu i Organizuar me Shumicë 3. Tregu i Balancimit

Udhëzim Bankar	Nënkupton formën e instruksionit lidhur me termat në të cilën paraja mbahet në Llogarinë e Garancisë në Para
Urdhër për Pezullim	Nënkupton një urdhër të nxjerrë nga ALPEX-i për Anëtarin e Bursës, kur ALPEX arrin në konkluzionin që ky Anëtar nuk po vepron në përputhje me kërkesat e Rregullave të ALPEX-it ose Procedurat
Urdhër Përfundimi	Nënkupton një urdhër të nxjerrë nga ALPEX-i për Anëtarin e Bursës, ku specifikohen kushtet e Përfundimit, koha dhe data prej kur ky përfundim hyn në Fuqi
Urdhërporosi	Nënkupton një ofertë për të shitur ose një kërkesë për të blerë energji elektrike nga një Anëtar i Bursës brenda Zonës së Ofertimit të Shqipërisë ose Kosovës, në lidhje me një Portofol të caktuar, Njësi kohore Tregu, volum dhe çmim në përputhje me specifikimet e Produkteve të lidhura
Urdhërporosi në Bllok	(a) Në lidhje me Urdhërporositë e dorëzuara për Ankandet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë, nënkupton Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje për më shumë se një Njësi Kohore Tregu me karakteristikat e përshkruara në seksionin B.1.7 të Procedurës së Tregtimit (b) Në lidhje me Urdhërporositë e dorëzuara në Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë nënkupton një Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje për më shumë se një Njësi Kohore Tregu me karakteristikat e përshkruara në seksionin D.1.2 të Procedurës së Tregtimit
Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje)	Urdhërporositë Marrëse e Çmimit me Përparësi janë Urdhërporosi me hapa orare (blerjeje/shitjeje) të dorëzuar për një çmim të barabartë me (maksimum/minimum) e Kufirit të Lejuar të Çmimit në Ankandet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë
Urdhërporosi Ajsberg	Nënkupton një Urdhërporosi me karakteristikat e përshkruara në paragrafin D.1.3 të Procedurës së Tregtimit
Urdhërporosi Blerjeje	Nënkupton një deklaram me qëllim blerjeje i futur në ETSS nga Anëtari i Bursës për të kryer Tregtim në Tregun e Energjisë Elektrike në përputhje me dispozitat specifike në Rregullat e ALPEX-it
Urdhërporosi e Thjeshtë	Nënkupton në Urdhërporosi, dhe: (a) në lidhje me Ankandin e Ditës në Avancë e përshkruar në paragrafin B.1.5 të Procedurës së Tregtimit; dhe (b) në lidhje me Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë, e përshkruar në paragrafin C.1.5 të Procedurës së Tregtimit;
Urdhërporosi e Thjeshtë Blerjeje	Një Urdhërporosi e Thjeshtë për blerjen e energjisë elektrike

Urdhërporosi e Thjeshtë Shitjeje	Një Urdhërporosi e Thjeshtë për të shitur energji elektrike
Urdhërporosi në Bllok të Pranuar Paradoksisht	Një Urdhërporosi në Bllok e cila është pranuar në klerimin e Tregun të Ditës në Avancë ndërsa është përtej vlerës financiar (out-of-money)
Urdhërporosi Orare të Grupuar	Kurba e vetme që rezulton nga të gjitha Urdhërporositë Blerjeje ose Shitjeje të të gjithë Anëtarëve të Bursës në të njëjtën Zonë Ofertimi për çdo Njësi Kohore Tregu
Urdhërporosi Shitjeje	Një deklaram i qëllimit për shitje e vendosur nga një Anëtar i Bursës në ETSS për kryerjen e tregtimeve në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me dispozitat e specifikuar në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat
Urdhërporosi Shitjeje në Bllok	Një Urdhërporosi në Bllok për të shitur Energji Elektrike
Urdhërporosi të Lidhura në Bllok	Një Urdhërporosi në Bllok, duke paraqitur kushtet specifikeve dhe karakteristikat siç mundësohen në paragrafin F.1.8 të Procedurës së Tregtimit
Vendim Teknik	Nënkupton një vendim të nxjerrë nga ALPEX-i në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat të cilat parashikojnë çështjet teknike, procedurale dhe operationale me natyre jo-rregullative
Vendimet e ALPEX	Një vendim i lëshuar nga ALPEX dhe njofton Palët
Vendimet nga Autoritetet Rregullatorë	Nënkupton një vendim të marrë nga ERE dhe/ose ZRrE lidhur me tregun e Shqipërisë dhe/ose të Kosovës sipas rastit
Vetëfaturimi	Nënkupton lëshimin e një fature nga ALPEX në emër të Anëtarit të Bursës i cili rezulton nga tregtimi në Tregjet e ALPEX-it si shitës i energjisë elektrike
Viti	Nënkupton një periudhë e cila fillon prej orës 00:00 të datës 01 Janar dhe mbaron në orën 24:00 të datës tjetër më 31 Dhjetor
Zonë Ofertimi	Nënkupton zonën gjeografike brenda së cilës pjesëmarrësit e tregut kanë mundësi të shkëmbejnë energjinë elektrike pa alokim të kapaciteteve
Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE)	Nënkupton Autoritetin Rregullator Kombëtar i cili është themeluar në Qershor 2004, me shpalljen e tij nga Parlamenti i Kosovës bazuar në Ligjin e Rregullatorit të Energjisë

Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike

Procedura e Tregtimit

PËRMBAJTJA

A. Hyrje5

A.1	Dispozita të Përgjithshme	5
A.1.1	Qëllimi dhe konteksti	5
A.2	Konceptet e përdorura në këtë Procedurë	5
A.2.1	Kushtet e përshkruara në Rregullat e ALPEX-it	5
A.2.2	Njësia Kohore e Tregut	5
A.2.3	Kufiri i Tregtimit	6
A.2.4	Librat e Urdhërporosive	6
A.2.5	Vlefshmëria dhe pranimi i Urdhërporosisë	8
A.2.6	Çmimet	8
A.2.7	Ankandi	8
A.2.8	Tregtimi i Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	9
A.3	Menaxhimi i Kufirit të Tregtimit	9
A.3.1	Vendosja e Kufirit të Tregtimit	9
A.3.2	Efekti i Kufirit të Tregtimit	10
A.4	Dorëzimi	10
A.4.1	Dorëzimi i Urdhërporosive	10
A.4.2	Paraqitja e Kapaciteteve Ndërkufitare	11
A.4.3	Vlerësimi i Urdhërporosive	11

B. Segmenti i Tregut të Ditës në Avancë 13

B.1	Ankandet e Ditës në Avancë, Produktet, Urdhërporositë	13
B.1.1	Ankandet e Ditës në Avancë	13
B.1.2	Orët e Tregtimit	13
B.1.3	Përshkrimi disponueshmërisë të Llojeve të Urdhërporosive	13
B.1.4	Përmbajtja e Urdhërporosive në Tregtimin e Ankandit të Ditës në Avancë	13
B.1.5	Urdhërporositë e Thjeshta në Ankandet e Ditës në Avancë	14
B.1.6	Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi (Priority Price-Taking Orders)	15
B.1.7	Urdhërporositë në Bllok në Ankandet e Ditës në Avancë	16
B.1.8	Urdhërporositë të Lidhura në Bllok	16
B.1.9	Grupi Ekskluziv i Urdhërporosive në Bllok	17
B.1.10	Operimi i Bashkimit të Tregjeve.	17
B.2	Ankandet e Ditës në Avancë - Përputhja dhe përpunimi i Urdhërporosive	17
B.2.1	Përcaktimi i Çmimeve dhe Sasive të Ankandit	17
B.2.2	Rregullat për Përputhjen e Urdhërporosive	20
B.2.3	Ankandi i Dytë për operimin e Bashkimit të Tregjeve dhe jo të bashkuar të tyre.	21
B.2.4	Procedurat Alternative	22
B.3	Ankandet e Ditës në Avancë - DHËNIA E rezultateve	23
B.3.1	Rezultatet paraprake – që ju jepen privatisht anëtarëve	23
B.3.2	Të dhënat e publikuara – për publikun	23

C. Segmenti i Tregut Brenda Së Njëjtës Ditë 24

C.1	Ankandet Brenda Së Njëjtës Ditë, Produktet, URDHËRPorositë	24
C.1.1	Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë	24

C.1.2	Orët e Tregtimit	24	
C.1.3	Përmbajtja e Urdhërporosive në Tregtimin e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë	24	
C.1.4	Pasqyra përgjithshme e Llojit të Urdhërporosive	25	
C.1.5	Urdhërporositë e Thjeshta në Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë	25	
C.1.6	Operimi i Bashkimit të Tregjeve	26	
C.2	Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë - Përputhja dhe Përpunimi i Urdhërporosive	26	
C.2.1	Përcaktimi i Çmimeve dhe Sasive të Ankandit	26	
C.2.2	Rregullat për Përputhjen e Urdhërporosive	27	
C.2.3	Procedurat Alternative	28	
C.3	Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë - DHËNIA E rezultateve	28	
C.3.1	Rezultatet paraprake – që ju jepen privatisht anëtarëve	28	
C.3.2	Të dhënat e publikuara - për publikun	28	
D. Tregu i Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë 30			
D.1	Pasqyrë E PËRGJITHSHME E Produkteve dhe LloJET E Urdhërporosive	30	
D.1.1	Produktet	30	
D.1.2	Urdhërporositë e Zakonshme në Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	30	
D.1.3	Urdhërporositë Ajsberg në Tregjet e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	31	
D.1.4	Urdhërporositë në Shportë	31	
D.1.5	Specifikimet e Ekzekutimit	32	
D.1.6	Përmbajtja e Urdhërporosive në Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	32	
D.1.7	Përputhja e Urdhërporosive në Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	33	
D.2	Tregu i vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë - rezultateT paraprake	36	
D.2.1	Publikimi i Tregtimeve në Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës ditë	36	
D.2.2	Rezultatet Paraprake – që ju jepen privatisht anëtarëve	36	
D.2.3	Të dhënat e publikuara – për publikun	37	
E. Procedurat alternative 38			
E.1	parashikime të përgjithshme	38	
E.2	Procedura alternative për ankandin e Ditës në Avancë	38	
E.2.1	Shkaqet	38	
E.2.2	FD 1	38	
E.2.3	FD 2	39	
E.2.4	FD 3	39	
E.2.5	Procedura e Ankandit Lokal	39	
E.3	Procedura alternative për ankaNdin brenda së Njëjtës Ditë	40	
E.3.1	Shkaqet	40	
E.3.2	FD 1	41	
E.3.3	FD 2	41	
E.3.4	FD 3	42	
E.3.5	Procedurat e Ankandit Lokal	42	
E.4	Të përgjithshme	42	
E.4.1	Njoftimet e Tregut	42	

F. Çështje të Tjera	44
F.1	Kërkesat për informacion, auditimet dhe inspektimet 44
F.1.1	Kërkesat 44
F.2	Procedurat e vendosjes së çmimeve 44
F.2.1	Lista e Tarifave të ALPEX-it 44
F.2.2	Pagesa e Tarifave Fikse dhe Tarifave Variabël të ALPEX-it 44
F.2.3	Pagesa e Tarifave Variabël të tregtimit, klerimit dhe tarifave të tjera 44
F.2.4	Faturimi dhe Pagesa e tarifave të ALPEX-it 45
F.2.5	TVSH-ja 45
G. Procedurat e Aksesit Teknik	46
G.1	Konfigurimi, licencat dhe mbështetja 46
G.1.1	Pronësia intelektuale dhe licencat 46
G.1.2	Aksesi teknik 46
G.1.3	Aksesi në Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) 46
G.2	Procedurat e komunikimit 47
G.2.1	Udhëzuesi për Publikimin e të Dhënave të ALPEX-it 47
G.2.2	Regjistrimet zanore 47
G.3	Tregtimi në emër të dikujt tjetër 47
H. Organizimi i Ndërprerjeve	50
H.1	Të përgjithshme 50
H.2	Hapja e Librave të Urdhërporosive për periudhën direkt pas Kohës së Ndërprerjes 50
SHTOJCA A	51
Tabela A.1: Specifikimet e Produkteve të Segmentit të Tregut të Ditës në Avancë	51
TABELA A.2: Specifikimet e Produkteve të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë	54
TABELA A.3: Specifikimet e Produkteve të Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	57

A. HYRJE

A.1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

A.1.1 Qëllimi dhe konteksti

A.1.1.1 Kjo Procedurë dhe Shtojca A përcaktojnë rregullat e detajuara për tregtimin në Bursë.

A.1.1.2 Kjo Procedurë është bërë sipas paragrafit B.3.3.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. Ato janë të detyrueshme për ALPEX-in dhe çdo Anëtar të Bursës, dhe duhet të zbatohen në përputhje me Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë si dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

A.1.1.3 Në rastet kur ka ndonjë mospërputhje ndërmjet:

(a) Kësaj Procedure dhe Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, do të mbizotërojnë Kushtet e Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike; ose

(b) Kësaj Procedure dhe Shtojcës A, do të mbizotërojnë kjo Procedurë.

A.1.1.4 Kjo Procedurë mund të ndryshohet sipas Kapitujve J dhe K të Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike

A.1.1.5 Kjo procedurë zbatohet për segmentet e mëposhtme të tregut:

(a) Ankandet e Ditës në Avancë, të përshkruara në Kapitullin B (Segmenti i Tregut të Ditës në Avancë) dhe në Tabelën A.1 të Shtojcës A;

(b) Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë, të përshkruara në Kapitullin C (Segmenti i Tregut Brenda së Njëjtës Ditë) dhe në Tabelën A.2 të Shtojcës A; dhe

(c) Tregtimi i Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë i përshkruar në Kapitullin D (Segmenti i Tregtimi i Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë) dhe në Tabelën A.3 të Shtojcës A.

A.1.1.6 Në këtë Procedurë, fjalët, frazat, akronimet dhe shkurtesat me shkronja të mëdha kanë kuptimin që u jepet atyre në Përkufizimet e ALPEX-it, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe.

A.2 KONCEPTET E PËRDORURA NË KËTË PROCEDURË

A.2.1 Kushtet e përshkruara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike

A.2.1.1 Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike përshkruajnë konceptin e Produkteve, Urdhërporosive, Transaksioneve dhe Kontratave.

A.2.2 Njësia Kohore e Tregut

A.2.2.1 Njësia Kohore e Tregut (MTU) është periudha kohore në të cilën Urdhërporositë përputhen në një Segment të caktuar Tregu. Njësia Kohore e Tregut ndryshon për secilin Segment Tregu, siç përcaktohet në paragrafin A.2.4.6 dhe Shtojcën A.

A.2.3 **Kufiri i Tregtimit**

A.2.3.1 Kufiri i Tregtimit është një vlerë monetare deri në të cilën një Anëtar i caktuar i Bursës mund të tregtojë për një periudhë të caktuar.

A.2.3.2 Kufiri i Tregtimit për çdo Anëtar të Bursës vendoset (dhe mund të përditësohet) nëpërmjet:

- (a) Anëtarit të Bursës, i cili emërohet si Anëtar Personal i Klerimit;
- (b) Anëtarit të Përgjithshëm i Klerimit i Anëtarit të Bursës; ose

Në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes si dhe me seksionin A.3.

A.2.3.3 ALPEX-i nuk mban përgjegjësi nëse një Anëtar i Bursës është subjekt ose jo i menaxhimit të Kufirit të Tregtimit ose Kufijve të Tregtimit që janë vendosur.

A.2.4 **Librat e Urdhërporosive**

A.2.4.1 Ndërkohë që Libri i Urdhërporosive është i hapur, një Anëtar i Bursës mund të dorëzojë, ndryshojë dhe anulojë Urdhërporositë e tij.

A.2.4.2 Librat e Urdhërporosive do të jenë anonime për të gjithë Anëtarët e Bursës.

A.2.4.3 Përmbajtja e Urdhërporosive lidhur me Ankandin dhe/ose me Tregun e Vazhdueshëm

- (a) Kodi EIC i Anëtarit të Bursës - Ankandi dhe Tregun e Vazhdueshëm;
- (b) Kodi i Zonës së Ofertimit EIC- Ankandin dhe Tregun e Vazhdueshëm;
- (c) Lloji i Urdhërporosisë - Ankand dhe Tregun e Vazhdueshëm;
- (d) Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje - Ankandin dhe Tregun e Vazhdueshëm;
- (e) Sasia dhe çmimi i energjisë për çdo segment të Urdhërporosisë së Thjeshtë ose për çdo Urdhërporosi në Bllok - Ankandin;
- (f) Kodi kontratës të aplikueshëm, i cili vendos kontratën e tregtueshme specifike brenda Ditës së Livrimit: Produkt Orar, Produkte 30 minuta, Produkte 15 minuta dhe Produkte në Bllok - Tregun e Vazhdueshëm;
- (g) Sasia dhe çmimi i energjisë elektrike - Tregun e Vazhdueshëm
- (h) Specifikimet e ekzekutimit të Urdhërporosive - Tregun e Vazhdueshëm;
- (i) Specifikimet e vlerësimit të Urdhërporosive - Tregun e Vazhdueshëm
- (j) Njësia(të) Kohore e Tregut për të cilat është dorëzuar - Ankandin dhe Tregun e Vazhdueshëm, dhe
- (k) Çdo informacion shtesë, kur kërkohet, siç përcaktohet në kërkesat e funksionimit të ETSS-së - Ankandin dhe Tregun e Vazhdueshëm.

A.2.4.4 Çdo Urdhërporosi e Thjeshtë mund të përfshijë deri në (50) segmente për çdo Njësi Kohore Tregu.

A.2.4.5 Në rastin e Ankandit të Ditës në Avancë ose Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë, sipas seksionit F.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrikedhe këtyre Procedurave:

- (a) Libri i Urdhërporosisë do të hapet dhe mbyllet automatikisht në kohën e përcaktuar në përputhje me tabelën në paragrafin A.2.4.6; dhe

- (b) pasi Libri i Urdhërporosive të jetë mbyllur:
- (i) Urdhërporositë në Librin e Urdhërporosisë nuk mund të ndryshohen ose anulohen nga Anëtari i Bursës dhe janë oferta detyruese dhe të parevokueshme për të blerë ose shitur energji elektrike (sipas rastit); dhe
 - (ii) ETSS-ja nuk do të pranojë më dorëzimin e Urdhërporosive në lidhje me Ankandin përkatës.

A.2.4.6 Në varësi të seksionit F.3 të Rregullave të ALPEX-it, oraret (CET) e hapjes dhe mbylljes së Librit të Urdhërporosive të Ankandeve të Ditës në Avancë dhe atyre Brenda së Njëjtës Ditë, dhe Njësine Kohore të Tregut që mbulon secilin Ankand, dhe natyra e planeve të Bashkimit të Tregut për Segmentin përkatës të Tregut, janë si vijon:

Emri i tregut	Koha e Hapjes së Portës	Koha e Mbylljes së Portës	Njësia Kohore e Tregut
DAM	10:00 CET (D-3)	12:00 CET (D-1)	00:00 – 24:00 (24* 1 orë)
CRIDA–1	13:00 CET (D-1)	15:00 CET (D-1)	00:00 – 24:00 (24* 1 orë)
CRIDA–2	15:30 CET (D-1)	22:00 CET (D-1)	00:00- 24:00 (24* 1 orë)
CRIDA–3	22:30 CET (D-1)	10:00 CET (D)	12:00 – 24:00 (12* 1 orë)
LIDA -1	13:00 CET (D-1)	15:00 CET (D-1)	00:00 – 24:00 (24* 1 orë)
LIDA -2	15:30 CET (D-1)	22:00 CET (D-1)	00:00- 24:00 (24* 1 orë)
LIDA -3	22:30 CET (D-1)	10:00 CET (D)	12:00– 24:00 (12* 1 orë)

DAM - Ankandi i Ditës në Avancë; CRIDA - Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë; LIDA - Ankandi Lokal Brenda së Njëjtës Ditë; D - Dita e Livrimit; CET- Zona Kohore e Evropës Qendrore

A.2.4.7 Në rastin e Tregimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë, sipas seksionit F.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe këtyre Procedurave:

- (a) Libri i Urdhërporosive për 24 Njësi Kohore Tregu orare do të hapet në 13:00 CET para fillimit të Ditës së Livrimit;
- (b) Urdhërporositë në Librin e Urdhërporosisë janë oferta të detyrueshme dhe të parevokueshme për të blerë ose shitur energji elektrike (sipas rastit);
- (c) Libri i Urdhërporosisë do t'i bëjë Urdhërporositë anonime aktive të dukshme për të gjithë Anëtarët e Bursës;
- (d) Libri i Urdhërporosive do të mbyllet në lidhje me një Njësi Kohore Tregu një (1) orë para livrimit fizik të Njesisë përkatëse Kohore të Tregut ; dhe
- (e) Pasi të mbyllet Libri i Urdhërporosisë në lidhje me një Njësi Kohore Tregu, nuk do të ketë Përputhje të Urdhërporosive të mëtejshme në lidhje me atë Njësi Kohore Tregu.

A.2.4.8 Në këtë Procedurë:

- (a) shprehja “D” i referohet Ditës së Livrimit përkatëse;
- (b) shprehja “D-X” i referohet X Ditë përpara Ditës së Livrimit , në këtë mënyrë “D-1” është 1(një) Ditë përpara Ditës së Livrimit përkatëse; dhe
- (c) shprehja “D+X” i referohet X Ditë pas Ditës së Livrimit, në këtë mënyrë që “D+1” është 1 (një) pas Ditës së Livrimit përkatëse.

A.2.5 **Vlefshmëria dhe pranimi i Urdhërporosisë**

A.2.5.1 Një Urdhërporosi do të qëndrojë në Librin e Urdhërporosisë, për çdo rast, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, derisa:

- (a) Urdhërporosia anulohet nga ose në emër të Anëtarit të Bursës që e ka bërë Urdhërporosinë;
- (b) Urdhërporosia anulohet nga ALPEX-i;
- (c) Anëtari i Bursës ndryshon Urdhërporosinë;
- (d) Urdhërporosia është Përputhur (pjesërisht ose plotësisht): ose
- (e) Urdhërporosia nuk ka qenë e Përputhur, i kaluar afati në rastin e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë.

A.2.5.2 Për të shmangur ndonjë dyshim:

- (a) mënyra se si krijohen Kontratat si rezultat i tregtimit në Bursë trajtohet në seksionin E.2.4 në Rregullat e ALPEX-it; dhe
- (b) pranimi i një Urdhërporosie në përputhje me këto Procedura nuk përbën kontratë për blerjen ose shitjen e energjisë elektrike.

A.2.6 **Çmimet**

A.2.6.1 Çmimet e specifikuar në Urdhërporositë, Transaksionet, dhe Kontratat dhe Çmimet e Ankandit do të përjashtohen nga çdo taksë (për shembull, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe çdo taksë tjetër), ose tarifa të tjera të ngjashme.

A.2.6.2 Çmimet për Urdhërporositë e dorëzuara në lidhje me Portofolet për çdo Zonë Ofertimi dhe Tregjet e ALPEX-it, sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes do të jenë në Euro.

A.2.7 **Ankandi**

A.2.7.1 Gjatë ankandit, të gjitha Urdhërporositë e dorëzuara nga Koha e Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës pranohen për ekzekutim nga ETSS-ja. Të gjitha Urdhërporositë e pranuar sipas rregullave në fuqi të vlefshmërisë, sipas rastit, vendosen në Librin e Urdhërporosisë.

A.2.7.2 Pas përfundimit të Kohës së Mbylljes së Portës së Ankandit, të gjitha Urdhërporositë Blerjeje dhe Shitjeje të pranuar, mblidhen nga Libri i Urdhërporosisë dhe më pas algoritmi llogarit balancimin e energjise elektrike të tregtuar , sasi të pranuar të Urdhërporosive Blerjeje dhe Shitjeje si dhe llogariten çmimin e balancuar të energjisë elektrike të tregtuar në çdo Ankand.

A.2.8 Tregtimi i Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë

- A.2.8.1 Gjatë Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë, të gjitha Urdhërporositë që janë dorëzuar nga Koha e Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës pranohen për ekzekutim nga ETSS-ja. Me dorëzimin e tyre në ETSS, Urdhërporositë e pranuar sipas metodës së Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë, regjistrohen në Librin e Urdhërporosisë Lokale pasi marrin gjurmën e kohës së Livrimit dhe pranohen si të vlefshme.
- A.2.8.2 Libri i Urdhërporosisë Lokale përfshin Urdhërporositë Blerjeje dhe Shitjeje, të cilat regjistrohen sipas kritereve të renditjes së tyre.
- A.2.8.3 Urdhërporositë të cilat, në momentin e vendosjes së tyre në ETSS, nuk plotësojnë kriteret e përputhshmërisë për transaksionet e ekzekutuara automatikisht, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe sipas Llojit të Urdhërporosisë, regjistrohen në Librin e Urdhërporosive Lokale. Urdhërporositë renditen sipas Llojit të Urdhërporosisë, Blerjeje ose Shitjeje.
- A.2.8.4 Çdo Urdhërporosi renditet, sipas llojit, në bazë të kritereve të mëposhtme:
- (a) **Çmimi më i mirë.** Urdhërporositë Blerjeje renditen sipas prioritetit në bazë të çmimit më të lartë, ndërsa Urdhërporositë Shitjeje renditen në bazë të çmimit më të ulët.
 - (b) **Koha.** Urdhërporositë më të njëjtin çmim renditen në bazë të përparësisë që kanë sipas kohës së hyrjes në ETSS.
- A.2.8.5 Në bazë të kritereve të renditjes, Tregtimi kryhet si në vijim: Në momentin e regjistrimit në ETSS, kufiri i çmimit të një Urdhërporosi Blerjeje duhet të jetë i barabartë ose më i lartë se çmimi më i mirë midis Urdhërporosive Shitjeje të regjistruara dhe, në rastin e një Urdhërporosi Shitjeje, kufiri i çmimit duhet të jetë i barabartë ose më i ulët se çmimi më i mirë midis Urdhërporosive Blerjeje të regjistruara.

A.3 MENAXHIMI I KUFIRIT TË TREGTIMIT

A.3.1 Vendosja e Kufirit të Tregtimit

- A.3.1.1 Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit konfirmon në sistem nëse tregtimi nga një Anëtar i Bursës është subjekt i menaxhimit të Kufirit të Tregtimit në përputhje me seksionin A.3.2, dhe, nëse po, do t'i ofrojë ALPEX-it një Kufi Tregtimi për Anëtarin e Bursës.
- A.3.1.2 Një Kufi Tregtimi i kombinuar për Ankandet e Tregut të Ditës në Avancë dhe atij Brenda së Njëjtës Ditë do të shprehet në Euro.
- A.3.1.3 Një Kufi Tregtimi për Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë do të shprehet në Euro.
- A.3.1.4 Në rastin e një Anëtari të Bursës që vepron si Anëtar Personal Klerimi, ALPEX-i do të caktojë një Kufi Tregtimi për Anëtarin e Bursës për të gjitha Segmentet e Tregjeve.
- A.3.1.5 Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit mund t'i ofrojë nëpërmjet EMCS Kufi Tregtimi të përditësuar që të zbatohen për një Anëtar të Bursës, siç parashikohet në paragrafin A.2.3.2.

A.3.2 Efekti i Kufirit të Tregtimit

- A.3.2.1 Ky seksion A.3.2 zbatohet vetëm në lidhje me një Anëtar të Bursës kur Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit e ka njoftuar ALPEX-in se Anëtari i Bursës është subjekt i menaxhimit të Kufirit të Tregtimit sipas seksionit A.3.1.1.
- A.3.2.2 Një Anëtar Burse nuk duhet të dorëzojë një Urdhërporosi, e cila, në vetvete ose në kombinim me Urdhërporositë e tjera të dorëzuara tashmë nga Anëtari i Bursës, për periudhën gjatë së cilës vlerësohet Kufiri përkatës i Tregtimit, dhe ku do ta bënte atë Anëtar të Bursës të tejkalonte Kufirin e tij të Tregtimit.
- A.3.2.3 Anëtarit të Bursës i kërkohet të monitorojë përditësimet përkatëse të Kufirit të tij të Tregtimit përmes ETSS-ë me qëllim që të mos vendosë Urdhërporosi në ETSS që do të rezultonte në tejkalimin e Kufiri të tij të Tregtimit.
- A.3.2.4 ETSS-ja dot të refuzojë automatikisht çdo Urdhërporosi të dorëzuar nga një Anëtar i Bursës, që do të bënte që ai Anëtar i Bursës të tejkalonte Kufirin e të tij të Tregtimit. Në të tilla raste ETSS-ja do të njoftojë Anëtarin e Bursës Urdhërporosia e dorëzuar është refuzuar.
- A.3.2.5 Anëtari i Bursës që vepron si Anëtar Personal Klerimi dhe çdo Anëtar i Përgjithshëm Klerimi sipas detyrimeve të tij kundrejt një Anëtari Burse do të jetë përgjegjës i vetëm për dhënien e Garancive të kërkuara sipas Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave për krijimin dhe mbajtjen e Kufirit të Tregtimit.
- A.3.2.6 Kufiri i Tregtimit i çdo Anëtari të Bursës monitorohet nga ETSS në përputhje me dispozitat specifike të paragrafëve të mëposhtëm:
- (a) Përpara Kohës së Hapjes së Portës për çdo Treg, vlera e Kufirit të Kreditit të Anëtarit të Bursës, e llogaritur nga ALPEX, sipas dispozitave të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, regjistrohen në ETSS.
 - (b) Për më tepër, në mënyrë të vazhdueshme dhe deri në Kohën e Mbylljes së Portës të çdo Tregu, çdo ndryshim në Kufirin e Tregtimit që janë regjistruar tashmë, futet në ETSS, pasi ndryshime të tilla mund të lindin për çdo Anëtar të Bursës në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes dhe Kushtet e Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

A.4 DORËZIMI

A.4.1 Dorëzimi i Urdhërporosive

- A.4.1.1 Anëtarët e Bursës duhet t'i dorëzojnë Urdhërporositë nëpërmjet një ndërfaqe elektronike në ETSS për Përputhje të mundshme, me përmbajtjen dhe formatin sipas të gjitha specifikimeve ose modeleve që ofron ALPEX-i herë pas here.
- A.4.1.2 ETSS-ja duhet t'i konfirmojë çdo Anëtar të Bursës se e ka marrë Urdhërporosinë e dorëzuar nga Anëtari i Bursës dhe se Urdhërporosia është në përputhje me kërkesat e Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave.
- A.4.1.3 Çdo Anëtar i Bursës është përgjegjës për të garantuar saktësinë e Urdhërporosive të dorëzuara.

- A.4.1.4 ETSS-ja do të refuzojë Urdhërporositë që nuk janë në përputhje me kërkesat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- A.4.1.5 Në rastin e Ankandit të Ditës në Avancë dhe Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë, për çdo Portofol, Urdhërporosia e Thjeshtë e fundit në lidhje me një Njësi Kohore Tregu e dorëzuar nga një Anëtar i Bursës përpara Mbylljes së Librit të Urdhërporosisë, përveç nëse anulohet më pas, do të konsiderohet Urdhërporosi e vlefshme për Ankandin dhe të gjitha të mëparshmet nuk do të merren në konsideratë.
- A.4.1.6 Anëtarët e Bursës do t'i dorëzojnë Urdhërporositë e tyre dhe mund t'i anulojnë ose ndryshojnë këto Urdhërporosi nga Koha e Hapjes së Portës dhe deri në Kohën e Mbylljes së Portës për tregjet e DAM-it, LIDA-t, CRIDA-t dhe Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë.

A.4.2 **Paraqitja e Kapaciteteve Ndërkufitare**

- A.4.2.1 Çdo OST duhet të dorëzojë Kapacitetin Ndërkufitar të vlefshëm dhe kufizimet në alokim nëpërmjet një ndërfaqeje elektronike me ETSS-n, më përmbajtje dhe format të tillë që të jetë në përputhje me çdo specifikim ose model të ofruar herë pas here nga ALPEX-i.
- A.4.2.2 Çdo OST duhet të dorëzojë informacionin e përmendur në paragrafin A.4.2.1 dhe në përputhje me Vendimet Teknike përkatëse të ALPEX-it.
- A.4.2.3 ALPEX-i duhet t'i konfirmojë çdo OST-je se e ka marrë informacionin e dorëzuar nga ajo sipas seksionit A.4.2 dhe që është në përputhje me kërkesat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike .
- A.4.2.4 Çdo OST është përgjegjëse për saktësinë e informacionit që dorëzon në përputhje me këtë seksion A.4.2.
- A.4.2.5 ALPEX-i do të refuzojë informacionin e paraqitur sipas seksionit A.4.2 që nuk përputhet me kërkesat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

A.4.3 **Vlerësimi i Urdhërporosive**

- A.4.3.1 ETSS-ja nuk do të lejojë një Urdhërporosi të dorëzuar nga një Anëtar i Bursës, bazuar në kohën e marrjes nga ALPEX-i, kur është marrë përpara Kohës së Hapjes së Portës për tregjet e DAM-it, LIDA-t, CRIDA-t dhe Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë ose pas Kohës së Mbylljes së Portës për tregjet e DAM-it, LIDA-t, CRIDA-t dhe Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë.
- A.4.3.2 ETSS-ja do të refuzojë automatikisht një Urdhërporosi të dorëzuar nga një Anëtar i Bursës bazuar në çmimin e Urdhërporosisë, kur çmimi i Urdhërporosisë është jashtë diapazonit të përcaktuar si Çmimi Minimal dhe Çmimi Maksimal për Tregjet DAM-it, LIDA-t, CRIDA-t dhe Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë. Në rast të refuzimit automatik të një Urdhërporosie, ETSS-ja duhet t'i dërgojë automatikisht Anëtarit përkatës të Bursës një njoftim refuzimi, duke përfshirë edhe arsyen për këtë refuzim.
- A.4.3.3 ETSS-ja duhet të refuzojë automatikisht çdo Urdhërporosi Blerjeje apo Shitjeje të dorëzuar nga një Anëtar i Bursës kur Urdhërporosia shkel kufizimet e aksesit për

Lloje të caktuara Urdhërporosish ose parametrat e dorëzimit të Urdhërporosisë në përputhje me dispozitat e Shtojcës A të kësaj Procedure.

B. SEGMENTI I TREGUT TË DITËS NË AVANCË

B.1 ANKANDET E DITËS NË AVANCË, PRODUKTET, URDHËRPOROSITË

B.1.1 Ankandet e Ditës në Avancë

B.1.1.1 Tregu i Ditës në Avancë i referohet Tregut të energjisë elektrike ku dorëzimi i Urdhërporosive Shitjeje dhe Blerjeje ndodh përpara Ditës së Livrimit, në intervalin e kohës nga Koha e Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës. Urdhërporositë e Përputhura krijojnë një Transaksion dhe Kontratë me një detyrim të livrimit fizik të energjisë elektrike për secilën Njësi Kohore Tregu të Ditës së Livrimit D.

B.1.1.2 Lidhur me Segmentin e Tregut të Ditës në Avancë, ALPEX-i do të kryej një Ankand të Ditës në Avancë në lidhje me një Ditë Livrimi, duke mbuluar të gjitha Njësitë Kohore të Tregut në atë Ditë Livrimi.

B.1.2 Orët e Tregtimit

B.1.2.1 Tregu i ditës në Avancë funksionon në përputhje me kohën e përcaktuar në Vendimet Teknike të ALPEX-it.

B.1.2.2 ALPEX-i mund të zgjasë Kohën e Mbylljes së Portës së Tregut të Ditës në Avancë për të mbajtur kushte të rregullta tregtimi. Koha e Mbylljes së Portës së Tregut të Ditës në Avancë mund të zgjatet për arsye që lidhen me disponueshmërinë e ETSS-ës, Librin e Urdhërporosisë Lokale, si dhe për arsye që lidhen me Ndarjen e Plotë të Tregjeve.

B.1.2.3 ALPEX-i do të informojë Anëtarët e Bursës për arsyet e zgjatjes si dhe veprimet që kanë lidhje me të, që kërkohen të merren prej tij dhe prej Anëtarëve të Bursës.

B.1.3 Përshkrimi disponueshmërisë të Llojeve të Urdhërporosive

B.1.3.1 Në Ankandet e Ditës në Avancë, Anëtarët e Bursës mund të dorëzojnë Llojet e Urdhërporosive Shitjeje dhe Blerjeje si më poshtë:

- (a) Urdhërporosi e Thjeshtë;
- (b) Urdhërporosi në Bllok;
- (c) Urdhërporosi të Lidhura në Bllok;
- (d) Grupi Ekskluziv i Urdhërporosive në Bllok.

B.1.3.2 Parametrat në fuqi për kategori specifike të Llojeve të Urdhërporosive përcaktohen në nga seksioni B.1.5 deri në seksionin B.1.9 (përfshirë dhe këtë seksion) si dhe në Tabelën A.1 të Shtojcës A të kësaj Procedure Tregtimi.

B.1.4 Përmbajtja e Urdhërporosive në Tregtimin e Ankandit të Ditës në Avancë

B.1.4.1 Përmbajtja minimale e një Urdhërporosie të dorëzuar në ETSS nga një Anëtar i Bursës për Tregtimin në Ankandin e Ditës në Avancë është si më poshtë:

- (a) Kodi EIC i Anëtarit të Bursës;

- (b) Kodi i Portofolit, ose karakteristika të tjera unike për të cilat Urdhërporosia është dorëzuar;
 - (c) Kodi i EIC i Zonës së Oferimit;
 - (d) Kodi i kontratës së zbatueshme i cili vendos kontratën e tregtueshme specifike brenda Ditës së Livrimit D: Produkte Orare, Produkte 30 minuta, Produkte 15 minuta ose në Bllok sipas rastit;
 - (e) Lloji i Urdhërporosisë;
 - (f) Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje;
 - (g) Sasia dhe çmimi i energjisë elektrike;
 - (h) Njësia Kohore e Tregut për të cilën Urdhërporosia dorëzohet; dhe
 - (i) Informacione të tjera shtesë kur kërkohet siç janë të përcaktuara nga kërkesat funksionale të ETSS-së.
- B.1.4.2 Çmimi i Urdhërporosive dorëzohet në EUR/MWh me dy (2) presje dhjetore. Sasia e Urdhërporosive dorëzohet në MWh me dy (2) presje dhjetore.
- B.1.5 Urdhërporositë e Thjeshta në Ankandet e Ditës në Avancë**
- B.1.5.1 Një Urdhërporosi e Thjeshtë në Ankandin e Ditës në Avancë lidhet me një Njësi Kohore Tregu dhe një Portofol specifik.
- B.1.5.2 Urdhërporositë e Thjeshta përbëhen nga segmente me hapa, të ndara për çdo Njësi Kohore Tregu në Ditën e Livrimit D. Kurba përkatëse është me trend rritës për Urdhërporosi Shitjeje dhe trend zbritës për Urdhërporosi Blerjeje.
- B.1.5.3 Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së Urdhërporosi Shitjeje është i barabartë me Çmimin Minimal të Tregut të Ditës në Avancë për Urdhërporositë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së Urdhërporosi Shitjeje është i barabartë me Çmimin Maksimal të Tregut të Ditës në Avancë për Urdhërporositë.
- B.1.5.4 Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së Urdhërporosi Blerjeje është i barabartë me Çmimin Minimal të Tregut të Ditës në Avancë për Urdhërporositë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së Urdhërporosi Blerjeje është i barabartë me Çmimin Maksimal të Tregut të Ditës në Avancë për Urdhërporosite.
- B.1.5.5 Një Urdhërporosi e Thjeshtë përbëhet nga të paktën dy dhe jo më shumë se 50 Çifte Çmim-Sasi ku një “Çift Çmim-Sasi” (“**çift ÇS**”) specifikon një çmim dhe një sasi të energjisë elektrike për shitje ose blerje për një Njësi Kohore e Tregu të caktuar.
- B.1.5.6 Çiftet ÇS në Urdhërporosinë e Thjeshtë paraqiten nga një funksion i thyer-me hapa (step-wise) i çmimit dhe sasisë se energjisë elektrike për blerje dhe/ose shitje në Njësinë Kohore të Tregut përkatës, ose me rritjen graduale të sasisë se energjisë elektrike ose me zbritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike për çdo hap çmimi sipas paragrafit B.1.5.7.

B.1.5.7 Çmimet e përcaktuara për Urdhërporositë e Thjeshta Shitjeje do të rriten në mënyrë monotnike, dhe për Urdhërporositë e Thjeshta Blerjeje do të zbriten në mënyrë monotnike. Në këtë mënyrë:

- (a) në rastin e një Urdhërporosi Shitjeje e Thjeshtë për një Njësi Kohore Tregu, lidhur me sasinë dhe çmimin do të zbatohet ky rregull:
 - (i) për një sasi, vlera e së cilës është më e madhe se sasia e dhënë më parë, edhe çmimi korespondues duhet të jetë më i lartë ose i barabartë më çmimin e dhënë më parë; dhe
 - (ii) për një sasi, vlera e së cilës është më e vogël se sasia e dhënë më parë, edhe çmimi korespondues duhet të jetë më i ulët ose i barabartë me çmimin e dhënë më parë; dhe
- (b) në rastin e një Urdhërporosi Blerjeje e Thjeshtë për një Njësi Kohore Tregu, lidhur me sasinë dhe çmimin do të zbatohet ky rregull:
 - (i) për një sasi, vlera e së cilës është më e madhe se sasia e dhënë më parë, edhe çmimi korespondues duhet të jetë më i ulët ose i barabartë më çmimin e dhënë më parë; dhe
 - (ii) për një sasi, vlera e së cilës është më e vogël se sasia e dhënë më parë, edhe çmimi korespondues duhet të jetë më i lartë ose i barabartë më çmimin e dhënë më parë.

B.1.6 **Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi**

B.1.6.1 Urdhërporosi Shitjeje Marrëse e Çmimit me Përparësi janë Urdhërporosi të Thjeshta që u vendoset çmimi sa çmimi minimal i pranuar në Tregun e Ditës në Avancë, që i korrespondon Çmimit Minimal në Tregun e Ditës në Avancë.

B.1.6.2 Urdhërporosi Blerjeje Marrëse e Çmimit me Përparësi janë Urdhërporosi të Thjeshta që u vendoset çmimi sa çmimi maksimal i pranuar në Tregun e Ditës në Avancë, që i korrespondon Çmimit Maksimal në Tregun e Ditës në Avancë.

B.1.6.3 Në rast se Çmimi Klerues i Tregut në një Zonë Ofertimi për një Njësi Kohore Tregu të caktuar të Ditës së Livrimit D është i barabartë me Kufirin Minimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe në të njëjtën kohë asnjë Urdhërporosi e Thjeshtë nuk është pranuar nga zgjidhja e algoritmit për një çmim të barabartë me Kufirin Minimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe përjashtuar rastet e Përparësisë, atëherë do të aplikohet procesi i Kufizimit të Urdhërporosisë Shitjeje Marrëse e Çmimit me Përparësi .

B.1.6.4 Në rast se Çmimi Klerues i Tregut në një Zonë Ofertimi për një Njësi Kohore Tregu të caktuar të Ditës së Livrimit D është i barabartë me Kufirin Maksimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe në të njëjtën kohë asnjë Urdhërporosi e Thjeshtë nuk është pranuar nga zgjidhja e algoritmit për një çmim të barabartë me Kufirin Maksimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe përjashtuar rastet e Përparësisë, atëherë do të aplikohet procesi i Kufizimit të Urdhërporosisë Blerjeje Marrëse e Çmimit me Përparësi.

B.1.6.5 Procedura për kufizimin e Urdhërporosive Blerjeje dhe/ose Shitjeje në rastet e paragrafëve B.1.6.3 dhe B.1.6.4 kryhet sipas një metodologjie të përcaktuar me vendim të Autoritetit Rregullator me rekomandim të ALPEX-it.

B.1.6.6 Autoriteti Rregullator, nëpërmjet një vendimi, do të përcaktojë detyrimin për Anëtarët përkatës të Bursës që do të dorëzojnë Urdhërporosi si Marrëse të Çmimit me Përparësi.

B.1.7 Urdhërporositë në Bllok në Ankandet e Ditës në Avancë

B.1.7.1 Një Urdhërporosi në Bllok përbëhet si më poshtë:

- (a) një kufi çmimi fiks (çmimi minimal për Urdhërporosi Shitjeje në Bllok dhe çmimi maksimal për Urdhërporosi Blerjeje në Bllok);
- (b) e njëjta sasi energjie elektrike për çdo Njësi Kohore të Tregut e përfshirë në Urdhërporosinë në Bllok; dhe
- (c) një Normë Minimale e Pranimit lidhur me sasinë e energjisë elektrike për çdo Njësi Kohore të Tregut e përfshirë në Urdhërporosi në Bllok.

B.1.7.2 Urdhërporosia në Bllok nuk mund të pranohet për një sasi më të vogël se Norma Minimale e Pranimit. Norma Minimale e Pranimit është e njëjtë për të gjitha Njësitë Kohore të Tregut të përfshira në Urdhërporosi në Bllok.

B.1.8 Urdhërporositë të Lidhura në Bllok

B.1.8.1 Një Urdhërporosi e Lidhur në Bllok përbëhet nga Urdhërporosi individuale në Bllok, me atributet e përmendura në Urdhërporosinë në Bllok, të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet marrëdhënies Udhëheqës-Vartës.

B.1.8.2 Urdhërporosi në Bllok Vartëse mund të pranohet vetëm kur ekzekutohet Urdhërporosia në Bllok Udhëheqëse, me të cilin ajo është e lidhur. Urdhërporositë në Bllok të pa lidhura me Urdhërporositë në Bllok Vartëse quhen Urdhërporosi në Bllok të Izoluara.

B.1.8.3 Kriteret e mëposhtme përdoren për pranimin e blloqeve të tjera të Urdhërporosive të Lidhura në Bllok:

- (a) Pranimi i një Urdhërporosi në Bllok Vartës është i kushtëzuar nga pranimi i Udhëheqësit të tij;
- (b) Norma e Pranimit të një Blloku Udhëheqës duhet të jetë më e madhe ose e barabartë me Normën më të lartë të Pranimit të Blloqeve të tij Vartëse;
- (c) Një Bllok Udhëheqës i cili është jashtë vlerës monetare (out-of-the-money) mund të pranohet në rastet kur Blloqet Vartëse të tij të pranuar japin teprica të mjaftueshme për të kompensuar të paktën humbjen nga Blloku Udhëheqës;
- (d) Pranimi i pjesshëm i mundshëm i Blloqeve Vartëse lejon pranimin e Bllokut Udhëheqës, kur;
 - (i) Teprica e blloqeve të Urdhërporosive të Lidhura në Bllok nuk është negative;

- (ii) Billoqet e Izoluara nuk prodhojnë humbje të përfitueshmërisë (welfare loss);

B.1.9 Grupi Ekskluziv i Urdhërporosive në Bllok

- B.1.9.1 Një Grup Ekskluziv përbëhet nga një numër Urdhërporosish në Bllok, për të cilat shuma e Normës së Pranimit nuk kalon njësinë një (1).
- B.1.9.2 Në rastet specifike kur Urdhërporositë në Bllok kanë një Normë Minimale Pranimi një (1) atëherë më shumë se një Urdhërporosi në Bllok mund të pranohet.

B.1.10 Operimi i Bashkimit të Tregjeve.

- B.1.10.1 Operatori i Bashkimit të Tregjeve është përgjegjës për kryerjen e Funkcionit të Operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funkzioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga Ofruesi i tij i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.
- B.1.10.2 Objektivi i mekanizmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë është maksimizimi i mirëqenies sociale i Zonave të Ofertimit të bashkuara, përkatësisht maksimizimi i shumës totale së tepricave të Urdhërporosive Shitjeje dhe Blerjeje të përfshira në Librin e Urdhërporosive të Grupuara plus të ardhurat nga kongjestionimi.
- B.1.10.3 Teprica e Urdhërporosive Shitjeje të pranuar është e barabartë me prodhimin (shumëzimin) e diferencës së Çmimit Klerues Margjinal minus Çmimin e Urdhërporosisë së tyre me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. Teprica e Urdhërporosive Blerjeje të pranuar është e barabartë me prodhimin (shumëzimin) e diferencës së Çmimit të Urdhërporosisë minus Çmimin Klerues Margjinal me sasinë e energjisë elektrike të pranuar.
- B.1.10.4 Algoritmi për Bashkimin e Tregjeve të Ditës në Avancë trajton Urdhërporositë Shitjeje dhe Blerjeje në Bllok të Pranuar Paradoksalisht nëpërmjet një procesi ripërsëritës, dhe në çdo fazë të ripërsëritjes të së cilës zgjidhjet e ndërmjetme rezultojnë në Urdhërporositë Shitjeje dhe Blerjeje në Bllok të Pranuar Paradoksalisht hiqen menjëherë nga pema binare (binary tree) duke përcaktuar hapësira për zgjidhje. Në zgjidhjen përfundimtare, nuk ka më Urdhërporosi Shitjeje dhe Blerjeje në Bllok të Pranuar Paradoksalisht.

B.2 ANKANDET E DITËS NË AVANCË - PËRPUHJA DHE PËRPUNIMI I URDHËRPOROSIVE

B.2.1 Përcaktimi i Çmimeve dhe Sasive të Ankandit

- B.2.1.1 Sapo të mbyllet Libri i Urdhërporosive për një Ankand të Ditës në Avancë, ALPEX-i do të:
 - (a) bëjë anonime Urdhërporositë në Librin e Urdhërporosive për çdo Zonë Ofertimi;
 - (b) krijojë kurbat e ofertës dhe kërkesës të grupuara duke përdorur Urdhërporosi Shitjeje dhe Blerjeje të bëra anonim (Libri i Urdhërporosive Lokale në çdo rast mbetet i paprekur);
 - (c) dorëzojë kurbën e ofertës dhe kërkesës të grupuara tek Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve, së bashku me Kapacitetet Ndërkufitare e aplikueshme për Interkonektorët.

B.2.1.2 Rregullat e pranimit të një Urdhërporosi Shitjeje e Thjeshtë të paraqitur në një Zonë Ofertimi janë si më poshtë:

- (a) Një segment i Urdhërporosi Shitjeje do të pranohet plotësisht nëse çmimi i tij është më i ulët se Çmimi Klerues i Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatës të Ditës së Livrimit D.
- (b) Një segment i Urdhërporosi Shitjeje do të pranohet pjesërisht nëse çmimi i tij është i barabartë me Çmimin Klerues të Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatës të Ditës së Livrimit D.
- (c) Një segment i Urdhërporosi Shitjeje nuk do të pranohet nëse çmimi i tij është më i lartë se Çmimi Klerues i Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatës të Ditës së Livrimit D.

B.2.1.3 Rregullat e pranimit të një Urdhërporosi Blerjeje e Thjeshtë të dorëzuar në një Zonë Ofertimi janë si më poshtë:

- (a) Një segment i Urdhërporosi Blerjeje do të pranohet plotësisht nëse çmimi i tij është më i lartë se Çmimi Klerues i Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatës të Ditës së Livrimit D.
- (b) Një segment i Urdhërporosi Blerjeje do të pranohet pjesërisht nëse çmimi i tij është i barabartë me Çmimin Klerues të Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatës të Ditës së Livrimit D.
- (c) Një segment i Urdhërporosi Blerjeje nuk do të pranohet nëse çmimi i tij është më i ulët se Çmimi Klerues i Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatës të Ditës së Livrimit D.

B.2.1.4 Rregullat e pranimit të një Urdhërporosi Shitjeje në Bllok janë si më poshtë:

- (a) Urdhërporosi Shitjeje në Bllok duhet të pranohet plotësisht (Norma e Pranimit është e barabartë me një (1)) dhe në rast se ekzistojnë kushtet e mëposhtme (i) dhe (ii) dhe janë të vlefshme në të njëjtën kohë:
 - (i) Nëse çmimi i tij është më i ulët se Çmimi Klerues i Tregut mesatar i ponderuar për Njësi Kohore Tregu duke përfshirë Urdhërporositë në Bllok (d.m.th. midis Periudhës të Fillimit dhe Periudhës së Përfundimit përkatës), të ponderuara me sasi të përkatëse të energjisë të pranuar të Urdhërporosive Shitjeje në Bllok, dhe
 - (ii) Gjatë procesit të përputhjes, kjo Urdhërporosi në Bllok nuk është identifikuar si Urdhërporosi në Bllok të Pranuar Paradoksalisht.
- (b) Një Urdhërporosi Shitjeje në Bllok do të pranohet pjesërisht (Norma e pranimit midis Normës Minimale të Pranimit të tij dhe një (1)), nëse çmimi i tij është fiks i barabartë me Çmimin Klerues të Tregut mesatar të ponderuar për Njësi Kohore Tregu të Ditës së Livrimit D duke përfshirë Urdhërporosi Shitjeje në Bllok i ponderuar me sasi të pranuar të Urdhërporosisë në Bllok. Norma e Pranimit do të marrë të tillë vlerë që Çmimi Klerues i Tregut mesatar i ponderuar midis Periudhës së Fillimit dhe Periudhës së Përfundimit të jetë i barabartë me çmimin e Urdhërporosisë Shitjeje në Bllok.

- (c) Urdhërporosi Shitjeje në Bllok nuk duhet të pranohet (Norma e Pranimit e barabartë me zero (0)) nëse zbatohet një nga dy rastet e mëposhtme:
 - (i) nëse çmimi i tij është më i lartë se Çmimi Klerues i Tregut mesatar të ponderuar për Njësi Kohore Tregu të Ditës së Livrimit D të përfshirë në Urdhërporosi Shitjeje në Bllok, ose
 - (ii) nëse çmimi i tij është më i ulët se Çmimi Klerues i Tregut mesatar të ponderuar për Njësi Kohore Tregu të Ditës së Livrimit D të përfshirë në Urdhërporosi Shitjeje në Bllok, por gjatë procesit të përputhjes kjo Urdhërporosi Shitjeje në Bllok është identifikuar si një Bllok i Refuzuar Paradoksalisht.

Në të gjitha rastet, sasia e pranuar e energjisë e një Urdhërporosi Shitjeje në Bllok për çdo Njësi Kohore Tregu të Ditës së Livrimit D të përfshirë në Urdhërporosi Shitjeje në Bllok do të jetë e barabartë me prodhimin e Normës së Pranimit dhe sasisë së energjisë së ofruar.

B.2.1.5 Rregullat e pranimit të një Urdhërporosi Blerjeje në Bllok janë të ngjashme me rregullat përkatëse të pranimit të një Urdhërporosi Shitjeje në Bllok, me ndryshimin se Urdhërporosia e Blerjes në Bllok klerohet kur çmimi i saj është më i lartë se çmimi Klerues i Tregut mesatar i ponderuar për Njësi Kohe të Tregut të Ditës së Livrimit e përfshirë në Urdhërporosi Blerjeje në Bllok, e ponderuar me sasi të përkatëse të pranuar të energjisë të Urdhërporosi Blerjeje në Bllok.

B.2.1.6 Rregullat e pranimit të një Urdhërporosi të Lidhur në Bllok janë si më poshtë:

- (a) Norma e Pranimit të një Urdhërporosi në Bllok e llojit-Udhëheqës është më e madhe ose e barabartë me Normën e Pranimit më të Lartë të Urdhërporosive në Bllokun Vartës të tij.
- (b) Pranimi i Urdhërporosive në Bllok Vartës mund të lejojë pranimin e Urdhërporosive në Bllokun Udhëheqës sipas kushteve të mëposhtme:
 - (i) teprica e kombinimit të pranuar të Urdhërporosive në Bllokun Udhëheqës dhe Vartës nuk është negative;
 - (ii) Urdhërporosi në Bllokun e Izoluar nuk do të prodhojë humbje të përfitueshmërisë.
- (c) Një Urdhërporosi në Bllokun Udhëheqës, e cila nuk është e pranueshme sipas rregullave të pranimit të Urdhërporosive në Bllok të përshkruar më sipër (përtej vlerës monetare “out-of-the-money”), mund të pranohet nëse Urdhërporositë e lidhura në Bllok Vartës të pranuar prodhojnë tepricë përfitueshmërie të mjaftueshme për të kompensuar humbjet e Urdhërporosive në Bllokun Udhëheqës.
- (d) Një Urdhërporosi në Bllokun Vartës, e cila nuk është e pranueshme sipas rregullave të pranimit të Urdhërporosive në Bllok të përshkruar më sipër (përtej vlerës monetare “out-of-the-money”), mund të pranohet nëse Urdhërporositë e lidhura në Bllokun Udhëheqës të pranuar prodhojnë tepricë të mjaftueshme për të kompensuar humbjet e Urdhërporosive në Bllok Vartës. Në rastin kur Urdhërporosia në Bllok Vartës është një Urdhërporosi e lidhur në Bllok

Udhëheqës për një tjetër Urdhërporosi në Bllok, zbatohet rregulli i vlefshmërisë i përshkruar në rregullin e pranimi në paragrafin B.2.1.6 (c).

- (e) Në rastin e dy Urdhërporosive të Lidhura në Bllok, rregullat e vlefshmërisë janë si më poshtë:
- (i) Urdhërporosi në Bllok Udhëheqës mund të pranohet e vetme, por pranimi i Urdhërporosive në Bllok Vartës kërkon pranimin e Urdhërporosisë në Bllok Udhëheqës.
 - (ii) Pranimi i një Urdhërporosie në Bllok Vartës do të rezultojë në pranimin e Urdhërporosisë në Bllok Udhëheqës, siç përshkruhet në rregullin e pranimi të paragrafit (c).
- B.2.1.7 Rregulli i pranimi të Urdhërporosive në Bllok që i përket Grupit Ekskluziv të Urdhërporosive në Bllok janë të njëjtat si rregullat e pranimi të Urdhërporosive në Bllok të përshkruara në paragrafin B.2.1.3 dhe B.2.1.4 dhe me kufizime shtesë që totali i Normës së Pranimi të Urdhërporosive në Bllok që i përkasin të njëjtit Grup Ekskluziv Urdhërporosi në Bllok nuk mund të kaloj shifrën një (1). Përzgjedhja e Urdhërporosisë në Bllok nga Grupi Ekskluziv bëhet nga zgjidhja e algoritmit për të maksimizuar tepicën e përfitueshmërisë (welfare surplus).
- B.2.1.8 Në rast se më shumë se një Urdhërporosi Shitjeje dhe Blerjeje në Bllok janë dorëzuar për të njëjtat Njësi Kohore Tregu dhe me një çmim të barabartë me Çmimin Klerues të Tregut mesatar të ponderuar i cili ka qenë i ponderuar me sasi të korresponduese të pranuar të energjisë elektrike për Urdhërporosi Shitjeje dhe Blerjeje në Bllok për Njësi Kohore Tregu të dhënë në Ditën e Livrimin fizik D (Urdhërporositë në Bllok me çmime të njëjta), pranimi i Urdhërporosi Shitjeje dhe Blerjeje në Bllok bëhet nga zgjidhja e algoritmit të Tregut të Ditës në Avancë bazuar në kohën kur këto janë vendosur në ETSS.
- B.2.1.9 Në rastin kur për një Njësi Kohore Tregu më shumë se një segment i një Urdhërporosive Shitjeje e Thjeshtë ka çmim të barabartë me Çmimin Klerues të Tregut, për pranimin e Urdhërporosive aplikohet një metodologji e përcaktuar me vendim nga Autoriteti Rregullator përkatës me propozimin e ALPEX-it.
- B.2.1.10 Në rastin kur për një Njësi Kohore Tregu më shumë se një segment i një Urdhërporosi Blerjeje e Thjeshtë ka çmim të barabartë me Çmimin Klerues të Tregut, për pranimin e Urdhërporosive aplikohet një metodologji e përcaktuar me vendim nga Autoriteti Rregullator përkatës me propozimin e ALPEX-it.
- B.2.1.11 Kur aplikohen rregullat e pranimi për Urdhërporosi e Thjeshtë Shitjeje dhe Blerjeje, Çmimi Klerues i Tregut mund të jetë më presje dhjetore si rezultat i Algoritmit të Përputhjes së Çmimit.

B.2.2 Rregullat për Përputhjen e Urdhërporosive

- B.2.2.1 Algoritmi përcakton Çmimin e Ankandit, sasi të Përputhura të grupuara dhe Pozicionet Neto për çdo Zonë Ofertimi në Bashkimin e Tregjeve.
- B.2.2.2 Në përcaktimin e rezultateve të përshkruara në paragrafin B.2.2.1 duhet të përmbushen parimet e mëposhtme për një rajon të Bashkimin e Tregjeve:

- (a) Çmimi i Bashkimit të Tregjeve në anën e importit të një interkonektori do të jetë më i lartë ose i barabartë me çmimin e Bashkimit të Tregjeve në anën e eksportit të interkonektorit; dhe
- (b) kur eksporti ose importi është më i vogël se Kapaciteti Ndërkufitar i caktuar nga ose në emër të OST-ve përkatëse, çmimi i Bashkimit të Tregjeve në anën e importit të një interkonektori do të jetë i barabartë me çmimin e Bashkimit të Tregjeve në anën e eksportit të interkonektorit pa humbjet.

B.2.2.3 ETSS-ja duhet të:

- (a) së pari, të llogarisë sasi të blera dhe të shitura nga Anëtarët e Bursës për çdo Portofol më interpolim linear me çmimin jo të rrumbullakosur të përcaktuar nga Algoritmi;
- (b) Pastaj, rrumbullakos:
 - (i) çmimi në dy (2) presje dhjetore; dhe
 - (ii) sasi të blera dhe të shitura nga Anëtarët e Bursës për çdo Njësi Kohore Tregu që është më afër 0.01 MW; dhe
- (c) më pas, në rast se funksionimi i këtyre rregullave të rrumbullakosjes ka në një diferencë midis sasive të blera dhe sasive të shitura, sasi të mbetura rishpërndahen tek ata Anëtarë të Bursës, sasi të shitjes ose blerjes së të cilëve janë rrumbullakosur kështu, me alokime të njëpasnjëshme prej 0,01 MW.

B.2.3 **Ankandi i Dytë për operimin e Bashkimit të Tregjeve dhe jo të bashkuar të tyre.**

B.2.3.1 Procedura për një Ankand të Dytë mundësohet nga ALPEX-i në rastet kur Çmimi Klerues i Tregut që vjen si pasojë e zgjidhjes nëpërmjet Algoritmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë, është e barabartë me ose kalon Kufirin Minimal dhe Maksimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë të përcaktuar për Ankandin e Dytë për një ose më shumë Njësi Kohore Tregu për një ose më shumë Zona Ofertimi.

B.2.3.2 Gjatë kryerjes së një Ankandi të dytë, ALPEX-i do të njoftojë Anëtarët e Bursës dhe rihapë Librin e Urdhërporosive për një periudhë të shkurtër kohe. Njoftimi i Anëtarëve të Bursës do të specifikojë:

- (a) Kohën kur do të rihapet Libri i Urdhërporosisë; dhe
- (b) Zonën e Ofertimit dhe Njësinë Kohore të Tregut që do të preket.

B.2.3.3 Rihapja e Librit të Urdhërporosive Lokale i jep mundësi Anëtarëve të Bursës të kenë mundësi të ndryshojnë ofertat e tyre për të përmirësuar rezultatin e zgjidhjes së Algoritmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme :

- (a) për Njësinë Kohore të Tregut për të cilat:
 - (i) Ankandi mund të rezultojë në një Çmim Ankandi, që është i barabartë ose më i lartë se Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit: Anëtarët e Bursës mund ti ndryshojnë Urdhërporositë në mënyrë që të shtojnë volumin e shitjeve, të pakësojnë volumin e blerjeve ose të ulin çmimet; ose

- (ii) Ankandi mund të rezultojë në një Çmim Ankandi që është i barabartë ose më i ulët se Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit: Anëtarët e Bursës mund ti ndryshojnë Urdhërporositë në mënyrë që të shtojnë volumin e shitjeve, të pakësojnë volumin e blerjeve ose të rrisin çmimet; ose
 - (b) për Njësi Kohore të Tregut: një Anëtar i Bursës mund ti ndryshojë Urdhërporositë vetëm nëse në të njëjtën kohë ndryshon Urdhërporositë për Njësitë Kohore të Tregut të përmendura në paragrafin (a).
- B.2.3.4 Një referencë për ndryshimin e Urdhërporosive në paragrafin B.2.3.3 përfshin anulimin e Urdhërporosive ekzistuese dhe dorëzimin e Urdhërporosive të reja.
- B.2.3.5 Një Ankand i Dytë sipas këtij seksioni B.2.3 do të kryhet në përputhje me këtë Kapitull B, përveç faktit se:
- (a) paragrafi B.2.3.1 nuk do të zbatohet në rastin e Ankandit të Dytë, do të thotë se nuk mbahet ankand i mëtejshëm në rast se pas Ankandit të Dytë Çmimi i Klerues i Tregut është i barabartë ose është më i lartë se një Kufi Maksimal ose Minimal i Lejuar i Çmimit të paracaktuar për Ankandin e Dytë për një ose më shumë Njësi Kohore Tregu;
 - (b) rezultatet paraprake dhe rezultatet përfundimtare publikohen pas Ankandit të dytë; dhe
 - (c) rezultatet përfundimtare të Ankandit të Dytë do të zëvendësohen me ato të ankandit të anuluar.
- B.2.3.6 ALPEX-i duhet të bëjë një njoftim siç kërkohet në paragrafin B.2.3.2 me anë të një Njoftimi për Tregu të dërguar me mjete elektronike në përputhje me pikën C.3.2 të Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- B.2.3.7 Në rast të operimit të Bashkimit të Tregjeve,
- (a) ALPEX-i do të njoftojë menjëherë Ofruesin e Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve dhe do të refuzojë Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregjeve.
 - (b) ALPEX-i do t'i dërgojë Ofruesit të Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve Librin i Urdhërporosisë Lokale të ndryshuar dhe do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin me sukses të Ankandit të Dytë.
 - (c) Në rast se Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve nuk ka përfunduar Rezultatet e Ankandit të Dytë deri në periudhën e përcaktuar së Ndarjes së Plotë të Tregut ALPEX-i do të operojë në Tregun e Ditës në Avancë në gjendjen e Ndarjes së Plotë të Tregut.
- B.2.4 Procedurat Alternative**
- B.2.4.1 Në rrethanat e parashikuara në Kapitullin E (Procedurat Alternative), procedurat e këtij seksioni B.2 ndryshohen në përputhje me dispozitat e atij Kapitulli.

B.3 ANKANDET E DITËS NË AVANCË - DHËNIA E REZULTATEVE

B.3.1 Rezultatet paraprake – që ju jepen privatisht anëtarëve

B.3.1.1 ALPEX-i do të vendosë në dispozicion të Anëtarëve të Bursës rezultatet e çdo Tregu të Ditës në Avancë në përputhje me paragrafët B.3.1.2 dhe B.3.1.3 dhe duke vepruar kështu, për aq sa është praktikisht e arsyeshme, duhet të jetë në përputhje me orarin në Tabelën A.1 të Shtojcës A.

B.3.1.2 Rezultatet e Tregu të Ditës në Avancë të vendosura në dispozicion për Anëtarin Bursës do të përfshijë çmimin dhe sasinë për çdo Transaksion ku ai është palë.

B.3.1.3 ALPEX-i vendos në dispozicion në ETSS për çdo Anëtar Burse një konfirmim tregtar që përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- (a) çmimin dhe sasinë; dhe
- (b) Urdhërporositë dhe Portofolin të cilit i përket.

B.3.2 Të dhënat e publikuara – për publikun

B.3.2.1 ALPEX-i do të publikojë në ueb-in e tij brenda një ore pas konfirmimit të rezultateve të tregut nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve të paktën informacionin përkatës për çdo Ankand të Ditës në Avancë si më poshtë:

- (a) Çmimi Klerues i Tregut për Njësi Kohore Tregu dhe Zonë Ofertimi;
- (b) Skedulet Import-Eksport për Interkoneksionet e Bashkimit të Tregjeve për Njësi Kohore Tregu;
- (c) Sasi të shitjes dhe blerjes për Njësi Kohore Tregu për çdo Portofol në anonim;

B.3.2.2 ALPEX-i do të publikojë në ueb-in e tij brenda dy orëve për çdo Ankand të Ditës në Avancë të dhënat si më poshtë:

- (a) Kurbat e blerjes dhe shitjes të grupuara dhe anonime, për Njësi Kohore Tregu duke përfshirë Librin e Urdhërporosisë Lokale
- (b) Statistikat për numrin total të Urdhërporosive në Bllok të paraqitura dhe pranuar së bashku me totalin e sasisë së energjisë elektrike të Urdhërporosisë në Bllok të ofruar dhe pranuar për Njësi Kohore Tregu;
- (c) Çdo informacion tjetër që mund të përcaktohet nga vendimet e Autoritetit Rregullator të propozuara nga ALPEX-i.

C. SEGMENTI I TREGUT BRENDA SË NJËJTËS DITË

C.1 ANKANDET BRENDA SË NJËJTËS DITË, PRODUKTET, URDHËRPOROSITË

C.1.1 Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë

C.1.1.1 Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë i referohet segmenteve të tregut Brenda së Njëjtës Ditë ku vendosja e Urdhërporosive Blerjeje dhe Shitjeje ndodh ditën përpara ose në të njëjtën Ditë me Ditën e Livrimit në intervalin kohor nga Koha e Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës. Urdhërporositë e Përputhura krijojnë Transaksion dhe Kontratë me detyrim livrimin fizik për Njësi Kohore Tregu përkatës në Ditën e Livrimit D.

C.1.1.2 LIDA-1, LIDA-2 dhe LIDA-3 zhvillohen si Ankande Lokale Brenda së Njëjtës Ditë.

C.1.1.3 CRIDA-1, CRIDA-2 dhe CRIDA-3 zhvillohen si një Ankand i Tregjeve të Bashkuar Brenda së Njëjtës Ditë që përfshin Zonat e Ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës dhe/ose Zona të tjera Ofertimi.

C.1.2 Orët e Tregtimit

C.1.2.1 Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë funksionon në përputhje me kohën e përcaktuar në Vendimet Teknike të ALPEX-it.

C.1.2.2 ALPEX-i mund të zgjasë Kohën e Mbylljes së Portës së Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë për të mbajtur kushtet e rregullta të tregtimit. Në Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë, Koha e Mbylljes së Portës mund të zgjatet për arsye që lidhen me disponueshmërinë e ETSS-ës, Librin e Urdhërporosisë Lokale, si dhe për arsye që lidhen me Ndarjen e Plotë të Tregjeve (Full Decoupling).

C.1.2.3 ALPEX-i do të informojë Anëtarët e Bursës për arsyet e zgjatjes si dhe veprimet që kanë lidhje me të, që kërkohen të ndërmerren prej tij dhe prej Anëtarëve të Bursës

C.1.3 Përmbajtja e Urdhërporosive në Tregtimin e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë

C.1.3.1 Përmbajtja minimale e një Urdhërporosie të dorëzuar në ETSS nga një Anëtar i Bursës për Tregtimin në Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë është si më poshtë:

- (a) Kodi EIC i Anëtarit të Bursës;
- (b) Kodi i Portofolit, ose karakteristika të tjera unike për të cilën Urdhërporosia është dorëzuar;
- (c) Kodi i EIC i Zonës së Ofertimit;
- (d) Kodi i kontratës së zbatueshme i cili vendos kontratën e tregtueshme specifike brenda Ditës së Livrimit D: Produkte Orare, Produkte 30 minuta, Produkte 15 minuta ose në Blok;
- (e) Lloji i Urdhërporosisë;
- (f) Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje;
- (g) Sasia dhe çmimi i energjisë elektrike;

- (h) Njësi Kohore e Tregut për të cilën Urdhërporositë dorëzohen; dhe
 - (i) Informacione të tjera shtesë kur kërkohet siç janë të përcaktuara nga kërkesat funksionale të ETSS-së.
- C.1.3.2 Çmimi i Urdhërporosive dorëzohet në EUR/MWh me dy (2) presje dhjetore. Sasia e Urdhërporosive dorëzohet në MWh me dy (2) presje dhjetore.
- C.1.4 **Pasqyra përgjithshme e Llojit të Urdhërporosive**
- C.1.4.1 Në çdo Ankand Brenda së Njëjtës Ditë, Anëtarët e Bursës mund të dorëzojnë Urdhërporosi të Thjeshta Shitjeje dhe Blerjeje.
- C.1.4.2 Kushtet dhe parametrat që aplikohen për Urdhërporosi të Thjeshta Shitjeje dhe Blerjeje të vlefshme në Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë kategori të caktuara Produktesh përcaktohen në seksionet C.1.5 dhe në Tabelën A.2 të Shtojcës A të kësaj Procedure.
- C.1.5 **Urdhërporositë e Thjeshta në Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë**
- C.1.5.1 Një Urdhërporosi e Thjeshtë në Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë lidhet me një Njësi Kohore Tregu dhe një Portofol specifik.
- C.1.5.2 Urdhërporositë e Thjeshta përbëhen nga segmente me hapa, të ndara për çdo Njësi Kohore Tregu në Ditën e Livrimit D. Kurba përkatëse është me trend rritës për Urdhërporosi Shitjeje dhe trend zbritës për Urdhërporosi Blerjeje.
- C.1.5.3 Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së Urdhërporosi Shitjeje është i barabartë me Çmimin Minimal të Ankandit të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë për Urdhërporositë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së Urdhërporosi Shitjeje është i barabartë Çmimin Maksimal të Ankandit të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë për Urdhërporositë.
- C.1.5.4 Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së Urdhërporosi Blerjeje është i barabartë me Çmimin Maksimal të Ankandit të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë për Urdhërporositë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së Urdhërporosi Blerjeje është i barabartë me Çmimin Minimal të Ankandit të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë për Urdhërporositë.
- C.1.5.5 Një Urdhërporosi e Thjeshtë përbëhet nga të paktën dy dhe jo më shumë se 50 Çifte Çmim-Sasi ku një **“Çift Çmim-Sasi” (“çift ÇS”)** specifikon një çmim dhe një sasi të energjisë elektrike për shitje ose blerje për një Njësi Kohore Tregu të caktuar.
- C.1.5.6 Çiftet **ÇS** në Urdhërporosinë e Thjeshtë paraqiten nga një funksion i thyer-me hapa (step-wise) i çmimit dhe sasisë së energjisë elektrike për blerje dhe/ose shitje në Njësi Kohore të Tregut përkatës, ose me rritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike ose me zbritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike për çdo hap çmimi sipas paragrafit C.1.5.7.
- C.1.5.7 Çmimet e përcaktuara për Urdhërporosi e Thjeshtë Shitjeje do të rriten në mënyrë monotnike, dhe për Urdhërporosi e Thjeshtë Blerjeje do të zbriten në mënyrë monotnike. Në këtë mënyrë:
- (a) Në rastin e një Urdhërporosi e Thjeshtë Shitjeje për një Njësi Kohore Tregu, lidhur me sasinë dhe çmimin do të zbatohet ky rregull:

- (i) për një sasi, vlera e së cilës është më e madhe se sasia e dhënë më parë, edhe çmimi korespondues duhet të jetë më i lartë ose i barabartë me çmimin e dhënë më parë; dhe
 - (ii) për një sasi, vlera e së cilës është më e vogël se sasia e dhënë më parë, edhe çmimi korespondues duhet të jetë më i ulët ose i barabartë me çmimin e dhënë më parë; dhe
- (b) Në rastin e një Urdhërporosi e Thjeshtë Blerjeje për një Njësi Kohore Tregu, lidhur me sasinë dhe çmimin do të zbatohet ky rregull:
- (i) për një sasi, vlera e së cilës është më e madhe se sasia e dhënë më parë, edhe çmimi korespondues duhet të jetë më i ulët ose i barabartë me çmimin e dhënë më parë; dhe
 - (ii) për një sasi, vlera e së cilës është më e vogël se sasia e dhënë më parë, edhe çmimi korespondues duhet të jetë më i lartë ose i barabartë me çmimin e dhënë më parë.

C.1.6 Operimi i Bashkimit të Tregjeve

- C.1.6.1 Operatori i Bashkimit të Tregjeve është përgjegjës për kryerjen e Funkcionit të Operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funkcioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga Ofruesi i tij i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.
- C.1.6.2 Objektivi i mekanizmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë është maksimizimi i mirëqenies sociale i Zonave të Ofertimit të bashkuara, përkatësisht maksimizimi i shumës totale së tepricave të Urdhërporosive Shitjeje dhe Blerjeje të përfshira në Librin e Urdhërporosive të Grupuar plus të ardhurat nga kongjestioni.
- C.1.6.3 Teprica e Urdhërporosive Shitjeje të pranuar është e barabartë me prodhimin (shumëzimin) e diferencës së Çmimit Klerues Margjinal minus Çmimin e Urdhërporosisë së tyre me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. Teprica e Urdhërporosive Blerjeje të pranuar është e barabartë me prodhimin (shumëzimin) e diferencës së Çmimit të Urdhërporosisë minus Çmimin Klerues Margjinal me sasinë e energjisë elektrike të pranuar.

C.2 ANKANDET BRENDË SË NJËJTËS DITË - PËRPUTHJA DHE PËRPUNIMI I URDHËRPOROSIVE

C.2.1 Përcaktimi i Çmimeve dhe Sasive të Ankandit

- C.2.1.1 Sapo të mbyllet Libri i Urdhërporosive për një Ankand Brenda së Njëjtës Ditë, ALPEX-i do të:
- (a) bëjë anonime Urdhërporositë në Librin e Urdhërporosive për çdo Zonë Ofertimi;
 - (b) krijoj kurbat e ofertës dhe kërkesës të grupuara duke përdorur Urdhërporosi Shitjeje dhe Blerjeje të bëra anonim (Libri i Urdhërporosive Lokale në çdo rast mbetet i paprekur);
 - (c) dorëzoj kurbën e ofertës dhe kërkesës të grupuara tek Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve, së bashku me Kapacitetet Ndërkufitare të aplikueshëm për Interkonektorët.

C.2.1.2 Rregullat e pranimit të një Urdhërporosi e Thjeshtë Shitjeje të paraqitur në një Zonë Ofertimi janë si më poshtë:

- (a) Një segment i Urdhërporosi Shitjeje do të pranohet plotësisht nëse çmimi i tij është më i ulët se Çmimi Klerues i Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatëse të Ditës së Livrimit D.
- (b) Një segment i Urdhërporosi Shitjeje do të pranohet pjesërisht nëse çmimi i tij është i barabartë me Çmimin Klerues të Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatës të Ditës së Livrimit D.
- (c) Një segment i Urdhërporosi Shitjeje nuk do të pranohet nëse çmimi i tij është më i lartë se Çmimi Klerues i Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore e Tregut përkatës të Ditës së Livrimit D.

C.2.1.3 Rregullat e pranimit të një Urdhërporosi e Thjeshtë Blerjeje të dorëzuar në një Zonë Ofertimi janë si më poshtë:

- (a) Një segment i Urdhërporosi Blerjeje do të pranohet plotësisht nëse çmimi i tij është më i lartë se Çmimi Klerues i Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore Tregu përkatës të Ditës së Livrimit D.
- (b) Një segment i Urdhërporosi Blerjeje do të pranohet pjesërisht nëse çmimi i tij është i barabartë me Çmimin Klerues të Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore Tregu përkatës të Ditës së Livrimit D.
- (c) Një segment i Urdhërporosi Blerjeje nuk do të pranohet nëse çmimi i tij është më i ulët se Çmimi Klerues i Tregut të Zonës së Ofertimit për Njësi Kohore Tregu përkatës të Ditës së Livrimit D.

C.2.1.4 Në rastin kur për një Njësi Kohore Tregu më shumë se një segment i një Urdhërporosi e Thjeshtë Shitjeje ka çmim të barabartë me Çmimin Klerues të Tregut, për pranimin e Urdhërporosive aplikohet një metodologji e përcaktuar me vendim nga Autoriteti Rregullator përkatës me propozimin e ALPEX-it.

C.2.1.5 Në rastin kur për një Njësi Kohore Tregu më shumë se një segment i një Urdhërporosie të Thjeshtë Blerjeje ka çmim të barabartë me Çmimin Klerues të Tregut, për pranimin e Urdhërporosive aplikohet një metodologji e përcaktuar me vendim nga Autoriteti Rregullator përkatës me propozimin e ALPEX-it.

C.2.1.6 Kur aplikohen rregullat e pranimit për Urdhërporosi e Thjeshtë Shitjeje dhe Blerjeje, Çmimi Klerues i Tregut do të përdoret me presje dhjetore si rezultat i Algoritmit të Përputhjes së Çmimit.

C.2.2 Rregullat për Përputhjen e Urdhërporosive

C.2.2.1 Algoritmi përcakton Çmimin e Ankandit, volumet e Përputhura të grupuara dhe pozicionet/gjendjet neto për çdo Zonë Ofertimi në Bashkimin e Tregjeve.

C.2.2.2 Në përcaktimin e rezultateve si pas paragrafit C.2.2.1 për një Rajon të Bashkuar, duhet të përmbushen parimet e mëposhtme:

- (a) Çmimi i Bashkimit të Tregjeve në anën e importit të një interkonektori do të jetë më i lartë ose i barabartë me çmimin e Bashkimit të Tregjeve në anën e eksportit të interkonektorit; dhe

- (b) kur eksporti ose importi është më i vogël se Kapaciteti Ndërkufitar i caktuar nga ose në emër të OST-ve përkatëse, çmimi i Bashkimit të Tregjeve në anën e importit të një interkonektori do të jetë i barabartë më çmimin e Bashkimit të Tregjeve.

C.2.2.3 ETSS-ja duhet të:

- (a) së pari, të llogarisë sasi të e blera dhe të shitura nga Anëtarët e Bursës për çdo Portofol më interpolim linear me çmimin jo të rrumbullakosur të përcaktuar nga Algoritmi;
- (b) Pastaj, rrumbullakos:
 - (i) çmimi në dy (2) presje dhjetore; dhe
 - (ii) sasi të e blera dhe të shitura nga Anëtarët e Bursës për çdo Njësi Kohore Tregu që është më afër 0.01 MW; dhe
- (c) më pas, në rast se funksionimi i këtyre rregullave të rrumbullakosjes ka një diferencë midis sasive të blera dhe sasive të shitura, sasi të e mbetura rishpërndahen tek ata Anëtarë të Bursës, sasi të e shitjes ose blerjes së të cilëve janë rrumbullakosur kështu, me alokime të njëpasnjëshme prej 0,01 MW.

C.2.3 **Procedurat Alternative**

C.2.3.1 Në rrethanat e parashikuara në Kapitullin E të këtij dokumenti, procedurat e këtij seksioni C.2 ndryshohen në përputhje me dispozitat e atij Kapitulli.

C.3 ANKANDET BRENDIA SË NJËJTËS DITË - DHËNIA E REZULTATEVE

C.3.1 **Rezultatet paraprake – që ju jepen privatisht anëtarëve**

C.3.1.1 ALPEX-i do të vendosë në dispozicion të Anëtarëve të Bursës rezultatet e çdo Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë në përputhje me paragrafët C.3.1.2 dhe C.3.1.3 dhe duke vepruar për atë që është praktikisht e arsyeshme, duhet të jetë përputhje me orarin në Tabelën A.2 të Shtojcës A.

C.3.1.2 Rezultatet e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë të vendosura në dispozicion për Anëtarin e Bursës do të përfshijë çmimin dhe sasinë për çdo Transaksion ku ai është palë.

C.3.1.3 ALPEX-i vendos në dispozicion në ETSS për çdo Anëtar Burse një konfirmim tregtar që të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- (a) çmimin dhe sasinë; dhe
- (b) Urdhërporositë dhe Portofolin të cilit i përket.

C.3.2 **Të dhënat e publikuara - për publikun**

C.3.2.1 ALPEX-i do të publikojë në ueb-in e tij brenda një ore pas konfirmimit të rezultateve të tregut nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve të paktën informacionin përkatës për çdo Ankand Brenda së Njëjtës Ditë si më poshtë:

- (a) Çmimi Klerues i Tregut për Njësi Kohore Tregu dhe Zonë Ofertimi;

- (b) Skedulet Import-Eksport për Interkoneksionet e Bashkimit të Tregjeve për Njësi Kohore Tregu;
 - (c) Sasitë e shitjes dhe blerjes për Njësi Kohore Tregu për çdo Protokol në anonim;
- C.3.2.2 ALPEX-i do të publikojë në faqen e internetit të tij brenda dy orëve për çdo Ankand Brenda së Njëjtës Ditë të dhënat si më poshtë:
- (a) Kurbat e blerjes dhe shitjes të grupuara dhe anonim, për Njësi Kohore Tregu duke përfshirë Libri i Urdhërporosisë Lokale;
 - (b) Statistikat për numrin total të Urdhërporosive në Bllok të paraqitura dhe pranuar së bashku me totalin e sasisë së energjisë elektrike të Urdhërporosive në Bllok të ofruar dhe pranuar për Njësi Kohore Tregu;
- C.3.2.3 Çdo informacion tjetër që mund të përcaktohet nga vendimet e Autoritetit Rregullator të propozuara nga ALPEX-i.

D. TREGU I VAZHDUESHËM BRENDA SË NJËJTËS DITË

D.1 PASQYRË E PËRGJITHSHME E PRODUKTEVE DHE LLOJET E URDHËRPOROSIVE

D.1.1 Produktet

D.1.1.1 Në Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë, Anëtarët e Bursës mund të dorëzojnë Urdhërporosi mbështetur nga algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm si më poshtë:

- (a) Urdhërporosi e Zakonshme të përshkruara në seksionin D.1.2;
- (b) Urdhërporosi Ajsberg të përshkruara në seksionin D.1.3
- (c) Urdhërporosi Shportë të përshkruara në seksionin D.1.4

D.1.2 Urdhërporositë e Zakonshme në Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë

D.1.2.1 Një Urdhërporosi e Zakonshme (ose Urdhërporosi e kufizuar) në Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë lidhet me një Njësi Kohore Tregu dhe një Portofol të caktuar.

D.1.2.2 Një Urdhërporosi e Zakonshme përfshin Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje për tregtimin e energjisë elektrike në Bllok i caktuar për Përdorues (User-defined Blocks) dhe lidhet me kombinimin e dy ose më shumë, deri në një maksimum për tridhjetë (30) Njësi Kohore Tregu të njëpasnjëshme siç përcaktohet nga Anëtari i Bursës.

D.1.2.3 Urdhërporositë në Bllok për Kontratat i caktuar për Përdorues (User Defined Contracts) kanë të njëjtin çmim dhe sasi për gjitha Njësitë Kohore të Tregut përkatës dhe gjithmonë kanë një kufizim në ekzekutim i cili është kushti **Gjithçka-ose- Asgjë (AON)**.

D.1.2.4 Një Urdhërporosi e Zakonshme kombinon një kufi çmimi (në Euro) dhe një sasi energjie elektrike (një **“çift Çmim Sasi ose “çifti ÇS”**) për shitje ose blerje në një Njësi Kohore Tregu të përcaktuar.

D.1.2.5 Urdhërporositë Blerjeje mund të ekzekutohen me një çmim të përcaktuar ose më të ulët se ai.

D.1.2.6 Urdhërporositë Shitjeje mund të ekzekutohen me një çmim të përcaktuar ose më të lartë se ai.

D.1.2.7 Urdhërporositë e Zakonshme mund të ekzekutohen pjesërisht (një pjesë e sasisë) ose e gjitha (për të gjithë sasinë).

D.1.2.8 Urdhërporositë e Zakonshme mund të dorëzohen me kushte ekzekutimi si më poshtë:

- (a) Kushti Pa Kushte -**None ose NON**;
- (b) Kushti Prano ose Largo - **Fill-Or-Kill ose FOK**;
- (c) Kushti Ekzekutoje menjëherë ose Fshije - **Immediate-or-Cancel ose IOC**;

- (d) Kushti Gjithçka-ose- Asgjë - **All-Or-Nothing ose AON**
- D.1.2.9 Të gjitha Urdhërporositë e Zakonshme mund të dorëzohen me Kushtin e Vlefshëm për Sesionin- **GFS** dhe Kushtin e Vlefshëm Deri në Datën- **GTD**.
- D.1.3 **Urdhërporositë Ajsberg në Tregjet e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë**
- D.1.3.1 Urdhërporositë Ajsberg janë të dukshme për tregun vetëm për një pjesë të sasisë totale të saj, ndërkohë sasia totale qëndron e disponueshme për tregun për tu Përputhur. Pjesa e fshehur e sasisë shfaqet për Përputhje menjëherë sapo kjo pjesë e shfaqur tashmë është ekzekutuar.
- D.1.3.2 Urdhërporositë Ajsberg përfshijnë një sasi të ekzekutueshme të produktit por e cila është vetëm pjesërisht e dukshme për tregun, duke lënë pjesën tjetër të sasisë së fshehur të ndara në pjesë më të vogla. Sasia totale e Urdhërporosisë është ndarë në pjesë më të vogla me vetëm njërin nga këto pjesë të shfaqura në Librin e Urdhërporosive. Të dyja pjesët e dukshme dhe e padukshme të Urdhërporosisë janë të vlefshme për ekzekutimin e mundshëm kundrejt Urdhërporosive që vijnë. Pjesa e dukshme rifreskohet automatikisht nga pjesa e padukshme kur pjesa e dukshme ekzekutohet plotësisht. Rinovimi i pjesës së dukshme konsiderohet si një Urdhërporosi e re me kushtet “ përparësi në kohë”. Sasia e pjesës së dukshme të Urdhërporosisë duhet të jetë më e madhe ose e barabartë me 5 MWh.
- D.1.3.3 Vlera e pjesës së fshehur të Urdhërporosisë Ajsberg mund të ndryshojë nga vlera korresponduese e pjesës së dukshme. Urdhërporositë Ajsberg mund të vendosen me një diferencë të vogël të çmimit maksimal (a peak price delta). Çdo segment i ri i cili bëhet i dukshëm vendoset me një kufi çmimi të ri i cili zvogëlohet nga diferenca maksimale e çmimit (maximum delta price) për Urdhërporosi Blerjeje dhe rritet nga diferenca maksimale e çmimit (maximum delta price) për Urdhërporosi Shitjeje. Diferenca maksimale e çmimit (maximum delta price) mund të përfshihet në diapazonin midis -5€/MWh në zero për Urdhërporosi Blerjeje dhe zero në 5€/MWh për Urdhërporosi Shitjeje.
- D.1.3.4 Një Urdhërporosi Ajsberg mund të vendoset me specifikimin e ekzekutimit “NON”.
- D.1.4 **Urdhërporositë në Shportë**
- D.1.4.1 ETSS-ja mbështet Urdhërporositë e shumëfishta të marra (Urdhërporositë në Shportë) me specifikimet e mëposhtme:
- (a) “Asnjëra (None)”: të gjitha Urdhërporositë trajtohen në mënyrë të pavarur.
 - (b) “Të vlefshme (valid)”: në këtë rast të gjitha Urdhërporositë e grupit duhet të jenë të vlefshme, psh. Asnjëra nuk mund të shkelë kontrollin e vlefshmërisë të Modullit të Librit të Urdhërporosive të Grupuara me qëllim që grupi të pranohet i gjithi. Nëse një Urdhërporosi dështon në kontrollin përkatës, e gjithë lista e Urdhërporosive të dorëzuara refuzohet.
 - (c) “të lidhura (Linked)”: në këtë rast të gjitha Urdhërporositë ekzekutohen plotësisht ose asnjë prej tyre nuk ekzekutohet. Një grup i Urdhërporosive mund të dorëzohen me specifikimin nëse ato përmbajnë vetëm Urdhërporosi me specifikimet e ekzekutimit “Ekzekutoje Menjëherë ose Fshije”. Urdhërporositë

e një grupi urdhrash me vendosjen e specifikimit “Të Lidhura” janë gjithashtu të konsideruara Urdhërporosi Të Lidhura.

D.1.5 **Specifikimet e Ekzekutimit**

D.1.5.1 Kushti, **Pa Kushte (None-NON)**: Një Urdhërporosi e dorëzuar me kufizimin në ekzekutim Pa Kushte (NON), ose ekzekutohet menjëherë ose nëse nuk përputhet menjëherë, Urdhërporosia do të futet në Librin e Urdhërporosive. Ekzekutimet e pjeshme të Urdhërporosive lejohen dhe Urdhërporositë **“Pa Kushte–NON”** mund të ekzekutohen përkundrejt shumë Urdhërporosive të tjera dhe të krijojnë tregtime të shumëfishta.

D.1.5.2 Kushti, **Prano ose Largo - Fill-Or-Kill ose FOK**: Një Urdhërporosi ose tregtohet i plotë në atë moment pasi Urdhërporosia dorëzohet me sasinë e plotë të tij ose fshihet pa u vendosur në Librin e Urdhërporosive. Urdhërporosia FOK mund të përputhet përkundrejt shumë Urdhërporosive të tjera në Libri i Urdhërporosive. Urdhërporosia FOK nuk mund të ketë kufizime në vlefshmëri.

D.1.5.3 Kushti, **Ekzekutoje Menjëherë ose Fshije - Immediate-or-Cancel ose IOC**: Urdhërporosia ose tregtohet (në çdo sasi) në atë moment pasi Urdhërporosia është dorëzuar ose nëse Urdhërporosia nuk përputhet, hiqet pa u vendosur në Librin e Urdhërporosive. Ekzekutimi i pjesshëm lejohet dhe Urdhërporositë IOC mund të ekzekutohen përkundrejt shumë Urdhërporosive të tjera dhe të krijojnë tregtime të shumëfishta. Një Urdhërporosi me kufizim ekzekutimi IOC nuk mund të ketë kufizim në vlefshmëri.

D.1.5.4 Kushti, **Gjithçka ose Asgjë - AON**: Një Urdhërporosi e dorëzuar me kufizim ekzekutimi AON ose ekzekutohet saktësisht përkundrejt një Urdhërporosi tjetër me sasinë e saj të plotë, ose Urdhërporosia do të vendoset në Librin e Urdhërporosive. Ekzekutimi i pjesshëm nuk lejohet. Kufizimet në ekzekutimin AON lejohet vetëm për Urdhërporosi në tregun përdorues i përcaktuar (user-defined market)

D.1.5.5 Një Urdhërporosi mund ti nënshtrohet kufizimeve të vlefshmërisë si më poshtë:

(a) Kushti, **i Vlefshëm Deri në Datën - GTD**:, ku (vetëm nëse anulohet më herët në përputhje operimin e Kushtit FOK ose IOC) Urdhërporosia do të fshihet dhe hiqet nga Libri i Urdhërporosive pas një date dhe ore të caktuar; ose

(b) Kushti, **i Vlefshëm për Sesionin - GFS**:, ku (vetëm nëse anulohet më herët sipas Kushtit FOK ose IOC”), Urdhërporosia do të anulohet dhe hiqet nga Libri i Urdhërporosive në mbyllje të Librit të Urdhërporosive për një Njësi Kohore Tregu për të cilin Urdhërporosia i përket. Urdhërporosi tërhiqet automatikisht nga tregu pasi kalon koha e vlefshme e përcaktuar për sesionin tregtar përkatës.

D.1.6 **Përmbajtja e Urdhërporosive në Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë**

D.1.6.1 Përmbajtja minimale e një Urdhërporosie të dorëzuar në ETSS nga një Anëtar i Bursës për Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë është si më poshtë:

(a) Kodi EIC i Anëtarit të Bursës;

- (b) Kodi i Portofolit, ose të tjera karakteristika unike për të cilën Urdhërporosia është dorëzuar;
 - (c) Kodi i EIC i Zonës së Oferimit;
 - (d) Kodi i kontratës së zbatueshme i cili vendos kontratën e tregtueshme specifike brenda Ditës së Livrimit D: Produkte Orare, Produkte 30 minuta, Produkte 15 minuta ose në Bllok, sipas rastit;
 - (e) Lloji i Urdhërporosisë;
 - (f) Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje;
 - (g) Sasia dhe çmimi i energjisë elektrike;
 - (h) Njësia (të) Kohore e Tregut për të cilën Urdhërporositë dorëzohen;
 - (i) Specifikimet e ekzekutimit të Urdhërporosisë;
 - (j) Specifikimet e vlefshmërisë të Urdhërporosisë: dhe
 - (k) Informacione të tjera shtese kur kërkohet siç janë të përcaktuara nga kërkesat funksionale të ETSS-se.
- D.1.6.2 Çmimet e Urdhërporosive dorëzohen në EUR/MWh me dy (2) presje dhjetore. Sasia e Urdhërporosive dorëzohen në MWh me një (1) presje dhjetore
- D.1.7 Përputhja e Urdhërporosive në Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë**
- D.1.7.1 Parimi i procesit të përputhjes së vazhdueshme është që Urdhërporositë Blerjeje me çmimin më të lartë dhe Urdhërporositë Shitjeje me çmimin më të ulët ekzekutohen të parat.
- D.1.7.2 Zgjidhja e vazhdueshme Brenda së Njëjtës ditë përfshin një Modul Libri i Urdhërporosive të Grupuara -SOB, një Modul të Menaxhimit të Kapaciteteve dhe një Modul Transaksioni Ndërkufitare. Moduli i Urdhërporosive të Grupuara ka të bëjë me menaxhimin e Urdhërporosive të vendosura, dhe përputhjen e Urdhërporosive. Moduli i Menaxhimit të Kapaciteteve menaxhon alokimin e kapaciteteve të transmetimit dhe procesin e menaxhimit.
- D.1.7.3 Urdhërporositë vendosen në ETSS nga Anëtarët e Bursës. Të gjitha Urdhërporositë e vlefshme të vendosura në kohë në ETSS, futen automatikisht në Librin e Urdhërporosive të Grupuara -SOB e Zgjidhjes Brenda së Njëjtës Ditës për të cilën është rënë dakord tashmë. Anëtarët e Bursës nuk kanë të drejtën e aksesit të drejtpërdrejtë në Librin e Urdhërporosive të vetme.
- D.1.7.4 Një Urdhërporosi është përgjithësisht e vlefshme nga momenti i regjistrimit të saj në ETSS derisa të përputhet, anulohet, ndryshohet ose ka skaduar sipas specifikimeve të saj individuale të ekzekutimit.
- D.1.7.5 Përputhja e kontratave kryhet në Modulin e Librit të Urdhërporosive të Grupuara -SOB. Moduli i Librit të Urdhërporosive të Grupuara -SOB mban një Libër të Urdhërporosive të konsoliduar për të gjitha kontratat bazuar në Kufizimet e Alokimit ndërmjet Zonave të Ofertimit. Të gjitha të dhënat hyrëse në lidhje me Urdhërporositë

Shitjeje dhe/ose Blerjeje që vijnë nga ETSS-ja, publikohen në SOB në mënyrë krejtësisht anonime për të siguruar që:

- (a) NEMO-t konkurruese nuk e dinë se cilët Anëtarë të Bursës të lidhur me Sistemin Lokal të Tregtisë së NEMO-s tjetër po bëjnë Urdhërporosi individuale, dhe
- (b) në përgjithësi, konfidencialiteti i Urdhërporosive individuale të Anëtarëve të Bursës është i mbrojtur.

D.1.7.6 Moduli i Menaxhimit të Kapaciteteve ofron në çdo rast informacionin aktual të disponueshmërisë së kapaciteteve në Librin e Urdhërporosive të Grupuar -SOB.

D.1.7.7 Kontratat ekzekutohen në Librin e Urdhërporosive të Grupuar -SOB sipas parimit çmim-kohë- përparësi.

D.1.7.8 Urdhërporositë ekzekutohen me çmimin më të mirë. Urdhërporosia Blerjeje më e mirë ekzekutohet përkundrejt të parës Urdhërporosisë Shitjeje më e mirë. Çmimi më i mirë për Urdhërporositë Blerjeje është çmimi më i lartë, kurse për Urdhërporositë Shitjeje është çmimi më i ulët:

- (a) Çmimi; Urdhërporositë ekzekutohen me çmimin më të mirë. Urdhërporosi Blerjeje më e mirë ekzekutohet përkundrejt të parës Urdhërporosi Shitjeje më të mirë. Çmimi më i mirë për Urdhërporositë Blerjeje është çmimi më i lartë, për Urdhërporositë Shitjeje është çmimi më i ulët.
- (b) Koha: Kur një Urdhërporosi vendoset në Librin e Urdhërporosive të Grupuar -SOB, ajo merr një gjurmë të kohës kur është futur. Kjo gjurmë kohe përdoret për t'u dhënë përparësi Urdhërporosive me të njëjtin çmim. Urdhërporositë me gjurmën e kohës më të hershme dhe me të njëjtin çmim ekzekutohen me përparësi më të lartë se Urdhërporositë me gjurmën e kohës më të vonshme.

D.1.7.9 Algoritmi i Përputhjes së Tregtisë së Vazhdueshme mbështet dy procese të ndryshme përputhjeje: Përputhjen e Zakonshme dhe Përputhjen në Grup. Përputhja e Zakonshme shkaktohet nga vendosja e një Urdhërporosi me një gjurmë të re të kohës. Përputhja në Grup shkaktohet nga rritja e kapaciteteve ndërkufitare.

D.1.7.10 Përputhja e Zakonshme shkaktohet nga futja e një Urdhërporosi me një gjurmë të re të kohës. Një Urdhërporosi me një gjurmë të re të kohës mund të jetë një Urdhërporosi e re, një Urdhërporosi e ndryshuar, një Urdhërporosi e (ri)aktivizuar që ishte joaktive më parë, ose një pjesë e re e një Urdhërporosi Ajsberg. Rregullat e mëposhtme zbatohen për Përputhjen e Zakonshme:

- (a) Përcaktimi i çmimit: Kur përputhen dy Urdhërporosi sipas Përputhjes së Zakonshme, njëra prej këtyre Urdhërporosive duhet të jetë Urdhërporosi me gjurmë të re të kohës dhe tjetra duhet të jetë Urdhërporosi tashmë e pranishme në Librin e Urdhërporosisë të Grupuar. Çmimi më të cilin përputhen dy Urdhërporositë bëhet çmimi i vendosur i tregtimit që është përmbyllur. Dy Urdhërporositë përputhen me çmimin kufi të Urdhërporosisë që ishte tashmë në Librin e Urdhërporosisë të Grupuar. Nëse një Urdhërporosi Blerjeje me një gjurmë të re të kohës përputhet me një Urdhërporosi Shitjeje ekzistuese, çmimi kufi i Urdhërporosisë Shitjeje bëhet çmimi i ekzekutimit të tregtimit. Nëse një Urdhërporosi Shitjeje me një gjurmë të re të kohës përputhet me një

Urdhërporosi Blerjeje ekzistuese, çmimi kufi i Urdhërporosisë Blerjeje bëhet çmimi i ekzekutimit të tregtimit.

- (b) Urdhërporositë Ajsberg në Përputhje të Zakonshme: Në një proces përputhjeje ku një Urdhërporosi e vetme me një gjurmë të re të kohës përputhet me më shumë se një pjesë të një Urdhërporosi Ajsberg që është tashmë në Librin e Urdhërporosive të Grupuar, çmimi përcaktohet gjithmonë nga Urdhërporosi Ajsberg që është tashmë në Librin e Urdhërporosive të Grupuar dhe asnjëherë nga Urdhërporosi me gjurmën e re të kohës, edhe nëse gjurma e kohës e Urdhërporosisë Ajsberg rinovohet gjatë procesit të përputhjes.
- (c) Përputhja me Urdhërporositë e shumëfishta: Nëse një Urdhërporosi me gjurmë të re të kohës mund të ekzekutohet, jo domosdoshmërisht ekzekutohet me një çmim të vetëm (përveç Urdhërporosive me kufizim ekzekutimi AON), por mund të gjenerojë në mënyrë të njëpasnjëshme transaksione të shumta me çmime të ndryshme përkundrejt shumë Urdhërporosive të ndryshme që ishin tashmë në Librin e Urdhërporosive të Grupuar. Sapo Urdhërporosia të jetë ekzekutuar përkundrejt të gjitha Urdhërporosive me një çmim kufi të caktuar, niveli tjetër më i mirë i çmimit bëhet më i miri dhe Urdhërporosia vazhdon të përputhet me Urdhërporositë e dhëna në këtë nivel çmimi. Ky proces vazhdon për sa kohë që Urdhërporosia hyrëse mbetet e ekzekutueshme dhe ka një Urdhërporosi me sasi pozitive. Më pas, Urdhërporosia hiqet nëse sasia e Urdhërporosisë ka arritur në zero ose nëse ka kufizimin e ekzekutimit të IOC. Në të gjitha rastet e tjera, Urdhërporosia futet në Librin e Urdhërporosive të Grupuar me sasinë e mbetur.
- (d) Urdhërporositë e papërputhura: Nëse një Urdhërporosi me një gjurmë të re të kohës nuk mund të ekzekutohet përkundrejt ndonjë Urdhërporosi ekzistues, ai vendoset në Librin e Urdhërporosive të Grupuar, përveç në rastet kur ka kufizim ekzekutimi IOC ose FOK. Nëse ka kufizim ekzekutimit IOC ose FOK, Urdhërporosia hiqet.

D.1.7.11 Përputhja në Grup shkaktohet nga rritja e Kapaciteteve Ndërkufitare. Rritja e Kapacitetit Ndërkufitar mund të çojë në një Libër Urdhërporosish të kryqëzuara. Kjo do të thotë që grupet e Urdhërporosive që nuk ishin të përputhshme më parë për shkak të Kapacitetit të pamjaftueshëm Ndërkufitar bëhen të përputhshme. Për Urdhërporositë që lejojnë përputhje të pjesshme, ky kusht mund të ndodhë vetëm nëse rritet një vlerë fillestare zero (çdo vlerë jo-zero do të ishte përdorur tashmë nga përputhje e pjesshme). Në raste të tilla, përdoret Përputhja në Grup. Përputhja e Zakonshme e Urdhërporosive pezullohet për aq kohë sa zgjat Përputhja në Grup. Për Përputhjen në Grup zbatohen Rregullat e mëposhtme:

- (a) Përcaktimi i çmimit: Të gjitha çiftet që përputhen në të njëjtin raund të Përputhjes në Grup marrin të njëjtin çmim tregtimi. Ky çmim tregtimi është mesatarja aritmetike e kufijve të çmimeve të çiftit të fundit të përputhur në rradhë.
- (b) Urdhërporositë Ajsberg në Përputhjen në Grup: Në Përputhjen në Grup, Urdhërporositë Ajsberg me një delta zero të çmimit maksimal marrin pjesë me sasinë e tyre totale të mbetur. Urdhërporositë Ajsberg me një delta jo-zero të çmimit maksimal marrin pjesë me secilën pjesë në mënyrë individuale. Pasi

pjesa e parë të ekzekutohet plotësisht, pjesa tjetër me një kufi të ri çmimi dhe gjurmë të kohës do të marrë pjesë derisa të gjitha pjesët të ekzekutohen me kujdes ose të mos jetë më i mundur ekzekutimi i mëtejshëm.

- (c) Rendi i kontratës në Përputhjen në Grup: Rritja e kapaciteteve mund të mundësojë përputhjen e menjëhershme të Urdhërporosive për kontrata të shumëfishta dhe për Njësi të ndryshme Kohe Tregu. Të gjitha Urdhërporositë në Librat e Urdhërporosive të prekura do të marrin pjesë në Përputhjen në Grup. Përputhja në Grup kryhet sipas kontratës, për sa kohë që kapaciteti është i disponueshëm.
- D.1.7.12 Urdhërporositë ekzekutohen plotësisht ose pjesërisht, me një fazë ose më shumë faza sipas specifikave të ekzekutimit të tyre.
- D.1.7.13 Kur një Urdhërporosi përputhet në një tregtim, sasia e saj zvogëlohet sipas sasisë së tregtimit. Urdhërporositë me kufizim ekzekutimi FOK ose AON mund të përputhen vetëm me sasinë e plotë të tyre. Urdhërporositë me kufizim ekzekutimi NON ose IOC mund të përputhen edhe pjesërisht.
- D.1.7.14 Ndryshimet në Urdhërporositë e regjistruara, të cilat ndikojnë në çmimin e Urdhërporosisë ose që rrisin sasinë e Urdhërporosisë, konsiderohen si Urdhërporosi të reja (Urdhërporosia fillestare anulohet), por me pasojën që Urdhërporosisë së re do t'i jepet një renditje e re kronologjike në Librin e Urdhërporosive të Grupuar.
- D.1.7.15 Ndryshimet në një Urdhërporosi të regjistruar, që kanë lidhje me zvogëlimin e sasisë, konsiderohen si rregullim i Urdhërporosisë së regjistruar dhe nuk ndikojnë në renditje.
- D.1.7.16 Urdhërporositë e kundërta të të njëjtit Anëtar të Bursës për të njëjtin aset duhet të përputhen.
- D.1.7.17 Nuk ka diskriminim midis Urdhërporosi me njësi-kohe-të vetme të përputhur dhe Urdhërporosi me njësi-kohe-të shumta të përputhur (p.sh Blloku). Këto kërkesa trajtohen të gjitha në bazë të parimit, kush vjen i pari do të shërbehet i pari.

D.2 TREGU I VAZHUESHËM BRENDA SË NJËJTËS DITË - REZULTATET PARAPRAKE

D.2.1 Publikimi i Tregtimeve në Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës ditë

D.2.1.1 ALPEX-i do t'i shfaqë tregtimet në mënyrë anonim në kohë reale për Anëtarët e Bursës nëpërmjet ETSS.

D.2.2 Rezultatet Paraprake – që ju jepen privatisht anëtarëve

D.2.2.1 Rezultatet e Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë të vendosura në dispozicion të një Anëtari të Bursës duhet të përfshijnë:

- (a) çmimin dhe sasinë; dhe
- (b) statusin e Urdhërporosisë dhe Portofolin me të cilën lidhet.

D.2.3 **Të dhënat e publikuara – për publikun**

D.2.3.1 Në lidhje me çdo ditë tregtimi, ALPEX-i do të publikojë në faqen e tij të internetit në lidhje me çdo Ditë Livrimi, të paktën të dhënat në bazë orare për:

- (a) Statistikat për Çmimin dhe volumet e tregtimit për Njësi Kohore Tregu;
- (b) Sasitë e transaksioneve për Zonë Ofertimi për çdo Njësi Kohore Tregu; dhe
- (c) Çdo informacion tjetër që mund të përcaktohet nga vendimet e Autoritetit Rregullator të propozuara nga ALPEX-i.

E. PROCEDURAT ALTERNATIVE

E.1 PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

- E.1.1.1 ALPEX-i mund të aplikojë Procedurën Alternative për segmentin e Tregut të Ankandëve të Ditës në Avancë dhe/ose segmentin e Tregut të Ankandëve Brenda së Njëjtës Ditë nëse ekzistojnë rrethana që nuk do të lejonin operimin e Bashkimit të Tregjeve në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike. Këto rrethana mund të përfshijnë ndërprerjen ose keqfunksionimin e ETSS, mungesën e shkëmbimit të të dhënave që nuk mund të kryhen përmes aplikimeve të proceseve standarde brenda afateve kohore, manipulimit i rezultateve të tregut për Tregun e Ankandit të Ditës në Avancë dhe/ose Tregun e Ankandëve Brenda së Njëjtës Ditë dhe situatave që përbëjnë Forcën Madhore.
- E.1.1.2 ALPEX-i nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë dëm ose humbje të shkaktuar një Anëtarit Burse për shkak të aplikimit të Procedurës Alternative për Ankandet e Ditës në Avancë dhe/ose Brenda së Njëjtës Ditë i cili nuk vjen si rezultat sjelljes së gabuar tij me dashje ose nga neglizhenca e madhe.

E.2 PROCEDURA ALTERNATIVE PËR ANKANDIN E DITËS NË AVANCË

E.2.1 Shkaqet

- E.2.1.1 Në këtë seksion E.2.1.1 Zonat e Ofertimit AL-KS konsiderohen si “ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve ” kur ALPEX-i deklaron ndarjen e Bashkimit të Tregjeve në rrethana që identifikohen në paragrafin E.2.1.2 sipas procedurës së qeverisjes së Bashkimit të Tregjeve të Zonave të Ofertimit AL-KS.
- E.2.1.2 Rrethanat që mund të shkaktojnë fillimin e Procedurës Alternative në këtë rast, të Ankandit të Ditës në Avancë janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme, dhe janë përshkruar në më shumë detaje në seksionin në vijim (të cilat mbizotërojnë mbi tabelën e mëposhtme në rastin e ndonjë mospërputhjeje).

Shkaku	Përshkrimi	Koha e synuar (D-1)
FD 1	Rezultatet e Ankandit të Ditës në Avancë nuk përcaktohen në kohë, ose Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregjeve nuk janë konfirmuar nga ALPEX dhe/ose OST-ja	13:00
FD 2	Dorëzimi me vonesë i Kapacitetit Ndërkufitar	11:00
FD 3	Ndarja e plotë e Bashkimit të Tregjeve njihet paraprakisht si informacion	09:30

E.2.2 FD 1

- E.2.2.1 Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve nuk është i aftë të përcaktojë rezultatet e një procesi të Bashkimit të Tregjeve AL-KS në lidhje me Ankandin e Ditës në Avancë deri në orën 13:00 (CET) në ditën përpara Ditës përkatëse të Livrimit D, ALPEX-i do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për Ditën përkatëse të Livrimit D.

- E.2.2.2 Në rast deklarimi të një ndarje të plotë të Bashkimit të Tregjeve, ALPEX-i do të:
- (a) Njoftojë Anëtarët e Bursës që Bashkimi i Tregjeve AL-KS është në ndarje të plotë;
 - (b) Zhvillimin e një Ankandi të Ditës në Avancë si një Ankand Lokal në përputhje me seksionin E.2.5;
 - (c) Nëse teknikisht është e mundur dhe e arsyeshme, rihap Librin e Urdhërporosisë për Ankandin e Ditës në Avancë për 20 minuta, për t'ju lejuar Anëtarëve të Bursës të ndryshojnë, anulojnë ose dorëzojnë Urdhërporositë.

E.2.2.3 ALPEX-i do të mundësojë rezultatet e Ankandit të Ditës në Avancë të zhvilluara si Ankand Lokal sipas paragrafit E.2.2.2(b) Anëtarëve të Bursës sapo ato të bëhen të disponueshme nga ora 13:25 (CET) në ditën para Ditës përkatëse të Livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në Tabelën A.1 të Shtojcës A.

E.2.3 **FD 2**

E.2.3.1 Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Kapaciteti Ndërkufitar në lidhje me Ankandin e Ditës në Avancë, në përputhje me kohët e synuara të aplikueshme të vendosura në tabelën në paragrafin E.2.1.2, nuk janë dorëzuar tek ALPEX-i, ALPEX-i mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për Ditën përkatëse të Livrimit (D).

E.2.3.2 Në rast deklarimi të një ndarje të plotë të Bashkimit të Tregjeve, ALPEX-i do të:

- (a) Njoftojë Anëtarët e Bursës që Bashkimi i Tregjeve AL-KS është në ndarje të plotë;
- (b) Zhvillojë një Ankand të Ditës në Avancë si një Ankand Lokal në përputhje me seksionin E.2.5;

E.2.4 **FD 3**

E.2.4.1 Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Bursa është prekur nga një ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve në lidhje me Ditën e Livrimit (D), dhe prej orës 09:30 (CET) në ditën përpara Ditës përkatëse të Livrimit (D) ALPEX është i bindur që çështjet teknike që shkaktojnë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve nuk mund të zgjidhen, ALPEX-i mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për Ditën përkatëse të Livrimit (D).

E.2.4.2 Paragrafi E.2.2.2 zbatohet gjithashtu në rastet e ndarjes së plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS të deklaruar sipas paragrafit E.2.4.1.

E.2.4.3 ALPEX-i do të bëjë përpjekjet e arsyeshme për të mundësuar rezultatin e Ankandit të Ditës në Avancë të zhvilluar si Ankand Lokal si rezultat i deklarimit sipas paragrafit E.2.4.1 tek Anëtarët e Bursës në përputhje me afatet e përcaktuara në Tabelën A.1 të Shtojcës A.

E.2.5 **Procedura e Ankandit Lokal**

E.2.5.1 Kur një Ankand i Ditës në Avancë zhvillohet si një Ankand Lokal në përputhje me paragrafin E.2.2.2, do të zbatohet procedura në seksionin B.2, dhe Kapaciteti

Ndërkufitar përkatës nuk merret parasysh nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.

- E.2.5.2 Nëse rezultati i Ankandit të Ditës në Avancë i zhvilluar si Ankand Lokal nuk është në dispozicion deri në orën 13:45 në ditën përpara Ditës përkatëse të Livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë Ankandin dhe do të njoftojë Anëtarët e Bursës.

E.3 PROCEDURA ALTERNATIVE PËR ANKANDIN BRENDIA SË NJËJTËS DITË

E.3.1 Shkaqet

- E.3.1.1 Në këtë seksion E.3 Zonat e Ofertimit AL-KS konsiderohen si “ndarje e plotë të Bashkimit të Tregjeve ” kur ALPEX-i deklaron ndarjen e Bashkimit të Tregjeve në rrethanat që identifikohen në paragrafin E.3.1.2 sipas procedurës së qeverisjes së Bashkimit të Tregjeve të Zonave të Ofertimit AL-KS.

- E.3.1.2 Rrethanat që mund të shkaktojnë fillimin e Procedurës Alternative për rastet CRIDA-1, CRIDA-2 ose CRIDA-3 janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme, dhe janë përshkruar në më shumë detaje në seksionin në vijim (të cilat mbizotërojnë mbi tabelën e mëposhtme në rastin e ndonjë mospërputhjeje).

CRIDA-1

Shkaku	Përshkrimi	Koha e synuar (D-1)
FD 1	Rezultatet e Ankandit të Ditës në Avancë nuk përcaktohen në kohë, ose Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregjeve nuk janë konfirmuar nga ALPEX dhe/ose OST-ja	16:15
FD 2	Dorëzimi me vonësë i Kapacitetit Ndërkufitar	14:45
FD 3	Ndarja e plotë e Bashkimit të Tregjeve njihet paraprakisht si informacion	09:30

CRIDA-2

Shkaku	Përshkrimi	Koha e synuar (D-1)
FD 1	Rezultatet e Ankandit të Ditës në Avancë nuk përcaktohen në kohë, ose Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregjeve nuk janë konfirmuar nga ALPEX dhe/ose OST-ja	23:30
FD 2	Dorëzimi me vonësë i Kapacitetit Ndërkufitar	21:45
FD 3	Ndarja e plotë e Bashkimit të Tregjeve njihet paraprakisht si informacion	09:30

CRIDA-3

Shkaku	Përshkrimi	Koha e synuar (D)
--------	------------	-------------------

FD 1	Rezultatet e Ankandit të Ditës në Avancë nuk përcaktohen në kohë, ose Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregjeve nuk janë konfirmuar nga ALPEX dhe/ose OST-ja	10:45
FD 2	Dorëzimi me vonesë i Kapacitetit Ndërkufitar	09:45
FD 3	Ndarja e plotë e Bashkimit të Tregjeve njihet paraprakisht si informacion	09:30

E.3.2 **FD 1**

E.3.2.1 Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve nuk është i aftë të përcaktojë rezultatet e një procesi të Bashkimit të Tregjeve AL-KS në lidhje me Tregjet përkatëse të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë si më poshtë;

- (a) Për CRIDA-1, deri në orën 16:15 (CET) në ditën përpara Ditës përkatëse të Livrimit (D) , ALPEX-i do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për Ditën përkatëse të Livrimit (D).
- (b) Për CRIDA-2, deri në orën 23:30 (CET) në ditën përpara Ditës përkatëse të Livrimit (D), ALPEX-i do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për Ditën përkatëse të Livrimit (D).
- (c) Për CRIDA-3, deri në orën 10:45 (CET) në Ditën përkatëse të Livrimit (D), ALPEX-i do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për Ditën përkatëse të Livrimit (D).

E.3.2.2 Në rast deklarimi të një ndarje të plotë të Bashkimit të Tregjeve, ALPEX-i do të:

- (a) Njoftojë Anëtarët e Bursës që Bashkimi i Tregjeve AL-KS është në ndarje të plotë;
- (b) Zhvillojë Ankandin përkatës Brenda së Njëjtës Ditë si një Ankand Lokal në përputhje me seksionin E.3.5;
- (c) Nëse teknikisht është e mundur dhe e arsyeshme, rihap Librin e Urdhërporosisë për Tregjet e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë për 10 minuta, për t'ju lejuar Anëtarëve të Bursës të ndryshojnë, anulojnë ose dorëzojnë Urdhërporositë.

E.3.2.3 ALPEX-i do të mundësojë rezultatet e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë të zhvilluara si Ankand Lokal sipas paragrafit E.3.2.2(b) Anëtarëve të Bursës sapo ato të bëhen të disponueshme nga ora **15:30 (CET)** në ditën para Ditës përkatëse të Livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në Tabelën A.2 të Shtojcës A.

E.3.3 **FD 2**

E.3.3.1 Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Kapaciteti Ndërkufitar në lidhje me Ankandin përkatës Brenda së njëjtës Ditë, në përputhje me kohët e synuara të aplikueshme të vendosura në tabelën në paragrafin E.3.1.2, nuk janë dorëzuar tek ALPEX-i, ALPEX-i mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për CRIDA-n përkatëse në Ditën e Livrimit (D).

E.3.3.2 Në rast deklarimi të një ndarje të plotë të Bashkimit të Tregjeve në lidhje me CRIDA-1, CRIDA-2 ose CRIDA-3 , ALPEX-i do të:

- (a) Njoftojë Anëtarët e Bursës që Bashkimi i Tregjeve AL-KS është në ndarje të plotë; dhe
- (b) Zhvillojë një Ankand Brenda së Njëjtës Ditë si një Ankand Lokal duke zbatuar procedurën në seksionin C.2, përvec që Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve do të zbatojë Algoritmin tek Libri i Urdhërporosive në mënyrë të pavarur dhe duke mos marrë parasysh Urdhërporositë e bëra në Zonën tjetër të Ofertimit;

E.3.3.3 ALPEX-i do të mundësojë rezultatet e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë të zhvilluara si Ankand Lokal sipas paragrafit E.3.3.2(b) Anëtarëve të Bursës sapo ato të bëhen të disponueshme nga ora 22:30 (CET) në ditën para Ditës përkatëse të Livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në Tabelën A.2 të Shtojcës A.

(a)

E.3.4 FD 3

E.3.4.1 Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Bursa është prekur nga një ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve në lidhje me Ditën e Livrimit (D), dhe prej orës 09:30 (CET) në Ditën përkatëse të Livrimit (D) dhe ALPEX është i bindur që çështjet teknike që shkaktuan ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve nuk mund të zgjidhen, ALPEX-i mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për Ditën përkatëse të Livrimit (D).

E.3.4.2 Paragrafi E.3.3.2 zbatohet gjithashtu në rastet e ndarjes së plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS të deklaruar sipas paragrafit E.3.4.1.

E.3.4.3 ALPEX-i do të bëjë përpjekjet e arsyeshme për të mundësuar rezultatin e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë të zhvilluar si Ankand Lokal si rezultat i deklarimit sipas paragrafit E.2.4.1 tek Anëtarët e Bursës në përputhje me afatet e përcaktuara në Tabelën A2. Të Shtojcës A.

E.3.5 Procedurat e Ankandit Lokal

E.3.5.1 Kur një Ankand i Brenda së Njëjtës Ditë zhvillohet si një Ankand Lokal në përputhje me paragrafin E.3.2.2, do të zbatohet procedura në seksionin C.2, dhe Kapaciteti Ndërkufitar përkatës nuk merret parasysh nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.

E.3.5.2 Nëse rezultati e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë, që zhvillohet si Ankand Lokale, nuk është në dispozicion deri në orën 13:45 në ditën përpara Ditës përkatëse së Livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë Ankandin dhe do të njoftojë Anëtarët e Bursës.

E.4 TË PËRGJITHSHME

E.4.1 Njoftimet e Tregut

E.4.1.1 ALPEX-i i bën njoftimet siç kërkohet në Kapitullin E me anë të një Njoftimi Tregu të dërguar me e-mail në përputhje me pikën C.3.2 të Rregullave të ALPEX-it.

F. ÇËSHTJE TË TJERA

F.1 KËRKESAT PËR INFORMACION, AUDITIMET DHE INSPEKTIMET

F.1.1 Kërkesat

F.1.1.1 ALPEX-i mund ti kërkojë një Anëtar të Bursës informacionin që ALPEX-i e konsideron të nevojshëm për:

- (a) Promovimin e sigurisë dhe integritetit të Bursës dhe tregtimin në mënyrë të rregullt nga Anëtar i Bursës; ose
- (b) Verifikimin e një Anëtar të Bursës sa i përket:
 - (i) Pajtueshmërisë me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike; ose
 - (ii) Përdorimit siç duhet të aksesit teknik të ofruar nga ALPEX-i për Anëtarin e Bursës.

F.1.1.2 Kërkesa sipas paragrafit F.1.1.1 duhet të jetë me shkrim dhe duhet të specifikojë informacionin e kërkuar dhe periudhën kohore në të cilën Anëtar i Bursës do t'i përgjigjet kërkesës.

F.1.1.3 Anëtar i Bursës duhet të pajtohet me kërkesën e bërë sipas seksionit F.1.

F.2 PROCEDURAT E VENDOSJES SË ÇMIMEVE

F.2.1 Lista e Tarifave të ALPEX-it

F.2.1.1 ALPEX-i vendos tarifa Fikse dhe Variabël (të quajtura “**Lista e Tarifave të ALPEX-it**”) ndaj Anëtarëve të Bursës, për sa i përket funksionimit të Bursës, në përputhje me Listën e Tarifave të ALPEX-it, të miratuara me Vendim të Autoritetit Rregullator.

F.2.1.2 ALPEX-i publikon Listën e Tarifave në faqen e tij të internetit.

F.2.1.3 ALPEX mund ta përditësojë Listën e Tarifave, pas marrjes së miratimit nga Autoritetet Rregullatore.

F.2.2 Pagesa e Tarifave Fikse dhe Tarifave Variabël të ALPEX-it

F.2.2.1 Çdo Anëtar i Bursës paguan Tarifat e ALPEX-it të llogaritura në përputhje me Listën e Tarifave të ALPEX-it.

F.2.2.2 Tarifat do të llogariten në Euro, dhe monedha e shlyerjes do të jetë siç përcaktohet në Listën e Tarifave të ALPEX-it.

F.2.3 Pagesa e Tarifave Variabël të tregtimit, klerimit dhe tarifave të tjera

F.2.3.1 Çdo Anëtar i Bursës pranon se ALPEX-i vendos Tarifat e tregtimit, klerimit dhe tarifave të tjera sipas Kushteve të Klerimit dhe pranon t’ia paguajë ALPEX-it ato tarifa në përputhje me Kushtet e Klerimit.

F.2.4 Faturimi dhe Pagesa e tarifave të ALPEX-it

F.2.4.1 ALPEX-i, duhet të lëshojë fatura për tarifatat e ALPEX-it që paguhen nga Anëtarët e Bursës (së bashku me shumën përkatëse të TVSH-së) jo më vonë se data e përcaktuar në Listën e Tarifave të ALPEX-it.

F.2.4.2 Anëtarët e Bursës duhet ti paguajnë tarifatat e ALPEX-it (së bashku me shumën përkatëse të TVSH-së) të dhëna në faturat e lëshuara në paragrafin F.2.4.1 në datën e përcaktuar në Listën e Tarifave të ALPEX-it.

F.2.5 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

F.2.5.1 Çdo Anëtar i Bursës do të jetë përgjegjës dhe i detyruar të plotësojë të gjitha kërkesat e dhe detyrimet e tij sipas legjislacionit në fuqi për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, përfshirë mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave përkatëse të TVSH-së.

F.2.5.2 Çdo anëtar i Bursës është i detyruar të paguajë plotësisht të gjitha kostot që mund t'i shkaktohen ALPEX-it në lidhje me TVSH-në, detyrimet doganore, kapacitetet ndërkufitare ose të tjera të ngjashme për energjinë elektrike që është tregtuar në cilindo nga Tregjet e ALPEX-it, pasi këto kosto janë përgjegjësi vetëm e Anëtarit në fjalë.

G. PROCEDURAT E AKSESIT TEKNIK

G.1 KONFIGURIMI, LICENCAT DHE MBËSHTETJA

G.1.1 Pronësia intelektuale dhe licencat

G.1.1.1 Kapitulli H i Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike përcakton detyrimet e Anëtarit të Bursës, ku në seksionin H.4 përshkruhet pronësia intelektuale dhe detyrimet e licencës.

G.1.2 Aksesit teknik

G.1.2.1 ALPEX-i do ti mundësojë Anëtarëve të Bursës kërkesat teknike të aksesit në Sistemet e Tregtimit, të cilat, do të japin për të gjitha Sistemet e Tregtimit dhe të gjitha shërbimet e lidhura të mundësuar, në mënyrë specifike:

- (a) Kërkesat minimale të sistemit;
- (b) Kërkesat e rrjetit;
- (c) Procesin që duhet ndjekur për të fituar aksesin në sistem;
- (d) Protokolli i Ndërfaqjes së Programimit të Aplikacionit (API) për hyrjen në Sistemin e Tregtimit; dhe
- (e) Çdo kërkesë tjetër në lidhje me marrjen e aksesit teknik në Sistemet e Tregtimit.

G.1.3 Aksesit në Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)

G.1.3.1 Për aksesin e Anëtarëve të Bursës në ETSS, ALPEX-i do të ndihmojë për t'u siguruar Anëtarëve të saj aplikacione të përshtatshme dhe të besueshme, si dhe që të kenë specifikimet teknike për zhvillimin e sistemeve të veta.

G.1.3.2 ALPEX-i mund t'i lejojë Anëtarët e Bursës të përdorin programe kompjuterike (*software*) të palëve të treta me kusht që të jenë në përputhje me specifikimet teknike të ALPEX-it.

G.1.3.3 Në lidhje me përdorimin e shërbimeve të lidhjes të ofruara nga ALPEX-i, Anëtari i Bursës ka këto detyrime:

- (a) Të marrë me shpenzimet e veta pajisjet e nevojshme teknologjike dhe pajisje të tjera dhe të sigurojë mjedise të përshtatshme për instalimin e tyre, bazuar në specifikimet teknike të përcaktuara nga ALPEX-i.
- (b) Të caktojë personin përgjegjës (personi përgjegjës i IT i Anëtarit të Bursës) i cili do të autorizohet për çdo çështje të lidhjes me shërbimet ALPEX-it dhe ndjekjen e çështjeve që kanë të bëjnë me aksesin e Anëtarit të Bursës.
- (c) Të sigurojë që, në kohën e përcaktuar nga ALPEX-i, (personi përgjegjës i IT i Anëtarit të Bursës do të jetë në gatishmëri në mjediset e Anëtarit të Bursës.
- (d) Të marrë masat e duhura për të parandaluar ose zbuluar aktivitetet që janë të ndaluara në përputhje me specifikimet teknike të ALPEX-it.

- (e) Të mbajë në gjendje të mirë pajisjet teknike dhe programin (*software*) e ofruar nga ALPEX-i, të mos ndërhyjë në to pa lejen paraprake të ALPEX-it dhe të respektojë të drejtat e ALPEX-it ndaj tyre.
- G.1.3.4 ALPEX-i mund të përditësojë herë pas here kërkesat teknike për aksesin dhe duhet të publikojë çdo përditësim.
- G.1.3.5 Anëtarët e Bursës duhet të respektojnë kërkesat teknike të aksesit të publikuara në këtë pikë.

G.2 PROCEDURAT E KOMUNIKIMIT

G.2.1 Udhëzuesi për Publikimin e të Dhënave të ALPEX-it

- G.2.1.1 ALPEX-i duhet të publikojë Udhëzuesin për Publikimin e të Dhënave të ALPEX-it, që mbulon (ndër të tjera):
 - (a) detajet që kërkohen të publikohen sipas pikës B.3.2, C.3.2 dhe D.2; dhe
 - (b) Çdo njoftim dhe publikim tjetër të kërkuar sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- G.2.1.2 Udhëzuesi i Publikimit të të Dhënave të ALPEX-it do të japë të specifikuarat:
 - (a) Natyrën e çdo publikimi të përmendur në paragrafin G.2.1.1(a) dhe G.2.1.1(b);
 - (b) Kohën e këtyre publikimeve;
 - (c) Formatin e këtyre publikimeve; dhe
 - (d) Çdo të dhënë tjetër të rëndësishme për ato publikime.
- G.2.1.3 ALPEX-i mund ta përditësojë Udhëzuesin e Publikimit të të Dhënave të ALPEX-it herë pas here.
- G.2.1.4 ALPEX-i duhet të zbatojë Udhëzuesin e Publikimit të të Dhënave të ALPEX-it të botuar në pikën G.2.1 për atë që ka të bëjë me funksionimin e Bursës.
- G.2.1.5 ALPEX-i do të mirëmbajë Publikimin e të Dhënave të Tregut siç specifikohet në Tabelën A.4 të Shtojcës A.

G.2.2 Regjistrimet zanore

- G.2.2.1 ALPEX-i mund të bëjë regjistrimin zanor të bisedave telefonike midis përfaqësuesve të Anëtarëve të Bursës dhe përfaqësuesve të ALPEX-it (dhe me përfaqësuesit e një nënkontraktori të ALPEX-it) në lidhje me funksionimin e Bursës ose tregtimin në Bursë (në seksionin G.2.2 janë quajtur “**regjistrime operacionale**”).
- G.2.2.2 ALPEX-i duhet të garantojë që regjistrimet operacionale bëhen në përputhje me dispozitat e të gjitha Kërkesave Ligjore në fuqi.

G.3 TREGTIMI NË EMËR TË DIKUJT TJETËR

- G.3.1.1 Kur rrjeti nuk punon ose në rast të ndonjë problemi tjetër teknik ose funksional që pengon një Anëtar të Bursës të bëjë porosi në një Ankand të Ditës në Avancë, ose Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë ose Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë

- , Anëtari i Bursës mund t'i kërkojë ALPEX-it që ta bëjë Urdhërporosinë në emër të tij.
- G.3.1.2 Kur paraqet një kërkesë sipas paragrafit G.3.1.1, Anëtari i Bursës do ta transmetojë Urdhërporosinë, modifikimin ose anulimin (sipas rastit) përmes Mjetit Elektronik të Përcaktuar për këtë qëllim nga ALPEX-i.
- G.3.1.3 ALPEX-i mund ta refuzojë një kërkesë të bërë sipas paragrafit G.3.1.1 nëse ALPEX-i mendon se situata teknike dhe/ose operationale ja bën të pamundur plotësimin e kërkesës.
- G.3.1.4 Kur ALPEX-i nuk e ka refuzuar një kërkesë sipas paragrafit G.3.1.3, ALPEX-i do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta përmbushur kërkesën. Megjithatë, ALPEX-i nuk do të jetë përgjegjës në asnjë rast nëse nuk arrin ta bëjë këtë ose nëse bën ndonjë gabim gjatë plotësimit të kërkesës.
- G.3.1.5 ALPEX-i duhet ta regjistrojë Urdhërporosinë në vijim të paragrafit G.3.1.2 në ETSS sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së Urdhërporosisë dhe në rast se ka disa Urdhërporosi do të përpiqet të regjistrojë Urdhërporositë e marra me të njëjtën renditje me Urdhërporositë që janë marrë nga ALPEX-i.
- G.3.1.6 Urdhërporosi konsiderohet e regjistruar vetëm kur ALPEX-i ua konfirmon regjistrimin e Urdhërporosisë në ETSS Anëtarëve të Bursës përmes Mjetit Elektronik të Përcaktuar. Pas marrjes së këtij konfirmimi, Agjentit Tregtar i Certifikuar përkatës i Anëtarit të Bursës duhet të konfirmojë Urdhërporosinë ashtu siç është në konfirmimin e ALPEX-it për regjistrimin e Urdhërporosisë në ALPEX përmes Mjetit Elektronik të Përcaktuar.
- G.3.1.7 Nëse Anëtari i Bursës nuk e konfirmon Urdhërporosinë në këtë mënyrë brenda 20 minutave para mbylljes së Portës, ALPEX-i ka të drejtën ta fshijë Urdhërporosinë nga ETSS dhe nëse e bën këtë duhet të njoftojë Anëtarin e Bursës. Nëse Anëtari i Bursës e mohon shprehimisht Urdhërporosinë në këtë mënyrë brenda 20 minutave para Kohës së Mbylljes së Portës, ALPEX-i do ta fshijë Urdhërporosinë nga ETSS-ja dhe do të njoftojë Anëtarin e Bursës. Konfirmimi ose mos konfirmimi i vonuar i çdo Anëtari të Bursës mund të merret parasysh vetëm sipas gjykimit të lirë të ALPEX-it. Urdhërporosia bëhet e detyrueshme për Anëtarin e Bursës që në momentin e regjistrimit, pavarësisht momentit të konfirmimit të ALPEX-it ose anëtarit të Bursës.
- G.3.1.8 Anëtarët e Bursës do të jenë përgjegjës për korrektësinë e të gjitha Urdhërporosive të regjistruara me anë të Mjetit Elektronik të Përcaktuar dhe Palët e përjashtojnë përgjegjësinë e ALPEX-it për regjistrimin e Urdhërporosive. Anëtarët e Bursës nuk mund të kërkojnë gabime në regjistrimin e Urdhërporosive të futura nga ALPEX-i nëse një gabim i tillë është evident nga konfirmimi në regjistrimin e Urdhërporosisë dhe Anëtarët e Bursës nuk e kanë refuzuar në mënyrë të qartë këtë regjistrim të Urdhërporosisë në ALPEX më së shumti deri 20 minuta përpara Kohës së Mbylljes së Portës.
- G.3.1.9 ALPEX-i do të bëjë përpjekje të arsyeshme komerciale për të pasur një shërbim efektiv të Mjetit Elektronik të Përcaktuar dhe për të ruajtur vazhdimësinë e aksesit në Mjetin Elektronik të Përcaktuar Mjeti Elektronik i Përcaktuar ofrohet si "e disponueshme" dhe ALPEX-i, në asnjë moment, nuk angazhohet ose nuk jep asnjë

garanci për disponueshmërinë e Mjetit Elektronik të Përcaktuar për asnjë Anëtar të Bursës, për çdo kohë të caktuar.

G.3.1.10 Mjetit Elektronik i Përcaktuar do të mbyllet 20 minuta përpara Kohës së Mbylljes së Portës.

H. ORGANIZIMI I NDËRPRERJEVE

H.1 TË PËRGJITHSHME

- H.1.1.1 Ky Kapitull përcakton disa dispozita kalimtare në lidhje me menaxhimin e zbatimit dhe periudhën kalimtare drejt fillimit të tregtimit në Bursë nga Koha e Përcaktuar.
- H.1.1.2 Ky Kapitull ka prioritet ndaj dispozitave të tjera të kësaj Procedure.
- H.1.1.3 Nëse ndonjë dispozitë sipas këtij Kapitulli është në kundërshtim ose e papajtueshme me një dispozitë tjetër të kësaj Procedure, atëherë dispozita e këtij Kapitull do të ketë përparësi në masën e mospërputhjes ose konfliktit dhe për periudhat kohore të përcaktuara në këtë Kapitull.

H.2 HAPJA E LIBRAVE TË URDHËRPOSOSIVE PËR PERIUDHËN DIREKT PAS KOHËS SË NDËRPRERJES

- H.2.1.1 ALPEX-i do të përcaktojë kohën kur hapen Librat e Urdhërporosive për secilin nga Segmentet e Tregut në lidhje me secilën prej dy (2) Ditëve të Tregtimit pas Kohës së Ndërprerjes.

SHTOJCA A

TABELA A.1: SPECIFIKIMET E PRODUKTEVE TË SEGMENTIT TË TREGUT TË DITËS NË AVANCË

Kontratat për energji elektrike	
Zonat e Ofertimit	<p>Dy zona ofertimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shqipëri (AL) • Kosovë (KS)
Procedura e tregtimit	Ankand ditor
Ditët e Tregtimit	Gjatë gjithë vitit
Koha e Hapjes së Portës	<p>Libri i Urdhërporosive hapet në orën 10.00, tre (3) ditë para Ditës së Livrimit.</p> <p>Urdhërporositë mund të dorëzohen në çdo kohë midis Hapjes dhe Mbylljes së Portës.</p>
Koha e Mbylljes së Portës	Çdo ditë në orën 12:00, një (1) ditë para Ditës së Livrimit
Njësia Kohore e Tregut (MTU 01 deri MTU 24)	<p>Një orë (24 x periudha një orëshe përpara Ditë Tregtimi):</p> <p>MTU 01: koha ndërmjet 00.00 CET dhe 01.00 CET</p> <p>MTU 02: koha ndërmjet 01.00 CET dhe 02.00 CET,</p> <p>Etj.</p> <p>MTU 24: koha ndërmjet 23.00 CET dhe 24.00 CET</p>
Ndryshimi i orës verore	Në ditën e ndryshimit të orës, nga ora dimërore në atë verore, ka 23 Periudha Tregtimi dhe në këtë rast, do të jenë vetëm 23 orë në Tregun e ALPEX-it në mënyrë që ora ndërmjet orës 02:00 dhe 03:00 të anashkalohej atë ditë.
Ndryshimi i orës dimërore	Në ditën e ndryshimit të orës, nga ora verore në atë dimërore, ka 25 Periudha Tregtimi dhe në këtë rast, do të raportohen 25 orë në Tregun e ALPEX-it në mënyrë që ora ndërmjet orës 02:00 dhe 03:00 të trajtohet si dy orë të ndryshme.
Produktet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Urdhërporositë e thjeshta 2. Urdhërporositë në Bllok dhe 3. Urdhërporositë në Bllok që kanë Lidhje më Njëra Tjetrën 4. Grupi Ekskluziv i Urdhërporosive në Bllok

	<p>siç përshkruhet në Kapitullin B janë të disponueshme në Tregun e Ditës së në Avancë.</p> <p>Produktet shtesë të ofruara në DAM i nënshtrohen miratimit nga Autoriteti Rregullator përkatës.</p>
Monedha	Euro (€)
Rezultatet Paraprake (te disponueshme brenda Sistemit të Tregtimit)	<p>Sa më shpejt të jetë e mundur që në orën 12:45 për rezultatet paraprake.</p> <p>Rezultatet paraprake publikohen vetëm për qëllime informacioni. Vetëm rezultatet përfundimtare janë të detyrueshme për Anëtarët e Bursës.</p> <p>Rezultatet përfundimtare do të publikohen sa më shpejt që të jetë e mundur nga ora 13:00 më përjashtim kur ka vonesa për shkak të problemeve teknike ose ndarjes së Bashkimit të Tregjeve.</p>
Çmimi Minimal i Ditës në Avancë	Është një çmim i shprehur në €/MWh në vlerë negative dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator.
Çmimi Maksimal i Tregut Ditës në Avancë	Është një çmim i shprehur në €/MWh në vlerë pozitive dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator.
Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë	Është një çmim i shprehur në vlerë negative dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator.
Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë	Është një çmim i shprehur në vlerë pozitive dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator.
Çmimi i ofertave bëhet deri në	dy (2) njësi mbas presjes dhjetore ose 0.01 Euro/MWh
Volumi i ofertave bëhet deri në	dy (2) njësi mbas presjes dhjetore ose 0.01 MWh
Kufiri Minimal dhe Maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (për Ankandin e Dytë)	Është një çmim i shprehur në vlerë negative dhe pozitive (sipas rastit) dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator.
Urdhërporositë e Thjeshta	
Numri minimal dhe maksimal i çifteve çmim-sasi	Ndërmjet 2 dhe 50, për Urdhërporosi për cdo Njësi Kohore Tregu.
Porosia duhet të përmbajë	<ul style="list-style-type: none"> një çift çmim-sasi më Çmimin Minimal të Ditës në Avancë, dhe

	<ul style="list-style-type: none"> • një çift çmim-sasi më Çmimin Maksimal të Ditës në Avancë <p>pa shkelur kushtet e Kufiri Minimal dhe Maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë, referuar ankandit të parë ose të dytë.</p>
Urdhërporositë Marrëse e Çmimit me Përparësi	
Porosia duhet të përmbajë	<ul style="list-style-type: none"> • një segment në Çmimi Minimal i Ditës në Avancë për rastin e shitjes dhe Çmimi Maksimal i Tregut Ditës në Avancë për rastin e berjes.
Urdhërporositë në Bllok	
Numri minimal dhe maksimal i çifteve çmim-sasi	Ndërmjet 2 dhe 50, për Urdhërporosi për cdo Njës Kohore e Tregut.
Çmim i Urdhërporosisë në Bllok	Çmim të vetëm midis Çmimi Minimal dhe Çmimi Maksimal i tregut Ankandeve.
Urdhërporositë të Lidhura në Bllok	
Urdhërporositë	Përbëhen nga të paktën dy Urdhërporosi individuale në Bllok
Çmimi i Urdhërporosive përmban	Referojuni Urdhërporosive në Bllok

TABELA A.2: SPECIFIKIMET E PRODUKTEVE TË ANKANDEVE BRENDA SË NJËJTËS DITË

Kontratat për energji elektrike	
Zonat e Ofertimit	Dy zona ofertimi: <ul style="list-style-type: none"> • Shqipëri (AL) • Kosovë (KS)
Procedura e tregtimit	Ankand - tre herë në ditë
Ditët e Tregtimit	Gjatë gjithë vitit
Koha e Hapjes të Portës	<p>LIDA 1: Në orën 13:00 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>LIDA 2: Në orën 15:30 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>LIDA 3: Në orën 22:30 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>CRIDA 1: Në orën 13:00 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>CRIDA 2: Në orën 15:30 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>CRIDA 3: Në orën 22:30 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p>
Koha e Mbylljes së Portës	<p>LIDA 1: Në orën 15:00 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>LIDA 2: Në orën 22:00 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>LIDA 3: Në orën 10:00 CET në Ditën e Livrimit</p> <p>CRIDA 1: Në orën 15:00 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>CRIDA 2: Në orën 22:00 CET një ditë përpara Ditës së Livrimit(D).</p> <p>CRIDA 3: Në orën 10:00 CET në Ditën e Livrimit</p>
Lokal	Dy zona ofertimi: <ul style="list-style-type: none"> • Shqipëri (AL) • Kosovë (KS)

<p>Njësia Kohore e Tregut</p>	<ul style="list-style-type: none"> • LIDA 1, 24 periudha x 1 orë • LIDA 2, 24 periudha x 1 orë • LIDA 3, 12 periudha x 1 orë • CRIDA 1, 24 periudha x 1 orë • CRIDA 2, 24 periudha x 1 orë • CRIDA 3, 12 periudha x 1 orë <p>Në ditën e ndryshimit të orës nga ora dimërore në atë verore, ka 23 Njësia Kohore Tregu në CRIDA-1 dhe CRIDA-2 dhe dy (2) orët ndërmjet 02:00 – 03:00 do të anashkaloen.</p> <p>Në ditën e ndryshimit të orës, nga ora verore në atë dimërore, ka 25 Njësia Kohore Tregu në CRIDA-1 dhe CRIDA-2 dhe 2 orët ndërmjet 02:00 – 03:00 do të trajtohen si dy orare të ndryshme.</p>
<p>Produktet</p>	<p>Urdhërporositë e Thjeshta</p>
<p>Monedha</p>	<p>Euro (€)</p>
<p>Rezultatet Paraprake (të disponueshme brenda Sistemit të Tregtimit)</p>	<p><u>Rezultatet Paraprake</u></p> <p>CRIDA1: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 15:30 CET në D-1.</p> <p>CRIDA2: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 22:30 CET në D-1.</p> <p>CRIDA3: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 10:30 CET në D.</p> <p><u>Rezultatet Përfundimtare</u></p> <p>LIDA1: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 15:30 CET në D-1.</p> <p>LIDA2: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 22:30 CET në D-1.</p> <p>LIDA3: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 10:30 CET në D.</p> <p>CRIDA1: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 15:45 CET në D-1.</p> <p>CRIDA2: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 22:45 CET në D-1.</p>

	<p>CRIDA3: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 10:30 CET në D.</p> <p>Rezultatet përfundimtare do të publikohen sa më shpejt që të jetë e mundur sipas afateve të përmendura më sipër më përjashtim kur ka vonesa për shkak të problemeve teknike ose ndarjes së Bashkimit të Tregjeve.</p>
<p>LIDA:</p> <p>Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit të Tregut Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë; Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë</p>	<p>Shprehet në €/MWh dhe është një çmim i shprehur në vlerë pozitive apo negative që përcaktohet me Vendim nga Autoriteti Rregullator.</p>
<p>CRIDA:</p> <p>Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit të Tregut Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë; Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë</p>	<p>Shprehet në €/MWh dhe është një çmim i shprehur në vlerë pozitive apo negative që përcaktohet me Vendim nga Autoriteti Rregullator.</p>
<p>Çmimi i ofertave bëhet deri në</p>	<p>dy (2) njësi mbas presjes dhjetore ose 0.01 Euro/MWh</p>
<p>Volumi i ofertave bëhet deri në</p>	<p>dy (2) njësi mbas presjes dhjetore ose 0.01 MWh</p>
<p>Urdhërporositë e Thjeshta</p>	
<p>Numri minimal dhe maksimal i çifteve çmim-sasi</p>	<p>Ndërmjet 2 dhe 50, për Urdhërporosi për cdo Njësi Kohore Tregu.</p>

TABELA A.3: SPECIFIKIMET E PRODUKTEVE TË TREGUT TË VAZHDESHËM BRENDA SË NJËJTËS DITË

Kontratat për energji elektrike	
Zonat e Ofertimit	Dy zona ofertimi: <ul style="list-style-type: none"> • Shqipëria • Kosova
Procedura e tregtimit	Në mënyrë të vazhdueshme, 24/7
Ditët e Tregtimit	Gjatë gjithë vitit
Koha e Hapjes së Portës	Libri i Urdhërporosive hapet në orën 13:00 CET në D-1 dhe mbulon të gjitha Njësitë Kohore të Tregut të Ditës së Livrimit D.
Koha e Mbylljes së Portës	Një Njësi Kohore Tregu para fillimit të Njësisë së parë së livrimit të energjisë elektrike.
Kohëzgjatja e Njësisë Kohore të Tregut	Në ditën e ndryshimit nga ora verore në atë dimërore, ka 50 Njësisë Kohore të Tregut ne IDM dhe në këtë rast do të ketë dy regjistrime për secilën nga periudhat 01:00-01:30 dhe 01:30-02:00. Në ditën e ndryshimit nga ora dimërore në atë verore, ka 46 Njësi Kohore Tregu dhe në këtë rast periudhat 01:00-01:30 dhe 01:30-02:00 nuk mund të Tregtohen.
Produktet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Urdhërporosi Zakonshme 2. Urdhërporosi Ajsberg 3. Urdhërporosi Shportë përshkruara në Kapitullin D janë të disponueshme në tregun e vazhdueshëm Brenda së Njëjtës ditë.
Monedha	Euro (€)
Rezultatet paraprake	Sa më shpejt që të jetë e mundur pas përputhjes së një Urdhërporosi
Çmimi Minimal i Ankandit të Vazhdueshëm i Brenda së Njëjtës Ditë; Çmimi Maksimal i Ankandit të	Shprehet në €/MWh dhe është një çmim i shprehur në vlerë pozitive apo negative që përcaktohet me Vendim nga Autoriteti Rregullator.

Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë	
Çmimi i ofertave bëhet deri në	dy (2) njësi pas presjes dhjetore ose 0.01 Euro/MWh
Volumi i ofertave bëhet deri në	një (1) njësi pas presjes dhjetore ose 0.1 MWh

Tabela A.6: Detaje mbi Publikimin e të Dhënave të Tregut

ID-ja e	Titulli i raportit	Periodiciteti	Audienca	Zgjidhja	Intervali kohor	Frekuenca	Formati
AK-001	Rezultatet e Tregut të ETSS	Të përditshme	Publiku i Gjerë	Dita në Avancë çdo orë; Brenda së Njëjtës Ditë: çdo orë	Për çdo specifikim të Ankandit	Ditore pas çdo Ankandi brenda një orë nga rezultati përfundimtarë	xlsx
AK-002	Kurbat e ofertës/kërkesës	Të përditshme	Publiku i Gjerë	Dita në Avancë çdo orë; Brenda së Njëjtës Ditë: çdo orë	Për çdo specifikim të Ankandit	Ditore pas çdo Ankandi brenda një orë nga rezultati përfundimtarë për DAM, CRIDA1, CRIDA2 ose CRIDA3 kur bëhen të vlefshme.	xlsx
AK-003	Statusi i pranimet të Urdhërporosive në Bllok	Të përditshme	Publiku i Gjerë	Dita në Avancë çdo orë	Për çdo specifikim të Ankandit	Ditore pas çdo Ankandi brenda një orë nga rezultati përfundimtarë	xlsx

Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike

**PROCEDURA E KLERIMIT DHE
SHLYERJES**

PËRMBAJTJA

A. HYRJE DHE INTERPRETIM	6
A.1 Hyrje	6
A.1.1 Dispozitë	6
A.2 OBJEKTIVAT E PROCEDURËS SË KLERIMIT DHE SHLYERJES	6
A.2.1 Objektivat	6
A.2.2 Vendimet Teknike të ALPEX-it	7
A.3 INTERPRETIMI	7
A.3.1 Interpretim i përgjithshëm	7
B. ÇËSHTJE LIGJORE DHE DREJTIMI	9
B.1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	9
B.1.1 Përgjegjësitë	9
B.1.2 Legjislacioni	10
B.1.3 Juridiksioni	10
B.1.4 Afati	10
B.1.5 Prioriteti	10
C. Anëtarësimi dhe Detyrimi i Palëve	11
C.1 Anëtari i Klerimit	11
C.1.1 E Drejta për tu bërë Anëtarë Klerimi	11
C.1.2 Anëtari Personal i Klerimit	12
C.1.3 Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit	12
C.1.4 Jo-Anëtar i Klerimit	12
C.2 Palët dhe Procesi i Aderimit	13
C.2.1 Dispozita të Përgjithshme	13
C.2.2 Kualifikimi për të qenë Anëtar Klerimi	14
C.2.3 Çështjet financiare	15
C.2.4 Përshtatshmëria organizative e Anëtarëve të Klerimit	15
C.2.5 Kompetenca profesionale	16
C.2.6 Përdoruesit e EMCS-së	17
C.3 Detyrimet e Palëve	17
C.3.1 Të përgjithshme	17
C.3.2 Informacioni për ALPEX-in	19
C.3.3 Detyrimet e Anëtarëve të Klerimit	19
C.3.4 Detyrimet e Anëtarëve të Bursës	20
C.3.5 Detyrimet Specifike të Anëtarëve të Klerimit	20
D. PROCEDURA E KLERIMIT	21
D.1 KLERIMI	21
D.1.1 Rregullat bazë të Klerimit	21

D.2	Llogaritë e Klerimit	21
D.2.1	Parashikime të Përgjithshme	21
D.2.2	Kushtet për hapjen e Llogarive të Klerimit	22
D.2.3	Mbyllja e Llogarisë së Klerimit	23
D.3	PROCEDURA E KLERIMIT	23
D.3.1	Dispozita të Përgjithshme	23
D.3.2	Realizimi i Klerimit	24
D.3.3	Njoftimi i Transaksioneve që do të klerohen	24
D.3.4	Finalizimi i Tregtimit	25
D.3.5	Llogaritja e Pozicioneve Neto	25
D.3.6	Vlerësimi i Garancisë	25
D.3.7	Dispozitat e informacionit dhe verifikimi i të dhënave	25
D.3.8	Komunikimi ndërmjet Palëve	25
E.	FONDI I MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE	27
E.1	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	27
E.1.2	Pjesa Proporcionale	28
E.1.3	Kontributi Fillestar dhe Minimal	28
E.2	Rregullat për llogaritjen e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve dhe Pjesa Proporcionale për Anëtarët e Klerimit	28
E.2.1	Vlera e Pjesës Proporcionale për Anëtarët e Klerimit	28
E.2.2	Vlera Monetare e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve	29
E.2.3	Pagesat që duhen të bëhen për korigjimin e Pjesës Proporcionale	29
E.2.4	Kontributet e jashtëzakonshme	30
E.2.5	Pagesa e vonuar e kontributeve në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve	30
E.2.6	Përdorimi dhe rimbushja e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve	30
E.2.7	Burimet, asetet	31
F.	MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI	32
F.1	MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI	32
F.1.1	Mospërmbushja e Detyrimeve	32
F.2	MENAXHIMI PËR MOSPËRMBUSHJE DETYRIMESH	33
F.2.1	Të drejtat e ALPEX-it	33
F.2.2	Marrja e detyrimeve nga ALPEX-i	35
F.2.3	Netimi përfundimtar	35
F.2.4	Njoftim për Mospërmbushje Detyrimesh	35
F.2.5	Pezullimi	36
F.2.6	Efekti i Urdhrit për Pezullim	37
F.3	PËRFUNDIM VULLNETAR NGA NJËRA PALË	37
F.3.1	Dispozita të përgjithshme	37
F.4	ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE	38
F.4.1	Të përgjithshme	38
F.4.2	Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	39

F.4.3	Procedurat gjyqësore	39
F.5	KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË	39
F.6	MASA KUNDREJT ANËTARËVE TË KLERIMIT	39
F.6.1	Llojet e masave	39
F.6.2	Rrethanat për vendosjen e masave	40
F.6.3	Organet kompetente për vendosjen e masave	42
F.6.4	Shqyrtimi i vendimeve	42
F.6.5	Zbatimi i vendimeve	43
F.6.6	Njoftimi	43
F.6.7	Ngjarja e Forcës Madhore	43
F.6.8	Publikimi i procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes	43
F.6.9	Sekreti	43
F.6.10	Njoftimet e ALPEX-it	44
G.	PROCEDURA E SHLYERJES FINANCIARE	45
G.1	TË PËRGJITHSHME	45
G.1.1	Qëllimi	45
G.1.2	Elementet e Shlyerjes	45
G.1.3	Monedha	45
G.1.4	Veprimtaritë Bankare	46
G.1.5	Banka për Shlyerje	46
G.1.6	Elementet e Veprimtarisë Bankare	46
G.2	LLOGARITË BANKARE PËR SHLYERJE	46
G.2.1	Llogaritë Bankare për Shlyerje	46
G.2.2	Llogaria Bankare e Garancisë në Para	47
G.2.3	Parashikimi i Garancisë në Para	47
G.3	Garancia	48
G.3.2	Format e Garancisë	48
G.3.3	Të drejtat e ALPEX-it mbi Garancinë	49
G.3.4	Shlyerja e Transaksioneve	50
G.3.5	Pamundësia për të kryer Shlyerjen në Para	50
G.3.6	Parimet e përgjithshme të Shlyerjes	51
G.3.7	Klerimi dhe Shlyerja në lidhje me palët në kontratat OTC	51
G.4	Ditë E Shlyerjes	52
G.4.1	Dispozitat e Ditës së Shlyerjes	52
G.4.2	Kalendari i Shlyerjes	52
G.4.3	Faturat, Vetëfaturimet	53
G.5	PARAMETRAT PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT TË KREDITIT	54
G.5.1	Llogaritja e Margjinës	54
G.5.2	Monitorimi i Kufirit të Kreditit	55
G.5.3	Ekzekutimi i Garancisë dhe Hapat për përdorimin e Fondit në Mospërbushje të Detyrimeve	57
G.5.4	Ekzekutimi i Garancisë	58

G.5.5	Tarifa Fikse e Aderimit dhe Tarifa Fikse Vjetore	58
G.5.6	Tarifat e tjera	59
H. DISPOZITA KALIMTARE		60
H.1	TË PËRGJITHSHME	60
H.1.1	Hyrje	60
H.1.2	Kufiri i Kreditit	60
H.1.3	Ndryshimet	60

A. HYRJE DHE INTERPRETIM

A.1 HYRJE

A.1.1 Dispozitë

A.1.1.1 Tregjet e ALPEX-it përfshijnë tregtimin ndërmjet pjesëmarrësve prodhues, tregtarë, konsumatorë, furnizues të energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo entitet tjetër që e parashikon Ligji në Fuqi. Është një kusht i Licencave të ALPEX-it (i referohet Licencës përkatëse të ALPEX-it në Tregun e Shqipërisë dhe rolit si përfitues i disa të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT-i për funksionimin e tregjeve të organizuara të energjisë elektrike të Tregut të Kosovës) që ALPEX-i do të hyjë, duke administruar dhe mbajtur në fuqi në çdo moment një procedurë e cila:

- (a) përcakton kushtet e aktivitetit të klerimit dhe shlyerjes për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike me shumicë në Tregjet e ALPEX-it;
- (b) të lehtësojë arritjen e objektivave të përcaktuara në paragrafin A.2.1.1 më poshtë;

A.1.1.2 Kjo procedurë përcakton rregullat e klerimit dhe shlyerjes për pjesëmarrjen në Tregjet e ALPEX-it.

A.2 OBJEKTIVAT E PROCEDURËS SË KLERIMIT DHE SHLYERJES

A.2.1 Objektivat

A.2.1.1 Qëllimi i kësaj Procedure Klerimi dhe Shlyerje është të ndihmojë në arritjen e objektivave të mëposhtëme:

- (a) të lehtësojë shlyerjen me efikasitet, nga ALPEX-i, të detyrimeve që i ngarkohen nga licencat e veta;
- (b) të lehtësojë funksionimin, administrimin dhe zhvillimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të Tregut të Energjisë Elektrike në mënyrë të sigurt në aspektin financiar;
- (c) të lehtësojë pjesëmarrjen e Anëtarëve të angazhuar në prodhimin, furnizimin, tregtinë dhe konsumin e energjisë elektrike në aktivitetin e tregtimit sipas Tregut të Energjisë Elektrike;
- (d) të nxisin konkurrencën në tregun e shitjes me shumicë të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë;
- (e) të sigurojnë transparencë në funksionimin e Tregjeve të ALPEX-it;
- (f) të sigurojnë që të mos ketë asnjë diskriminim të padrejtë ndërmjet subjekteve që janë Palë në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes;
- (g) të promovojnë interesat afatshkurtra dhe afatgjata të konsumatorëve të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë në lidhje me çmimin, cilësinë, besueshmërinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

- (h) zbatimin e masave shtrënguese dhe bërjen e pagesave për Anëtarët përkatës të Bursës dhe/ose Anëtarëve të Klerimit në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara;
- (i) mbajtja e dokumenteve të transaksioneve; dhe
- (j) mirëmbajtjen dhe përditësimin e kalendarit të Klerimit dhe Shlyerjes

A.2.1.2 Paragrafët A.1.1 deri në A.2.1 të këtij seksioni A.1 janë vetëm për informim dhe, pa paragjykuar të drejtat, detyrat dhe detyrimet e përcaktuara në Licencat dhe legjislacionin e përmendur aty, nuk ka për qëllim në vetvete dhe nuk duhet të interpretohet në mënyrë që të krijojë detyrime ligjore ose të vendosë të drejta dhe detyrime ndërmjet Palëve.

A.2.2 Vendimet Teknike të ALPEX-it

A.2.2.1 Vendimet Teknike të ALPEX-it përcaktojnë në detaje procedurat që duhet të ndiqen nga Palët në kryerjen e detyrimeve dhe funksioneve sipas kësaj Procedure Klerimi dhe Shlyerje.

A.3 INTERPRETIMI

A.3.1 Interpretim i përgjithshëm

A.3.1.1 Në këtë Procedurë Klerimi dhe Shlyerje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe:

- (a) Tabela e Përmbajtjes, indeksi dhe titujt në këtë Procedurë Klerimi dhe Shlyerje janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk janë pjesë e përmbajtjes së kësaj Procedure Klerimi dhe Shlyerje dhe nuk ndikojnë dhe nuk do të ndikojnë në të ardhmen në interpretimin e saj;
- (b) fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas dhe gjinia mashkullore përfshin gjininë femërore dhe asnjëse;
- (c) fjala “përfshij” dhe variantet e saj duhet të interpretohen pa kufizim;
- (d) çdo referencë ndaj çdo legjislacioni, primar ose sekondar, në këtë Procedurë të Klerimit dhe Shlyerjes përfshin çdo interpretim, ndryshim, modifikim, zëvendësim, rifunksionim ose konsolidim ligjor të çdo legjislacioni të tillë dhe çdo rregulloreje ose urdhri të nxjerrë nga Autoriteti Kompetent i bërë nga ai dhe çdo referencë të përgjithshme tek çdo legjislacion i cili përfshin çdo rregullore ose urdhër të Autoritetit Kompetent i bërë nga ai;
- (e) çdo referencë ndaj seksioneve, paragrafëve dhe Vendimeve Teknike të ALPEX-it është referenca ndaj seksioneve, paragrafëve dhe Vendimeve Teknike të ALPEX-it të kësaj Procedure të Klerimit dhe Shlyerjes, të ndryshuar ose modifikuar herë pas here në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure Klerimi dhe Shlyerje;
- (f) çdo referencë ndaj një marrëveshje ose dokumenti tjetër, ose ndonjë akt ose instrument tjetër duhet të interpretohet si një referencë ndaj asaj marrëveshjeje ose dokumenti, akti ose instrumenti tjetër të ndryshuar, modifikuar, plotësuar, zëvendësuar, caktuar ose rinovuar herë pas here në mënyrë të ligjshme;

- (g) çdo referencë që i bëhet një dite të caktuar duhet të interpretohet si referencë për një ditë kalendarike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, dhe çdo referencë që i bëhet një viti të caktuar duhet të interpretohet si referencë për një periudhë prej 12 muajsh;
- (h) çdo referencë që i bëhet një ore të caktuar duhet të interpretohet si CET (Zona Kohore e Evropës Qendrore) ;
- (i) kur ndonjë Pala i vendoset ndonjë detyrim në përputhje me këtë Procedurë të Klerimit dhe Shlyerjes dhe shprehet se kërkohet përmbushja brenda një afati kohor të caktuar, ai detyrim, sipas rastit, do të vazhdojë të jetë i detyrueshëm dhe i zbatueshëm pas këtij afati kohor nëse Pala nuk arrin ta përmbushë detyrimin brenda atij afati kohor (por pa paragjykuar të gjitha të drejtat dhe ndreqjet e mundshme kundrejt atij personi për shkak të dështimit të atij personi për ta përmbushur atë detyrim brenda afatit kohor);
- (j) fjalët dhe frazat me shkronjë të madhe, format e shkurtra, shkurtesat dhe nënshkrimet kanë kuptimin që u jepet në Përkufizimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe;
- (k) Referenca ndaj një "personi ose entiteti" përfshin çdo individ, ortakëri, firmë, shoqëri, korporatë (e krijuar me ligj ose me mënyra të tjera), sipërmarrje të përbashkët, fond, shoqatë, organizatë ose njësi tjetër, pavarësisht nëse ka/kanë ose jo status juridik të veçantë;
- (l) kur kjo Procedurë Klerimi dhe Shlyerje kërkon që të dhënat të publikohen nga ALPEX-i, ato do të vihen në dispozicion të publikut (të cilat, për të shmangur çdo dyshim, do të jenë të disponueshme për të gjithë publikun dhe jo vetëm për Palët);
- (m) kur kjo Procedurë Klerimi dhe Shlyerje kërkon që ALPEX-i të publikojë informacion dhe nuk specifikohet një afat kohor për këtë publikim, atëherë ky informacion publikohet sa më shpejt që të jetë e mundur;
- (n) kur nuk specifikohet asnjë afat kohor për përmbushjen në lidhje me çdo lloj detyrimesh që duhet të ekzekutohet nga një Palë, atëherë ky detyrim do të ekzekutohet brenda një kohë të arsyeshme;

B. ÇËSHTJE LIGJORE DHE DREJTIMI

B.1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

B.1.1 Përgjegjësitë

- B.1.1.1 ALPEX-i është përgjegjës për procesin e Klerimit dhe Shlyerjen e Transaksioneve lidhur me tregtimin e Produkteve në tregjet e ALPEX-it, në rolin e tij si Kundërpalë Qendrore.
- B.1.1.2 Një Anëtar Klerimi është përgjegjës para ALPEX-it për qëllimin e Klerimit si Kundërpalë në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike dhe këtë Procedurë.
- B.1.1.3 Klerimi kryhet nëpërmjet sistemit elektronik (në vijim EMCS) dhe proceseve përkatëse.
- B.1.1.4 Shlyerja e të gjithë Kreditorëve dhe Debitorëve të ALPEX-it që vijnë si rezultat i Pozicionit të Anëtarëve të Bursës nga Transaksionet në Tregjet e ALPEX-it, duke krijuar një Kontratë detyruese për Palët për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike, do të kryhet nëpërmjet Bankës për Shlyerje të përcaktuar nga ALPEX-i.
- B.1.1.5 ALPEX-i do të marrë masat e duhura për parandalimin e problemeve operationale në sistemet që menaxhon dhe do të kërkojë të riparojë sa më shpejt problemet këqfunksionimin dhe dështimet.
- B.1.1.6 Kjo Procedurë për Transaksionet e ndodhura në Tregjet e Ditës në Avancë dhe ato Brenda të Njëjtës Ditë, siç është në fuqi në çdo kohë sipas vendimeve të Autoritetit Rregullator për miratimin e çdo ndryshimi sipas rastit, dhe është detyruese për ALPEX-in, Anëtarët e Bursës, Anëtarët e Klerimit, sistemet dhe organet e pagesës/shlyerjes e të tjera që bashkëpunojnë me ALPEX-in, si dhe të gjithë personat e përfshirë në Transaksionet e kleruara nga ALPEX-i.
- B.1.1.7 Kjo Procedurë është e detyrueshme për personat që nuk janë Anëtarë Klerimi dhe Anëtarë të Bursës në tregjet e ALPEX-it, por janë të lidhur kontraktualisht me ta, siç mund të jenë në cilësinë e Anëtarit të Bordit të Drejtorëve, nëpunësit ose agjentit, Anëtarëve të Klerimit dhe Anëtarëve të Bursës, sipas rastit, se duhet të sigurojnë me mjetet e duhura dhe në përputhje me çdo udhëzim të ALPEX-it, pajtueshmërinë e këtyre personave me dispozitat e Procedurës si dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj.
- B.1.1.8 Personat e përmendur në paragrafët e mësipërm kanë një detyrim më vete që të njohin dhe të respektojnë dispozitat e kësaj Procedurë, megjithëse kjo në asnjë mënyrë nuk i çliron ata nga detyrimet e tjera që rrjedhin nga ligji ose që u vendosen nga organet kompetente apo autoritetet mbikëqyrëse, sipas rastit.
- B.1.1.9 Dispozitat e kësaj Procedure do të interpretohen në mirëbesim, në përputhje me normat më të mira etike të biznesit dhe praktikat e pranuar të tregut, me synimin për të siguruar funksionimin e rregullt dhe në mënyrë të qetë të sistemit elektro-energjitik. Nëse për çfarëdo arsye, ndonjë nga dispozitat e procedurës bëhet e pavlefshme, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë dhe efektin detyrues të dispozitave të tjera të Procedurës.

B.1.1.10 ALPEX-i nuk duhet të diskriminojë pa arsye ndonjë nga Palët në cilindo pozicion sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes në ushtrimin e të drejtave dhe kompetencave të tij dhe në kryerjen e funksioneve dhe detyrimeve të tij.

B.1.1.11 ALPEX-i është i autorizuar nga të gjitha palët për të ushtruar dhe kryer të drejtat, detyrimet dhe funksionet që i janë dhënë sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes sa dhe siç kërkohet nga kjo Procedurë Klerimi dhe Shlyerje dhe në përputhje me të.

B.1.2 **Legjislacioni**

B.1.2.1 Kjo Procedurë Klerimi dhe Shlyerje dhe çdo mosmarrëveshje që lind sipas, nga ose në lidhje me këtë Procedurë të Klerimit dhe Shlyerjes do të interpretohen, shpjegohen dhe drejtohen përkatësisht në përputhje me ligjet e Shqipërisë dhe/ose Kosovës, sipas rastit.

B.1.3 **Juridiksioni**

B.1.3.1 Duke qenë se, në lidhje me Procesin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, u nënshtrohen dispozitave që i referohen Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Palët janë nën juridiksionin përkatës të Gjykatave dhe Legjislacionit të Shqipërisë dhe/ose Kosovës sipas rastit, për të gjitha mosmarrëveshjet që lindin sipas, nga ose në lidhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

B.1.4 **Afati**

B.1.4.1 Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes duhet të fillojë në Ditën e Përcaktuar nga këto Rregulla.

B.1.5 **Prioriteti**

B.1.5.1 Në rast të ndonjë konflikti në lidhje me ndonjë detyrim mes Palëve, sipas çfarëdo Kërkese Ligjore dhe Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, ky konflikt do të zgjidhet duke u dhënë përparësi, sipas renditjes së mëposhtme:

- (a) kërkesave sipas ligjeve në fuqi;
- (b) çdo kërkesë, drejtimi, përcaktimi, vendimi, udhëzimi ose rregulli në fuqi të çdo Autoriteti Kompetent;
- (c) licencës në fuqi;
- (d) Kushtet e Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike;
- (e) kësaj Procedurë Klerimi dhe Shlyerje;
- (f) Vendimet Teknike të ALPEX-it;
- (g) Marrëveshja e Anëtarësimit në Bursë
- (h) Marrëveshja Kuadër për Klerim

C. ANËTARËSIMI DHE DETYRIMI I PALËVE

C.1 Anëtari i Klerimit

C.1.1 E Drejta për tu bërë Anëtarë Klerimi

C.1.1.1 Anëtari i Klerimit mund të jetë Anëtar Personal i Klerimit ose Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit.

C.1.1.2 Një entitet që kërkon të pranohet si Anëtar Klerimi duhet:

- (a) të paguajë Tarifën Fikse të Aderimit
- (b) të paraqesë aplikimin për anëtarësim, në përputhje me kushtet e kësaj Procedure të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- (c) të sigurojë ALPEX-in se i plotëson kërkesat në fuqi të përcaktuara në paragrafin C.1.1 dhe për këtë arsye është i pranueshëm për t'u bërë Anëtar i Klerimit.

C.1.1.3 Kapaciteti i Anëtarit të Klerimit nuk i transferohen apo cedohet një Pale të tretë.

C.1.1.4 Në rast të ndonjë ndryshimi të madh të korporatës, në veçanti në rast bashkimi nëpërmjet përthithjes, që ndikon në funksionimin e një Anëtari Klerimi, zbatohet procedura e mëposhtme:

- (a) nëse transformimi i korporatës rezulton në përthithjen e një Anëtari Klerimi nga një person juridik që nuk është Anëtar Klerimi, personi juridik përthithës duhet të fitojë të njëjtin kapacitet të një Anëtari Klerimi si ky Anëtar Klerimi i përthithur në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure. Personi juridik përthithës merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Anëtarit të Klerimit të përthithur;
- (b) nëse transformimi i korporatës rezulton në përthithjen e një Anëtari Klerimi nga një Anëtar tjetër Klerimi, Anëtari i Klerimit përthithës merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Anëtarit të Klerimit të përthithur. Nëse përthithja përfshin Anëtarë Klerimi me kapacitet të ndryshëm Klerimi, atëherë transformimi i korporatës do të shqyrtohet rast pas rasti nga ALPEX-i duke pasur parasysh dispozitat në fuqi të sektorit energjetik dhe financiar dhe procedurat e parashikuara nga Vendimi Teknik përkatës i ALPEX-it;
- (c) në çdo rast, Anëtari i Klerimit përthithës ose i përthithur, sipas rastit, duhet të njoftojë ALPEX-in përpara transformimit të korporatës në përputhje me dispozitat e Vendimit Teknik përkatës të ALPEX-it. I njëjti Vendim Teknik do të përcaktojë gjithashtu procedurën specifike si dhe të gjitha kushtet teknike dhe detajet e nevojshme të cilave duhet t'u përmbahen Anëtarët e Bursës në rast të transformimit të korporatës.

C.1.1.5 Anëtarët e Klerimit janë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të tyre në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure. Këto përgjegjësi përfshijnë çdo veprim ose mosveprim nga ana e organeve të tyre përfaqësuese, nëpunësve dhe agjentëve, dhe në veçanti personat që përdorin Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS) me qëllim Klerimin e Transaksioneve të Përmbyllura.

C.1.2 Anëtari Personal i Klerimit

- C.1.2.1 Një Anëtar i Bursës mund të pranohet nga ALPEX-i si Anëtar Personal i Klerimit sipas kësaj Procedure.
- C.1.2.2 Anëtari Personal i Klerimit është përgjegjës vetëm për Klerimin e Transaksioneve të tij që kanë krijuar një Kontratë detyruese për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike në Tregjet e ALPEX-it, ndërkohë që nuk kanë të drejtë të kryejnë Klerimin e Transaksioneve të Anëtarëve të tjerë të Bursës.
- C.1.2.3 Si Anëtarë Personal të Klerimit, ata kryejnë Transaksione Klerimi nëpërmjet Llogarive të tyre të Klerimit, ose nëpërmjet një Llogarie tjetër Klerimi e mundësuar nga një Anëtar i Përgjithshëm Klerimi. Në një rast të tillë, Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit lejohet të klerojë Transaksionet e kryera nga Anëtari Personal i Klerimit si Anëtar i Bursës në Tregjet e ALPEX-it në bazë të deklarimeve të seksionit D.3.2.

C.1.3 Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit

- C.1.3.1 ALPEX-i pranon si Anëtarë të Përgjithshëm Klerimi çdo Bankë tregtare të licencuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë dhe/ose e Kosovës përkatësisht në përputhje me këtë Procedurë, me kusht që ata të plotësojnë kushtet e përcaktuara në Vendimin Teknik përkatës të ALPEX-it.
- C.1.3.2 Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit është përgjegjës për Klerimin e Transaksioneve të kryera nga Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it, ashtu siç janë deklaruar që do të klerohen në EMCS nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit në përputhje me seksionin D.3.2.
- C.1.3.3 Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit duhet të ketë burimet e nevojshme financiare shtesë dhe kapacitetin operacional për ta kryer këtë aktivitet. Në këtë kuadër, ai duhet të mbledhë nga Anëtarët e Bursës të kontraktuar prej tij të gjithë informacionin bazë që jepet në lidhje me Klerimin në përputhje me kushtet e kësaj Procedure për të identifikuar, monitoruar dhe menaxhuar ndonjë rrezik të mundshëm. Me Vendim Teknik, ALPEX-i mund të përcaktojë të gjitha kushtet e nevojshme dhe detajet teknike ose procedurale në lidhje me zbatimin e këtij paragrafi.
- C.1.3.4 Sa herë që ALPEX-i do e kërkojë, Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të japë informacion në lidhje me kriteret, planet dhe procedurat që po zbaton për të bërë të mundur që Anëtari Bursës së kontraktuar prej tij të aksesojë Tregjet e ALPEX-it dhe shërbimet e Klerimit. Në çdo rast, përgjegjësia për tu siguruar që Anëtari i Bursës të përmbushë detyrimet në Tregjet e ALPEX-it, bie mbi Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit të lidhur me këtë Anëtar Bursë.

C.1.4 Jo-Anëtar i Klerimit

- C.1.4.1 Anëtari i Bursës në Tregjet e ALPEX-it që është Jo-Anëtar Klerimi nuk ka të drejtë të marr pjesë në Klerimin e Transaksioneve.
- C.1.4.2 Çdo Jo-Anëtar Klerimi, për Klerimin e Transaksioneve të tij, duhet të ketë caktuar të paktën një (1) Anëtar të Përgjithshëm Klerimi në përputhje me kushtet e kësaj Procedure. Në asnjë rast nuk do të pranohet që një Jo-Anëtar Klerimi të caktojë një Anëtar të Përgjithshëm Klerimi që nuk është në përputhje me seksionin D.3.2.

C.2 Palët dhe Procesi i Aderimit

C.2.1 Dispozita të Përgjithshme

- C.2.1.1 Një entitet ligjor mund të bëhet Palë në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes vetëm në përputhje me kushtet e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe Marrëveshjes Kuadër për Klerim.
- C.2.1.2 Çdo entitet ligjor që është Palë në Marrëveshjen Kuadër për Klerim do të jetë Palë në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, në përputhje me Procesin e Aderimit të dhënë më poshtë.
- C.2.1.3 Për t'u bërë Anëtar Klerimi, "Aplikanti" duhet të plotësojë një formular aplikimi duke përdorur formularin standard të dhënë dhe ta dërgojë atë në ALPEX. Ky formular duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i Aplikantit dhe të shoqërohet me dokumentet e nevojshme mbështetëse, siç përcaktohet nga ALPEX-i, dhe për më tepër do të pranohet se krijon një deklaratë serioze nga Aplikanti që ai i plotëson kërkesat për marrjen e kapacitetit të kërkuar. Në formularin e aplikimit specifikohen të gjitha kushtet që Aplikanti duhet të përmbushë për t'u bërë Anëtar Klerimi, kushte sipas të cilave Aplikanti duhet të:
- (a) paguajë Tarifën Fikse të Aderimit; dhe
 - (b) nënshkruajë Marrëveshjen Kuadër për Klerim.
- C.2.1.4 Tarifa Fikse e Aderimit është e pakthyeshme.
- C.2.1.5 Me dorëzimin e aplikimit do të konsiderohet se aplikanti i ka pranuar të gjitha dispozitat e kësaj Procedurë dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, përfshirë të gjitha Vendimet Teknike të nxjerra në zbatim të saj, si dhe të detyrimeve përkatëse në lidhje me kapacitetin e kërkuar.
- C.2.1.6 Me dorëzimin e aplikimit, aplikanti duhet t'i paraqesë ALPEX-it një memorandum, ku përcaktohen procedurat e brendshme organizative për ushtrimin e veprimtarisë së Anëtarit të Klerimit, në mënyrë që të plotësohen kërkesat e kësaj Procedure dhe veçanërisht dispozitat e seksionit C.2.4. Ky memorandum do t'i referohet në mënyrë specifike infrastrukturës dhe kompetencave organizative, operacionale, tekniko-ekonomike, si dhe mekanizmave dhe procedurave për Klerimin dhe Shlyerjen, kontrollin e brendshëm, menaxhimin e riskut, raportimin financiar dhe kontabël, që duhet të ketë Aplikanti për të përmbushur detyrimet e tij të Klerimit.
- C.2.1.7 Nëse aplikimi është për kapacitetin e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, duhet t'i referohemi gjithashtu:
- (a) politikës që duhet të adoptojë Aplikanti, në rastin e një Anëtari të Përgjithshëm Klerimi, për përcaktimin e kriterëve, planeve dhe procedurave që duhet të zbatojë për t'i mundësuar Anëtarit të Bursës të kontraktuar prej tij të aksesojë shërbimet e klerimit;
 - (b) procedurat për ndarjen e llogarive, monitorimin dhe menaxhimin e riskut që do të zbatohen nga aplikanti në lidhje me Pozicionet e Anëtarit të Bursës në tregjet e ALPEX-it, duke përfshirë në veçanti procedurat që kanë të bëjnë me:

- (i) mënyrën se si do të dallohen Pozicionet e Anëtarit të Bursës nga Pozicioni i një Anëtari tjetër të Bursës në Tregjet e ALPEX-it me qëllim përcaktimin e mënyrës se cili prej shërbimeve të Klerimit dhe Shlyerjes do të kryhet;

C.2.1.8 ALPEX-i do të ketë të drejtë të bëjë të ditur dorëzimin e aplikimit dhe të bëjë të njohur identitetin e Aplikantit.

C.2.1.9 ALPEX-i ka të drejtë të kërkojë çdo dokument ose informacion tjetër shtesë ose plotësues që e gjykon të nevojshëm për shqyrtimin e aplikimit ose verifikimin e të dhënave të paraqitura, si dhe paraqitjen përpara tij të përfaqësuesve ose punonjësve të Aplikantit, veçanërisht atyre që synojnë të kryejnë detyrat e Agjentit Klerues të Certifikuar.

C.2.1.10 Për të përcaktuar aftësinë dhe gatishmërinë e Aplikantit, ALPEX-i mund t'i kërkojë që të marrë pjesë në seancat e testimit të Klerimit ose skenarë të tjerë simulues të Tregtimit, Klerimit dhe Shlyerjes.

C.2.1.11 Kur ALPEX-i merr një aplikim nga një Aplikant, duhet që brenda 20 ditëve nga marrja e aplikimit t'i dërgojë Aplikantit një Njoftim duke e informuar Aplikantin për çdo informacion ose sqarim të mëtejshëm që kërkohet në lidhje me aplikimin ose kur aplikimi është i paplotë. ALPEX-i do të japë me detaje së çfarë sqarimi kërkohet ose ku është i paplotë aplikimi.

C.2.1.12 Nëse ALPEX-i nuk sqarohet ose nuk merr informacionin shtesë të kërkuar brenda 10 ditëve pasi aplikanti është informuar nga ALPEX-i për nevojën e një sqarimi të tillë, do të pranohet se Aplikanti e ka tërhequr aplikimin. Aplikanti mund të kërkojë kohë shtesë për të dhënë informacione ose sqarime të mëtejshme dhe ALPEX-i nuk duhet ta refuzojë në mënyrë të paarsyeshme një kërkesë të tillë.

C.2.1.13 Pas marrjes së formularit të aplikimit të plotësuar dhe çdo sqarimi apo informacion shtesë të kërkuar nga ALPEX-i dhe me kusht që Aplikanti të plotësojë kushtet për anëtarësim të specifikuar në formularin e aplikimit, brenda 15 ditëve nga marrja përfundimtare e të gjithë informacionit të kërkuar, ALPEX-i duhet të pajisë Aplikantin me një Marrëveshje Kuadër për Klerim. Aplikanti duhet ta dorëzojë Marrëveshjen Kuadër për Klerim të nënshkruar brenda 30 ditëve.

C.2.1.14 Pas marrjes nga ALPEX-i të Marrëveshjes Kuadër për Klerim të nënshkruar në përputhje me paragrafin C.2.1.13, Aplikanti do të bëhet Palë në datën e specifikuar në Marrëveshjen Kuadër për Klerim, nëse ALPEX-i dhe Aplikanti nuk kanë rënë dakord me shkrim për një datë tjetër.

C.2.1.15 Në bazë të një Vendimi Teknik, ALPEX-i mund të specifikojë më tej procedurën e marrjes së kapacitetit të Anëtarit të Klerimit.

C.2.2 **Kualifikimi për të qenë Anëtar Klerimi**

C.2.2.1 Një entitet ligjor mund të kualifikohet për të marrë kapacitetin e Anëtarit të Klerimit, kur përmbush kërkesat në lidhje me funksionimin e tij në përputhje me dispozitat në fuqi, sipas rastit, si dhe me dispozitat e përcaktuara në këtë Procedurë. Përmbushja e këtyre kërkesave përbën një detyrim të vazhdueshëm dhe të përvokueshëm për

Anëtarin e Klerimit dhe duhet ti përmbushë gjatë gjithë kohës së funksionimit të tij në përputhje me këto kushte.

- C.2.2.2 Që një entitet ligjor të mund të ketë të drejtë të fitojë kapacitetin e Anëtarit Personal të Klerimit, Aplikanti duhet të ketë marrë Njoftimin e Pranimit të përcaktuar në Rregullat e ALPEX-it në mënyrë që të fitojë pozicionin e Anëtarit të Bursës në përputhje me dispozitat e Rregullave të ALPEX-it.
- C.2.2.3 ALPEX-i mund të kufizojë aksesin e një Anëtarit Klerimi në Klerim nëse e konsideron të nevojshme për të kontrolluar riskun e vet, duke zbatuar, aty është e aplikueshme, dispozitat e seksionit F.6.
- C.2.2.4 Anëtarët e Klerimit duhet t'i bëjë të mundur ALPEX-it të gjithë aksesin e nevojshëm në shërbimet e tyre, informacionin dhe të dhënat në lidhje me shërbimet e Klerimit, në mënyrë që ALPEX-i të jetë në gjendje të verifikojë përputhjen e tyre me kushtet dhe kriteret që vendos çdo herë për funksionimin e tyre.
- C.2.2.5 Anëtarët e Klerimit duhet të kenë mjetet e nevojshme financiare, organizative dhe operacionale për të mbikëqyrur dhe monitoruar përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tyre që rrjedhin nga kapaciteti përkatës.
- C.2.2.6 ALPEX-i mund t'ua refuzojë aksesin Anëtarëve të Klerimit që nuk përmbushin kriteret për marrjen e një kapaciteti të tillë në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure, vetëm pasi ta justifikojë siç duhet me shkrim këtë refuzim dhe mbi bazën e një analize gjithëpërfshirëse risku.
- C.2.2.7 ALPEX-i, të paktën një herë në vit, duhet të bëjë një rishikim gjithëpërfshirës të përputhshmërisë së Anëtarëve të Klerimit me kushtet dhe kriteret për pranimin e tyre në përputhje me përcaktimet e dispozitave në fuqi dhe sipas kushteve të kësaj Procedure. Në bazë të Vendimit Teknik të tij, ALPEX-i mund të specifikojë çdo çështje teknike ose procedurale dhe detajet e nevojshme në lidhje me rishikimin e sipërpërmendur. Për të mbajtur kapacitetin e tyre, Anëtarët e Klerimit duhet të respektojnë çdo rekomandim të dhënë nga ALPEX-i në kuadër të rishikimit të sipërpërmendur.

C.2.3 **Çështjet financiare**

- C.2.3.1 Anëtarit Personal i Klerimit duhet të disponojë fonde të veta të paktën 20,000,000.00 Lekë (njëzet milion) ose ekuivalenti 170,000.00 Euro (njëqind e shtatëdhjetë mijë).
- C.2.3.2 Anëtarit i Përgjithshëm i Klerimit duhet të disponojë fonde të veta të paktën 200,000,000.00 Lekë (dyqind milion) ose ekuivalenti 1,700,000.00 Euro (një milion e shtatëqind mijë).

C.2.4 **Përshtatshmëria organizative e Anëtarëve të Klerimit**

- C.2.4.1 Anëtarët e Klerimit duhet të kenë infrastrukturën dhe përshtatshmërinë e duhur organizative, operacionale dhe tekniko-ekonomike, së bashku me mekanizmat e përshtatshëm të kontrollit dhe sigurisë në fushën e përpunimit elektronik të të dhënave dhe kontrollit të brendshëm, në mënyrë që të sigurojnë:
 - (a) monitorimin e vazhdueshëm, menaxhimin dhe përmbushjen si duhet të detyrimeve që ata ndërmarrin në lidhje me Klerimin dhe Shlyerjen në përputhje

me dispozitat në fuqi dhe kushtet e kësaj Procedure, për shembull në lidhje me sigurimin e Margjinës dhe pjesëmarrjen e tyre në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, bërjen e pagesave dhe, në përgjithësi, përmbushjes së detyrimeve të Shlyerjes në para, si dhe monitorimit të Pozicioneve dhe Kufirit të Kreditit të përcaktuara sipas kushteve të kësaj Procedure;

- (b) në rastin e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit:
 - (i) monitorimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshëm të kriterëve, rregullave dhe procedurave që kanë përshtatur për t'i mundësuar Anëtarit të Bursës akses në shërbimet e Klerimit të ofruara nga ALPEX-i;
 - (ii) monitorimin e vazhdueshëm, menaxhimin dhe përmbushjen siç duhet të detyrimeve përkatëse që rrjedhin nga Transaksionet dhe Pozicionet e Anëtarit të Bursës kundrejt Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit dhe nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit kundrejt Anëtarëve të Bursës;
 - (iii) monitorimin dhe menaxhimin e vazhdueshëm të Garancisë së ofruar nga Anëtari i Bursës dhe trajtimin e çdo Mospërbushje Detyrimi;
- (c) respektimin e rreptë të kushteve, detyrimeve dhe procedurave që ata ndërmarrin në bazë të memorandumit të paraqitur në ALPEX në përputhje me dispozitat e tij, si dhe kryerjen e çdo ndryshimi dhe komunikimin e tij me ALPEX-in në rast të ndryshimit të kushteve të tyre të operimit si Anëtarë Klerimi;
- (d) monitorimin, menaxhimin dhe përmbushjen e vazhdueshme të detyrimeve të tyre ndaj autoriteteve kompetente, ALPEX-it dhe të gjitha sistemeve dhe organeve, përfshirë Bankën për Shlyerje, të cilat janë të lidhura me EMCS-në në kuadër të Klerimit dhe Shlyerjes së Transaksioneve.

C.2.4.2 Anëtarët e Klerimit duhet të kenë një politikë të përshtatshme të vazhdimësisë së biznesit dhe një plan rikuperimi që synon mbrojtjen e funksioneve të tyre nga çdo fatkeqësi, duke siguruar rikuperimin në kohë të aktiviteteve dhe përmbushjen e detyrave të tyre si Anëtarë Klerimit në përputhje me dispozitat në fuqi.

C.2.4.3 Për të përmbushur detyrimet e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure, Anëtarët e Klerimit duhet:

- (a) të krijojnë dhe të kenë një shërbim Klerimi, të drejtuar nga Agjentët Klerues të Certifikuar të tyre, si dhe një shërbim të menaxhimit të riskut në përputhje me dispozitat në fuqi;
- (b) të mbajë llogaritë e nevojshme bankare, sipas rastit, në Bankën për Shlyerje në përputhje me procedurat e ALPEX-it.

C.2.4.4 ALPEX-i, në bazë të Vendimit Teknik të tij, mund të specifikojë më tej kërkesat organizative që duhet të plotësohen nga Anëtarët e Klerimit në përputhje me paragrafët e mësipërm.

C.2.5 **Kompetenca profesionale**

C.2.5.1 Çdo Anëtar i Klerimit duhet të caktojë të paktën një (1) Agjent Klerues të Certifikuar për Klerimin e Transaksioneve që ai ndërmerr. Në çdo rast, Anëtari i Klerimit duhet

të ketë një numër të mjaftueshëm Agjentësh Klerues të Certifikuar, duke marrë parasysh gamën e transaksioneve që ai ndërmerr për Klerimin dhe rreziqet e mundshme.

- C.2.5.2 Anëtari i Klerimit duhet të sigurojë praninë e një Agjent Klerues të Certifikuar në shërbimin e tij të Klerimit dhe menaxhimit të riskut për të gjithë kohëzgjatjen e Klerimit, në përputhje me procedurat e planifikuara nga ALPEX-i, dhe të ketë një plan për të zëvendësuar këtë Agjent Klerues të Certifikuar në rast mungesë ose pamundësisë së tij. Një Agjent Klerues i Certifikuar mund të zëvendësohet vetëm nga një person që ka kapacitetin përkatës.
- C.2.5.3 Për të kryer detyrat e Agjentit Klerues të Certifikuar, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e kompetencës profesionale të përcaktuara nga ALPEX-i në bazë të Vendimit Teknik të tij. Këto kërkesa do të konsiderohen të përmbushura kur, në përputhje me procedurat e ALPEX-it, verifikohet së kandidati ka njohuri të mjaftueshme për rregullat dhe procedurat teknike që rregullojnë funksionimin e EMCS-së dhe tregjeve të ALPEX-it.
- C.2.5.4 Anëtarët e Klerimit duhet të deklarojnë në ALPEX të dhënat e Agjenteve Klerues të Certifikuar që emërojnë, si dhe çdo ndryshim të këtyre të dhënave. Në lidhje me detyrat e Klerimit që kryejnë në kuadër të detyrave të tyre, Agjentët Klerues të Certifikuar të emëruar duhet t'i japin ALPEX-it të gjitha të dhënat dhe informacionin menjëherë sapo kërkohet.

C.2.6 Përdoruesit e EMCS-së

- C.2.6.1 Vetëm Agjentët Klerues të Certifikuar të autorizuar në mënyrën e duhur nga Anëtarët e Klerimit dhe përdoruesit e autorizuar të Anëtarit të Bursës në tregjet e ALPEX-it, kur është rasti, në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure, mund të jenë përdorues të EMCS-së për Klerimin e Transaksioneve. Anëtarët e Klerimit dhe Anëtari i Bursës në tregjet e ALPEX-it duhet t'i komunikojnë ALPEX-it të dhënat e përdoruesve të tyre dhe çdo detaj tjetër përkatës të parashikuar nga procedurat e ALPEX-it, si dhe çdo ndryshim në këto të dhëna dhe detaje.
- C.2.6.2 Anëtarët e Klerimit duhet të kenë procedura specifike të kontrollit të brendshëm për monitorimin e detyrave të kryera nga përdoruesit e EMCS-së. Ata gjithashtu duhet të vënë në dispozicion të ALPEX-it procedurat e mësipërme dhe të respektojnë çdo udhëzim nga ALPEX-i në lidhje me respektimin e procedurave përkatëse.
- C.2.6.3 Anëtarët e Klerimit duhet të sigurohen që përdoruesit e tyre të operojnë siç duhet sistemet e informacionit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe me këtë Procedure, dhe duhet të jenë përgjegjës ndaj ALPEX-it për çdo humbje që rezulton nga një veprim ose mosveprim nga ana e këtyre përdoruesve.

C.3 DETYRIMET E PALËVE

C.3.1 Të përgjithshme

- C.3.1.1 Secila palë do të respektojë Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes dhe Marrëveshjen Kuadër për Klerim në ushtrimin e të drejtave dhe kompetencave të tij për kryerjen e funksioneve dhe detyrimeve të tij sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

- C.3.1.2 Pa paragjykuar në përgjithësi paragrafin C.3.1.1, asnjë Palë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, vetë ose në bashkëpunim me ndonjë Palë ose person tjetër, nuk duhet të pengojë funksionimin si duhet të Bursës sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- C.3.1.3 Pa paragjykuar ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Procedure të Klerimit dhe Shlyerjes ose Marrëveshjes Kuadër për Klerim, secila Palë:
- (a) do të ushtrojë të gjitha të drejtat, funksionet dhe detyrimet e saj sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes duke treguar shkallën e duhur të kujdesit dhe të standardeve,
 - (b) do të jetë në përputhje, do të mbajë dhe do të sigurojë në çdo kohë pajtueshmërinë dhe mirëmbajtjen e të gjitha miratimeve, lejeve dhe Licencave (dhe kushteve që i bashkëngjiten çdo përjashtimi), që duhet të merren dhe mbahen për të marrë pjesë në Tregjet e ALPEX-it ose të jetë Palë në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes për çdo kapacitet në të cilën vepron si palë ose Anëtar i Klerimit sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes;
 - (c) do të paguajë të gjitha kuotat, taksat, tarifrat dhe pagesat e tjera që rrjedhin nga Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes në momentin që bëhen të pagueshme;
 - (d) do të sigurojë që çdo informacion ose e dhënë që kërkohet t'i dorëzohet ALPEX-it, Audituesve ose çdo personi, që kërkohet për shkak të të qenit Palë ose Anëtar Bursë do të dorëzohet në kohën e duhur për t'i mundësuar ALPEX-it, Audituesve ose një personi tjetër të kryejë detyrimet dhe funksionet e tyre që lindin në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes; dhe
 - (e) do të bashkëpunojë dhe t'i ofrojë çdo ndihmë të arsyeshme ALPEX-it në rast se i kërkohet, me qëllim që ALPEX-i të kryejë funksionet dhe detyrimet e tij sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- C.3.1.4 Transaksionet kryhen në tregjet e ALPEX-it me pjesëmarrjen e Anëtarëve të Bursës si palë në to, në përputhje me Procedurën e Tregtimit.
- C.3.1.5 Çdo Anëtar i Bursës, në përputhje me kushtet specifike të kësaj Procedure, në Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje që vendos në ETSS me qëllim realizimin e një Transaksioni, duhet të deklarojë Anëtarin e Klerimit që do të jetë përgjegjës ndaj ALPEX-it për Klerimin e Transaksionit përkatës dhe Llogarinë përkatëse të Klerimit.
- C.3.1.6 Pas përfundimit të tij, Transaksioni rinovohet për qëllime Klerimi si më poshtë:
- (a) ALPEX-i konsideron se, në përfundim të Transaksionit, ka pranuar detyrimet në para dhe pretendimet përkatëse që rrjedhin nga Urdhërporosi të Përputhura që formojnë Transaksionin;
 - (b) në mënyrë të ngjashme, Anëtari i Klerimit i deklaruar në bazë të çdo Urdhërporosi përputhjeje zëvendëson Anëtarin e Bursës që ka vendosur këtë Urdhërporosi dhe bëhet përgjegjës ndaj ALPEX-it si Kundërpalë e tij për Klerimin e detyrimeve përkatëse monetare që ka marrë përsipër.
- C.3.1.7 Çdo pavlefshmëri, anullim ose defekt tjetër në Urdhërporositë ose udhëzimet që formojnë bazën për realizimin e Transaksionit dhe nuk do të ndikojnë vlefshmërinë e këtij të fundit.

C.3.2 Informacioni për ALPEX-in

- C.3.2.1 Anëtarët e Klerimit do t'i japin ALPEX-it të gjitha të dhënat dhe informacionin në lidhje me detyrat e Klerimit që kryejnë dhe rreziqet e mundshme që ekzistojnë, sa herë që ALPEX-i e kërkon këtë.
- C.3.2.2 Anëtarët e Klerimit, në momentin e paraqitjes së të dhënave që kontrollohen nga Autoritetet Kompetente në përputhje me rregullat që rregullojnë funksionimin e tyre, duhet t'i komunikojnë ALPEX-it, në mënyrë të veçantë si më poshtë:
- (a) pasqyrat financiare vjetore dhe/ose gjashtëmujore, të audituara dhe të nënshkruara nga auditorë të certifikuar;
 - (b) informacion mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të tyre, fondet e veta, raportin e aftësisë paguese ose ekspozimet e mëdha, si dhe pasqyrat financiare përkatëse për periudhën raportuese në fjalë.
- C.3.2.3 Anëtarët e Klerimit duhet të njoftojnë menjëherë ALPEX-in për çdo ndryshim që ndikon në informacioni i cili është konsideruar nga ALPEX-i për miratimin e tyre si Anëtar Klerimi. Ata gjithashtu duhet të njoftojnë ALPEX-in për çdo çështje që mund të rrezikojë pjesëmarrjen e tyre të rregullt në Klerim. Çështje të tilla përfshijnë - por nuk kufizohen vetëm në - mospërbushjen e detyrimeve të një Anëtari të Bursës ndaj Anëtarit të Klerimit, të dhënat se Anëtari i Bursës përkohësisht nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij, ose ngjarjet që ndikojnë në funksionimin e Anëtarit të Klerimit, si p.sh. vendimi për të marrë pjesë në një bashkim, shkrirje ose blerje të biznesit të tij ose vendosjen e gjobave nga Autoritetet Kompetente.
- C.3.2.4 Menjëherë sapo Autoriteti Rregullator t'jua kërkojë, ALPEX-i do të vendosi në dispozicion të dhënat dhe informacionin që mban në përputhje me paragrafët e mësipërm.

C.3.3 Detyrimet e Anëtarëve të Klerimit

- C.3.3.1 Anëtarët e Klerimit përveç plotësimit të dispozitave në seksionin C.3.2, dhe në veçanti u kërkohet që:
- (a) të ruajnë funksionimin normal të ALPEX-it në rolin e tij si Kundërpalë Qendrore, duke treguar kujdesin dhe vëmendjen e duhur gjatë pjesëmarrjes në operacionet e Klerimit për të siguruar kryerjen e rregullt të transaksioneve;
 - (b) të shmangin çdo veprim apo mosveprim që mund të dëmtojë reputacionin e ALPEX-it dhe në përgjithësi besueshmërinë dhe sigurinë e sistemit elektro-energjetik;
 - (c) t'i përgjigjen menjëherë, me vërtetësi dhe plotësisht çdo kërkesë të ALPEX-it për të dhënë informacione dhe të dhëna, të përmbushin detyrimet e tyre të raportimit të rregullt ose *ad hoc* ndaj ALPEX-it në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure dhe të bashkëpunojnë me ALPEX-in pa pengesë duke marrë pjesë në takimet përkatëse ose duke lejuar ALPEX-in të kryejë inspektime në mjediset e tyre;
 - (d) të sigurojnë që pajisjet kompjuterike dhe programi softuerik që kanë për të hyrë në EMCS përdoret në mënyrë të arsyeshme dhe në përputhje me këtë Procedure për të siguruar funksionimin pa probleme dhe të sigurt të tij;

- (e) të zbatojnë vazhdimisht procedura efektive të kontrollit të brendshëm me qëllim verifikimin e përputhshmërisë rigoroze të personelit të tyre me dispozitat në fuqi, përfshirë ato të përcaktuara në këtë Procedurë;
- (f) të sigurojnë Klerimin dhe Shlyerjen e Transaksioneve në përputhje me dispozitat në fuqi dhe me këtë Procedurë;
- (g) t'i japin informacion të plotë me shkrim çdo Anëtarit të Bursës me të cilin kanë marrëdhënie kontraktuale në lidhje me çdo detyrim që rrjedh nga Klerimi dhe Shlyerja e Transaksioneve;
- (h) të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të zgjidhur çdo rast Mospërbushje Detyrimi ose shume të papaguar nga Klerimi, në bashkëpunim me të gjithë Palët përkatëse sipas rastit;
- (i) të marrin në konsideratë praktikën e pranuar të drejtimin të Transaksioneve të Klerimit dhe Shlyerjes, siç përcaktohen kohë pas kohë.

C.3.4 Detyrimet e Anëtarëve të Bursës

C.3.4.1 Anëtarit i Bursës në Tregjet e ALPEX-it duhet të përmbushë detyrimet që merr përsipër sipas dispozitave të kësaj Procedure. Në kuadrin e detyrimeve të tyre të pavarura, atyre u kërkohet veçanërisht që:

- (a) t'i përmbahen Kufirit të Kreditit që u janë caktuar në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure;
- (b) të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar Klerimin e rregullt të transaksioneve;
- (c) të veprojnë së bashku me Anëtarët e Klerimit me të cilët ata bashkëpunojnë, veçanërisht në rastet e Mospërbushjes së Detyrimeve;
- (d) të respektojnë çdo rekomandim ose udhëzim nga ALPEX-i me qëllim sigurimin e Klerimit të rregullt.

C.3.5 Detyrimet Specifike të Anëtarëve të Klerimit

C.3.5.1 Llogaritja e riskut të ALPEX-it në lidhje me Anëtarët e Klerimit dhe dhënia e Garancisë për efekt të mbulimit të këtij risku, në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure, do të kryhet për Anëtar Klerimi dhe Llogari Klerimi.

C.3.5.2 Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit u kërkohet që:

- (a) të veprojnë në përputhje me detyrimet e tyre për të mbajtur në EMCS llojet e ndryshme të Llogarive të Klerimit që ata përdorin në përputhje me kushtet e kësaj Procedure;
- (b) të mbajnë shënime dhe llogari të veçanta që u mundësojnë atyre të dallojnë asetet dhe pozicionet që ata mbajnë në EMCS në emër të Anëtarit të Bursës në kuadër të ofrimit të shërbimeve për ta.

D. PROCEDURA E KLERIMIT

D.1 KLERIMI

D.1.1 Rregullat bazë të Klerimit

- D.1.1.1 Klerimi kryhet ndërmjet ALPEX-it dhe Anëtarëve të Klerimit.
- D.1.1.2 ALPEX-i do të kryejë Klerimin në ditët e punës të përcaktuara në kalendarin e Ditëve të Klerimit. Me Vendim Teknik, ALPEX-i do të përcaktojë orën e fillimit të procesit të Klerimit (T) për çdo ditë pune, kohëzgjatjen dhe çdo çështje tjetër procedurale në lidhje me afatin kohor të Klerimit.
- D.1.1.3 Klerimi dhe Shlyerja e Transaksioneve kryhet në bazë të afatit kohor të Shlyerjes, siç përcaktohet në këtë Procedurë dhe në Vendimet Teknike përkatëse të ALPEX-it.
- D.1.1.4 ALPEX-i do të ushtrojë ndonjë ose të gjitha të drejtat që rrjedhin nga Transaksionet kundrejt Anëtarëve të Klerimit.
- D.1.1.5 Pas orës së fillimit të procesit të klerimit (T) në çdo ditë pune, ALPEX-i do të njoftojë me shkrim çdo Anëtar Klerimi, nëpërmjet çdo mjeti elektronik komunikimi që siguron transmetimin e sigurt të informacionit, siç përcaktohet në Vendimin Teknik të ALPEX-it, në lidhje me:
 - (a) Shumën e Margjinës që çdo Anëtar Klerimi duhet t'ia mundësojë ALPEX-it për Llogari Klerimi për të gjitha Transaksionet që ai kleron dhe që janë përmbyllur nga ora (T) në Tregjet e ALPEX-it, dhe
 - (b) Pozicionet që duhet të shlyejë, d.m.th. detyrimet në para dhe pretendimet përkatëse për Llogari Klerimi dhe Ditë Shlyerje.
- D.1.1.6 Garancia dhe Pozicionet për Llogari Klerimi ndahen nga ALPEX-i në EMCS i cili mban të dhënat përkatëse.
- D.1.1.7 Në rast të Mospërbushjes së Detyrimeve nga një Anëtar Klerimi, ALPEX-i do të ushtrojë të drejtat e tij mbi Garancinë e vendosur nga ky Anëtar Klerimi dhe në Pjesën e tij Proporcionale në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, në përputhje me dispozitat specifike të seksionit G.5.3.
- D.1.1.8 Nuk lejohet cedimi i të drejtave ose transferimi i detyrimeve që rrjedhin nga pozicionet e ndonjë Transaksioni dhe asnjë Pozicion i tillë nuk mund të transferohet ndërmjet Llogarive të Klerimit, përveç rasteve kur në këtë Procedurë parashikohet ndryshe.

D.2 Llogaritë e Klerimit

D.2.1 Parashikime të Përgjithshme

- D.2.1.1 Llogaritë e Klerimit përdoren për Klerimin e Transaksioneve.
- D.2.1.2 Menjëherë pasi janë përmbyllur në Tregjet e ALPEX-it, Transaksionet regjistrohen automatikisht në Llogaritë e Klerimit në bazë të të dhënave të ofruara nga ETSS në EMCS në përputhje me seksionin D.3.2 të këtij Kapitulli.

- D.2.1.3 Llogaritë e Klerimit përdoren gjithashtu për caktimin nga ALPEX-i të një Kufiri Krediti për Anëtarin e Klerimit dhe, në rastin e Anëtarëve të Përgjithshëm Klerimi, për shpërndarjen përkatëse prej tyre, të një Kufiri Krediti për një Jo-Anëtar Klerimi në përputhje me kushtet e seksionit G.5.2.
- D.2.1.4 Llogaritë e Klerimit hapen nga ALPEX-i dhe mbahen në EMCS në përputhje me kushtet e seksionit D.2.2.
- D.2.1.5 Llogaritë e Klerimit mbahen për Anëtar Burse në Tregjet e ALPEX-it. Llogaria e Klerimit nuk mbahet e përbashkët nga Anëtarët e Bursës.
- D.2.1.6 Anëtari Personal i Klerimit mban vetëm Llogarinë e tij të Klerimit.
- D.2.1.7 Çdo Anëtar Personal i Klerimit duhet mbajë të paktën një Llogari Klerimi.
- D.2.1.8 Çdo Anëtar i Bursës i cili është Jo-Anëtar Klerimi duhet të mbajë në emër të tij të paktën një Llogari Klerimi nëpërmjet një Anëtari të Përgjithshëm Klerimi.
- D.2.1.9 Një Anëtar i Bursës mund të mbajë më shumë se një Llogari Klerimi.
- D.2.1.10 Çdo Anëtar i Përgjithshëm Klerimi mban të paktën një Llogari Klerimi për çdo Anëtar Burse për Transaksionet e të cilit ai kryen Klerimin.
- D.2.1.11 Netimi midis Llogarive të Klerimit të mbajtura tek një Anëtar i Klerimit nuk lejohet.

D.2.2 Kushtet për hapjen e Llogarive të Klerimit

D.2.2.1 Në rastin e Anëtarit Personal të Klerimit, Llogaritë e Klerimit hapen në EMCS nga ALPEX-i me kërkesë të tij, dhe pasi ka deklaruar informacionin e mëposhtëm:

- (a) Të dhënat e identifikimit të Anëtarit të Klerimit, përkatësisht:
 - (i) Emrin e plotë ligjor të kompanisë;
 - (ii) Formën juridike të shoqërisë;
 - (iii) Numrin e regjistrimit dhe datën në të cilën shoqëria është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri ose Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës;
 - (iv) Numri i Regjistrimit Tatimor të shoqërisë;
 - (v) Kodi EIC i Anëtarit të Bursës i caktuar si Anëtar Personal Klerimi në tregjet e ALPEX-it.

D.2.2.2 Detajet e llogarisë bankare të Anëtarit Personal të Klerimit, e cila do të përdoret nga ALPEX-i për të kryer pagesa ose rimbursime në lidhje me Pjesën e tij Proporcionale në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, për të menaxhuar Garancinë e tij, duke përfshirë shembullin e paragrafit G.5.4, dhe për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj ALPEX-it.

D.2.2.3 Në rastin e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, Llogaritë e Klerimit për Anëtarët e Bursës së kontraktuar prej tij, hapen në EMCS nga ALPEX-i, me kërkesën e tij, dhe pasi ka deklaruar informacionin e mëposhtëm:

- (a) Detajet e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, në përputhje me rastet (i) deri në (v) të pikës b), dhe detajet e llogarisë Bankare të tij e cila do të përdoret nga ALPEX-i për të kryer pagesa ose rimbursime lidhur me Pjesën

Proporcionale të Anëtarit të Klerimit në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, për të menaxhuar Garancinë e tij, dhe për përmbushjen e të gjitha detyrimeve kundrejt ALPEX-it.

- (b) Të dhënat e identifikimit të Anëtarit të Bursës, përkatësisht:
 - (i) Emrin e plotë ligjor të kompanisë;
 - (ii) Formën juridike;
 - (iii) Numrin e regjistrimit dhe datën në të cilën shoqëria është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri ose Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës;
 - (iv) Numri i Regjistrimit Tatimor të shoqërisë;
 - (v) Kodin EIC të Anëtarit të Bursës dhe

D.2.2.4 Detajet e Llogarisë Bankare të Anëtarit të Bursës dhe/ose Anëtarit të Klerimit me qëllim kryerjen e çdo rimbursimi të parave në rast të Mospërbushjes së Detyrimeve, në përputhje me seksionin G.5.4.

D.2.3 Mbyllja e Llogarisë së Klerimit

D.2.3.1 Një Llogari Klerimi do të mbyllet nga ALPEX-i me marrjen e një kërkesë për mbylljen e llogarisë, ose me Përfundimin Vullnetar të Anëtarit të Klerimit që mban llogarinë.

D.2.3.2 Për të hequr çdo dyshim, një Llogari Klerimi mbyllet nëse nuk ka Pozicione të hapura ose detyrime të tjera të papaguara dhe të drejta korresponduese që rrjedhin nga Transaksionet.

D.3 PROCEDURA E KLERIMIT

D.3.1 Dispozita të Përgjithshme

D.3.1.1 Ky seksion përcakton termat dhe kushtet sipas të cilave transaksionet klerohen përmes EMCS-së. Procedura e Klerimit përfshin pjesëmarrjen e Anëtarëve të Klerimit dhe ALPEX-it, si dhe Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it në rastet që është e zbatueshme, në përputhje me dispozitat specifike të këtij seksioni.

D.3.1.2 Klerimi i Transaksioneve kryhet nëpërmjet EMCS-së në mënyrë individuale për të gjitha Transaksionet e regjistruara në EMCS në ditën e Klerimit brenda kohës së planifikuar të punës, të vendosur nga ALPEX-i.

D.3.1.3 Klerimi përfshin procedura të ndara si më poshtë:

- (a) njoftimin nga ETSS në EMCS për Transaksionet për tu kleruar;
- (b) finalizimin e Tregtimeve;
- (c) llogaritjen, në një moment të caktuar të ditës, të Kreditorëve dhe Debitorëve të ALPEX-it;
- (d) vlerësimin e Garancisë;
- (e) llogaritjen dhe mbulimin e kërkesave të Margjinës;

- (f) Ilogaritjen dhe monitorimin e Kufirit të Kreditit dhe njoftimin në ETSS për Kufirin e Kreditit për Anëtar Burse në tregjet e ALPEX-it;
- (g) shpalljen e rezultateve të Klerimit tek Anëtarët e Klerimit;
- (h) shlyerjen me para dhe lëshimin e deklaratës përkatëse për këtë Shlyerje.

D.3.1.4 Çdo detaj procedural ose teknik në lidhje me Klerimin do të përcaktohet në përputhje me vendimet teknike dhe procedurat e ALPEX-it.

D.3.2 Realizimi i Klerimit

D.3.2.1 Përpara fillimit dhe/ose gjatë çdo Ditë Tregtimi, në përputhje me procedurat e ALPEX-it, çdo Anëtar i Përgjithshëm Klerimi do të deklarojë në EMCS Anëtarët e Bursës, Transaksionet e të cilëve në tregjet e ALPEX-it do të klerohen prej tij, dhe Kufirin përkatës të Kreditit, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij dokumenti, i cili i caktohet këtyre Anëtarëve të Bursës në lidhje me Ditën përkatëse të Livrimit.

D.3.2.2 Të gjitha veprimet në paragrafin D.3.2.1 do të konsiderohen si një deklaratë për përcaktimin e Klerimit të Transaksioneve përkatëse të Anëtarit të Bursës nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit si dhe njëkohësisht një deklaratë për ndërmarrjen e Klerimit nga ana e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit. Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit nuk lejohet të ndërmarrë Klerimin e ndonjë Transaksioni për të cilin nuk ka bërë deklaratën e sipërpërmendur.

D.3.2.3 Çdo Anëtar i Bursës i cili vepron si Anëtar Personal Klerimi, në çdo ditë tregtimi, mund të vendosë Urdhërporosi në ETSS dhe të kryejë Transaksione vetëm deri në Kufirin e Kreditit që i është caktuar për Ditën përkatëse të Livrimit, në përputhje me dispozitat e këtij dokumenti.

D.3.2.4 Jo-Anëtarët e Klerimit që nuk janë përfshirë në deklaratën e një Anëtari të Përgjithshëm Klerimi sipas seksionit D.3.2, nuk lejohen të vendosin Urdhërporosi në ETSS.

D.3.3 Njoftimi i Transaksioneve që do të klerohen

D.3.3.1 Pas përfundimit të Tregtimit, ETSS do t'i transmetojë në mënyrë elektronike tek EMCS-ja të dhëna të detajuara mbi Transaksionet e përfunduara. Të dhënat e transmetuara do të kontrollohen në përputhje me dispozitat e paragrafëve në vijim.

D.3.3.2 Të dhënat e detajuara mbi Transaksionet duhet të përfshijnë si vijon:

- (a) Tregjet e ALPEX-it (të Ditës në Avancë ose Brenda së Njëjtës Ditë);
- (b) Kodin EIC të Anëtarit të Bursës;
- (c) Kodin EIC të aseteve për të cilin Transaksionet janë realizuar, nëse është rasti;
- (d) Lloji i Urdhërporosisë;
- (e) Transaksionin e Blerjes ose Shitjes;
- (f) Sasinë dhe çmimin i Transaksionit;
- (g) Datën dhe orën e Tregtimit;

- (h) Njësia Kohore e Tregut me të cilën/at lidhen Transaksionet;
- (i) Monedhën e Tregtimit në Euro;
- (j) Kodi i Llogarisë së Klerimit

D.3.4 Finalizimi i Tregtimit

D.3.4.1 Pas përfundimit të kontrolleve dhe korigjimit të çdo mungese dhe mospërputhjeje, sipas seksionit D.3.3, Transaksionet e komunikuara si më sipër finalizohen për qëllim Klerimi, për të formuar Pozicionet totale për Llogari Klerimi dhe një Kontratë të detyruese për Palët e përfshira.

D.3.4.2 Pas finalizimit të tyre, Transaksioneve nuk mund t'iu bëhet më, asnjë ndryshim, korigjim ose plotësim nga EMCS-ja.

D.3.5 Llogaritja e Pozicioneve Neto

D.3.5.1 Pas finalizimit të Tregtimit, EMCS-ja llogarit Pozicionet (Debitorët dhe Kreditorët e ALPEX-it) për Anëtarë Klerimi për Llogari Klerimi.

D.3.5.2 Për të llogaritur Pozicionet për Llogari Klerimi, EMCS-ja në një kohë të caktuar T në çdo Ditë pune llogarit për çdo Anëtar Klerimi dhe Llogari Klerimi detyrimet neto dhe pretendimet neto që lindin në bazë të transaksioneve që janë kryer në tregjet e ALPEX-it dhe i janë komunikuar EMCS-së para kohës T.

D.3.6 Vlerësimi i Garancisë

D.3.6.1 Me qëllim përmbushjen e kërkesave të Margjinës dhe Kufirin e Kreditit, EMCS-ja llogarit vlerën totale të Garancisë të dhënë për Llogari Klerimi, duke marrë parasysh shumën e parave të depozituara si dhe vlerën monetare dhe periudhën e vlefshmërisë së Letër Garancisë Bankare të depozituar në favor të ALPEX-it.

D.3.7 Dispozitat e informacionit dhe verifikimi i të dhënave

D.3.7.1 Anëtarëve të Klerimit që marrin pjesë në Shlyerjen e Transaksioneve në para, në përputhje me kushtet e këtij dokumenti, u kërkohet të paraqesin të gjitha të dhënat dhe informacionin e kërkuar nga ALPEX-i në lidhje me llogaritë e përshkruara në këtë Procedurë të cilën ata menaxhojnë, ose me detyrimet që rrjedhin prej tyre, si dhe çdo ndryshim në këto të dhëna dhe informacione. Ata gjithashtu duhet të njoftojnë ALPEX-in për çdo ndryshim të të dhënave të tyre, mbi bazën e të cilave janë hapur llogaritë përkatëse.

D.3.7.2 ALPEX-i ka të drejtën ligjore, në kuadër të mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara për hapjen dhe mbajtjen e llogarive të mësipërme, të shkëmbejë çdo informacion të nevojshëm me Bankën për Shlyerje dhe Bankat që mundësojnë Garancinë në favor të ALPEX-it, si dhe me çdo subjekt tjetër i përfshirë në Klerimin dhe Shlyerjen e Transaksioneve, duke respektuar dispozitat e sekretit profesional.

D.3.8 Komunikimi ndërmjet Palëve

D.3.8.1 Komunikimi ndërmjet ALPEX-it dhe Anëtarëve të Klerimit do të jetë me shkrim. Ky komunikim përfshin dokumente në formë elektronike ose të tjera, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në Rregullat e ALPEX-it dhe në këtë Procedurë.

- D.3.8.2 Në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure, çdo njoftim i ALPEX-it për Anëtarët e Klerimit në lidhje me Klerimin dhe rezultatet, do të transmetohet në mënyrë elektronike nëpërmjet EMCS-së ose Mjetit Elektronik të Përcaktuar ose nëpërmjet mekanizmave alternativë të mbajtur nga ALPEX-i për rastet e keqfunksionimit ose ngjarjeve të tjera të jashtëzakonshme.
- D.3.8.3 Me qëllim komunikimin me ALPEX-in, adresa e Anëtarit të Klerimit do të jetë ajo e përcaktuar nga Anëtari i Klerimit në aplikimin e tij për marrjen e kapacitetit përkatës. Për çdo ndryshim të adresës Anëtari i Klerimit do të njoftojë me shkrim ALPEX-in.
- D.3.8.4 Në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me Klerimin dhe Shlyerjen e Transaksioneve, ALPEX-i do të komunikojë me Agjentin e Klerues të Certifikuar të deklaruar në ALPEX nga Anëtari i Klerimit. Për çdo çështje tjetër që lidhet me Anëtarin e Klerimit, ALPEX-i do të komunikojë me personin e kontaktit të Anëtarit të Klerimit.
- D.3.8.5 Me qëllim komunikimin me ALPEX-in, Anëtarët e Klerimit duhet të kontaktojnë me ALPEX-in, sipas informacionit të shpallur në faqen e internetit nga ALPEX-i.

E. FONDI I MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE

E.1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- E.1.1.1 ALPEX-i krijon një Fond të Mospërbushjes së Detyrimeve me qëllim mbulimin e riskut në lidhje me operacionet e Klerimit që kryen, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.
- E.1.1.2 Fondi i Mospërbushjes së Detyrimeve formon një fond aktivesh nga kontributet e Anëtarëve të Klerimit, dhe ky Fond i përket bashkarisht Anëtarëve të Klerimit në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në të. Fondi i Mospërbushjes së Detyrimeve do të mbahet në një llogari bankare dhe administrohet nga ALPEX-i.
- E.1.1.3 Vlerat monetare të disponueshme në çdo kohë në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, siç përcaktohet në përputhje me kushtet këtu, përbëjnë një marrëveshje Garanci financiare në favor të ALPEX-it si marrës i Garancisë dhe ALPEX-i ka të drejtë të përdorë Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve në përputhje me dispozitat e seksionit E.2.6.
- E.1.1.4 ALPEX-i do të administrojë Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve me qëllim mbulimin e humbjeve që rrjedhin nga Mospërbushja e Detyrimeve në përputhje me seksionin G.5.3.
- E.1.1.5 Fondi i Mospërbushjes së Detyrimeve është një fond për ndarjen e riskut midis Anëtarëve të Klerimit. Në rastin e Mospërbushjes së Detyrimeve nga një Anëtar Klerimi dhe nëse vlera e Pjesës Proporcionale të këtij Anëtari Klerimi është e pamjaftueshme për të mbuluar një humbje që vjen nga Mospërbushja e Detyrimeve të tij, pjesa e mbetur e humbjes ngarkohet proporcionalisht (pro rata basis) në vlerën e Pjesës Proporcionale të Anëtarëve të tjerë të Klerimit që marrin pjesë në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, duke reduktuar në këtë mënyrë në mënyrë proporcionale pjesëmarrjen e tyre në të.
- E.1.1.6 Vlera e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve dhe e kontributeve të Anëtarëve të Klerimit në të përcaktohet në përputhje me kushtet e këtij Kapitulli. Vlera minimale e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve nuk mund të jetë më e vogël se shuma e grupuar e Kontributeve Minimale e Anëtarëve të Klerimit siç është përcaktuar në këtë Kapitull.
- E.1.1.7 Pjesëmarrja e çdo Anëtari Klerimi në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve përcaktohet nga vlera e Pjesës së tij Proporcionale. Pjesa Proporcionale përbëhet nga kontributet e Anëtarëve të Klerimit në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, plus të ardhurat që i korrespondojnë kësaj llogarie, minus të gjitha llojet e shpenzimeve që rrjedhin nga interesi negativ bankar, komisionet bankare ose tarifat e llogarisë bankare të Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve në përputhje me seksionin E.2.7, siç përcaktohet në Procedurën e ALPEX-it. Të ardhurat dhe shpenzimet shpërndahen për çdo Pjesë Proporcionale të Anëtarit të Klerimit në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve në përpjesëtim me madhësinë e kësaj llogarie.
- E.1.1.8 Kontributet në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve bëhen nga Anëtarët e Klerimit në formën e depozitimit në para në Llogarinë Bankare siç përcaktohet nga

ALPEX-i. Në rast kur një shumë e caktuar e mbajtur në Pjesën Proporcionale do të kthehet, në zbatim të kushteve të saj nëse është e aplikueshme, ALPEX-i, transferon shumën përkatëse në llogarinë bankare të Anëtarit të Klerimit përkatës.

E.1.1.9 Shuma e Parave në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve do të mbahet në një llogari në Bankën për Shlyerje. ALPEX-i do të regjistrojë të gjitha shumat e Kontributeve, në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, për çdo Pjesë Proporcionale të Anëtarëve të Klerimit në një regjistër kontabël.

E.1.2 Pjesa Proporcionale

E.1.2.1 Çdo Anëtar i Klerimit mban vetëm një Pjesë Proporcionale në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve. Kjo pjesë aktivizohet pas marrjes së kapacitetit të Anëtarit të Klerimit.

E.1.2.2 Çdo rast i bashkimit, ndarjes ose çaktivizimit të Pjesës Proporcionale si rezultat i veprimeve të korporatave ose ngjarjeve të tjera në lidhje me Anëtarët e Klerimit, në rastet e bashkimit ose blerjes, do të rregullohen nga Vendimet Teknike të ALPEX-it.

E.1.2.3 Një Pjesë Proporcionale e Anëtarit të Klerimit do të çaktivizohet në rast se Anëtari i Klerimit humbet kapacitetin, siç përcaktohet në çdo rast nga dispozitat e kësaj Procedure.

E.1.3 Kontributi Fillestar dhe Minimal

E.1.3.1 Anëtarët e Klerimit duhet të bëjnë një Kontribut Fillestar në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve në mënyrë që të fitojnë kapacitetin përkatës.

E.1.3.2 Shuma e Kontributit Fillestar përcaktohet në bazë të një Vendimi Teknik të ALPEX-it.

E.1.3.3 Kontributi Minimal i Anëtarëve të Klerimit në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, siç është përcaktuar në bazë të dispozitave të mëposhtme, nuk mund të jetë më i vogël se Kontributi Fillestar (Kontributi Minimal).

E.2 Rregullat për llogaritjen e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve dhe Pjesa Proporcionale për Anëtarët e Klerimit

E.2.1 Vlera e Pjesës Proporcionale për Anëtarët e Klerimit

E.2.1.1 Vlera e Pjesës Proporcionale të Anëtarit të Klerimit në lidhje me çdo periudhë aktuale do të jetë cilado shumë më e madhe ndërmjet normës (Normës së Kontributit), siç është përcaktuar nga ALPEX-i, shumëzuar me shumën e Margjinës mesatare të të gjitha Llogarive të Klerimit të Anëtarit të Klerimit për periudhën e llogaritjes, dhe Kontributit Minimal. Më konkretisht, vlera e Pjesës Proporcionale (μ_i) të Anëtarit të Klerimit (i) llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$E.2.1.2 \quad \mu_i = \max \left(\alpha \cdot \sum_{k=1}^{N(i)} \left(\frac{\sum_{j=1}^{M_{ki}} M(kij)}{M_{ki}} \right), \text{Minimum Contribution (i)} \right) \text{ ku:}$$

(a) $N(i)$: Numri i përgjithshëm i Llogarive të Klerimit të Anëtarit të Klerimit (i) gjatë periudhës së llogaritjes.

- (b) $M(k,i,j)$: Margjina e Llogarisë së Klerimit (k) të Anëtarit të Klerimit (i) e llogaritur gjatë llogaritjeve ditore të detyrimeve dhe pretendimeve të Ditës së Klerimit (j).
- (c) Mk,i : Numri i ditëve të Klerimit të Tregut të periudhës së mëparshme të llogaritjes, për të cilën është llogaritur margjinë jo-zero për Llogari Klerimi (k) të Anëtarit të Klerimit (i).
- (d) Kontributi Minimal (i): Kontributi minimal i kërkuar në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve të Anëtarit të Klerimit (i) në përputhje me dispozitat e seksionit E.1.3.
- (e) α : Norma e kontributit, e përcaktuar në bazë të një Vendimi Teknik përkatës i ALPEX-it.

E.2.2 Vlera Monetare e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve

- E.2.2.1 Vlera monetare e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve llogaritet në bazë mujore në përputhje me këtë Procedurë. Vlera monetare e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve llogaritet në tre (3) ditët e para të punës të çdo periudhe të llogaritjes aktuale. Pas llogaritjes së saj, ALPEX-i do të komunikojë shumën përkatëse për Anëtarët e Klerimit dhe ta shpallë atë në faqen e tij të ueb-it.
- E.2.2.2 Vlera monetare totale e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve përcaktohet nga shuma totale e Pjesëve Proporcionale të të gjithë Anëtarëve të Klerimit sipas llogaritjes në përputhje me seksionin E.2.1
- E.2.2.3 ALPEX-i do të përcaktojë të gjitha çështjet përkatëse dhe detajet e nevojshme nëpërmjet një Vendimi Teknik.

E.2.3 Pagesat që duhen të bëhen për korrigjimin e Pjesës Proporcionale

- E.2.3.1 Kur ALPEX-i njofton Anëtarët e Klerimit në lidhje me vlerën monetare të Pjesës të tyre Proporcionale në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, ku do të përcaktojë saktë shumën që duhet paguar nga:
 - (a) Anëtarët përkatës të Klerimit në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, ose
 - (b) Fondi i Mospërbushjes së Detyrimeve (nëpërmjet ALPEX) për Anëtarët e Klerimit.
- E.2.3.2 Nëse vlera monetare e Pjesës Proporcionale të një Anëtari Klerimi gjatë periudhës së llogaritjes së mëparshme është më e vogël se vlera monetare e Pjesës Proporcionale që duhet të mbahet nga Anëtari i Klerimit gjatë periudhës aktuale të llogaritjes, Anëtari i Klerimit duhet të paguajë diferencën në para në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve brenda tre (3) ditëve pune nga njoftimi i ALPEX-it në lidhje me vlerën monetare të Pjesës Proporcionale të Anëtarëve të Klerimit në këtë Fond gjatë periudhës aktuale të llogaritjes.
- E.2.3.3 Nëse vlera monetare e Pjesës Proporcionale të një Anëtari Klerimi gjatë periudhës së mëparshme të llogaritjes është më e madhe se vlera monetare e Pjesës Proporcionale që duhet të mbahet nga Anëtari i Klerimit gjatë periudhës aktuale të llogaritjes, diferenca duhet të paguhet në para nga burimet e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve nëpërmjet ALPEX-it për Anëtarin e Klerimit brenda katër (4) ditëve pune nga njoftimi i ALPEX-it në lidhje me vlerën e Pjesës

Proporcionale të Anëtarëve të Klerimit në Fond gjatë periudhës aktuale të llogaritjes, pasi të jenë paguar fillimisht detyrimet e Anëtarëve të Klerimit sipas paragrafit E.2.3.2.

E.2.4 Kontributet e jashtëzakonshme

E.2.4.1 Me vendim të ALPEX-it, kontributet e jashtëzakonshme do të paguhen nga Anëtarët e Klerimit drejt Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve në rastet për:

- (a) aktivizimin e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve për të rimbushur burimet e tij që janë përdorur për të mbuluar humbjen për shkak të Mospërbushjes së Detyrimeve të një Anëtari Klerimi.
- (b) ndryshime të rëndësishme veçanërisht në lidhje me çmimet e tregut dhe faktorë të tjerë në përgjithësi që ndikojnë në madhësinë e kërkuar të Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve.

E.2.4.2 Në shembullin të paragrafit të mëparshëm E.2.4.1(a), ALPEX-i llogarit shumën e Kontributeve të jashtëzakonshme të secilit prej Anëtarëve të Klerimit në bazë të përqindjes së tyre të re të pjesëmarrjes në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve.

E.2.4.3 Në rastet e paragrafëve pararendës ALPEX-i, me qëllim të llogaritjes së madhësisë së kontributeve të jashtëzakonshme, zbaton Procedurën sipas seksionit E.2.1 ose, nëse konsiderohet e nevojshme, mund të vendosë parametra shtesë në përlllogaritje për të mbrojtur Tregjet e ALPEX-it. Parametra të tilla shtesë i referohen në veçanti Normës së Kontributit në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve dhe periudhës së llogaritjes së tij. ALPEX-i do t'ia komunikojë pa vonesë vendimin e tij përkatës Autoriteteve Rregullatore.

E.2.4.4 Kur është marrë një vendim për rregullim të jashtëzakonshëm të Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve, ALPEX-i përcakton metodologjinë dhe parametrat mbi bazën e të cilave do të bëhet rregullimi, i cili mund të ndryshojë nga metodologjia e ndjekur për rregullimin e tij të zakonshëm, duke marrë parasysh arsyet që kanë bërë të nevojshme një rregullim të tillë. Ai gjithashtu përcakton periudhën brenda së cilës Anëtarët e Klerimit duhet të japin kontributet shtesë.

E.2.5 Paguesa e vonuar e kontributeve në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve

E.2.5.1 Në rast të vonesës së pagesës së kontributit të një Anëtari Klerimi në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, një Anëtar i tillë Klerimi nuk do të lejohet të ndërmarrë Transaksione për Klerim derisa të ketë përmbushur detyrimin e tij përkatës. Po kështu, Anëtari i Bursës do të përjashtohet nga kryerja e Transaksioneve nëse këto janë kleruar nga Anëtari i Klerimit në Mospërbushje të Detyrimeve.

E.2.6 Përdorimi dhe rimbushja e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve

E.2.6.1 ALPEX-i mund përdorë përkohësisht burimet e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve si marrësi i Garancisë në ushtrimin e të drejtës së tij të përdorimit sipas seksionit E.1.1.3 në rastin kur një Anëtar Klerimi është në Mospërbushje të Detyrimeve. ALPEX-i do të bëjë një përdorim të tillë për të përmbushur kërkesat e

likuiditetit në lidhje me detyrimet e prapambetura të Anëtarit të Klerimit në Mospërbushje të Detyrimeve të cilin ALPEX-i merr përsipër të adresojë Mospërbushjen e Detyrimeve të lartpërmendur në përputhje me dispozitat e seksionit F.2.2, duke përfshirë të gjitha llojet e shpenzimeve në lidhje me përmbushjen e detyrimeve.

E.2.6.2 Kur burimet e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve janë përdorur sipas paragrafit të mëparshëm, atëherë ky Fond duhet të rimbushet brenda një kohe të arsyeshme dhe sigurisht përpara përdorimit të Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve për të mbuluar çdo humbje të shkaktuar nga Mospërbushja e Detyrimeve, siç është përcaktuar në seksionin G.5.3.

E.2.6.3 Nëse, Mospërbushja e parë e Detyrimeve nuk është zgjidhur ende, dhe një tjetër Mospërbushje e Detyrimeve ndodh gjatë kësaj periudhe, përdorimi i burimeve nga Fondi i Mospërbushjes së Detyrimeve për secilën Mospërbushje të Detyrimeve në përputhje me paragrafët e mëparshëm do të bëhet në mënyrë sekuenciale dhe në rend kronologjik, kush ka ndodhur më përpara mbulohet i pari, sipas kushteve të seksionit G.5.3, për humbjen e secilës Mospërbushje të Detyrimeve të mëparshme.

E.2.7 **Burimet, asetet**

E.2.7.1 Burimet e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve do të jenë kontributet në para të Anëtarëve të Klerimit, siç është përcaktuar në këtë Procedurë.

E.2.7.2 ALPEX-i do të publikojë raportin vjetor në lidhje me menaxhimin e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve që përfshin:

- (a) një ndarje të aseteve të Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve,
- (b) një pasqyrë të detajuar të të ardhurave, duke paraqitur sipas kategorisë të ardhurat dhe të gjitha mënyrat e kontributeve që i janë paguar, si dhe çdo shpenzim apo humbje që rezulton nga aktivizimi i tij,
- (c) një pasqyrë të detajuar të disbursimeve të Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve në zbatim të dispozitave të kësaj Procedurë, dhe
- (d) një listë të detajuar të pretendimeve të shlyera dhe të pashlyera që rrjedhin nga Mospërbushja e Detyrimeve.

E.2.7.3 Auditimi i menaxhimit financiar të Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve dhe i raportit vjetor të administrimit të përgatitur nga ALPEX-i do t'u caktohet dy (2) audituesve të regjistruar ose një firme auditimi të njohur.

F. MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI

F.1 MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI

F.1.1 Mospërbushja e Detyrimeve

- F.1.1.1 Seksionet e mëposhtme mbi Mospërbushjen e Detyrimeve, Pezullimin dhe Përfundimin do të zbatohen në lidhje me Mospërbushjen e Detyrimeve nga çdo Palë tjetër përveç ALPEX-it.
- F.1.1.2 Një Palë do të jetë në Mospërbushje të Detyrimeve kur është në shkelje materiale të çdo dispozite të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes ose të Marrëveshjes Kuadër për Klerim.
- F.1.1.3 Kur Mospërbushja e Detyrimeve ka të bëjë me pagesë jo të plotë nga një Anëtar i Klerimit për ndonjë Faturë, atëherë të gjitha këto mospagesa do të klasifikohen si një Mospërbushje e Detyrimeve.
- F.1.1.4 Në rast se një Anëtar i Klerimit dështon në përbushjen e detyrimeve ndaj ALPEX-i që lindin nga Klerimi i Transaksioneve, Anëtari i Klerimit do të konsiderohet në Mospërbushje të Detyrimeve sipas Kapitullit F dhe ALPEX-i duhet:
- (a) të marrë rolin e Kundërpalës Qendrore në përbushjen e detyrimeve në para kundrejt Anëtarëve të Klerimit që janë Kundërpalë përfituese, dhe
 - (b) të ushtrojë të drejtat e tij ndaj Anëtarit të Klerimit në Mospërbushje të Detyrimeve në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure dhe Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
- F.1.1.5 Në qoftë se një Anëtar i Klerimit dështon në përbushjen e detyrimeve të tij në lidhje me Klerimin dhe Shlyerjen e Transaksioneve, siç këto detyrime lindin për secilën nga Llogaritë e tij të Klerimit dhe janë përcaktuar në këtë Procedurë, ky Anëtar i Klerimit duhet të konsiderohet në Mospërbushje të Detyrimeve, sipas dispozitave të këtij Kapitulli.
- F.1.1.6 Një Anëtar i Klerimit do të konsiderohet në Mospërbushje të Detyrimeve në rastet që përfshijnë por nuk kufizohen si më poshtë:
- (a) Kur në Llogarinë bankare për Shlyerje të Anëtarit të Klerimit, balanca në para nuk është e mjaftueshme për të përbushur të gjitha detyrimet e Anëtarit të Klerimit, siç detyrime të tilla janë parashikuar në këtë Procedurë.
 - (b) Kur Anëtari i Klerimit nuk ka siguruar Garancinë e kërkuar në favor të ALPEX-it ose kontributin në favor të Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve, siç përcaktohet në dispozitat e kësaj Procedure.
 - (c) Në rastet e mëposhtme, të cilat për qëllim të kësaj pike konsiderohen në përgjithësi si raste të paaftësisë paguese të një Anëtari Klerimi dhe mund të lindin pavarësisht nëse Anëtari ka dështuar në përbushjen e detyrimeve të tij kundrejt ALPEX-it në lidhje me Klerimin dhe Shlyerjen e Transaksioneve:

- (i) Në rast se do të hapet procedura e falimentimit kundër një Anëtari Klerimi, me kusht që ALPEX-i të jetë informuar në përputhje me këtë.
 - (ii) Në rast të paaftësisë përfundimtare të një Anëtari Klerimi, për shembull për shkak të problemeve të tij të likuiditetit ose paaftësisë pagueuse, në lidhje me të cilën ende nuk është hapur asnjë procedurë falimentimi, në përputhje me nën paragrafin (i), nëse ALPEX është informuar në lidhje me pamundësi të tillë nga Autoritetet Kompetente ose me mjete të tjera.
 - (iii) Në rast të ndonjë ngjarje tjetër që ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e Anëtarit të Klerimit dhe bën ose pritet të bëjë të pamundur përmbushjen e detyrimeve të tij, si për shembull, siç mund të jenë, revokimin nga Autoritetet Përkatëse mbikëqyrëse të licencës së tij operative ose licencës për të ofruar shërbime, ose shpërbërjen e kompanisë së tij, nëse ALPEX është informuar për një ngjarje të tillë nga Autoritetet Përkatëse mbikëqyrëse ose me mjete të tjera.
 - (iv) Në rast të dështimit të një Anëtari Klerimi për të përmbushur detyrimet e tij kundrejt ALPEX-it për arsye të tjera përveç atyre në lidhje me Klerimin në fjalë, të tilla si, si për shembull, arsyet e lidhura me pjesëmarrjen e tij në sisteme ose tregje të tjera me të cilat ALPEX është i lidhur dhe mund të jetë i ekspozuar ndaj rrezikut në kuadrin e funksionimit të tij në zbatim të dispozitave në fuqi.
- (d) Çdo referim në këtë Procedurë për Mospërmbushjen e Detyrimeve përfshin gjithashtu rastet e falimentimit siç janë përcaktuar më sipër.

F.2 MENAXHIMI PËR MOSPËRMBUSHJE DETYRIMESH

F.2.1 Të drejtat e ALPEX-it

F.2.1.1 Pa paragjykuar të drejtën e ALPEX-it për të marrë masa ndaj një Anëtari Klerimi në Mospërmbushje Detyrimesh, në përputhje me seksionin F.6, nëse një Anëtar Klerimi dështon të përmbushë detyrimet e tij të Klerimit dhe Shlyerjes që vijnë nga Llogaria e tij e Klerimit dhe Mospërmbushja e Detyrimeve nuk është plotësuar ende, atëherë, në varësi të shembullit të Mospërmbushjes së Detyrimeve, ALPEX-i ka të drejtat ligjore të mëposhtme të përcaktuara në seksionin G.5.3:

- (a) të përdorë ose të disponojë Garancinë, sipas rastit, në përputhje me dispozitat e seksionit G.5.4 ose të kërkojë ekzekutimin e menjëhershëm të Letrës së Garancisë Bankare që i është siguruar nga Anëtari i Klerimit që është në Mospërmbushje të Detyrimeve;
- (b) të mbledhë shumat e nevojshme të parave nga Pjesa përkatëse Proporcionale të Anëtarit të Klerimit në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve dhe/ose shumat përkatëse të Pjesëve të tjera Proporcionale, kur është e zbatueshme në përputhje me dispozitat e seksionit G.5.3

F.2.1.2 Deri në korigjimin e Mospërmbushjes së Detyrimeve, Anëtari i Klerimit në Mospërmbushje Detyrimesh do të lejohet të Kleroj Transaksionet e reja vetëm dhe ekskluzivisht në bazë të udhëzimeve dhe procedurave përkatëse të ALPEX-i si më poshtë:

- (a) Nëse një Anëtar Personal i Klerimit (në rastet e OST-ve, OSSH-ve dhe FSHU-ve) është në Mospërbushje Detyrimesh ai mund të vendosë Urdhërporosi në ETSS dhe të kryejë transaksione si një Anëtar i Bursës vetëm në qoftë së Risku nga Urdhërporositë e lartpërmendura është i barabartë me zero (0). Vendosja e Urdhërporosive është e lejuar vetëm për një periudhë të kufizuar kohore e cila është caktuar nga ALPEX-i dhe me kusht që fillimisht të njoftohet Autoriteti Rregullatorë. Nëse Anëtari Personal i Klerimit në Mospërbushje Detyrimesh ka një Llogari Klerimi tek ndonjë Anëtar i Përgjithshëm Klerimi si një Anëtar i Bursës nuk do të ndikohet nga Mospërbushja e Detyrimeve përveç nëse ka rrethana të veçanta të ekspozimit të riskut, të cilat bëjnë të nevojshme ndërhyrjen e ALPEX-it në lidhje me ta gjithashtu.
- (b) Në rast se një Anëtar i Përgjithshëm Klerimi është në Mospërbushje Detyrimesh zbatohet procedura e mëposhtme:
 - (i) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit njofton menjëherë ALPEX-in dhe jep detaje të Anëtarëve të Bursës të kontraktuar prej tij për të cilët ofron shërbime Klerimi.
 - (ii) Në rast se ky Anëtar i Bursës i kontraktuar nuk ka një Llogari Klerimi tek një Anëtar tjetër Klerimi, përveç llogarisë që mbahet për të nga Anëtari i Përgjithshëm Klerimit në Mospërbushje Detyrimesh, Anëtari i Bursës mund të vendosë Urdhërporosi në ETSS dhe të kryejë Transaksione vetëm në qoftë se Risku nga Urdhërporositë e sipërpërmendura është i barabartë me zero (0). Vendosja e Urdhërporosive të sipërpërmendura është e lejuar vetëm për një periudhë të kufizuar kohore e cila është caktuar nga ALPEX-i dhe me kusht që fillimisht të jetë njoftuar Autoriteti Rregullator.
 - (iii) Në rast se një Anëtar i Bursës i kontraktuar ka një Llogari Klerimi tek një Anëtar tjetër Klerimi, përveç llogarisë së mbajtur për të nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit në Mospërbushje Detyrimesh, Anëtari i Bursës mund të vendosë Urdhërporosi në ETSS dhe të kryejë Transaksione me anë të kodeve që janë të lidhura me Llogarinë e Klerimit të Anëtarit të Bursës, të cilin e mban pranë Anëtarit tjetër të Përgjithshëm të Klerimit.

F.2.1.3 Në çdo rast, ALPEX-i do të marrë të gjitha hapat e nevojshme në lidhje me Mospërbushjen e Detyrimeve, me qëllim për të ndaluar vendosjen e Urdhërporosive nga Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it përveç rasteve të paragrafit F.2.1.2

F.2.1.4 Nëntëdhjetë minuta (90') përpara Kohës së Hapjes së Portës së Tregut të Ditës në Avancë, në qoftë se shumat e kërkuara të parave nuk janë gjendje në një Llogari bankare Shlyerje të një Anëtari Klerimi, një tarifë do të vendoset, edhe nëse Mospërbushja e Detyrimeve është korrigjuar më pas nga ai Anëtar. Kjo pagesë do të jetë e barabartë me dy për qind (2%) të vlerës së shumës së mbetur pa paguar, me një pagesë minimale prej 500 Euro (pesëqind).

F.2.1.5 Shuma që korrespondon me tarifën e vendosur si më sipër duhet të paguhet në ditën e ardhshme të punës sipas Procedurës së Shlyerjes në Para.

F.2.1.6 Tarifat e mësipërme do të zbatohen pavarësisht nga vendosja e pagesës së penalitetit ndaj Anëtarit të Klerimit në Mospërmbushje Detyrimesh sipas dispozitave të seksionit F.6.1.

F.2.2 **Marrja e detyrimeve nga ALPEX-i**

F.2.2.1 Nëse Mospërmbushja e Detyrimeve përfshin mosplotësimin e një Detyrimi të Shlyerjes në para nga ana e Anëtarit të Klerimit në Mospërmbushje Detyrimesh për shkak të fondeve të pamjaftueshme në Llogarinë e tij bankare të Shlyerjes, ALPEX-i do të përmbushë detyrimin monetar të Anëtarit të Klerimit që nuk ka përmbushur detyrimet ndaj Anëtarëve të Klerimit që kanë përmbushur detyrimet duke aktivizuar procesin e Hapave për përdorimin e Fondit në Mospërmbushje të Detyrimeve (default waterfall) sipas seksionit G.5.3 kundrejt Anëtarit të Klerimit në Mospërmbushje Detyrimesh.

F.2.3 **Netimi përfundimtar**

F.2.3.1 Në rast të një Anëtari Klerimi në Mospërmbushjeje Detyrimesh në lidhje me detyrimet e tij të Klerimit dhe Shlyerjes që rrjedhin nga një Llogari e Klerimit, ALPEX-i mund të aplikojë netimin përfundimtar për këtë Anëtar Klerimi dhe detyrimeve të tij të mëparshme, në përputhje me dispozitat specifike të paragrafëve të mëposhtëm.

F.2.3.2 Me aplikimin e netimit përfundimtar:

- (a) ndonjë dhe të gjitha detyrimet ose të drejtat e Anëtarit të Klerimit në Mospërmbushje Detyrimesh të cilat lindin nga Llogaria përkatëse e Klerimit ose detyrimet përkatëse të ALPEX-it kundrejt këtij Anëtari Klerimi do të bëhen menjëherë të pagueshme, edhe nëse ato nuk janë ende për tu paguar, ose skadojnë, automatikisht dhe zëvendësohen nga një detyrim për të paguar një shumë të tillë, dhe
- (b) shumat që i detyrohet Anëtari i Klerimit në Mospërmbushje Detyrimesh kundrejt ALPEX-it dhe anasjelltas, të cilat lindin nga Llogaria përkatëse e Klerimit, llogariten dhe pala që detyrohet në shumën më të madhe duhet t'i paguajë palës tjetër shumën neto të barabartë me diferencën midis shumave që i detyrohen.

F.2.3.3 Netimi përfundimtar mund të zbatohet gjithashtu midis Llogarive të ndryshme të Klerimit, me kusht që përfituesi i llogarisë përkatëse të jetë i njëjti Anëtar i Bursës.

F.2.4 **Njoftim për Mospërmbushje Detyrimesh**

F.2.4.1 Pas marrjes dijeni të një Mospërmbushje Detyrimesh në lidhje me një Palë, ALPEX-i duhet të lëshojë tek Pala në Mospërmbushje Detyrimesh një Njoftim për Mospërmbushje Detyrimesh.

F.2.4.2 ALPEX-i specifikon në një Njoftim për Mospërmbushje Detyrimesh;

- (a) natyrën e Mospërmbushjes së Detyrimeve;
- (b) nëse Mospërmbushja e Detyrimeve është e mundur të korrigjohet, kohën nga data e Njoftimit për Mospërmbushje Detyrimesh, brenda së cilës i kërkohet Palës Mospërmbushëse e Detyrimeve të korrigjojë këtë Mospërmbushje; dhe

- (c) çdo veprim tjetër që ALPEX-i mund ti kërkojë në mënyrë të arsyeshme Palës Mospërbushëse së Detyrimeve të ndërmarrë në lidhje me Mospërbushjen e Detyrimeve.
- F.2.4.3 Pala në Mospërbushje Detyrimesh duhet të respektojë kërkesat e Njoftimit të Mospërbushjes së Detyrimeve.
- F.2.4.4 Para marrjes së masave të përcaktuara në seksionin F.2 për trajtimin e rasteve të Mospërbushjes së Detyrimeve, ALPEX-i do të njoftojë menjëherë Autoritetin Rregullator për Mospërbushjen dhe t'iu sigurojë atyre të dhënat e Anëtarit të Klerimit që është në Mospërbushje të Detyrimeve. ALPEX-i gjithashtu do të mbajë të informuar Autoritetin Rregullator lidhur me çdo masë të marrë për Mospërbushjen e Detyrimeve dhe mënyrën e trajtimit të saj.
- F.2.5 Pezullimi**
- Në rast se Anëtari i Klerimit në Mospërbushje të Detyrimeve nuk ka mundësinë që ta korrigjojë atë, atëherë ALPEX-i do të lëshojë një Urdhër Pezullimi në të njëjtën kohë ose pas lëshimit të Njoftimit për Anëtarin e Klerimit në Mospërbushje të Detyrimeve në lidhje me këtë Mospërbushje, lëshon një Urdhër Pezullimi në lidhje me Llogaritë e Klerimit të Anëtarëve të Bursës të kontraktuar siç mund të jetë rasti. Një Urdhër Pezullimi i lëshuar sipas këtij paragrafi ka efekt të menjëhershëm.
- F.2.5.1 ALPEX-i mund, të lëshojë një Urdhër Pezullimi në lidhje me të gjithë ose cilindo Portofol të Anëtarëve të Bursës kur;
- (a) bëhet e paligjshme që një Anëtar i Bursës të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes;
 - (b) bëhet e paligjshme që Lëshuesi i LoG të një Anëtari Klerimi të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij të detyrimit të Garancisë;
 - (c) Një Kërkesë Ligjore e nevojshme për të mundësuar një Anëtar i Klerimit ose Lëshuesi i LoG për të përmbushur detyrimet dhe funksionet e tij sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes ndryshohet ose revokohet në tërësi ose pjesërisht në mënyrë që të parandalojë një Palë ose Lëshuesi i LoG nga përmbushja e detyrimeve dhe funksioneve të saj sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes;
 - (d) Një Anëtar i Klerimit ose Lëshuesi i LoG pezullon ose pushon së kryeri veprimtarinë e tij, ose çdo pjesë të veprimtarisë të tij që është relevant për veprimtarinë e tij në kuadrin e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes;
 - (e) Një Lëshues i LoG të një Anëtari Klerimi nuk është më i përshtatshëm për qëllimet e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për të qenë në gjendje të sigurojë Kufirin e Kreditit dhe Pala nuk ka siguruar një Lëshues tjetër LoG.
- F.2.5.2 Kur ALPEX-i lëshon një Urdhër Pezullimi, ALPEX-i në të njëjtën kohë dërgon një kopje të Urdhrit të Pezullimit tek Autoriteti Rregullator dhe e publikon atë në faqen e tij zyrtare të internetit.
- F.2.5.3 Në lidhje me Mospërbushjen e Detyrimeve të një Anëtari Klerimi, ALPEX-i duhet të marrë masat e parashikuara në këtë Procedurë, veçanërisht ato në lidhje me ndalimin e Anëtarëve të Bursës që klerojnë transaksionet e tyre nëpërmjet Llogarive

të Klerimit të Anëtarit në Mospërbushje Detyrimesh për të futur Urdhërporosi në ETSS, pa paragjykitime ndaj dispozitave të paragrafit F.2.1.2.

F.2.6 Efekti i Urdhrit për Pezullim

- F.2.6.1 Kur ALPEX-i lëshon një Urdhër për Pezullim, ky Urdhër specifikon Llogarinë e Klerimit të Anëtarit të Bursës të cilit i aplikohet Urdhri për Pezullim, datën dhe orën nga e cila pezullimi do të hyjë në fuqi dhe kushtet e pezullimit.
- F.2.6.2 Kur një Urdhër për Pezullim hyn në fuqi, Anëtari i Bursës tek i cili zbatohet Urdhri për Pezullim pezullohet nga pjesëmarrja në Bursë deri në momentin kur ALPEX-i publikon një njoftim ku thuhet se:
- (a) Urdhri për Pezullim ose është hequr ose do të hiqet (duke specifikuar datën dhe orën)
- F.2.6.3 ALPEX do të heqë Urdhrin e Pezullimit nëse Pala ka korigjuar çështjen ose çështjet për të cilat ka lindur Urdhri i Pezullimit, ose rrethanat për lëshimin e Urdhrit të Pezullimit nuk janë më të aplikueshme.
- F.2.6.4 Kur një Urdhër Pezullimi është hequr nga ALPEX-i, ALPEX-i do të njoftojë Autoritetin Regullator dhe do të publikojë njoftimin që Urdhri i Pezullimit është hequr.

F.3 PËRFUNDIM VULLNETAR NGA NJËRA PALË

F.3.1 Dispozita të përgjithshme

- F.3.1.1 Në varësi të paragrafit F.3.1.2 më poshtë, një Anëtar Klerimi mund të aplikojë në çdo kohë që të pushojë së qënuri Anëtar Klerimi.
- F.3.1.2 Një Anëtar Klerimi do të paraqesë një njoftim me shkrim tek ALPEX-i të paktën 30 Dite kalendarike përpara në rastin e Anëtarit Personal të Klerimit dhe të paktën 60 Dite kalendarike përpara në rastin e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, lidhur me qëllimin e tij për të pushuar së qënuri Anëtar Klerimi dhe do të specifikojë kohën dhe datën në të cilën ai dëshiron që Përfundimi të hyjë në fuqi.
- F.3.1.3 Pas marrjes së një kërkesë për Përfundim Vullnetar, ALPEX-i lëshon urdhrin e pëlqimit për Përfundim Vullnetar nëse Anëtari i Klerimit përkatës ka respektuar kushtet e mëposhtme;
- (a) të gjitha shumat e detyrueshme dhe të pagueshme nga Anëtari i Klerimit përkatës në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes janë paguar plotësisht;
- (b) ndonjë shumë e papaguar nga Anëtari i Klerimit përkatës sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, e cila është në gjendje të korigjohet, është korigjuar;
- F.3.1.4 ALPEX-i mund të zgjasë afatin kohor të përcaktuar në paragrafin F.3.1.2 në varësi të detyrimeve të prapambetura të Anëtarit të Klerimit, ose nevojës për të mbrojtur ALPEX-in kundër rreziqeve të afërta, veçanërisht në rastin e Mospërbushjes së një Anëtarit tjetër të Klerimit, në përputhje me paragrafin F.3.1.6. Në rast se afati kohor është modifikuar, efektet e Përfundimit Vullnetar të marrëveshjeve përkatëse, të referuara në paragrafin F.3.1.2, zbatohen që nga data e pranimit të dorëheqjes nga ALPEX-i, e cila do të bëhet jo më vonë se skadimi i afatit të ri.

- F.3.1.5 Nëse plotësohen kushtet e paragrafëve F.3.1.2 dhe F.3.1.4, ALPEX-i lëshon urdhrin e pëlqimit për Përfundim Vullnetar dhe informon Anëtarin e Klerimit si dhe Autoritetin Rregullator me shkrim. Nëse ALPEX-i nuk e pranon Përfundimin Vullnetar, do të jap një përgjigje të arsyetuar me shkrim.
- F.3.1.6 Pas përmbushjes të të gjitha detyrimeve të Anëtarit të Klerimit ndaj ALPEX-it, ky i fundit do t'i kthejë atij Garancinë në para dhe/ose Letër Garancinë Bankare që i janë dhënë nga Anëtari i Klerimit ALPEX-it dhe, me pranimin e Përfundimit Vullnetar të tij, ALPEX-i do t'i kthejë Anëtarit të Klerimit gjendjen e Pjesës Proporcionale në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve. Në qoftë se, përpara datës së pranimit të Përfundimit Vullnetar në përputhje me paragrafin F.3.1.5, një tjetër Anëtar i Klerimit është në Mospërmbushje të Detyrimeve, Pjesa Proporcionale e Anëtarit të dorëhequr të Klerimit do të kthehet vetëm pas aplikimit të procesit lidhur me Hapat për përdorimin e Fondit në Mospërmbushje të Detyrimeve (default waterfall) sipas seksionit G.5.3 kundrejt Anëtarit të Klerimit në Mospërmbushje Detyrimesh dhe vetëm nëse kjo Pjesë Proporcionale ka gjendje.
- F.3.1.7 Përfundimi Vullnetar nga statusi i Anëtarit të Klerimit nuk përjashton mundësinë e ri-marrjes së këtij statusi. Nëse Anëtari i Klerimit është në Mospërmbushje të Detyrimeve që rezultojnë në përdorimin e Pjesës Proporcionale të Anëtarëve të tjerë të Klerimit në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve ose të Burimet Personale të Dedikuara në përputhje me seksionin G.5.3, në mënyrë që të ri-marrë statusin e Anëtarit të Klerimit, ky Anëtar Klerimi në Mospërmbushje duhet së pari të shlyejë plotësisht shumat e përdorura të sipërpërmendura që detyroheshin prej tij.
- F.3.1.8 Kushtet dhe procedura në lidhje me Përfundimin Vullnetar mund të specifikohet më tej me një Vendim Teknik të ALPEX-it.

F.4 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

F.4.1 Të përgjithshme

- F.4.1.1 Një "Mosmarrëveshje" do të thotë çdo pretendim, mosmarrëveshje ose dallim të çfarëdo natyre ndërmjet secilës prej Palëve që do të lindë sipas, nga ose në lidhje me këto Procedura ose Marrëveshjen Kuadër për Klerim (duke përfshirë ekzistencën ose vlefshmërinë e së njëjtës) në lidhje me të cilën një Palë ka dërguar një Njoftim për Mosmarrëveshje.
- F.4.1.2 Një Njoftim Mosmarrëveshjeje mund t'i dërgohet një numri të caktuar Palësh. Kur ALPEX-i në mënyrë të arsyeshme përcakton se zgjidhja e një situatë mosmarrëveshjeje do të ndikojë mbi një Palë të tretë që nuk i është dorëzuar një Njoftim Mosmarrëveshjeje, ALPEX-i do të informojë palën e tretë për ekzistencën, natyrën dhe ecurinë e Mosmarrëveshjes, duke ruajtur konfidencialitetin e Palëve në Mosmarrëveshje.
- F.4.1.3 Njoftimi i Mosmarrëveshjes do të përcaktojë shkurtimisht natyrën e Mosmarrëveshjes dhe çështjet e përfshira. Një kopje e Njoftimit të Mosmarrëveshjes do të dërgohet në ALPEX dhe, kur ALPEX-i është palë në Mosmarrëveshje, tek Autoritetet Rregullatore.

F.4.1.4 Palët mund të kërkojnë zgjidhje të përkohshme ose të ndërmjetme drejtpërdrejt nga një Gjykatë kompetente.

F.4.2 **Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

F.4.2.1 Palët në Mosmarrëveshje do të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore përpara së të fillojë ndonjë procedurë gjyqësore.

F.4.3 **Procedurat gjyqësore**

F.4.3.1 Çdo Mosmarrëveshje në lidhje me të cilën është lëshuar një njoftim mosmarrëveshje mund të zgjidhet përfundimisht vetëm nëpërmjet procedimit në një Gjykatë të Tiranës apo Prishtinës siç mund të jetë rasti.

F.5 **KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË**

F.5.1.1 ALPEX-i nuk do të jetë në asnjë rrethanë përgjegjës ndaj asnjë Pale tjetër në lidhje me çdo shkelje të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes ose të Marrëveshjes Kuadër për Klerim ose të ndonjë përgjegjësie kontraktuale ose jo-kontraktuale, përveç për sjellje të gabuar të qëllimshme ose neglizhencë të rëndë. ALPEX-i nuk është përgjegjës për:

- (a) humbjen e fitimeve, humbjen e të ardhurave, humbjen e kontratës, humbjen e kursimeve të parashikuara, humbjen e kthimit të investimit, humbjen e emrit të mirë (goodwill), humbjen e përdorimit ose prishjen e reputacionit;
- (b) çdo humbje që mund t'i shkaktohet një Anëtari Klerimi ose ndonjë palë e tretë për shkak të ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore sipas Seksionit F.6.7, duke përfshirë por pa u kufizuar ose shkaqe të tjera përtej kontrollit të ALPEX-it; ose
- (c) Kompensimin e çdo humbjeje që i është shkaktuar një Anëtari Klerimi, Anëtari të Bursës në Tregjet e ALPEX-it ose ndonjë palë e tretë, e cila është për shkak të dështimit të EMCS-së, si pasojë e rasteve të sipërpërmendura të forcës madhore, qoftë edhe të përkohshme, ose është për shkak të humbjes së të dhënave të mbajtura në EMCS ose për ndonjë përdorim mashtrues të EMCS-së ose të dhënave të tij nga palë të treta;

F.6 **MASA KUNDREJT ANËTARËVE TË KLERIMIT**

F.6.1 **Llojet e masave**

F.6.1.1 ALPEX-i mund të marrë masat e mëposhtme kundër Anëtarëve të Klerimit:

- (a) Vërejtje me shkrim.
- (b) Vendorsja e kushteve ose kufizimeve në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit në Klerimin ose Shlyerjen e Transaksioneve.
- (c) Ndalimi i pjesëmarrjes së një Agjenti Klerues i Certifikuar në Klerimin e Transaksioneve.
- (d) Vendorsja e gjobave, nga 100 Euro (njëqind) deri në 20,000 Euro (njëzetmijë), të cilat janë dakorduar për tu paguar në rast se kemi një fajësi nga mos

performanca ose performancë jo e duhur ose Mospërbushje që vijnë nga dispozitat e kësaj Procedure. Në rastet kur nga Mospërbushja e Detyrimeve rezulton një diferencë në para në favor të këtij Anëtar, ALPEX-i do ta rimburojë këtë shumë me gjobën e vendosur me sipër. Vendosja e gjobave të mësipërme nuk do të paragjykojë pretendimet e ALPEX-it për kompensim të humbjeve të shkaktuara nga ky Anëtar Klerimi. Bie dakord që gjobat e mësipërme përbëjnë një sanksion për tu vendosur në pikëpamje të rëndësisë jetike të përbushjes së duhur dhe në kohë të detyrimeve të përcaktuara në dispozitat e kësaj Procedure me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt të Tregjeve të ALPEX-it dhe Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë.

- (e) Pezullimi i statusit të Anëtarit të Klerimit për një periudhë të tillë siç përcaktohet në çdo rast nga ALPEX-i, kur kjo është e nevojshme për shkak të paaftësisë së përkohshme të një Anëtar Klerimi për të përbushur detyrimet e tij, veçanërisht në lidhje me papajtueshmërinë e kërkesave për mbikëqyrje. Gjatë peridhës së Pezullimit Anëtar i Klerimit është ndaluar të marrë pjesë në Klerimin dhe Shlyerjen e Transaksioneve. Vendosja e masës së pezullimit nuk e shkarkon Anëtarin e Klerimit nga detyrimet e tij kundrejt ALPEX-it për të paguar ndonjë borxh, duke përfshirë, por pa u kufizuar në detyrimet e tij për të paguar tarifën vjetore, komisionet dhe të tjera tarifa të vendosura nga ALPEX-i mbi Anëtarët e Klerimit, edhe nëse detyrime të tilla lindin gjatë periudhës së pezullimit.
- (f) Përfundimi i anëtarësimit të Anëtarit të Klerimit sjell humbjen e menjëhershme dhe të detyrueshme të statusit të Anëtarit të Klerimit. Vendosja e masave të tilla sjell menjëherë detyrimin për të paguar të ndonjë dhe të gjitha pretendimeve të ALPEX-it kundrejt Anëtarit të Klerimit, të cilat duhet të përbushen menjëherë, plotësisht dhe siç duhet sipas udhëzime të ALPEX-it. Në lidhje me kthimin e Garancisë dhe kontributeve në Pjesën Proporcionale të Anëtarit të Klerimit, zbatohen dispozitat e kapitullit F.3 sipas rastit.

F.6.1.2 Vendosja e masave ndaj një Anëtar Klerimi në asnjë rrethanë nuk e liron atë nga përgjegjësia e tij për çdo veprim ose mosveprim të tij kundrejt ALPEX-it.

F.6.2 Rrethanat për vendosjen e masave

F.6.2.1 ALPEX-i do të vendosë masat e përcaktuara në seksionin F.6.1, sipas mënyrës së duhur, për rastet e parashikuara nga paragrafi F.6.2.2 deri në paragrafin F.6.2.10.

F.6.2.2 Çdo shkelje nga një Anëtar i Klerimit të dispozitave të kësaj Procedure, në veçanti:

- (a) Kur një Anëtar i Klerimit nuk i plotëson fare ose nuk i plotëson siç duhet kushtet e nevojshme për anëtarësim si Anëtar i Klerimit, siç mund të jenë:
 - (i) Mungesa e pamjaftueshmërisë së kërkuar organizative dhe operacionale të Anëtarit të Klerimit.
 - (ii) Pakësimi i fondeve të veta të Anëtarit të Klerimit nën minimumin e kërkuar për marrjen e statusit të Anëtarit të Klerimit.

- (iii) Dështimi i punonjësit të Anëtarit të Klerimit i cili kryen detyrat e Agjentit Klerues të Certifikuar për të përmbushur kriteret e pranimit.
 - (iv) Mospërmbushja e Detyrimeve ose vonesa e pagimit në kohë të tarifave të anëtarësisimit dhe tarifave të tjera dhe të detyrimeve në përgjithësi të Anëtarit të Klerimit ndaj ALPEX-it.
 - (v) Dështimi për të përmbushur kërkesat që kanë të bëjnë me Klerimin ose Shlyerjen e Transaksioneve, sipas rastit.
- (b) Papajtueshmëria e një Anëtari Klerimi me udhëzimet teknike të ALPEX-it ose me specifikimet teknike të përcaktuara nga ALPEX-i për përdorimin dhe funksionimin e sistemeve të shfrytëzuara nga Anëtari i Klerimit për të marrë pjesë në Procedurën e Klerimit ose Shlyerjes.
 - (c) Përdorimi ose keqpërdorimi i paligjshëm ose i paautorizuar i sistemeve të përdorura nga një Anëtar Klerimi për pjesëmarrjen e tij në Klerim ose Shlyerjen e Transaksioneve.
 - (d) Papajtueshmëria e një Anëtari Klerimi me kërkesat e përcaktuara nga ALPEX-i në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Klerim ose Shlyerje, si për shembull:
 - (i) Mos sigurimi i Garancisë së kërkuar për ALPEX-in ose mos depozitimi i kontributeve të nevojshme në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve.
 - (ii) Monitorim i pamjaftueshëm i rreziqeve që dalin nga Pozicionet e Llogarive të Klerimit të mbajtura nga Anëtari i Klerimit.
 - (iii) Dështimi i Anëtarit të Klerimit për të përmbushur detyrimet e tij ose për të vepruar sipas udhëzimeve të ALPEX-it në lidhje me menaxhimin e Mospërmbushjes së Detyrimeve në Llogaritë e Klerimit që mban ose përmbushjen me vonesë të detyrimeve të tij.
- F.6.2.3 Dorëzimi nga një Anëtar Klerimi i informacioneve të rreme në ALPEX, si në rastet e mëposhtme:
- (a) Me dorëzimin e aplikimit për fitimin e statusit të Anëtarit të Klerimit.
 - (b) Kur hap ose përdor ndonjë nga Llogaritë e Klerimit të Anëtarit në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Klerim ose Shlyerjen e Transaksioneve.
 - (c) Me dorëzimin e të dhënave, dokumenteve mbështetëse ose informacioneve të kërkuara Anëtarit nga ALPEX-i herë pas here.
- F.6.2.4 Dështimi i një Anëtari Klerimi për të vepruar në përputhje me njoftimet, vendimet ose udhëzimet e ALPEX-it.
- F.6.2.5 Mospërmbushja ose përmbushja e pjesëshme e detyrimeve të një Anëtari Klerimi që rrjedhin nga një apo të gjitha kontratat e nënshkruara me ALPEX-in, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kontratat teknike dhe kontratat e përgjithshme të nënshkruara nga Anëtari me ALPEX-in me qëllim lidhjen me EMCS-në, si dhe çdo detyrim tjetër që rrjedh nga angazhimet e ndërmarra nga Anëtari i Klerimit ndaj ALPEX-it.
- F.6.2.6 Veprimet ose mosveprimet e një Anëtari Klerimi që dëmtojnë reputacionin dhe pozicionin e ALPEX-it ose diskreditojnë shërbimet e ofruara dhe aktivitetet e ushtruara nga ALPEX-i.

F.6.2.7 Ndodhja e ngjarjeve që ndikojnë në funksionimin e një Anëtari Klerimi, të tilla si shpërbërja e ndërmarrjes ose shoqërisë së Anëtarit të Klerimit, nisja e procedurave të Paaftësisë paguese, duke përfshirë falimentimin, mbylljen e detyruar ose rehabilitimin e ndërmarrjes së Anëtarit të Klerimit, si dhe revokimin e licencës së Anëtarit të Klerimit për të operuar ose për të ofruar shërbime.

F.6.2.8 Vendosja e sanksioneve ndaj një Anëtari Klerimi nga Autoritetet Kompetente.

F.6.2.9 Marrjen nga ALPEX-i të informacionit nga Autoritetet Kompetente, duke e njoftuar atë se janë vendosur masa kundër një Anëtari Klerimi në mënyrë që të mbrojnë tregun.

F.6.2.10 Sjellje e gabuar e rëndë nga një Anëtar Klerimi në lidhje me pajtueshmërinë e tij me dispozitat ligjore.

F.6.3 **Organet kompetente për vendosjen e masave**

F.6.3.1 Organi përgjegjës për vendosjen e masave ndaj Anëtarëve të Klerimit është Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX-it ose ndonjë nga organet e tij të autorizuar për këtë qëllim. Para se të caktojë një masë, ALPEX-i do të ftojë përfaqësuesit e Anëtarit të Klerimit që të marrin pjesë në një seancë dëgjimore, në një kohë që do të specifikohet në njoftimin përkatës për Anëtarin e Klerimit. Seanca e dëgjimit mund të shmanget nëse ALPEX-i e gjykon të nevojshme vendosjen e menjëhershme të një mase në mënyrë që të mbrojnë tregun e energjisë elektrike dhe interesat e Anëtarëve të Bursës.

F.6.3.2 ALPEX-i, në kuadrin e procedurës për vendosjen e masave ndaj një Anëtari, mund:

- (a) t'i kërkojë Anëtarit të Klerimit të dorëzojë të gjitha të dhënat dhe informacionet që ALPEX-i i gjykon të nevojshme në mënyrë që të shqyrtojë çështjen në fjalë;
- (b) t'u kërkojë një ose më shumë punonjësve, drejtuesve, përfaqësuesve dhe administratorëve të Anëtarit të Klerimit të paraqiten personalisht përpara tij;
- (c) të kërkojë ndërprerjen e menjëhershme të praktikave ose procedurave të aplikuara nga Anëtari i Klerimit kur merr pjesë në Klerim dhe Shlyerje.

F.6.3.3 ALPEX-i mund të vendosë masa mbi një Anëtar Klerimi veçmas ose të kombinuar me Anëtarë të tjerë, sipas rastit, duke marrë parasysh çdo herë të gjitha rrethanat përkatëse.

F.6.3.4 Vendimi për vendosjen e masave duhet t'i komunikohet zyrtarisht Anëtarit të Klerimit.

F.6.4 **Rishikimi i vendimeve**

F.6.4.1 Në rastin kur Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX-it ose ndonjë nga organet e tij të autorizuar për këtë qëllim, merr vendim për të vendosur masa ndaj një Anëtari Klerimi, ky vendim mund të jetë objekt rishikimi me kërkesë të Anëtarit të Klerimit nga Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX-it, bazuar në një ankim të paraqitur me shkrim nga Anëtari i Klerimit, brenda një periudhe prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga komunikimi i vendimit ndaj Anëtarit të Klerimit.

F.6.4.2 Nëse ALPEX-i refuzon një aplikim për marrjen e statusit të Anëtarit të Klerimit, ky refuzim mund të jetë objekt i ri-shqyrtimit nga Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX-it, me

kërkesë të Anëtarit të Klerimit, të paraqitur brenda një periudhe prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga komunikimi i vendimit ndaj Anëtarit të Klerimit.

F.6.4.3 Vendimet mbi shqyrtimin e kërkesës i komunikohen Anëtarit të Klerimit.

F.6.5 **Zbatimi i vendimeve**

F.6.5.1 Në qoftë se vendimi për vendosjen e masave mbi një Anëtar Klerimi bëhet përfundimtar dhe i përvokueshëm, ai zbatohet nga ALPEX-i. Në rast se një gjobë i është vënë Anëtarit të Klerimit, Anëtari i Klerimit duhet të paguajë shumën përkatëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga data në të cilën vendimi përkatës është bërë përfundimtar dhe i përvokueshëm.

F.6.6 **Njoftimi**

F.6.6.1 Ftesat për një seancë dëgjimore ose vendimet e ALPEX-it do t'i komunikohen Anëtarit të Klerimit me çdo mjet të përshtatshëm të zgjedhur nga ALPEX-i, duke përfshirë mënyrën elektronike.

F.6.6.2 ALPEX-i në çdo rast njofton Autoritetin Rregullator në lidhje me:

(a) vendosjen e një mase ndaj një Anëtari Klerimi, duke u siguruar atyre të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme lidhur me shkeljet përkatëse ose arsyet e vendosjes së masës;

(b) heqjen e një mase, kur nuk ka më arsye për ta mbajtur atë.

F.6.6.3 ALPEX mund të bëj publik me çdo mjet të përshtatshëm sipas zgjedhjes së tij vendosjen e një mase ndaj një Anëtari Klerimi dhe heqjen e saj.

F.6.7 **Ngjarja e Forcës Madhore**

F.6.7.1 Ngjarja e Forcës Madhore ka kuptimin e Kapitullit G.4 “Forca Madhore” të Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

F.6.8 **Publikimi i procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes**

F.6.8.1 ALPEX-i do të publikojë versionin aktual dhe efektiv të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Data e publikimit të versionit të plotë të ndryshuar të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes nuk do të ndikojë në datën e hyrjes në fuqi të Ndryshimit përkatës.

F.6.8.2 ALPEX-i gjithashtu do të publikojë në çdo kohë një listë të Ndryshimeve efektive të cilat janë miratuar por ende nuk janë përfshirë në versionin e aktual të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

F.6.8.3 ALPEX-i nuk është i detyruar të publikojë ndonjë material që në mënyrë të arsyeshme beson se mund të jetë i një natyre të pahijshme, të turpshme ose të ngjashme me to.

F.6.9 **Sekreti**

F.6.9.1 Funkcionimi i EMCS-së udhëhiqet nga dispozitat mbi sekretin profesional të legjisllacionit në fuqi.

F.6.9.2 Dhënia nga ALPEX-i e informacionit që ka regjistruar, lejohet në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi ose që konsiderohet e nevojshme për zbatimin e kësaj Procedurë.

F.6.9.3 ALPEX-i është i detyruar të respektojë sekretin profesional në lidhje me të gjitha të dhënat, faktet dhe informacionin që i vihen për dijeni atij si pjesë e Procedurës për vendosjen e masave kundër një Anëtari Klerimi.

F.6.9.4 Pa cenuar dispozitat në fuqi për sekretin, ALPEX-i mundet me rastet përjashtuese të ofrojë të dhëna, fakte dhe informacione të tilla për:

- (a) Autoritetet Kompetente të cilat kanë të drejtë me ligj për të aksesuar dhe inspektuar të dhënat, faktet dhe informacionin përkatës;
- (b) çdo entitet tjetër Klerimi ose Shlyerje me të cilën ALPEX-i bashkëpunon, me kusht që entitete të tilla janë ligjërisht ose kontraktualisht të detyruara të respektojnë sekretin profesional për shkak të bashkëpunimit të tyre me ALPEX-in.

F.6.10 **Njoftimet e ALPEX-it**

F.6.10.1 Njoftimet që kërkohen të publikohen nga ALPEX-i do të publikohen në faqen e tij të internetit brenda afatit kohor të të përcaktuar në këtë Procedurë të Klerimit dhe Shlyerjes.

G. PROCEDURA E SHLYERJES FINANCIARE

G.1 TË PËRGJITHSHME

G.1.1 Qëllimi

G.1.1.1 Ky kapitull:

- a) specifikon veprimtaritë dhe proceset për shlyerjen të pagesave dhe llogaritjen e tarifave;
- b) përcakton veprimtarinë për llogaritjen dhe shlyerjen e Tarifave në Tregjet e ALPEX-it; dhe
- c) përcakton veprimtarinë bankare dhe Garancisë për të mbështetur shlyerjen e këtyre pagesave dhe tarifave.

G.1.2 Elementet e Shlyerjes

G.1.2.1 ALPEX-i do të kryejë ose garantojë Shlyerjet në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes të vlerave të mëposhtme:

- a) Pagesat e Tregtimit për çdo Faturë;
- b) Tarifat Variabël të Tregtimit dhe të Klerimit të pagueshme nga Anëtarët e Bursës nëpërmjet Anëtarëve të Klerimit në lidhje me Llogaritë e Klerimit të tyre për çdo Faturë;
- c) Tarifat Fikse të pagueshme nga Anëtarët e Bursës dhe/ose Anëtarët e Klerimit sipas Listës së Tarifave të ALPEX-it për çdo Vit ose periudhë me të cilën lidhen këto tarifate;
- d) Tarifate Fikse të pagueshme nga Anëtarët e Klerimit në lidhje me çdo depozitim ose zëvendësim të LoG;

G.1.2.2 Të gjitha pagesat dhe tarifate të përcaktuara në paragrafin G.1.2.1 do të llogariten në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes dhe do të aplikohet TVSH-ja ose të tjera taksa sipas ligjit.

G.1.3 Monedha

G.1.3.1 Shlyerja e Transaksionit do të jenë në Euro për tregun e Shqipërisë dhe të Kosovës, dhe në Lekë për tregun e Shqipërisë vetëm në raste specifike të parashikuara në paragrafin G.1.3.3. Kursi i Këmbimit ndërmjet Euro dhe Lekë, është kursi fiks i këmbimit i publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e faturës përkatëse.

G.1.3.2 Tarifate Fikse në lidhje me Tregjet e ALPEX-it për Shqipërinë do të shlyhen në Lekë nga Anëtari i Klerimit dhe nga Anëtari i Bursës nëse është rezident në Shqipëri. Kursi i Këmbimit ndërmjet Euro dhe Lekë, është kursi fiks i këmbimit i publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e faturës përkatëse.

G.1.3.3 Të gjitha pagesat në respekt të Shlyerjes së Transaksioneve për Kontratën Dypalëshe - Over the Counter (OTC) në lidhje me çmimin e rregulluar ndërmjet Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU sh.a) dhe Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a) do të jetë në Lekë. Kursi i Këmbimit ndërmjet Euro dhe

Lekë, do të jetë kursi fiks i këmbimit i publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e faturës përkatëse.

G.1.4 Veprimtaritë Bankare

G.1.4.1 Njëpërmjet kontratës së tij me Bankën për Shlyerje, ALPEX-i, administron shërbimet e nevojshme bankare në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes për Anëtarët e Bursës dhe/ose Anëtarët e Klerimit. ALPEX-i dhe çdo Anëtar i Bursës dhe/ose Anëtar i Klerimit, në çdo rast në lidhje me këto veprimtari bankare që duhet të jenë në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, i merr, i përdor, i vë në dispozicion dhe i administron këto veprimtari bankare në përputhje me paragrafin G.1.6.1.

G.1.5 Banka për Shlyerje

G.1.5.1 Banka për Shlyerje do të jetë një bankë e cila duhet të ketë Licencë Bankare për operim të dhënë nga Banka Qendrore e Shqipërisë ose Kosovës sipas rastit.

G.1.6 Elementet e Veprimtarisë Bankare

G.1.6.1 Veprimtaritë Bankare përbëhen nga shtatë elementë kryesorë që ndikojnë ose rezultojnë nga aktivitetet e Anëtarëve të Bursës dhe/ose Anëtarëve të Klerimit:

- a) Shumat që do të paguhën nga Anëtarët e Klerimit sipas kësaj Procedure.
- b) Shumat që do të paguhën nga Anëtarët e Bursës sipas kësaj Procedure.
- c) Përdorimi e parave nga Llogaria Bankare e Garancisë në Para.
- d) Ekzekutimi i Letër Garancisë (LoG)
- e) Depozitimet në Llogarinë e Garancisë në Para
- f) Depozitimi në Llogaritë e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Anëtarët e Klerimit
- g) Depozitimi i interesit dhe Tarifave Fikse dhe Variabël nga Anëtarët e Bursës dhe/ose Anëtarët e Klerimit

G.2 LLOGARITË BANKARE PËR SHLYERJE

G.2.1 Llogaritë Bankare për Shlyerje

G.2.1.1 Llogaritë Bankare për Shlyerje të ALPEX-it do të jenë në emër të ALPEX-it dhe në monedhën Euro dhe/ose Lekë.

G.2.1.2 ALPEX-i do të krijojë dhe përdori në përputhje me këtë Procedurë:

- (a) Dy Llogari për Shlyerje në monedhën Euro pranë Bankës për Shlyerje në Shqipëri dhe dy Llogari për Shlyerje në Euro pranë Bankës për Shlyerje Kosovë; dhe
- (b) Dy Llogari për Shlyerje në Lekë pranë Bankës për Shlyerje në Shqipëri,

Nga dhe tek të cilat do të shlyhen të gjitha Pagesat e Tregtimit dhe shlyerja e Tarifave Fikse dhe Variabël të llogaritura në përputhje me këtë Procedurë.

- G.2.1.3 Çdo Llogari për Shlyerje për Pagesat e Tregtimit do të jetë një llogari me interes. Interesi mund të jetë negativ ose pozitiv. Çdo interes i kredituar dhe/ose i debituar për shumat e mbajtura në Llogaritë për Shlyerje do të mblidhet dhe i përket ALPEX-it.
- G.2.1.4 Këto llogari do të përdoren për të arkëtuar dhe paguar të gjitha Pagesat e Tregtimit dhe për të arkëtuar Tarifatat Fikse dhe Variabël të llogaritura në përputhje me këtë Procedurë.
- G.2.1.5 Llogaritë për Shlyerje të Anëtarit të Klerimit
- a) Për Shlyerjen e Transaksioneve, çdo Anëtar Personal i Klerimit dhe Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit duhet të mbajë Llogaritë e nevojshme për Shlyerje në Bankën për Shlyerje, në përputhje me dispozitat e Vendimit Teknik përkatës të ALPEX-it.
 - b) Llogaritë për Shlyerje shfaqen në EMCS dhe tregojnë gjendjen e kredisë ose debisë, që është përkatësisht i pagueshëm ose i arkëtueshëm nga Anëtari i Klerimit.
 - c) Çdo Anëtar i Klerimit duhet të njoftojë ALPEX-in në lidhje me numrin e Llogarive për Shlyerje që i përkasin atyre, nëpërmjet të cilave do të përmbushë detyrimet e tij monetare në lidhje me të gjitha Pagesat e Tregtimit dhe shlyerjen e Tarifave Fikse dhe Variabël të llogaritura në favor të ALPEX-it.

G.2.2 Llogaria Bankare e Garancisë në Para

- G.2.2.1 Këto llogari do të përdoren nga Anëtari i Klerimit i cili do të dërgojnë në to një pjesë ose të gjithë kufirin e tyre të Kreditit në formën e Garancisë në Para.
- G.2.2.2 Kur një Anëtar Personal i Klerimit vendos të sigurojë një depozitë të tillë monetare, atëherë Anëtari i Klerimit do të udhëzojë ALPEX-in të krijojë dhe të mbajë Llogaritë Bankare të Garancisë në Para në Bankën për Shlyerje. Këto llogari do të jetë vetëm në emër të ALPEX-it dhe do të mbahen në mirëbesim siç përshkruhet më tej në këtë Procedurë.
- G.2.2.3 Në rastin e Anëtarit të Përgjithshëm Klerimi, kjo llogari mund të mbahet në të njëjtën bankë dhe/ose Bankën Qendrore dhe vetëm në emër të ALPEX-it.
- G.2.2.4 Për shmangur dyshimet, ALPEX-i nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ose detyrim për asnjë humbje ose mungesë që lind si rezultat i normave negative të interesit të aplikuar për ndonjë nga Llogaritë Bankare e Garancisë në Para.

G.2.3 Parashikimi i Garancisë në Para

- G.2.3.1 Llogaria Bankare e Garancisë në Para në lidhje me secilin Anëtar Klerimi do të përmbajë vlera monetare të Kufirit të Kreditit të këtij Anëtar Klerimi sipas kushteve të mëposhtme:
- a) Llogaria Bankare e Garancisë në Para do të jetë vetëm në emër të ALPEX-it me emërtimin "**Llogaria Bankare e Garancisë në Para në lidhje me [Vendos të dhënat e Anëtarit të Klerimit]**";

- b) Anëtari Personal i Klerimit dhe ALPEX-i do të nënshkruajnë një formular Udhëzimi Bankar, i cili do të udhëzojë në mënyrë të pakthyeshme Bankën për Shlyerje për të kryer pagesën vetëm me udhëzim të ALPEX-it. Në rast se ka ndonjë Mungesë, ALPEX-i mund të tërheqë fonde nga këto llogari për ta plotësuar këtë Mungesë siç përshkruhet më tej në këtë Procedurë. Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes do të ketë përparësi ndaj Udhëzimit Bankar;
- c) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit dhe ALPEX-i do të nënshkruajnë së bashku një formular Udhëzimi Bankar me të njëjtën bankë, ku Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do ta pranojë në mënyrë të parevokueshme për të kryer pagesën vetëm me udhëzim të ALPEX-it. Në rast se ka ndonjë Mungesë, ALPEX-i mund të tërheqë fonde nga këto llogari për ta plotësuar këtë Mungesë siç përshkruhet më tej në këtë Procedurë. Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes do të ketë përparësi ndaj Udhëzimit Bankar; dhe
- d) Çdo normë interesi, ose përfitime të tjera të marra për Llogaritë e Garancisë në Para (p.sh. interesat e paguara nga Banka për Shlyerje në Llogaritë e Garancisë në Para për Garancitë e depozituara në Para), pavarësisht nga natyra e tyre, do të bëhen automatikisht pjesë e Garancisë dhe nuk do ti kompensohen Anëtarit përkatës të Klerimit të cilit i atribuohet Llogaria Bankare e Garancisë në Para.

G.2.3.2 Nëse një Anëtar i Klerimit që ka ofruar garanci në lidhje me Llogarinë e Klerimit, kërkon ta zvogëloj vlerën e tij, atëherë shuma e mbetur e parave në një kohë të arsyeshme do të transferohet në llogarinë bankare përkatëse të Anëtarit të Klerimit, vetëm nëse nuk ka detyrime që mbuloohen nga Margjina e Llogarisë përkatëse të Klerimit ose të tilla detyrime duhen përmbushur sipas një mënyrë tjetër në përputhje dispozitat e kësaj Procedure. ALPEX-i mund të refuzojë ta kthejë tepricën e Garancisë të përmendur më lart me qëllim mbulimin e ndonjë risku që lidhet ose me Llogarinë përkatëse të Klerimit, ose në rastin e parashikuar në seksionit G.3.3.2, me Llogari të tjera Klerimi të Anëtarit të Klerimit që bën kërkesën.

G.2.3.3 Me anë të një Vendimi Teknik, ALPEX-i mund të specifikojë më tej çdo çështje teknike dhe detaj të nevojshëm në lidhje me zbatimin e kushteve të këtij seksioni.

G.2.3.4 Çdo tarifë bankare për transferimin e fondeve do të mbulohet nga Anëtari i Klerimit (përfituesi paguan të gjitha tarifat bankare).

G.3 Garancia

G.3.1.1 Anëtarëve të Klerimit u kërkohet të sigurojnë garanci në favor të ALPEX-it për të siguruar detyrimet e tyre të Klerimit dhe Shlyerjes ndaj ALPEX-it në përputhje me dispozitat specifike të kësaj Procedure.

G.3.1.2 Garancia do të sigurohet dhe do të ndahet për Llogari Klerimi.

G.3.2 Format e Garancisë

G.3.2.1 ALPEX-i do të pranojë si garanci në para në monedhën Euro ose Lekë. Garancia mund të pranohet sipas një Vendimi Teknik të ALPEX-it, në përputhje me këtë seksion dhe seksionin G.3.3, ose në formën e një Letër Garancie Bankare në përputhje me paragrafin G.3.2.5

- G.3.2.2 Garancia në Para do të depozitohet tek Llogaria e Garancisë në Para e cila do të jetë në monedhën Euro për Tregjet e ALPEX-it në Shqipëri dhe Kosovë ndërkohë do të jetë në Lekë për Tregjet e ALPEX-it në Shqipëri.
- G.3.2.3 Nëse një Anëtar i Klerimit do të paraqesë Garancinë në Para në monedhën Lekë, atëherë vlera e kësaj Garancie do të jetë të paktën 130% e vlerës ekuivalente në Lekë. Për llogaritjen e vlerës ekuivalente në Lekë, ALPEX-i do të referohet kursit të Bankës së Shqipërisë e specifikuar në Vendimin Teknik.
- G.3.2.4 Nëse rrethanat lidhur me luhatjet e kursit të këmbimit (Lekë-Euro) do të kërkojnë ALPEX-it të ndryshojë përqindjen e mbulimit me Garanci në Para për monedhën Lekë, kjo do të njoftohet përmes Vendimit Teknik të ALPEX-it i cili do të prekë dhe Garancinë aktuale në Para.
- G.3.2.5 Si garanci, ALPEX-i do të pranojë gjithashtu Letër Garanci Bankare (LoG) në varësi të kushteve të mëposhtme:
- a) LoG e lëshon një Bankë Tregtare e licencuar në Shqipëri ose Kosovë sipas rastit;
 - b) LoG duhet të jetë e përvokueshme dhe pa kushte dhe ai që e lëshon nuk mund të mbështetet tek ndonjë përjashtim ligjor ose kontraktual ose në ndonjë mënyrë mbrojtjeje për të kundërshtuar pagesën e garancisë. Ai që lëshon Letër Garancinë është i detyruar të depozitojë menjëherë shumën e plotë të LoG-së ose një pjesë të saj në llogarinë për Shlyerjes të ALPEX-it, ku ALPEX-i ka të drejtë të kërkojë tërheqjen e LoG brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin Teknik të ALPEX-it;
 - c) LoG mund të kërkohet dhe paguhet, me kërkesë të ALPEX-it, pa asnjë kufizim rregullator, ligjor ose operacional, sipas kërkesës, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Pozicionet që klerohen nga Anëtarët e Klerimit në emër të të cilit ishte lëshuar;
 - d) Lëshuesi i LoG nuk i përket të njëjtit grup me Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit.
 - e) LoG është subjekt i konfirmimit nga ALPEX-i përpara se ajo të lëshohet.
- G.3.2.6 Letra e garancisë bankare lëshohet në një format standard që përcaktohet me Vendim Teknik të ALPEX-it. Bazuar në të njëjtin Vendim Teknik, ALPEX-i mund të specifikojë çdo çështje të lidhur dhe detaj të nevojshëm.
- G.3.2.7 ALPEX, bazuar në Vendimin Teknik të tij, duhet të kategorizojë Garancinë që mund të pranojë, duke vendosur kufij përqindjeje, veçanërisht në lidhje me përqindjet maksimale ose minimale të mbulimit të pranueshëm ose shumën maksimale të mbulimit të pranueshëm për kategori të caktuar.

G.3.3 Të drejtat e ALPEX-it mbi Garancinë

- G.3.3.1 Në rast të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga një Anëtar i Klerimit, ALPEX-i në përputhje me kushtet e këtyre procedurave do të përdorë Garancinë për të mbuluar humbjen e shkaktuar nga Mospërmbushja e Detyrimeve që lidhet vetëm me Llogarinë e Klerimit për të cilën është vendosur Garancia.

G.3.3.2 Për përmbushjen e detyrimeve ndaj ALPEX-it, nuk lejohet përdorimi i Garancisë për një Llogari Klerimi të ndryshme nga ajo e sipërpërmendur, përveç rastit kur përfituesi i Llogarisë është i njëjti Anëtar i Bursës.

G.3.3.3 ALPEX-i ka të drejtën që t'i përdorë paratë që i janë dhënë si garanci, të drejtë që mund ta ushtrojë nëpërmjet Anëtarit të Klerimit dhe në përputhje me:

- a) ALPEX-i, thjesht pasi ka njoftuar Anëtarin e Klerimit, mund të përdorë për kohësisht Garancinë e dhënë, në rast Mospërmbushjeje të Detyrimeve nga ana e Anëtarëve të tjerë të Klerimit për të mbuluar riskun e likuiditetit. ALPEX-i nuk mund ta përdorë këtë garanci nëse përbën Garancinë e Vlefshme për Llogarinë e Klerimit të Anëtarit të Klerimit që ka dhënë Garancinë dhe tashmë i është bërë kërkesë ALPEX-it për kthimin e tij. Anëtarët e Klerimit i japin pëlqimin e tyre me shkrim ALPEX-it që ky i fundit të ushtrojë të drejtën e tij për të përdorur Garancinë – në një formë që u është dhënë në momentin e aplikimit fillestar të paraqitur në përputhje me dispozitat e seksionit C.2.
- b) Nëse ALPEX-i ushtron të drejtën e përdorimit, duhet t'i kthejë të njëjtën shumë në të njëjtën monedhë Anëtarit të Klerimit që ka dhënë Garancinë.
- c) ALPEX-i gjithashtu, në rast Mospërmbushjeje të Detyrimeve të një Anëtari të Klerimit dhe pasi ta njoftojë atë, mund të përdorë Garancinë e dhënë prej tij si mjet pagese dhe Shlyerje të detyrimeve të Procedurës së Klerimit për Transaksionet në Tregjet e ALPEX-it që rrjedhin nga Llogaria përkatëse e Klerimit të Anëtarit të Klerimit si rezultat i Shlyerjes së Transaksioneve, duke aplikuar procedurat e netimit.

G.3.4 **Shlyerja e Transaksioneve**

G.3.4.1 Banka për Shlyerje, ALPEX-i dhe Anëtarët e Klerimit marrin pjesë në Shlyerjen e transaksioneve në përputhje me kushtet e kësaj Procedure.

G.3.4.2 Shlyerja kryhet nga çdo Anëtar Klerimi nëpërmjet Bankës për Shlyerje në bazë të udhëzimeve nga ALPEX-it.

G.3.4.3 Pagesat do të kryhen vetëm nga ALPEX-i dhe Anëtarët e Klerimit në Tregjet e ALPEX-it nëpërmjet EMCS.

G.3.4.4 EMCS duhet të jenë në linjë me praktikat bankare standarde dhe me metodat dhe procedurat e përshkruara në Vendimin Teknik të ALPEX-it.

G.3.5 **Pamundësia për të kryer Shlyerjen në Para**

G.3.5.1 Nëse një Anëtar i Klerimit/Banka për Shlyerje nuk është në gjendje t'i komunikojë menjëherë ALPEX-it gjendjet e Llogarive për Shlyerje dhe të kryejë Shlyerjen në para, ALPEX-i, pasi të jetë informuar për këtë çështje nga Anëtari i Klerimit/Banka për Shlyerje, do të organizojë Shlyerjen me anë të procedurave alternative. Në një rast të tillë, Shlyerja në Para mund të kryhet nga një Anëtar tjetër Klerimi ose nëpërmjet të njëjtit Anëtar në përputhje me procedurat alternative.

G.3.5.2 Kur zbatohet procedura e paragrafit të mësipërm, Anëtarët e Klerimit duhet t'i paguajnë ALPEX-it shumat që i detyrohen sipas udhëzimeve të ALPEX-it. Nëse një Anëtar i Klerimit nuk e paguan shumën e detyrimit, Anëtari i Klerimit do të

konsiderohet në Mospërbushje të Detyrimeve dhe i nënshtrohet zbatimit të dispozitave përkatëse të Kapitullit G të kësaj Procedurë.

G.3.5.3 Nëse paaftësia e sipërpërmendur e Bankës për Shlyerje nuk vlen më, Shlyerja në para mund të vazhdojë normalisht nëpërmjet kësaj Banke në përputhje me udhëzimet dhe direktivat përkatëse të ALPEX-it.

G.3.6 **Parimet e përgjithshme të Shlyerjes**

G.3.6.1 Shlyerja me cikle

- a) Shlyerja e Transaksioneve kryhet në mënyrë të përditshme për çdo Ditë Shlyerje në cikle, të cilat përcaktohen në bazë të Procedurës së ALPEX-it.
- b) Operacionet e Shlyerjes që nuk mund të shlyhen në një cikël të caktuar të Ditës së Shlyerjes, për shkak të mosplotësimit të kushteve të Shlyerjes që i rregullojnë ato, transferohen automatikisht në ciklin që vjen menjëherë më pas, në përputhje me kushtet që rregullojnë Shlyerjen në përputhje me Procedurën përkatëse të ALPEX-it.

G.3.6.2 Kryerja e Shlyerjes

- a) Shlyerja i Transaksioneve në lidhje me EMCS kryhet në baza shumëpalëshe ndërmjet ALPEX-it dhe Anëtarëve të tij të Klerimit.
- b) Shlyerja kryhet për Anëtar Klerimi, Llogari Klerimi dhe Llogari për Shlyerje në lidhje me detyrimet dhe pretendimet që lindin për Ditë Klerimi dhe Ditë Shlyerje. Kërkesat për para dhe detyrimet përkatëse të cilat shlyhen në të njëjtën Ditë Shlyerje janë subjekt i netimit.
- c) Shlyerja kryhet në lidhje me të gjithë Anëtarët e Klerimit, ndërkohë që detyrimi ose pretendimi i secilit Anëtar i Klerimit është i pavarur nga përmbushja e detyrimeve të palës tjetër në Transaksionin përkatës. Shlyerja kryhet në cikle dhe bëhet përfundimtare sa herë që kryhet një pjesë e këtij cikli.
- d) Shlyerja kryhet pavarësisht nga përmbushja ose mospërbushja e detyrimeve monetare të Anëtarit të Bursës në tregjet e ALPEX-it ndaj Anëtarëve të Klerimit dhe anasjelltas.

G.3.6.3 Siç përcaktohet në këtë Seksion, të gjitha detajet proceduriale ose teknike në lidhje me procedurat e zbatuara nga ALPEX-i për sa i përket Shlyerjes së Transaksioneve, për shembull në lidhje me orët e punës të përcaktuara për kryerjen e Shlyerjeve në EMCS, në përputhje me dispozitat e kësaj Procedurë, specifikimet e veçanta të algoritmit të Shlyerjes ose numrit dhe kohëzgjatjes e cikleve të Shlyerjes, do të përcaktohen bazuar në një Vendim Teknik të ALPEX-it, pasi të merren parasysh fillimisht specifikimet teknike dhe procedurat e Anëtarit të Klerimit dhe Bankës për Shlyerje.

G.3.7 **Klerimi dhe Shlyerja në lidhje me palët në kontratat OTC**

G.3.7.1 Transaksionet e Palëve në lidhje me kontratat OTC përkatëse do të klerohen përmes Llogarisë së Klerimit ku në rastin e një Anëtari të Bursës (pala blerëse në OTC-në përkatëse) ky do të vendosë në ETSS, Urdhërporosi Blerjeje Marrëse e Çmimit me Prioritet.

- G.3.7.2 Në rastin e Anëtarit të Bursës (pala shitëse në OTC-në përkatës) do të vendosë Urdhërporosi si Ndikues në Çmim ku, Urdhërporositë do të mbulohen me Garanci nga Anëtari i Klerimit i kontraktuar prej tij, sikur këto Urdhërporosi të ishin Urdhërporosi Blerjeje. Anëtari i Klerimit do të kleroj dhe shlyej Transaksionin përkatës që rrjedh nga vendosja e këtyre Urdhërporosive në respekt të parashikimeve në paragrafin G.3.7.4.
- G.3.7.3 Në rast të kryerjes të transaksioneve në lidhje me Anëtarin e Bursës (si Palë blerëse në OTC-në përkatëse) do të rezultojë me mos mbulimin e plotë me garanci prej Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit të kontraktuar prej tij atëherë:
- (a) Kjo diference do të shlyhet prej fondeve të Anëtarit të Bursës nëpërmjet Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit;
 - (b) Nëse diferenca nga paragrafi (a) me sipër nuk shlyhet atëherë Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit nuk do të jetë në kushtet e Mospërbushjes së Detyrimeve për këtë rast;
 - (c) Shlyerja e Transaksionit për shumën që vjen nga kjo diference nuk do të kryhet nga ALPEX-i për Anëtarin e Bursës (i cili është Palë shitëse në OTC-në përkatëse). ALPEX-i nuk është përgjegjës për shlyerjen e kësaj vlere Transaksioni;
 - (d) Palët përkatëse në këtë OTC bien dakort që me nënshkrimin e Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë të shlyejnë midis njeri-tjetrit të tilla shuma në diferencë dhe jo përmes ALPEX-it si Kundërpalë Qendrore.
- G.3.7.4 Në rastin kur Anëtari i Bursës (si Palë shitëse në OTC-në përkatëse) nuk do të dal fitues nga Ankandi përkatës i Ditës në Avancë përfshirë çdo Njësi Kohore Tregu në lidhje me Ditën e Livrimit, për sasinë e energjisë të parashikuar në OTC, atëherë ky Anëtar do të shlyejë çdo vlerë të dal si diference sipas parashikimeve të paragrafit G.3.7.3 nëpërmjet Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit të tij.
- G.3.7.5 Në vijim të paragrafëve G.3.7.3 dhe G.3.7.4 nëse kjo shumë në diference nuk do të shlyhet nga Anëtari i Bursës (si Palë shitëse në OTC-në përkatëse) atëherë Anëtarët (palët në OTC) do të jenë në Mospërbushje të Detyrimeve.
- G.3.7.6 ALPEX-i do të informoj Autoritetin Rregullator.

G.4 DITA E SHLYERJES

G.4.1 Dispozitat e Ditës së Shlyerjes

- G.4.1.1 Të gjitha Shlyerjet e Pagesave të Tregtimit dhe Tarifat Variabël të Tregtimit bazohen në Ditën e Klerimit (C).
- G.4.1.2 Terminologjia “C” nënkupton Ditën e Klerimit përkatës.
- G.4.1.3 Terminologjia “C+X” nënkupton X Ditë Pune pas Ditës së Klerimit.

G.4.2 Kalendari i Shlyerjes

- G.4.2.1 ALPEX-i përpara fillimit të çdo viti, duhet të publikojë Kalendarin e Shlyerjes për të gjitha ditët e vitit të ardhshëm.

G.4.3 Faturat, Vetëfaturimet

G.4.3.1 ALPEX-i do të prodhojë dhe lëshojë Fatura dhe Vetëfaturime për Pagesat e Tregtimit dhe Tarifat Variabël dhe Fikse si më poshtë:

- (a) Faturat dhe Vetëfaturimet për Pagesat Tregtimit dhe Tarifat Variabile do t'u lëshohen të gjithë Anëtarëve të Bursës në lidhje me Pozicionin e tyre të Transaksionit në Ditën e Tregtimit;
- (b) Faturat e Tarifave Fikse do t'u lëshohen të gjithë Anëtarëve të Bursës/Anëtarëve të Klerimit në lidhje me detyrimin në ditën përkatëse;

Me reference të Anëtarit të Klerimit përgjegjës për këto pagesa.

G.4.3.2 Pagesa do të bëhet në përputhje me si më poshtë:

- a) Çdo Faturë dhe Vetëfaturim duhet të përfshijë të paktën:
 - (i) Sasinë dhe çmimin e shitjes/blerjes së energjisë elektrike në tregjet e ALPEX-it për çdo Njësi Kohore Tregu të pasuar nga pagesat përkatëse; dhe
 - (ii) Shumën e të gjitha tarifave të aplikueshme për volumet e Transaksioneve, dhe
 - (iii) do të përfshijë çdo TVSH të aplikueshme;
- b) Çdo Anëtar Klerimi, i Anëtarit të Bursës së faturuar nga Pozicionet e Llogarisë së Klerimit, është debitor i ALPEX-it, dhe duhet të paguajë çdo Faturë që rrjedh nga Llogaria e Klerimit përkatës, të plotë, pa zbritje, duke paguar shumën e duhur në Llogarinë përkatëse të Shlyerjes për vlerën e plotë deri në Datën e Pagesës të Faturës. Dita e Shlyerjes do të jetë dita e punës që pason ditën e Klerimit të Transaksionit nga i cili u krijuan Pozicionet përkatëse: deri në orën 11:00, një (1) Ditë Pune pas datës së Faturës;
- c) ALPEX-i, në varësi të dispozitave të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, do t'i paguajë çdo Vetëfaturim Anëtarit të Klerimit që është kreditor i ALPEX-it duke paguar shumën që duhet nga Llogaria Bankare për Shlyerje në Llogarinë ose Llogaritë Bankare të përcaktuara nga kreditori i ALPEX-it, për vlerën e plotë deri në datën e Pagesës së Vetëfaturimit. Koha e Pagesës së Vetëfaturimit është ora 15:00, dy (2) Ditë Pune pas datës së Vetëfaturimit, përveç rasteve kur ka ndodhur një Borxh i Keq i Pasiguar.

G.4.3.3 Pagesat dhe arkëtimet e sipërpërmendura kryhen në përputhje me Procedurën e Shlyerjes në Para, në përputhje me dispozitat e Kapitullit G.

G.4.3.4 Pa paragjykuar dispozitat e paragrafit G.4.3.2, Anëtari i Klerimit do të bëjë një pagesë totale.

G.4.3.5 Nëse ndonjë Anëtar i Klerimit nuk arrin të paguajë plotësisht një Faturë në përputhje me paragrafin G.4.3.2 b), atëherë Anëtari i Klerimit ka një Mungesë dhe ALPEX-i do;

- (a) Të tërheqë shumën përkatëse në para nga Llogaria e Garancisë në Para të Anëtarit të Klerimit për të mbuluar këtë Mungesë.

- (b) Të bëjë menjëherë një Kërkesë për ekzekutimin e Letër Garancisë Bankare të Anëtarit të Klerimit për të mbuluar këtë Mungesë.
 - (c) Të mbledhë shumat e nevojshme të parave nga Pjesa Proporcionale përkatëse të Anëtarit të Klerimit në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve dhe/ose shumat përkatëse nga Pjesët e tjera Proporcionale kur është e aplikueshme në përputhje me dispozitat e seksionit G.5.4
 - (d) ALPEX-i do të identifikojë periudhën e shlyerjes me të cilën ka të bëjë Mungesa, që shkakton ekzekutim të Garancisë. Kamatvonesa do të mblidhen për çdo Mungesë dhe Borxh i Keq i Pasiguruar në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.
- G.4.3.6 Nëse ALPEX-i nuk paguan në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes (me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes) shumën e plotë që i detyrohet në përputhje me një Vetëfaturim për vlerën e plotë deri në Datën Pagesës së Vetëfaturimit, atëherë Kamatëvonesa do të mblidhet mbi shumën e papaguar në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.
- G.4.3.7 Pavarësisht kryerjes së ekzekutimit të Garancisë nga ALPEX-i, nëse Anëtari i Klerimit plotëson Mungesën qoftë me anë të fondeve të veta, Garancinë në Para ose të një kombinimi të elementëve të sipërpërmendura deri në orën 11:00 të Ditës Tjetër të Punës pas Datës kur Duhet të Paguhet Fatura (C+2), atëherë Shlyerja do të vazhdojë në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.
- G.4.3.8 Nëse Mungesa nuk paguhet plotësisht deri në orën 11:00 të Ditës Tjetër të Punës pas Datës së Skadimit të Faturës (C+2), atëherë Letra e Garancisë Bankare do të ekzekutohet, në varësi të dispozitave të kësaj Procedurë:
- (a) shumat e Mungesës e mbuluar nga LoG do të bëhet Borxh i Keq i Pasiguruar për qëllimet e kësaj Procedurë të Klerimit dhe Shlyerje;
 - (b) ALPEX-i, aty ku është e mundur, do të mbajë, do të zbresë ose do të kompensojë pagesën e çdo shumë Detyrimesh, në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, Anëtarit të Klerimit në Mospërbushje të Detyrimeve derisa shumat e Borxhit të Keq të Pasiguruar dhe çdo Kamatëvonesë e Aplikueshme do të jetë rikuperuar plotësisht;

G.5 PARAMETRAT PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT TË KREDITIT

G.5.1 Llogaritja e Margjinës

- G.5.1.1 ALPEX-i llogarit Margjinën e kërkuar për Llogari Klerimi, duke marrë në konsideratë detyrimet e pagesës me para të llogaritura në seksionin D.3.5, të cilat ende nuk janë shlyer.
- G.5.1.2 ALPEX-i do të ketë të drejtë të ndryshojë në çdo kohë metodat e llogaritjes së Margjinës me qëllim mbrojtjen e tregut. ALPEX-i gjithashtu do të ketë të drejtë të rrisë në çdo kohë kërkesat e Margjinës për të gjitha Llogaritë e Klerimit, si dhe për çdo Llogari Klerimi individuale, dhe të caktojë një afat kohor për sigurimin e kësaj Margjine shtesë, veçanërisht duke marrë parasysh çfarëdo lloj rreziku të afërt.

- G.5.1.3 Pas përfundimit të Pozicioneve të Llogarive të Klerimit nëse Margjina e kërkuar është më e madhe në vlerë, në lidhje me të gjitha Garancitë e Llogarisë së Klerimit përkatëse, Anëtari i Klerimit do të njoftohet nga ALPEX-i në mënyrë që të rregullojë këtë Mungesë brenda një afati kohor të përcaktuar në bazë të Vendimit Teknik përkatës të ALPEX-i. Ky detyrim nuk do të zbatohet nëse Anëtari i Klerimit ndërkohë i ka shlyer detyrimet e tij në para në lidhje me kërkesën e lartpërmendur përmes Procedurës së Shlyerjes me Para.
- G.5.1.4 Nëse Margjina e kërkuar nga ALPEX-i në lidhje me Llogarinë e Klerimit të një Anëtari Klerimi, e llogaritur prej tij në bazë të vlerësimeve që ai kryen pas finalizimit të pozicioneve, është në vlerë më të vogël se vlera e të gjithë Garancisë të Llogarisë përkatëse, meqenëse një garanci i tillë i është dhënë ALPEX-it në përputhje me dispozitat e këtij neni, teprica do të trajtohet si Garanci e Vlefshme. ALPEX-i do t'i caktojë një Kufi Krediti për Anëtarin e Klerimit për secilën prej Llogarive të tij të Klerimit deri në shumën e kësaj Garanci të Vlefshme.
- G.5.1.5 Në rastet kur fondet e disponueshme në formën e parave ose të letër garancisë dhënë ALPEX-it nga një Anëtar i Klerimit me qëllim të mbulimit të Margjinës së kërkuar për më shumë se një Llogari Klerimi, Anëtari i Klerimit duhet që, me përgjegjësinë e tij, t'i deklarojë ALPEX-it pjesën e këtyre fondeve të disponueshme që korrespondojnë me çdo Llogari Klerimi me qëllim plotësimin e kërkesës përkatëse. Në rast të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga një Anëtar i Klerimi në përputhje me dispozitat e këtij neni, kjo garanci do të përdoret nga ALPEX-i në përputhje me dispozitat e seksionit G.5.4.

G.5.2 Monitorimi i Kufirit të Kreditit

- G.5.2.1 Gjatë çdo Ditë Tregtimi, për një Anëtar Klerimi për çdo Llogari të tij Klerimi në atë Ditë Tregtimi kryhet një llogaritje në kohë reale e riskut (njihet si Risku Brenda së Njëjtës Ditë) si më poshtë:
- (a) në lidhje me Anëtarët Personal të Klerimit, për Llogarinë Personale të Klerimit, dhe që ka të bëjë me vendosjen e Urdhërporosive në ETSS nga ky Anëtar në rolin e Anëtarit të Bursës dhe kryerjen e Transaksioneve përkatëse që klerohen nëpërmjet Llogarisë Personale të Klerimit përkatës, dhe
 - (b) në lidhje me Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit, për Llogari të Klerimit të Anëtarit të Bursës, të mbajtur nga ky Anëtar Klerimi dhe ka të bëjë me vendosjen e Urdhërporosive në ETSS nga Anëtari i Bursës i kontraktuar nga ky Anëtar Klerimi dhe kryerjen e Transaksioneve përkatëse që klerohen përmes Llogarisë përkatëse të Klerimit të Anëtarit të Bursës.
- G.5.2.2 Me qëllim llogaritjen e Riskut Brenda së Njëjtës Ditë, merren parasysh hapat e mëposhtëm:
- (a) Transaksionet e përfunduara atë ditë në Tregjet e ALPEX-it, në lidhje me çdo Anëtar Burse dhe për Llogari përkatëse të Klerimit, dhe
 - (b) Urdhërporositë e paplotësuara për kryerjen e Transaksioneve për çdo Anëtar Burse në tregjet e ALPEX-it dhe për Llogarinë përkatëse të Klerimit.

Metodologjia për llogaritjen e Riskut Brenda së Njëjtës Ditë, si dhe të gjitha detajet e nevojshme teknike që lidhen me të, do të përcaktohen me Vendim Teknik të ALPEX-it.

- G.5.2.3 ALPEX-i vendos Kufirin e Kreditit dhe e regjistron atë në Llogarinë përkatëse të Klerimit për çdo Anëtar Klerimi në lidhje me secilën prej këtyre Llogarive bazuar në Garancinë e Vlefshme në përputhje me seksionin G.5.1.
- G.5.2.4 Kufiri i Kreditit për Llogari Klerimi dhe Anëtar të Bursës në tregjet e ALPEX-it, siç është përcaktuar në përputhje me paragrafin G.5.2.6, përbën Riskun maksimal Brenda të Njëjtës Ditë sipas paragrafit G.5.2.1 të cilin Anëtari i Klerimit mund të marrë përsipër gjatë Ditës përkatëse të Tregtimit, që lidhet me Llogarinë e Klerimit dhe Anëtarin përkatës të Bursës. Nëse nuk ka Garanci të Vlefshme për Llogari përkatëse të Klerimit dhe Anëtar të Bursës, Kufiri i Kreditit të Anëtarit të Klerimit do të jetë zero për atë Llogari Klerimi, duke ndaluar vendosjen e Urdhërporosisë në përputhje me kushtet e kësaj Procedure.
- G.5.2.5 Kufiri i Kreditit për Anëtar Klerimi, Llogari Klerimi dhe Anëtar Burse, regjistrohet në ETSS dhe ky Kufi përcaktohet në paragrafin G.5.2.6 dhe monitorohet vazhdimisht nga ALPEX-i gjatë gjithë Ditës së Tregtimit.
- G.5.2.6 Çdo Anëtar i Përgjithshëm Klerimi mund të ndajë një Kufi Krediti tek një Llogari Klerimi me kusht që të ketë Garanci të Vlefshme siç llogaritet në paragrafin G.5.1.4 dhe në përputhje me kushtet specifike të dispozitave të mëposhtme:
- (a) Ndarja bëhet pas një deklarate përkatëse të Anëtarit të Përgjithshëm Klerimi të dorëzuar në ALPEX nëpërmjet EMCS-së përpara Kohës së Hapjes së Portës të çdo Tregu ose në çdo moment deri në Kohën e Mbylljes së Portës së çdo Tregu.
 - (b) Përqindja e ndarë ose shuma për Anëtar Burse regjistrohet në Llogarinë e Klerimit të Anëtarit të Bursës.
 - (c) Nëse një Anëtar i Bursës nuk ka Kufi Krediti, nuk do të lejohet të vendosë Urdhërporositë në ETSS, në përputhje edhe me dispozitat specifike të Procedurës së Tregtimit.
 - (d) Një Anëtar i Përgjithshëm Klerimi gjatë Ditës së Tregtimit mund ti ndryshojë shumat e ndara të Kufirit të Kreditit. Një ndryshim i tillë do të bëhet pas deklaratës si në shembullin (a) më sipër. Në rast të një deklarate që shpall ulje të Kufirit të Kreditit që ndahet për një Anëtar të Bursës, deklarata do të pranohet nga ALPEX-i me kusht që Kufiri i ri i reduktuar i Kreditit të Anëtarit të Bursës të jetë më i madh së Kufiri i Kreditit që ai ka përdorur tashmë.
- G.5.2.7 Gjatë Ditës së Tregtimit, Risku Brenda të Njëjtës Ditë i llogaritur tashmë në bazë të Urdhërporosive të paplotësuara të futura në ETSS nga Anëtari i Bursës dhe Transaksioneve që ai ka kryer gjatë së njëjtës Ditë Tregtimi, zbritet në mënyrë progresive nga ALPEX-i nga Kufiri i Kreditit të çdo Llogarie Klerimi, dhe Kufiri i Kreditit shtohet përkatësisht në bazë të Garanci të Vlefshme të Llogarisë së Klerimit.

G.5.3 **Ekzekutimi i Garancisë dhe Hapat për përdorimin e Fondit në Mospërmbushje të Detyrimeve**

G.5.3.1 ALPEX-i do të mbulojë humbjet për Llogari Klerimi në bazë të hapave të procesit të Mospërmbushjes së Detyrimeve si më poshtë në rend kronologjik (default waterfall):

- (a) Detyrimet financiare që lindin në lidhje me Llogarinë e Klerimit në Mospërmbushje të Detyrimeve mbulohen nga Garancia që i është vënë në dispozicion ALPEX-it për këtë Llogari Klerimi në përputhje me seksionin G.5.4.
- (b) Nëse Garancia e shembullit në paragrafin (a) është i pamjaftueshëm, ALPEX-i, me qëllim mbulimin e pjesës së mbetur të detyrimeve financiare, do të përdorë Pjesën Proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve që i përket Anëtarit të Klerimit që është në Mospërmbushje të Detyrimeve.
- (c) Nëse kontributi i dhënë në shembullin e paragrafit (b) është i pamjaftueshëm, ALPEX-i, me qëllim mbulimin e pjesës së mbetur të detyrimeve financiare, do të përdorë Pjesën Proporcionale të Anëtarëve të tjerë të Klerimit të mbajtura në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve në mënyrë proporcionale (pro rata basis), sipas përqindjes së pjesëmarrjes së tyre në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve.
- (d) Nëse Pjesa Proporcionale e Anëtarëve të tjerë të Klerimit në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve të dhënë në shembullin e paragrafit (c) nuk janë të mjaftueshme, pjesa e mbetur e detyrimeve financiare do të mbulohet nga Burimet Personale të Dedikuara të ALPEX-it.

G.5.3.2 Procesi i mbulimit të detyrimeve financiare të paragrafit të mësipërm nuk çënon të drejtën e ALPEX-it për të kërkuar plotësimin e pretendimeve të tij kundrejt Anëtarit të Klerimit që është në kushtet e Mospërmbushjes së Detyrimeve, veçanërisht kur ALPEX përdor fondet në përputhje me nenet G.5.3.1.c) dhe G.5.3.1.d). Kamatëvonesa për Mospërmbushjen e Detyrimeve do të ngarkohet në shumën që i detyrohet ALPEX-it nga Anëtari i Klerimit që është në kushtet e Mospërmbushjes së Detyrimeve, i llogaritur në ditën pas Datës së Shlyerjes në Para të shumës përkatëse, siç njoftohet nga ALPEX-i.

G.5.3.3 Shuma minimale e Burimeve Personale të Dedikuara është dy për qind (2%) e kapitalit aksionar të ALPEX-it. ALPEX-i rirregullon Burimet e Personale të Dedikuara, sipas përqindjes së sipërpërmendur, sa herë që ka një ndryshim në vlerën e kapitalit të tij aksionar.

G.5.3.4 Në rastin e Mospërmbushjes së Detyrimeve që rezulton në përdorimin e Pjesës Proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve dhe të Burimeve Personale të Dedikuara të ALPEX-it, pjesërisht ose tërësisht, në përputhje përkatësisht me paragrafët, G.5.3.1, ALPEX-i, me qëllim mbulimin e pjesës së mbetur të humbjes dhe për të vazhduar funksionimin e tij si Kundërpalë Qendrore, pasi të trajtohet Mospërmbushja e Detyrimeve të Anëtarit të Klerimit, do të marrë masat e mëposhtme, duke vendosur një plan kohor përkatës për zbatimin e tyre:

- (a) Aktivizimin e rimbushjes së burimeve të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve në përputhje me seksionin C.1.1;

- (b) Në të njëjtën kohë me aktivizimin e masave si në shembullin në paragrafin (a), do të plotësojë Burimet e Personale të Dedikuara për të përmbushur kërkesat e paragrafit G.5.3.3, dhe
 - (c) Do të specifikojë masat e nevojshme të mbulimit të riskut, sipas rastit, për nevojat operacionale të Klerimit deri në rimbushjen e burimeve të shembujve në paragrafin (a) dhe (b). Në kuadrin e fjalisë së mësipërme, masat e mbulimit të rrezikut mund të përfshijnë, si tregues, rritjen e kërkesave të Margjinës, rritjen e përqindjeve të aktiveve likuide të pranuar si garanci, si dhe masa të tjera që mund të merren duke përjashtuar këtë Procedurë me qëllim zbutjen e riskut.
- G.5.3.5 ALPEX-i njofton menjëherë Autoritetet Rregullatore për Mospërmbushjen e Detyrimeve, marrjen e masave dhe afatin kohor për zbatimin e masave të parashikuara në paragrafin G.5.3.4.
- G.5.3.6 Deri në momentin që zbatohen masat e paragrafit G.5.3.4 Klerimi mund të vazhdojë normalisht, me kusht që Anëtarët e Klerimit pjesëmarrës të përmbushin detyrimet e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj Procedure.
- G.5.4 Ekzekutimi i Garancisë**
- G.5.4.1 Për të përmbushur pretendimet e tij në lidhje me mbulimin e një detyrimi financiar të shkaktuar nga Mospërmbushja e Detyrimeve, ALPEX-i do të përdorë ose do të vazhdojë me Ekzekutimin e Garancisë të dhënë nga Anëtari i Klerimit që është në kushtet e Mospërmbushjes së Detyrimeve, si më poshtë:
- (a) do të mbledhë shumat që i detyrohen nga Llogaria bankare përkatëse e Garancisë në Para,
 - (b) do të vazhdojë me ekzekutimin deri në vlerën maksimale të Letër Garancisë Bankare të depozituar si garanci nga Anëtari i Klerimit që është në kushtet e Mospërmbushjes së Detyrimeve.
- G.5.5 Tarifa Fikse e Aderimit dhe Tarifa Fikse Vjetore**
- G.5.5.1 ALPEX-i do të publikojë Tarifën Fikse të Aderimit të shprehur në Euro, e cila do të paguhet në Euro nga Anëtarët e Klerimit në Kosovë dhe në Lekë nga Anëtarët e Klerimit në Shqipëri e konvertuar sipas Kursit të Këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e faturimit.
- G.5.5.2 Anëtarët e Klerimit duhet ti paguajnë ALPEX-it, të plotë dhe në para, Tarifën Fikse Vjetore e cila do të paguhet në Euro nga Anëtarët e Klerimit në Kosovë dhe në Lekë nga Anëtarët e Klerimit në Shqipëri e konvertuar sipas Kursit të Këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e faturimit.
- G.5.5.3 Tarifa Fikse Vjetore dhe Tarifa Fikse e Aderimit paguhen në një shumë totale pas marrjes së kapacitetit përkatës dhe nuk rimbursohen nëse ky kapacitet humbet për çfarëdo lloj arsyeje, përfshirë dhe rastin e bashkimit/shkrirjes.

G.5.6 **Tarifat e tjera**

G.5.6.1 ALPEX-i do të publikojë detajet e Tarifave të tjera fikse, pas miratimit përkatës të tyre.

H. DISPOZITA KALIMTARE

H.1 TË PËRGJITHSHME

H.1.1 Hyrje

- H.1.1.1 Çdo referencë që i bëhet Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për çdo gjë që kërkohet të bëhet përpara fillimit të një Viti, në lidhje vetëm me Vitin e Parë të Tregtimit, do të konsiderohet si para Datës së Fillimit të Tregut.
- H.1.1.2 Çdo referencë që i bëhet Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për një periudhë para fillimit të një viti, në lidhje vetëm me Vitin e Parë të Tregtimit, do të konsiderohet se i referohet periudhës përkatëse përpara Datës së Fillimit të Tregut, ose një periudhe tjetër që mund të përcaktohet nga Autoriteti Rregullator.
- H.1.1.3 Çdo referencë që i bëhet Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes të një Viti, në lidhje me Vitin e Parë të Tregtimit, do të zbatohet vetëm për atë pjesë të vitit që përfshihet në Vitin e Parë të Tregtimit.
- H.1.1.4 Për të shmangur dyshimet, procesi i Klerimit nuk do të fillojë përpara Datës së Fillimit të Tregut.

H.1.2 Kufiri i Kreditit

- H.1.2.1 Çdo Anëtar i Bursës/Anëtar i Klerimit do t'i japë ALPEX-it një vlerësim të kërkesës së parashikuar për Periudhën fillestare të Ekspozimit, jo më vonë se 2 javë përpara Datës së Fillimit të Tregut.

H.1.3 Ndryshimet

- H.1.3.1 Ndryshimet do të përpunohen me synim që të realizohet arritje sa më e madhe nga Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes dhe Objektivave të Procedurës të Klerimit dhe Shlyerjes.
- H.1.3.2 Këto ndryshime do të konsultohen me Palët, përpara se të depozitohen për miratim pranë Autoriteteve Rregullatore.